

Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë



GJEOPOLITIKA

Revistë shkencore

Nr. 4

ISSN

Prishtinë 2025

Drejtor & kryeredaktor

Dr. Sadri Ramabaja

Redaksia

Dr. Enika Abazi

Dr. Selim Ibraimi

Dr. Dritan Hoti

Dr. Gurakuq Kuçi

Këshilli botues

Dr. Odise Çaçi, universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Dr. Martin Berishaj, Universiteti i Lubjanës, ambasador

Dr. Agim Krasniqi, Sekretar i ISHGJ-së

Dr. Skënder Demaliaj, Universiteti Mesdhetar, Tiranë

Dr. Venera Llunji, Universiteti AAB, Prishtinë

Dr. Gjon Berisha, studiues, Instituti i Historisë, Prishtinë

Mr. sc. Stephan Lipsius, politolog, Kasel [D]

Emin Azemi, UEJ, Tetovë

Redaktore gjuhësore: Sevi Agolli

Revista “Gjeopolitika” botohet një herë në vit. Artikujt e paraqitur duhet të përmbajnë punime origjinale dhe të pabotuara më parë. Ata duhet të jenë në gjuhën shqipe ose angleze, të shtypura në kompjuter. Numri i faqeve është i pakufizuar dhe shkrimi të jetë sipas standardeve kompjuterike: “Times New Roman” me madhësi 12 dhe me hapësirë 1,5 ndërmjet rreshtave. Materialet që dërgohen duhet të shoqërohen me një përmbledhje në gjuhën shqipe dhe/ose angleze dhe me referencat përkatëse, të cilat duhet të përmbajnë emrin e autorit, titullin e plotë të burimit (të librit ose artikullit), vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqen referuese. E drejta e autorësisë për artikujt e botuar i takon Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë, por autori është i lirë t’i përdorë materialet e tij edhe në botime të tjera, me kusht që referimet t’i bëhen revistës “Gjeopolitika”, si vendi i parë i botimit.

**INSTITUTI SHQIPTAR PËR GJEOPOLITIKË
ALBANIAN INSTITUTE FOR GEOPOLITICS**

**Nr. 4
2025**

ISSN: 3005-2777

Shtypur në shtypshkronjën: “Lena Grafik”

PËRMBAJTJA

Editoriali	13
------------------	----

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA

1.1. Dr. Sadri RAMABAJA	21
Nacionalizmi modern shqiptar dhe Federata Shqiptare	21

1.2 Dr. Hysamedin FERAJ dhe dr. Elvis HOXHA	38
Çfarë mësojmë nga konflikti me Serbinë në Kosovë lidhur me sovranitetin tonë	38
1.3 Profesor Abdulla MEHMETI.....	51
Krahina e Sanxhakut rikthehet në identitetin e natyrshëm.....	51

1.4 Kristina Nano [kandidate për doktoraturë, JMU, SHBA]	54
Shqipërisë dhe shqiptarëve u duhen liderë të bashkimit, jo të dasive!.....	54

1.5 Dr. Mentor BEQA	59
Shqipëria, si mund të jetë!?.....	59

1.6 Gjeneral Piro AHMETAJ	65
Shqipëri-Kosovë, dy vende sovranë – një Komb i vetëm	65

1.7 Dr. Jorgji KOTE	71
Gjeopolitika kërkon edhe mirëqeverisje	71

1.8 Arbër ZAIMI, politolog	76
Shenjë e kombit dhe e qytetërimit.....	76

1.9 Dr. Agim KRASNIQI.....	83
Bashkimi kombëtar: e drejta historike përballë sfidave gjeopolitike.....	83

1. 10 Arian GALDINI	101
Neoshqiptarizmi si thirrje e kohës	101

II. GJEOPOLITIKA RAJONALE

2.1. Dr. Sadri RAMABAJA	105
Aleanca ushtarake shqiptaro-kroate: produkt i lëvizjeve të reja gjeopolitike ..	105

2.2 Dr. Gurakuq KUÇI.....	112
Ballkani Perëndimor në udhëkryq: një front i vjetër lufte në kompozicionet e reja gjeopolitike	112

2.3 Dr. Skënder DEMALIAJ	128
Teza serbe për “Shqipërinë e Madhe” ka si qëllim krijimin e “Botës Serbe” dhe moslejimin e bashkimit të trojeve shqiptare etnike.....	128
2.4 Dr. Lavdim HAMITI.....	151
Roli korridoreve rrugore në përcaktimin e gjeopolitikës në rajonin e Ballkanit Perëndimor	151
2.5 Bardhyl MAHMUTI, politolog.....	161
Luftërat Ballkanike dhe gjenocidi ndaj shqiptarëve.....	161
2. 6 Gzim RUSHITI, PhD.....	171
Diplomacia e Turqisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor	171
2.7 Xhelal NEZIRI.....	189
Bota po ndryshon - shqiptarët gjithashtu	189
III. BOTA	
3.1 Dr. Enver BYTYÇI	195
Pozita gjeopolitike e Shqipërisë dhe e Kosovës në zhvillimet e sotme të vendosjes së rendit të ri botëror	195
3.2 Dr. Samet DALIPI [Profesor, kolegji “Universum”, Kosovë]	201
Revolucioni “Trump”-ian i politikës së jashtme të SHBA-së dhe ndikimi i saj në Ukrainë e Kosovë.....	201
3.3 Zoran METER [<i>Gjeopolitika News</i> , Zagreb]	216
Kryqi i Trump-it mbi globalizimin liberal! Një botë e re lindi	216
IV. GJEOEKONOMI	
4.1 Akademik Anastas ANGJELI.....	229
A mund të flitet për trampizëm në fushën ekonomike?	229
4.2 Dr. Drita SHAQIRI	237
Ndikimi i luftës hibride në sentimentet ekonomike - investitorët në Kosovë..	237
V. HISTORI	
5.1 Akademik Pëllumb XHUFI.....	244
Shqipëria e nëntorit 1912	244
5.2 Nga dr. Mark PALNIKAJ	253
Kultprotektorati për katolikët e Shqipërisë	253

5.3 Dr. Qazim NAMANI	260
Gjurmë të mbishkrimeve në gurë në territorin e Dardanisë Qendrore	260

VI. INTERVISTA

6.1 Dr. Martin BERISHAJ	271
Paqëndrueshmëria në Ballkan mund të ketë pasoja të rënda për sigurinë dhe prosperitetin e rajonit dhe më gjerë.....	271
6.2 Dr. Yascha MOUNK	285
“Për Uashingtonin, bota ndahet në sfera influence. Ata që e ndajnë atë janë SHBA-ja, Rusia dhe Kina”	285
6.3 Albert Vlash NIKOLLA.....	288
Shqipja me vjetërsinë e saj - një çelës magjik për gjuhët indoeuropiane!	288

VII. KOMENTI

7.1 Emin AZEMI	299
Datat serbe të ripushtimit të Maqedonisë së Veriut inspirojnë kryetarin e Kumanovës, Dimitrievskin	299

VIII. RECENSIONE

8.1 Dr. Valbona Emini Pllaha.....	301
Eskadronët e vdekjes, kronikë e komunikimeve dezinformuese, shtyllë e së vërtetës në procesin e drejtësisë tranzicionale	301
8.2. Peter TASE.....	327
Shaban Murati: Kroacia është aleati kryesor i Shqipërisë në BE.....	327
8.3 Dr. Skënder Demaliaj dhe dr. Dritan Hoti.....	331
Vendi, roli, detyrat dhe misioni i shqiptarëve në gjeopolitikën postmoderne ..	331

IX: ANALYSIS IN ENGLISH

9.1 Dr. Sadri RAMABAJA	341
Between Ideological Nostalgia and Utopia: History Proves That Paradise Lost Was Never Like That	341
9.2 Dr. Gurakuq KUÇI.....	363
The Struggle for Truth: Unveiling Efforts to Discredit the History and Stability of Kosova.....	363

EDITORIALI

Në këtë numër të revistës “Gjeopolitika” jemi përqendruar në trajtimin e fenomeneve aktuale në fushën e mendimit gjeopolitik që po imponon epoka në lindje e Rendit të Ri Botëror, e që kanë të bëjnë me rreshtimin tonë si Komb.

I rikthehem kështu krejt natyrshëm fenomenit të nacionalizmit në procesin e rikthimit të gjeopolitikës në politikën e jashtme të shtet-kombeve, dhe me këtë, edhe rikthimit të vetvetja.

Tashmë nuk ka dilema: ndërkohë po jetojmë epokën e rikthimit të imperatorive. Fuqitë e Mëdha dhe ato rajonale kërkojnë të rimarrin apo të ripërcaktojnë sferat e tyre të ndikimit, ashtu siç ndodhte në epokat e perandorive klasike. Rikthimi i rivaliteteve të mëdha, përplasjet për burime, territore dhe ndikim kulturor e ekonomik janë bërë më të dukshme, veçanërisht pas ndryshimeve të mëdha gjeopolitike të dekadave të fundit.

Me rikthimin e gjeopolitikës po rikthehen gradualisht edhe imperatoritë. Ky rikthim i imperatorive në një formë moderne nuk do të thotë domosdoshmërisht se jemi në prag të restaurimit të perandorive klasike me territore të pushtuara dhe të administruara drejtpërdrejt, por më shumë kemi të bëjmë me një zgjerim të ndikimit ekonomik, politik, ushtarak dhe kulturor. Në epokën moderne nuk ka nevojë për pushtime ushtarake për të ndërtuar një “perandori”. Në vend të pushtimit fizik përdoren ekonomia, teknologjia, ndikimi kulturor dhe diplomacia e zgjuar për të krijuar një sferë të madhe kontrolli.

Superfuqitë me prirje imperialiste moderne, si SHBA-ja, Kina dhe Rusia, tashmë kanë bërë hapat e parë që imponon ndryshimi i balancës gjeopolitike. SHBA-ja dhe Kina janë dy superfuqitë me më shumë potencial për të ndërtuar “perandoritë” e tyre, ndërsa Rusia, Turqia, Irani dhe India përpiqen të krijojnë zonat e tyre të ndikimit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) vazhdojnë të mbajnë një rrjet të gjerë bazash ushtarake në të gjithë botën. Ato kontrollojnë institucionet financiare globale (si FMN dhe Banka Botërore). Ndërkaq, përdorimi i “soft power”-it dhe “dollar diplomacy”-së i mundësojnë

pengimin e BRICS-it për të promovuar monedhën e vet, ndërsa dominimi i tyre kulturor dhe teknologjik përmes korporatave, si *Google*, *Apple*, *Microsoft* dhe *Hollywood* është evident.

Kina, në anën tjetër, ka projektuar të ngrihen si fuqi përmes iniciativës “Rruga e Mëndafshit” (BRI), duke e lidhur ekonomikisht dhe politikisht botën me veten. Krahas kësaj, ajo ka krijuar bazat e para ushtarake jashtë kufijve (p.sh., në Xhibuti). Ndërkaq, ajo shfrytëzon kapitalin ekonomik dhe investimet për të rritur ndikimin në Afrikë, në Amerikë Latine dhe në Europë. Por Kina ka gjithashtu edhe ambicie të qarta për dominim teknologjik (AI, 5G etj.).

Rusia po përdor fuqinë ushtarake për të rikthyer ndikimin në hapësirën postsovjetike (Ukrainë, Gjeorgji, Bjellorusi, Azinë Qendrore). Thellon kursin diplomatik për mbajtjen e aleancave me regjime autokratike për të kundërshtuar Perëndimin [rasti në Serbi, Hungari, Republika Serbe e Bosnjës...] Ka vite që ajo ka krijuar monopol në fushën e energjisë dhe mbështet eksportin e saj si instrument politik e shantazhi. Ndërkaq, Rusia vazhdon ta intensifikojë përdorimin e mercenarëve dhe dezinformimin për të ndikuar te vendet e tjera, jo vetëm në Ballkan.

Në këtë garë nuk kanë mbetur mbrapa as fuqitë rajonale me prirje imperialiste.

Turqia po ringjall trashëgiminë osmane përmes diplomacisë kulturore dhe fetare në Ballkan, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Ka ndërhyrë ushtarakisht në Siri, Libi, Azerbajxhan dhe është bërë lojtar kyç në Mesdheun Lindor. Industria e saj ushtarake po rritet ndjeshëm, duke e bërë më të pavarur strategjikisht.

Irani ka ndërtuar një “perandori” me anë të milicive dhe grupeve të armatosura në Irak, Siri, Liban, Jemen (përmes *Houthi*). Përdor kombinimin e fesë dhe të ideologjisë për të zgjeruar ndikimin në botën shiite. Ka ambicie të bëhet një fuqi bërthamore, duke sfiduar Perëndimin dhe rivalët arabë e, para së gjithash, Izraelin.

India po rrit ndikimin në Oqeanin Indian dhe po përpiqet të rivalizojë Kinën në Azinë Juglindore dhe Afrikë. Ka një forcë të madhe ushtarake dhe një ekonomi që po pëson rritje të shpejtë. Përpiqet të krijojë një zonë ndikimi përmes lidhjeve kulturore dhe teknologjike.

* * *

Triarkia plus dhe fati i Europës

Europa po detyrohet ndërkohë të bëhet gati ta mbrojë Ukrainën qoftë edhe pa Amerikën. Ajo është e bindur se vetëm kështu bën më të mirën të mundshme në këto qaste historike.

Nëse këtë nuk arrijnë dot ta bëjnë të gjithë tok, si BE e si Europë, atëherë atë do ta bëjë një aleancë shtetesh të gatshme për ta ndaluar marshutën e Putinit. Takimi urgjent i Parisit e dëshmoi pikërisht këtë strategji veprimi të pritshme dhe të domosdoshme. Kjo lagje e shteteve europiane e kanë kuptuar qartë se duhet mbrojtur Ukraina, qoftë edhe pa Amerikën e Donald Trump-it.

Në vitin 1841, filozofi hebraiko-gjerman, Moses Hess, kishte publikuar librin “*Triarkia europiane*”. Teza bazë e Hess-it kishte të bënte me atë, se fati i Europës është përcaktuar nga tri shtete: Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania. Moses Hess, në teorinë e tij të triarkisë, i përqendronte analizat e tij mbi tri fuqitë kryesore europiane të shekullit XIX: *Britaninë e Madhe, Gjermaninë dhe Francën*. Ai argumentonte se këto tri fuqi përfaqësonin tri aspekte të ndryshme të zhvillimit politik dhe shoqëror:

1. **Franca** si simbol i revolucionit dhe i barazisë sociale.
2. **Gjermania** si përfaqësuese e filozofisë dhe e zhvillimit intelektual.
3. **Britania e Madhe** si simbol i kapitalizmit dhe i industrializimit.

Teorisë së triarkisë ndërkohë, sidomos gjatë rrjedhës së luftës në Ukrainë, i është bashkëngjitur Polonia, duke krijuar kështu një katërkëndësh më të qëndrueshëm për rrethanat e reja gjeopolitike. Lufta në Ukrainë e ka shpërfaqur rolin e Polonisë në një konteksti modern,

duke kontribuar krejt natyrshëm në formësimin e tezës mbi **Triarkinë Plus**.

Polonia për shumëçka mund të cilësohet si një përfaqësuese tipike e nacionalizmit dhe vetëvendosjes, po aq sa edhe si *qendër e sigurisë dhe balancës gjeopolitike në Europën Qendrore*, duke qenë njëkohësisht edhe si një ndërmjetëse mes Lindjes dhe Perëndimit.

Pra, një **Triarki Plus** do të mund të funksiononte në këtë mënyrë:

- **Britania e Madhe** – përfaqësuese e traditës anglosaksone dhe e kapitalizmit të tregut të lirë.
- **Franca** – si lider i integritit evropian dhe e frymës republikane.
- **Gjermania** – si lokomotivë ekonomike dhe model i stabilitetit social-demokrat.
- **Polonia** – si qendra e një Europe të re, e cila po përcakton vetë rolin e saj strategjik në Lindje.

Rolin e Polonisë në rrafshin e strategjisë në Lindje, Shqipëria dhe Kosova do të mund ta kishin në Europën Juglindore.

Në këtë terren të zhvillimeve gjeopolitike, rishikimi i pozicionit të së ardhmes së dy republikave tona, Shqipërisë politike dhe Republikës së Kosovës, por edhe kombit si tërësi, është crucial.

Brenda këtij viti do të duhej të ndërmerreshin tri veprime konkrete:

1. Nënshkrimi i **Marrëveshjes së Sigurisë mes Shqipërisë dhe Kosovës**;
2. Hartimi dhe miratimi i **Strategjisë Kombëtare**;
3. Organizimi i **referendumit** në të dyja republikat tona me pyetjen bosht: *A jeni për bashkim në trajtën e një Federate Shqiptare*.

Nënshkrimi i marrëveshjes në fushën e sigurisë është urgjencë, respektivisht kusht i domosdoshëm – *sine qua non*.

Një marrëveshje e sigurisë mes Shqipërisë dhe Kosovës, e modeluar p.sh., sipas asaj mes Francës dhe Greqisë, do të përfshinte një angazhim të ndërsjellët për mbrojtje dhe bashkëpunim strategjik. Marrëveshja mes Francës dhe Greqisë është një traktat mbrojtjeje reciproke, ku të dyja

vendet zotohen ta ndihmojnë njëri-tjetrin në rast të një agresioni të jashtëm. Në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës, një marrëveshje e ngjashme mund të përfshinte elementet e mëposhtme:

1. Klauzola e mbrojtjes së ndërsjellët

- Një angazhim i qartë: nëse njëra palë përballet me kërcënime apo agresion nga një palë e tretë, pala tjetër do të ofrojë mbështetje ushtarake dhe politike.
- Kjo mund të përfshijë ndihmë me trupa, pajisje ushtarake ose mbështetje logjistike.

2. Bashkëpunim në industrinë e mbrojtjes

- Marrëveshje për bashkëprodhimin e pajisjeve ushtarake dhe zhvillimin e industrisë së mbrojtjes në të dyja republikat.
- Shkëmbime teknologjike dhe trajnime për modernizimin e forcave të armatosura të Kosovës dhe Shqipërisë.

3. Manovra dhe stërvitje të përbashkëta

- Organizimi i stërvitjeve të përbashkëta të rregullta midis ushtrisë shqiptare dhe asaj të Kosovës.
- Harmonizimi i doktrinave ushtarake për rritjen e ndërveprimit operacional.

4. Bashkëpunim në inteligjencë dhe siguri kibernetike

- Krijimi i një qendre të përbashkët për shkëmbimin e informacionit mbi kërcënimet e sigurisë kombëtare.
- Bashkëpunim në mbrojtjen kibernetike dhe luftën kundër dezinformimit.

5. Ankorim në struktura ndërkombëtare

- Përfshirja e Kosovës në programet e sigurisë të NATO-s përmes Shqipërisë.
- Koordinim në politikën e jashtme për të forcuar pozicionin strategjik të dy shteteve në rajon.

Një marrëveshje e tillë do të forconte sigurinë kombëtare dhe stabilitetin rajonal, duke e bërë më të vështirë për aktorët e jashtëm të kërcënonin sovranitetin dhe sigurinë e Shqipërisë dhe Kosovës.

* * *

Thelbi i demokracisë parlamentare dhe forma e aplikuar e saj në demokracitë liberale të etabluara perëndimore aktualisht është nën presion si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë.

E parë në dritën e zhvillimeve në rrafshin global, para së gjithash pas rikthimit të Donald Trump-it në Shtëpinë e Bardhë, marrëdhëniet transatlantike po hyjnë në fazën e re historike që pritet të përballët me tronditje të thellë tektonike.

BE-ja aktualisht përballët me kërcënimin që i vje nga tri drejtime njëkohësisht:

- i pari nga Rusia dhe projekti i saj për ekspansioni;
- i dyti nga Amerika e Donald Trump-it;¹¹
- i treti nga neofashizmi, që po rikthehet në trajtën e nacionalizmit agresiv brenda vetë shteteve më të mëdha europiane. Krahas kësaj trandjeje që po imponon agsholi i Rendit të Ri Botëror, BE-në dhe të ardhmen e demokracisë e sjell përballë konkurrencës së pazakontë me sistemet autoritaro-teknokratike dhe autoritaro-autokratike.

Ndërkaq, në ambientet e shtet-kombit dhe institucionet e BE-së, demokracia po ballafaqohet me ndeshtrashat e uraganit që po sjell rikthimi i neofashizmit në trajtën e populizmit politik, por veçanërisht humbja e ndjeshme dhe në rritje e rëndësisë së angazhimit eksplicit politik nga elita intelektuale perëndimore e në veçanti e partive socialdemokrate, të cilat kanë humbur rolin që kishin si ekuivalenti funksional që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, ekzistenca e shtet-kombit dhe e vetë demokracisë është në ndërvanje të plotë nga prania e kësaj të fundit në jetën aktive të qytetarëve dhe përkushtimi për ruajtjen dhe selitjen e shtet-kombit dhe demokracisë njëkohësisht. Shtet-kombi rezulton të jetë shtrati ku mund të selitet më tutje demokracia, por me parakushtin që imponon rirreshtimi i ri, respektivisht Rendi i Ri Botëror në krijim dhe gjeopolitika postmoderne. Në këtë kontekst, e ardhmja e demokracisë dhe shtet-kombit merr kuptim të ri, por është e qartë se në këtë etapë historike si demokracia, ashtu edhe shtet-kombi pritet të pësojnë ndryshime të thella. Në këto rrethana,

krijimi i Federatës Shqiptare duhet të jetë produkt i një akti juridiko-politik, respektivisht i një referendumi të lirë, i organizuar në të dyja republikat tona dhe me praninë e mekanizmave përcjellës të OSBE-së dhe BE-së. Ky hap do të jetë krucial në fillet e procesit të krijimit të Federatës Shqiptare dhe pozicionimit të kombit brenda konceptit të strategjisë autonome europiane, si përgjigje adekuate ndaj ndryshimeve të reja gjeopolitike që po ndodhin.

Prishtinë, qershor 2025

Dr. Sadri RAMABAJA

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA

1.1. DR. SADRI RAMABAJA

Nacionalizmi modern shqiptar dhe Federata Shqiptare

“Për me kenë Shqipnija shtet përnjimend i pamvarshëm e me u mbajtë në kambë si shtet e me përparue, nuk asht mjaft që shqiptari të jetë shqiptar vetëm me fis, me trup, por duhet që të jetë shqiptar me shpirt: asi shqiptari, që të përbajë kombin e jo vetëm popullin [...] për me mujtë me i vjeftë shtetit - Atdheut, ma parë me dalë duhet me dijtë se çka asht Atdheu e mandej këtë Atdhe me e dashtë me gjithë zemër?”

FISHTA

“Shekulli XX do të jetë shekulli i nacionalizmit!” - kishte paralajmëruar Niçja dhe kjo ide mbeti forca mbizotëruese përgjatë gjithë shekullit. Nacionalizmi si ideologji, që në fillimet e tij, qe shndërruar në një sistem kompleks mendimi. Ndërkohë, ai është rikthyer me gjithë fuqinë e tij dhe po mëton ta dominojë edhe shekullin XXI.

Nacionalizmi si ideologji ishte një forcë thelbësore në formimin e shtetit modern evropian, sidomos nga fundi i shekullit XVIII dhe përgjatë shekullit XIX. Ai u shfrytëzua në disa mënyra për të ndërtuar dhe legjitimuar shtetet e reja dhe për të forcuar ato ekzistuese.

Në fillimet e tij, nacionalizmi ishte një forcë e fuqishme për ndryshim, duke ndihmuar në krijimin e shteteve të reja dhe në forcimin e atyre ekzistuese. Megjithatë, ai gjithashtu mbolli farat e konflikteve dhe luftërave që do të shpërthenin më vonë, sidomos në shekullin XX, duke nxjerrë kokë sërish në dekadën e dytë të shekullit XXI, me theks nacionalizmin serb dhe atë rus.

1. Nacionalizmi si mjet për çlirimin dhe bashkimin kombëtar

Në disa raste, nacionalizmi u përdor për të mobilizuar popujt në luftëra për pavarësi kundër perandorive të huaja ose sunduesve të huaj. Disa shembuj të rëndësishëm që ka nënvizuar historia moderne janë:

- **Revolucioni Francez (1789):** Përhapja e idesë se sovraniteti i takon kombit, jo monarkut, nxiti ndjenja kombëtare në të gjithë Europën.

- **Pavarësia e Greqisë (1821-1830):** Lufta kundër Perandorisë Osmane u mbështet nga një ndjenjë e fortë kombëtare greke.

- **Luftërat e Italisë dhe Gjermanisë për bashkim (1860-1871):** Italia dhe Gjermania, të ndara në principata dhe shtete të vogla, përdorën nacionalizmin për të krijuar shtete të bashkuara.

- **Rilindja Kombëtare Shqiptare [1844-1878]:** Rilindësit tanë, ideologët e asaj lëvizjeje politike, përdorën kulturën, gjuhën, historinë dhe etnopsikologjinë e etnisë si mjet unifikimi.

Njëri prej tyre, Luigj Gurakuqi, iu përmbajt tezës sa patriotike, aq edhe shkencore, se gjuha është shenja e parë e kombit, kushti themelor për ekzistencën e tij dhe mjeti më i mirë për bashkimin kombëtar. Sipas tij, gjuha dhe kombi janë një trup e një shpirt.

Të vetëdijshëm për pengesat reale që u sillte aparati i Perandorisë Osmane dhe nacionalizmi ekspansionues në përmasat e shovinizmit të fqinjëve tanë, ata do të këmbëngulnin në përpunimin e ideologjisë nacionaliste progresive për ngjizjen e idesë nacionale, kalimin e fazave të këtij procesi në procedura të përshpejtuara, me qëllim që të ruanin tërësinë territoriale ku shtriheshin atëbotë shqiptarët - në katër njësi federale brenda Perandorisë Osmane, që quheshin *vilajete*.

2. Nacionalizmi si mjet për forcimin e shtetit dhe legjitimimin e pushtetit

Te shtetet që tashmë ekzistonin, nacionalizmi u përdor për të krijuar një identitet të përbashkët dhe për të forcuar besnikërinë ndaj shtetit. Kjo u bë përmes:

- *Gjuhës dhe arsimit:* Shtetet promovuan gjuhën zyrtare dhe historinë kombëtare në shkolla për të krijuar një ndjenjë të përkatësisë.

- *Simbolikës kombëtare*: Himnet, flamujt dhe festat kombëtare u përdorën për të nxitur patriotizmin.
- *Shërbimit ushtarak*: Ushtria u bë një mjet për të formuar qytetarë besnikë ndaj shtetit.

3. Nacionalizmi si justifikim për zgjerim dhe imperializëm

Në disa raste, nacionalizmi u përdor për të justifikuar zgjerimin territorial ose nënshtrimin e popujve të tjerë. Në Europën Juglindore këtë tip të nacionalizmit agresiv me përmasa të shovinizmit e aplikoi sidomos Serbia dhe Greqia. Ato kërkuan të zgjeroheshin në dëm të integritetit të shqiptarëve, duke përdorur argumente nacionaliste.

Mes dy Luftërave Botërore [1918-1941], në shoqëritë perëndimore, me theks në spektrin e së djathtës liberale, kishte dominuar një lloj erozioni mendor ndaj Adolf Hitlerit.

Sociologë e politologë të njohur këtë erozion mendor ua atribuonjë disa faktorëve:

Frika nga komunizmi - Për shumë konservatorë dhe elita ekonomike, Hitleri shihej si një mburojë kundër rrezikut bolshevik, duke bërë që të injoronin ose minimizonin rrezikun që ai përbënte për demokracinë.

Besimi se ai mund të kontrollohej - Shumë politikanë në Gjermani dhe jashtë saj mendonin se Hitleri do të ishte i detyruar të moderonte politikat e tij njëherë në pushtet.

a) *Izolacionizmi dhe kalkulimi i gabuar i Fuqive të Mëdha* - Britania dhe Franca ndoqën një politikë pajtuese ndaj tij, duke mos ndërhyrë në fillimet e ekspansionizmit nazist.

b) *Manipulimi i nacionalizmit dhe populizmit* - Hitleri përdori retorikën populiste për të fituar mbështetje duke u paraqitur si një figurë që do të rikthente lavdinë gjermane.

Edhe pse rrethanat historike janë shumë të ndryshme, ka disa ngjashmëri në mënyrën se si pjesë e së djathtës moderne amerikane dhe botërore po e shohin Trump-in. Këto mënyra janë:

- **Frika nga e majta progresive:** Ashtu si dikur e djathta europiane e shihte komunizmin si rrezikun kryesor, sot shumë konservatorë shohin liberalizmin progresiv si një kërcënim ekzistencial.

- **Besimi se ai mund të kontrollohet:** Ashtu si me Hitlerin në fillim, shumë republikanë menduan se Trump-i do të sillej ndryshe një herë në pushtet, por ai vazhdoi të sfidonte normat demokratike.

- **Tolerimi i retorikës autoritare:** Trump, si Hitleri në vitet '30, ka përdorur një gjuhë të ashpër kundër kundërshtarëve dhe ka promovuar teori konspirative, që minojnë institucionet demokratike.

- **Adhurimi i liderit të fortë:** Të dy kanë shfrytëzuar ndjenjat e një pjese të shoqërisë që ndihet e lënë pas dore për të krijuar një kult personaliteti, që i bën ndjekësit të injorojnë ose justifikojnë aktet e tyre antidemokratike.

Nëse në vitet '30 e djathta europiane nënvlerësoi rrezikun që shfaqte Hitleri, deri kur ishte tepër vonë, sot dilema është nëse e djathta amerikane dhe ndërkombëtare do të bëjë të njëjtin gabim me Trump-in dhe politikanë të ngjashëm.

Ndërkohë, bota në të cilën jetojmë po bëhet në fakt një skenë politike, në të cilën aplikohet qartë e shqeto darvinizmi social, ku po "luajnë" vetëm tre autokratë të mëdhenj: Vladimir Putini, Xi Jinping-u dhe Donald Trump-i. Konform teorisë së darvinizmit social, duket se ata, thënë troç, duan të zgjerojnë dhe forcojnë shtetet e tyre territorialisht dhe me ndikim.

Kjo doktrinë i sipërvihet nacionalizmit modern që njohim deri më sot. Prandaj kërkohet mençuri në përshtatjen e lundrimit edhe në oqeanin e tërbuar nga rrymat e gjeopolitikës moderne.

Strategjia gjeopolitike e SHBA-së nën Trump-in në vitin 2025 thekson unilateralizmin, nacionalizmin ekonomik dhe një angazhim të reduktuar ndaj aleancave tradicionale, në kontrast të qartë me qasjen e administratave të mëparshme. Prandaj po vëmë re një lloj ringjalljeje të nacionalizmit amerikan në formën e proteksionizmit ekonomik, euroskepticismit dhe theksimit të sovranitetit kombëtar në kundërshtim me globalizimin.

Kjo strategji i paraprin rikthimit gradual në “epokën e perandorive moderne”, i cili do të bëhet paralelisht me përdorimin e luftës dhe të retorikës nacionaliste, sepse është homogjenizuese kombëtare. Dhe, si të tilla, ato mund të realizoheshin përmes një marrëveshjeje hipotetike, e ngjashme me ato të karteleve, si: “Ne marrim Ukrainën Lindore dhe daljen në Detin e Zi, ju merrni Tajvanin, ndërkaq ju [SHBA] merrni Grënlandën” e nëse pretendoni edhe Europën Juglindore! Në të kundërtën mund të përsëritet viti 1914!

4. E djathta shqiptare dhe nacionalizmi politik farsë i saj

Në historinë moderne shqiptare nacionalizmi si ideologji nga ana e një pjese të inteligjencës shqiptare, pra jo vetëm në prag dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe në periudhën e tranzicionit demokratik [1990-2020], do t’i shërbejë, para së gjithash, PD-së në Shqipërinë politike dhe LDK-së në Kosovë, si mbulesë për të fshehur e maskuar nacionalizmin farsë, që ata aplikojnë në raport me protektorët e tyre realë.

Prandaj ky raport i kësaj lagjeje intelektualësh që morën fatet e Kombit në dorë për katër dekada me radhë me të djathtën ekstreme perëndimore, është kompleks dhe kërkon një analizë të kujdesshme.

E ashtuquajtura e djathtë shqiptare sot, PD dhe LDK, ka dëshmuar se nuk dallon nga e djathta kuislinge e epokës së Hitlerit. Prandaj nacionalizmi i saj i proklamuar është fals, i stisur dhe mashtrues.

Nacionalizmi si ideologji, mbi themelet e së cilës qe ngritur shteti modern, ndërkohë ka rrëshqitur në ujërat e populizmit dhe fashizmit modern, sidomos në Europën Perëndimore. Prandaj ai gradualisht, si i tillë, mund të shndërrohet në farsë politike, sidomos kur përdoret jo për të mbrojtur interesat kombëtarë në mënyrë legjitime, por për qëllime populiste, manipulim elektoral ose për të fshehur dështimet e qeverisjes. Kjo ndodh në disa situata tipike, kur ai shndërrohet në një lloj instrumenti *sui generis* për të shpërqendruar vëmendjen e opinionit. Shpesh liderët politikë përdorin nacionalizmin për të shmangur debatet mbi çështje reale, si korrupsioni, papunësia ose mungesa e reformave ekonomike. Duke krijuar një "armik të jashtëm" ose duke nxitur ndjenja patriotike të ekzagjeruara, respektivisht duke rrëshqitur me qëllim në ujërat e

nacionalizmit folklorik [ky fenomen venerohet vecanërisht në Ballkan dhe ndër ne shqiptarët], prandaj të ashtuquajturit *nacionalistë folklorikë* synojnë te ne, që të largojnë vëmendjen nga problemet e brendshme.

Ndërkaq, kur nacionalizmi bazohet në mite dhe manipulime historike, shndërrohet në një karikaturë të llojit të vet. Kështu, nacionalizmi mund të kthehet në farsë, kur historia falsifikohet për të justifikuar veprime politike, duke krijuar një ndjenjë fiktive superioriteti ose viktimizimi kolektiv. Fenomeni i viktimizimit kolektiv deri në shkallën e mjerimit kolektiv ishte aplikuar sidomos në dekadën e aparteidit serb në Kosovë. Ndërkaq, në Serbi viktimizimi kolektiv shpesh përdoret për të rritur mobilizimin e turmave.

Nacionalizmi primitiv ndër ne në Kosovë, i katapultuar edhe në piramidën e institucioneve të kontrolluara nga UNMIK-u e EULEX-i, por në një trajtë më të theksuar edhe pas shpalljes së pavarësisë më 2008 dhe heqjes së mbikëqyrjes nga ndërkombëtarët, që përdorur ekskluzivisht për përfitime personale e grupore. Në shumë raste, politikanët përdornin retorikën nacionaliste për të fituar vota, respektivisht e keqpërdorën reputacionin pozitiv të UÇK-së për të mbuluar aktet e tradhtisë klasike, ndërkohë që në realitet nuk merrnin masa konkrete për të mbrojtur interesat kombëtarë. Përkundrazi, i kishin lëshuar terren të lirë Serbisë të instalojë njerëzit e saj kudo në piramidën e shtetit e deri edhe në ndërmarrjet publike! Ky pozicionim, me kalimin e kohës, natyrshëm kishte krijuar hendekun mes fjalëve dhe veprave dhe, rrjedhimisht, “nacionalizmi” i asaj klase politike u shndërrua në farsë të llojit të vet.

Nacionalizmi primitiv ndër ne mes viteve 2008-2020, pati për objektiv politik edhe justifikimin e autoritarizmit dhe, gradualisht, justifikimin e inaugurimit të diktaturës. Disa liderë e përdorën nacionalizmin si farsë dhe justifikim për kufizimin e lirive demokratike, duke e paraqitur çdo kritikë ndaj tyre si "akt të orientuar kundër shtetit". Madje edhe mobilizimin e opozitës për ta penguar ratifikimin e marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi, ku shihej qartë se Republika humbiste 8200 ha, e cilësonin si akt antishtetëror! Ndërkaq, kauzën për ta penguar ratifikimin e Marrëveshjes së prillit 2019, që i hapte rrugë Bashkësisë Serbe [Zajednicës] alis “Republikës Sërbska 2”,

qoftë edhe përmes hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvend, edhe sot e cilësojnë si akt antishtetëror dhe terrorist!

Në këto raste, siç është vënë në pah në Kosovë, nacionalizmi humbet kuptimin e tij si një ideologji për mbrojtjen e vlerave dhe të interesave kombëtarë dhe kthehet në një farsë politike që dëmton, më shumë sesa ndihmon.

Nacionalizmi progresiv shqiptar vs ai skocez

Nacionalizmi progresiv skocez dhe ai i Rilindjes Kombëtare Shqiptare kanë disa paralele interesante, pavarësisht se kanë ndodhur në kontekste historike dhe gjeopolitike të ndryshme. Të dyja lëvizjet përfaqësojnë forma të nacionalizmit, që synojnë jo vetëm çlirimin kombëtar, por edhe përparimin shoqëror dhe politik të kombit përkatës.

Si në Skoci, ashtu edhe në Shqipëri kombi që në ngjizje ishte projekt kulturor dhe politik. Por më poshtë do të shohim edhe disa pikëtakime të tjera. Në Skoci, nacionalizmi modern është përqendruar në forcimin e identitetit skocez brenda Mbretërisë së Bashkuar, duke e bazuar atë në një kombinim të kulturës, historisë dhe aspiratave politike për vetëqeverisje ose pavarësi.

Në Shqipëri, Rilindja Kombëtare (shek. XIX - fillimi i shek. XX) kishte si objektiv kryesor krijimin e një ndërgjegjeje kombëtare shqiptare përmes gjuhës, arsimit dhe historisë, si dhe çlirimin nga Perandoria Osmane. Krahasimi midis nacionalizmit progresiv skocez dhe nacionalizmit shqiptar sot është interesant, pasi ata operojnë në kontekste të ndryshme historike, politike dhe sociale.

Skocezët kanë një shtet brenda Mbretërisë së Bashkuar dhe synojnë pavarësinë nga një shtet më i madh (Britania). Nacionalizmi skocez i SNP-së (Scottish National Party) është i orientuar kryesisht drejt vetëqeverisjes, duke u mbështetur te demokracia, ekonomia e mirëqenies dhe politika e majtë progresive. Ndërkaq, shqiptarët tashmë kanë shtetin e tyre kombëtar (Shqipërinë) dhe një tjetër shtet shqiptar (Kosovën), por nacionalizmi shqiptar shpesh përqendrohet në idenë e bashkimit kombëtar ose të fuqizimit të shqiptarëve në Ballkan. Ky fakt krijon një dimension të ndryshëm nga nacionalizmi skocez.

Nacionalizmi skocez është kryesisht progresiv, socialdemokrat dhe pro integritetit europian. Ai fokusohet më shumë te politikave të mirëqenies dhe ndërtimi i një shoqërie më të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Nacionalizmi shqiptar, megjithëse ka elemente progresive (sidomos në Kosovë me përpjekjet për integrim në BE dhe NATO e, mbi të gjitha, kontinuitetit të mendimit politik burimor e me theks socialdemokrat të Lëvizjes “Vetëvendosje”, shpesh përzihet me një ndjenjë etnocentrike dhe historike, për shkak të pasojave të copëtimit kombëtar.

Nacionalizmi ndër skocez ka një prirje progresive, duke u lidhur shpesh me politikave sociale, shtetin e mirëqenies dhe demokracinë e decentralizuar. SNP (Scottish National Party) përpiket ta paraqesë Skocinë si një komb modern me një model nordik të zhvillimit.

Nga ky lloj nacionalizmi ka marrë shumëçka Lëvizja “Vetëvendosje” dhe po aplikon gjatë këtyre viteve sa është në pushtet. Skocezët e shohin nacionalizmin e tyre si gjithëpërfshirës - ai nuk bazohet tek etnia, por tek identiteti qytetar skocez. Ka një qasje liberale ndaj emigracionit dhe multikulturalizmit.

Nacionalizmi shqiptar pavarësisht se ka elemente të theksuara të nacionalizmit progresiv, ai shpesh është më etnocentrik, duke u bazuar kryesisht në historinë dhe përkatësinë etnike. Megjithatë, ka progres në këtë rrafsh në vitet e fundit në përgjithësi në hapësirën shqiptare e me theks në Kosovë, ku në dekadën e fundit po formësohet nacionalizmi urban progresiv, ndoshta edhe për shkak të kontekstit ndërkombëtar. Nacionalizmi skocez është kryesisht anti-Brex dhe pro-BE. Një pjesë e madhe e tij bazohet tek ideja, se Skocia do të jetë më mirë si një shtet i pavarur brenda BE-së sesa si pjesë e Britanisë.

Nacionalizmi shqiptar përqendrohet në rritjen e ndikimit shqiptar në rajon dhe në integrimin në strukturat euroatlantike, por ka edhe tendenca të forta antiserbe dhe dyshime ndaj ndërhyrjes ndërkombëtare në disa raste. Skocezët bazohen te një narrativë e shtypjes nga Anglia dhe një dëshirë për vetëvendosje demokratike. Ndërkaq, shqiptarët mbështeten shumë në historinë e ndarjes së territoreve, padrejtësisë ndërkombëtare dhe nevojës për ruajtjen e identitetit kombëtar. Te të dy popujt, nacionalizmi si ideologji kishte mëkuar Rilindjen Kombëtare, që kishte

për objektiv krijimin e shtet-kombit të fortë dhe të pavarur, por konteksti i tyre është i ndryshëm.

Skocia operonte brenda një sistemi demokratik britanik, ndërkaq shqiptarët në kohën e Rilindjes duhej të luftonin për ekzistencën e tyre në një ambient perandorak dhe ballkanik shumë të paqëndrueshëm, në përballje doktrinat ekstreme antishqiptare serbe dhe greke [Naçertania serbe dhe *Megalo Ideja* greke]. Gjithsesi, në të dyja rastet, si në Skoci, ashtu edhe në Shqipëri, nacionalizmi është parë si një mjet për të arritur një shoqëri më të drejtë dhe më të zhvilluar.

Si nacionalizmi progresiv skocez, edhe ai shqiptar, kanë marrë shumë nga Revolucioni Francez [1789] dhe veçmas nga ideologu i tij, Jean-Jacques Rousseau. Por si ideologët e nacionalizmit progresiv skocez, edhe ata shqiptarë shquhen për qasjen që bashkon aspiratat për vetëqeverisje me vlera sociale progresive, si: barazia, drejtësia sociale dhe përfshirja demokratike.

Ky lloj nacionalizmi është veçanërisht i lidhur me Partinë Kombëtare Skoceze (SNP) dhe lëvizjet pro pavarësisë në Skoci dhe me Lëvizjen “Vetëvendosje”. Disa nga ideologët dhe figurat më të shquara të nacionalizmit progresiv skocez janë:

- **John MacCormick** (1904-1961), që konsiderohet një nga figurat kryesore në formimin e nacionalizmit modern skocez, që kontribuoi shumë në krijimin e *Scottish National Party* (SNP) dhe më vonë të *Scottish Covenant Association*, e cila promovoi vetëqeverisjen skoceze.

- **Neil MacCormick** (1941-2009). Filozof dhe akademik i shquar i së drejtës, i cili argumentoi pavarësinë skoceze brenda një kornize europiane dhe demokratike.

- **Tom Nairn** (1932-2023). Akademik dhe teoricien i njohur për analizat e tij mbi nacionalizmin skocez dhe për idenë se dezintegrimi i Mbretërisë së Bashkuar ishte i pashmangshëm në një botë moderne.

- **Jim Sillars** (1937-?). Ish-deputet dhe mendimtar i rëndësishëm i nacionalizmit skocez, i cili argumentoi për një qasje më socialiste ndaj pavarësisë.

Këto figura kanë ndikuar në zhvillimin e nacionalizmit progresiv në Skoci, duke e orientuar atë drejt një modeli demokratik, të hapur dhe të bazuar në vlera sociale.

Le të rikujtojmë se ideologët që ishin bartës të Rilindjes sonë Kombëtare [Jeronim de Rada, Jani Vreto, Zef Jubani, Pashko Vasa, Sami Frashëri, Abdyl Frashëri e deri te Josip Bageri i përkisnin rrymës liberale dhe mendimit progresiv.

Në këtë linjë mendimi janë kultivuar edhe brezi i ndërmjetëm prej Hasan Prishtinës, Ismail Qemalit e deri tek Ukshin Hoti e Arbër Xhaferi dhe pasuesit e tyre, që sot kryesisht janë në kuadër të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Por në historinë e mendimit politik dhe në zhvillimet politike në nivel europian, vetë nocioni mbi progresin shoqëror është relativisht i ri. Deri te Revolucioni Francez [1789] shkruan filozofi holandez Rutger Bregmann, të gjitha shtetet në botë ishin të rreshtuara në pozicionin e shfrytëzimit të fuqisë punëtore me shtrëngim¹. Madje deri në vitin 1800 mbi një e katërta e popullsisë botërore që punonin në fusha, ishin thjesht shërbëtorë të të pasurve². Më shumë se 90 për qind e popullsisë punonin në bujqësi, ndërkaj me shumë se 80 për qind jetonin në varfëri ekstreme³. Në këtë kohë, në raport me këtë zhvillim të shoqërisë, teksa po shkruante kryeveprën e tij “Kontrata shoqërore”, Zhan Zhak Rusoi e fillon atë pikërisht me këtë fjali: “*Njeriu është i lindur i lirë, dhe gjithandej ai është në zinxhirë*”, shkruante atëbotë Rusoi⁴.

Kur dinamika multipolare është në proces të riorganizimit

Aftësitë dhe rezonimi politik në përputhje me interesin kombëtar të cilësdo forcë politike maten me mençurinë e shprehur programore,

¹ Rutger Bregmann; *Im Grunde Gut – Eine neue Geschichte der Menschheit*, botimi i 6-të, Hamburg 2020, f. 136.

² Adam Hochschild; *Sprengt die Ketten. Der entscheidende Kampf und die Abschaffung der Sklaverei*. Klett-Cotta, 2007, f. 12

³ Max Roser und Esteban Ortiz-Ospina, “GlobalExtreme Poverty”Our-WorldInData.org [shkarkuar më 13.12.2013].

⁴ Shënim: Kjo është fjalia e parë e librit të Rusoit, “Kontrata shoqërore e Zhan zhak Rusosë, cituar sipas R. Bregmann.

politike e qeverisë në përputhje me interesat jetikë të kombit, që garanton mençuria për lundrim në situata të reja, që do të thotë aftësi për përshtatshmëri ndaj rrethanave të reja gjeopolitike.

Nëse këtij konkluzioni i shtojmë edhe një qëndrim francez, sipas të cilit vetëm ata shtete që kanë armë bërthamore (SHBA, Federata Ruse, Kina, Franca, Britania e Madhe, India, Pakistani, Izraeli dhe Koreja e Veriut) janë shtete sovrane⁵, atëherë ky kuadër i ri politik global bëhet edhe më i qartë, ndërkaq aleanca ushtarake shqiptaro-kroate merr konotacion shpjegues të plotë. Në këtë kontekst vërehet një tendencë se bota po i afrohet një epoke, në të cilën dinamika multipolare (9 fuqitë bërthamore)⁶ është në proces të riorganizimit. Çështja është se a do të reduktohet në dominimin e tre liderëve të fortë, apo do të rikonstruktohet edhe BE-ja, tok me Britaninë e Madhe dhe Francën në strumbullarin e dominancës si palë e katërt dhe a do të jetë Europa Juglindore domen i saj.

Në rast se mënjanohej poli i katërt, Europa, respektivisht nëse ajo ndahet në sfera të interesit mes SHBA-ve dhe Rusisë, pak a shumë në ato linja që ishte në kulmin e prosperimit të BRSS-së, atëherë në të ardhmen e afërt do të kishim krijimin e një "karteli politik" të tri superfuqive: SHBA-ve, Federatës Ruse dhe Kinës. Në këtë rindarje në sfera të ndikimit do të kishim një realitet krejt të ri gjeopolitik (i bazuar në modelin e kartelit), ndërkaq në këtë ndarje Europa Juglindore, si tërësi, do të ishte pjesë e sferës së ndikimit amerikan.

Kur dominanca politike i nënshtrohet logjikës së merkantilizmit

Pas Luftës së Dytë Botërore, bota ishte ndarë kryesisht në dy zona ndikimi:

1. Perëndimi (SHBA, NATO, BE) – Kapitalistë dhe demokratë.
2. Lindja (Bashkimi Sovjetik, Kina dhe, më vonë, edhe Rusia) – Komunistë dhe autoritarë.

⁵ Kristijanom Ilovač: <https://www.geopolitika.news/razgovori/intervju/intervju-sa-strucnjakom-za-obranu-kristijanom-ilovacom-odani-savezima-ali-fokus-na-nasu-sigurnost/>

⁶ Tonči Mirić: <https://www.geopolitika.news/razgovori/komentari/serifi-jasu-globalno-stizemo-li-to-u-vrli-novi-svijet/>

Rindarja e këtij karteli politik në tri sfera të ndikimit: SHBA, Kinë dhe Rusi, nëse e pranojmë tashmë se ky kuadër hipotetik gjeopolitik në shqyrtim do të kishte një karakter imperialist, atëherë do ta kuptonim më qartë doktrinën e Donald Trump-it që ka në themel idenë e zgjerimit të kontrollit mbi shtetet e tjera me qëllim arritjen e supremacisë ushtarake, ekonomike dhe politike.

Në realitet dominanca politike në këtë rast praktikisht i nënshtrohet logjikës së merkantilizmit - një drejtim në teorinë ekonomike, doktrina dhe praktika e të cilit bazohen në pikëpamjen se përparimi ekonomik i një shteti mund të sigurohet përmes "tregtisë" në kurriz të vendeve të tjera "më të dobëta", ku lejohen të gjitha mjetet e konkurrencës, nga mbrojtja doganore deri te resurset e caktuara të luftës, siç po e shohim se po e aplikon Trump-i edhe në raport me partnerët. Në historinë e ndarjeve të zonave të interesit dhe ndikimit mes superfuqive, Shqipëria fillimisht ishte në Bllokun Komunist me Jugosllavinë (deri në 1948), pastaj u lidh me Bashkimin Sovjetik (deri në 1961) dhe Kinën (deri në 1978), përfundimisht duke mbetur e izoluar deri në vitet '90.

Ndërkaq, Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë, një lloj kolonie moderne e Serbisë, ku gëzonte autonomi deri në vitet '80, kur regjimi serb e shtypi këtë autonomi dhe aplikoi pastaj për një dekadë të tërë [1989-1999] aparteidin në zemrën e Europës [!] dhe për turpin e Europës, derisa u krijuan bërthamat e para të UÇK-së dhe imponuan një ndryshim të thellë, meqë ato çuan drejt luftës së vitit 1999, kur qe implikuar ndërhyrja e NATO-s, duke i hapur kështu rrugë pavarësisë në vitin 2008.

Çlirimi i Kosovës i hapi rrugë rikthimit të plotë të shqiptarëve në familjen e vet kulturore, politike e ushtarake në Europë. Ndërkaq, anëtarësimi i Shqipërisë politike në NATO më 4 prill 2009 shënoi një moment historik jo vetëm në aspektin e sigurisë dhe të mbrojtjes, por edhe në kontekstin më të gjerë të integritetit euroatlantik dhe të rikthimit të shqiptarëve në familjen evropiane. Ky proces duhet të shihet edhe si një kontribut i llojit të vet drejt unitetit shpirtëror dhe kulturor të kombit. Ai ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar shqiptar në Europë, duke krijuar më shumë mundësi për bashkëpunim ndërkulturor.

Nacionalizmi modern shqiptar

Nacionalizmi modern u zhvillua në Europë sidomos në shekullin XIX, kur kombet kërkuar pavarësi dhe sovranitet shtetëror. Shqiptarët, të ndikuar nga këto lëvizje, formuan Lidhjen e Prizrenit (1878) për të mbrojtur territoret shqiptare nga copëtimi. Megjithatë, fuqitë e mëdha të kohës, sidomos Perandoria Osmane, Austro-Hungaria, Rusia dhe më vonë shtetet fqinje (Serbia, Greqia, Mali i Zi), ndanë tokat shqiptare në Konferencën e Londrës (1913), duke lënë jashtë kufijve të Shqipërisë një pjesë të madhe të shqiptarëve.

Në shekullin XX, nacionalizmi shqiptar u përqendrua në bashkimin e shqiptarëve të ndarë mes shteteve të ndryshme. Shqipëria dhe Kosova u gjendën nën regjime të ndryshme: Shqipëria kaloi nga monarkia në diktaturën komuniste (1944-1991), ndërsa Kosova mbeti nën sundimin serb deri në qershor 1999, duke kaluar më pas një dekadë pothuajse nën administrimin ndërkombëtar [UNMIK], derisa shpalli pavarësinë e saj më 2008.

Nacionalizmi shqiptar, si fenomen modern, u formësua në kontekstin e shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, duke u ndikuar nga lëvizjet nacionaliste europiane dhe nga proceset e shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Synimi kryesor i nacionalizmit shqiptar ishte krijimi i një shteti të pavarur kombëtar, bazuar në identitetin gjuhësor dhe kulturor të shqiptarëve.

Kombi është produkt i nacionalizmit progresiv modern, i kultivuar në ndërgjegjen e mileniumit të civilizimit perëndimor si nacionalizëm human, që Winkler (1992, f. 12) e quante si instrument për emancipimin e kombit dhe realizimin e qëllimeve progresive, siç është e drejta për vetëvendosje⁷. Një nga format më të rëndësishme të organizimit nationalist shqiptar do të jetë bashkimi në trajtën e një Federate Shqiptare, e cila po lind si rezultat i përpjekjeve për të bashkuar shqiptarët rreth një platforme të përbashkët politike, ushtarake dhe kulturore.

7

https://docs.google.com/document/d/1u1flutpSCvcCJdrnHSSgqR4mFLf8b2G_dpPthFbSaNA/edit

Nacionalizmi shqiptar dhe Federata Shqiptare do të formësohen nga një kombinim i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në nivel të brendshëm, gjuha, traditat dhe historia e përbashkët shërbejnë si faktorë unifikues. Bartës i saj do të jetë, si në periudhën e Rilindjes Kombëtare, e majta progresive liberale. E djathta reale, që tashmë ekziston vetëm si embrion i përqendruar në disa parti, do ta mbështesë këtë proces, e ndërgjegjshme se nuk ka peshën e duhur për të marrë rol drejtues. Në anën tjetër, ndërhyrjet e fuqive të mëdha dhe interesat e shteteve fqinje që për një shekull të tërë e pamundësuan dhe ndërkohë po e komplikojnë këtë proces në rirreshtimin gjeopolitik që po ndodh, por nuk ka gjasa ta pengojnë më tutje. Si përfundim, Federata Shqiptare, si produkt i nacionalizmit shqiptar, do të luajë rol vendimtar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe prosperimin e kombit si tërësi, duke përfshirë në këtë kuadër edhe mërgatën.

* * *

Sot Shqipëria dhe Kosova janë pjesë e zonës perëndimore: Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe synon anëtarësimin në BE. Kosova është e pavarur, por ende nuk është njohur nga të gjitha shtetet ndërkombëtare dhe ka vështirësi në integrimin euroatlantik, për shkak të bllokadave nga Serbia dhe Rusia, por edhe nga një lagje shtetesh të BE-së [pesë syresh], që ende nuk e njohin.

Në një botë të ndarë midis Perëndimit dhe fuqive rivale, si Rusia dhe Kina, Shqipëria dhe Kosova janë të lidhura ngushtë me SHBA-në dhe BE-në, por përballen ende me sfida gjeopolitike dhe ekonomike. Shqipëria është një aleate e ngushtë e SHBA-së, anëtare e NATO-s dhe në proces të negociatave për anëtarësim në BE. Politika e jashtme e Tiranës shpesh përpiket të balancojë mbështetjen ndaj SHBA-së me angazhimin ndaj Brukselit. Në raste të përplasjeve mes BE-së dhe SHBA-së, Shqipëria, në përputhje me interesat nacionalë, ka prirje të ndjekë linjën amerikane, por pa prishur marrëdhëniet me BE-në. Kosova mbështetet shumë te SHBA-ja për sigurinë dhe njohjen ndërkombëtare. Ndërkaq, BE-ja ka një qasje disi të mefshtë ndaj Kosovës, sidomos për shkak të mosnjohjes nga pesë shtete anëtare (Spanja, Greqia, Sllovakia,

Rumania dhe Qiproja). Përplasjet e fundit mes Uashingtonit dhe Brukselit sigurisht që e vendosin Prishtinën në një pozitë të vështirë.

Në këto rrethana duhet të veprojë lidershipi shqiptar, ndërkaq aleanca ushtarake shqiptaro-kroate e arritur ndërkohë, është hapi i parë i hedhur në drejtimin e duhur dhe plotësisht në përputhje me interesat jetikë nacionalë. Kjo do të thotë se ne duhet të jemi besnikë ndaj aleancave, por të fokusuar në sigurinë tonë dhe tek interesat tanë.

* * *

Nacionalizmi shqiptar, si fenomen modern, u formësua në kontekstin e shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, duke u ndikuar nga lëvizjet nacionaliste europiane dhe nga proceset e shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Synimi kryesor i nacionalizmit shqiptar ishte krijimi i një shteti të pavarur kombëtar, bazuar në identitetin gjuhësor dhe kulturor të shqiptarëve. Një nga format më të rëndësishme të organizimit nationalist shqiptar do të jetë bashkimi në trajtën e një Federate Shqiptare, e cila po lind si rezultat i përpjekjeve për të bashkuar shqiptarët rreth një platforme të përbashkët politike, ushtarake dhe kulturore.

Nacionalizmi shqiptar dhe Federata Shqiptare do të formësohen nga një kombinim i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në nivel të brendshëm, gjuha, traditat dhe historia e përbashkët shërbejnë si faktorë unifikues. Bartës i saj do të jetë, si në periudhën e Rilindjes Kombëtare, e Majta progresive liberale. E djathta reale, që tashmë ekziston vetëm si embrion i përqendruar në ca partiza, do ta mbështesë këtë proces, e ndërgjegjshme se nuk ka peshën e duhur për të marrë rol drejtues. Në anën tjetër, ndërhyrjet e fuqive të mëdha dhe interesat e shteteve fqinje që për një shekull të tërë e pamundësuan dhe ndërkohë po e komplikojnë këtë proces, në rirreshtimin gjeopolitik që po ndodhë, nuk ka gjasa ta pengojnë tutje.

Në përfundim, Federata Shqiptare, si produkt i nacionalizmit shqiptar, do të luajë rol vendimtar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe prosperimin e kombit si tërësi, duke përfshi në këtë kuadër edhe mërgatën. Bashkimi European (BE) është duke punuar në ngritjen e një arkitekture të re të sigurisë, me synimin për të reduktuar varësinë nga

Shtetet e Bashkuara dhe për të rritur blerjet e armëve europiane⁸. Në këtë kontekst, presidenti francez, Emmanuel Macron, ka theksuar se arkitektura e re e sigurisë duhet të marrë parasysh shqetësimet e Rusisë dhe t'i ofrojë asaj garanci sigurie, nëse Moska kthehet në tryezën e negociatave për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë⁹.

Nga ana tjetër, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitrij Peskov, ka deklaruar se Europa do të duhet të ndërtojë një arkitekturë të re të sigurisë, duke pasur parasysh ndryshimet e shpejta në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe se Rusia do të kërkojë të sigurojë interesat e saj në këtë proces¹⁰.

Shqipëria tok me Kosovën e bashkuar në trajtën e një Federate Shqiptare më vete, do të kishin vendin e tyre të merituar edhe në autonominë strategjike të sigurisë europiane. Ndërkaq, më pas, mundësisht brenda një periudhe sa më të shkurtër, do të mund të luaj rolin e një ndërmjetësi mes SHBA-së dhe BE-së në Ballkan, duke qenë pjesë e korpusit anglosakson dhe, njëkohësisht, edhe e BE-së.

Përfundim

Në dritën e mendimit gjeopolitik mbi thellësinë strategjike të Europës, Ballkani, veçanërisht Shqipëria dhe shqiptarët, ishin trajtuar si një kufi mbrojtës. Shqipëria e tillë ishte që në epokën e Gjergj Kastriotit. Ndërkaq, në epokën e krijimit të shteteve moderne, fundi i shekullit XIX dhe atij XX, ishin qarqet politike gjermane, sidomos ato austriake, që ua njihnin këtë rol shqiptarëve, prandaj mbështetën bartësit e ideologjisë së nacionalizmit progresiv shqiptar dhe këmbëngulën që të krijohej Shteti Shqiptar në një territor sa më të gjerë, ndërkaq në fund të shekullit XX kontribuan ndjeshëm në çlirimin e Kosovës.

⁸https://www.starplus-tv.com/be-ja-shpalos-strategjine-e-re-te-sigurise-te-reduktohet-rol-i-shba-se-te-rriten-bletjet-e-armeve-evropiane/?utm_source=chatgpt.com

⁹ https://www.aa.com.tr/sq/bota/macron-arkitektura-e-re-e-siguris%C3%AB-duhet-t%C3%AB-marr%C3%AB-parasysh-shqet%C3%ABsimet-e-rusis%C3%AB/2755342?utm_source=chatgpt.com

¹⁰https://mia.mk/en/story/kremlini-evropa-do-t%C3%AB-duhet-t%C3%AB-nd%C3%ABrtoj%C3%AB-arkitektur%C3%AB-t%C3%AB-re-t%C3%AB-siguris%C3%AB?utm_source=chatgpt.com

Roli i Shqipërisë dhe i Kosovës në optikën e Bashkimit European dhe popujve gjermanikë ka evoluuar ndjeshëm, por mbetet i lidhur me konceptin e thellësisë strategjike. Nëse dikur shqiptarët shiheshin si një kufi mbrojtës për Perëndimin kundrejt Perandorisë Osmane, sot rajoni shihet përmes prizmit të stabilitetit, sigurisë dhe integritetit european.

BE-ja sheh Shqipërinë dhe Kosovën si faktorë kyç në stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Krizat, si ajo në Bosnjë, tensionet Serbi-Kosovë apo ndikimi i aktorëve të tretë (Rusia, Kina, Turqia) i bëjnë të rëndësishme dy republikat tona për strategjinë e BE-së. Ndërkaq, në luftën kundër ndikimeve të jashtme Shqipëria dhe Kosova nga Brukseli shihen si një pengesë e natyrshme ndaj ndikimit rus në Ballkan dhe si partnerë të besueshëm të Perëndimit.

Sot Shqipëria dhe Kosova nuk shihen më thjesht si “kufi mbrojtës” i Europës, por si faktorë aktivë në arkitekturën e sigurisë dhe të integritetit european. Roli i tyre si aleatë strategjikë të Perëndimit vetëm sa po rritet, veçanërisht në kontekstin e sfidave gjeopolitike, me të cilat po përballet Europa.

1.2 Dr. Hysamedin FERAJ dhe dr. Elvis HOXHA

Çfarë mësojmë nga konflikti me Serbinë në Kosovë lidhur me sovranitetin tonë

Nisur nga konteksti i luftës së ndërmarrë nga Rusia në Ukrainë dhe nga rivaliteti mes fuqive të tilla, si Shtetet e Bashkuar ose Kina, koncepti i sovranitetit nuk ka qenë kurrë më aktual për Bashkimin Europian. Dhe është pikërisht ky sovranitet evropian, ai që gjendet përballë lidhjes që Serbia ka ushqyer me Rusinë, në dëm të Kosovës. Hysamedin Feraj dhe Elvis Hoxha, filozofë dhe themelues të Institutit Politik të Studimeve Humane (IPSH) në Tiranë, analizojnë dinamikat dhe i kujtojnë Europës të llogarisë mirë masën e agresioneve të prodhuara nga regjimi serb i Vuçiqit në Kosovë.

Hyrje

Fillimi i shekullit XXI përmbysi shumëçka nga fundi i shekullit XX dhe riktheu shumëçka nga mesi i tij. Besimi i fundit të shekullit XX në rendin demokratik u përmbys në mosbesim ndaj demokracisë; besimi në fitore përballë totalitarizmit u përmbys në frikë përballë autokracisë; efienca e demokracisë u përmbys në eficiencë të autokracisë; festimi i fitores demokratike përballë totalitarizmit u përmbys në dramë të braktisjes së demokracisë, “lufta e ftohtë” e dikurshme është kthyer sot në “luftë të nxehtë”; fundi i historisë është kthyer në përsëritje të painformuar të saj. Për rrjedhojë, sot kemi një demokraci që ka humbur besimin te vetja; një demokraci të frikësuar nga tjetri i ndryshëm; një demokraci që me të dyja këto veti ka trimëruar tjetrin e ndryshëm, autokratin e sotëm e ka zëvendësuar me totalitarin e djeshëm. Këtë gjendje të botës e ka parë qartë presidenti francez, z. Emmanuel Macron, kur sulmin rus kundër Ukrainës e vlerësoi si rrezik për sovranitetin e shteteve dhe për vetë qytetërimin evropian¹¹.

¹¹ Jean-Baptiste Chastand, “En vendant des avions Rafale à la Serbie, Emmanuel Macron espère éloigner Belgrade de Moscou”, *Le Monde*, 13 gusht 2024. Çfarë del veçanërisht nga fjala në “L’Europe”, më 24 prill 2024, në Sorbonë, ku ai propozon “të ndërtohet një Europë... më sovranë, së cilës mos t’i detyrohet prej të tjerëve fati,

Tejkalimi rus i Brezhnjev

Agresioni i Rusisë kundër Ukrainës ka tronditur rendin botëror të bazuar në sovranitetin krahasimisht të barabartë të shteteve. Ky sistem ka siguruar periudha më të gjata stabiliteti në Europë, duke mundësuar zhvillimin e fushave dhe praktikave të tjera, në vend të drejtimit kah teknika dhe industria e luftës. Pas agresionit të fundit rus, ndjenja e rrezikimit të sovranitetit dhe e pavarësisë së shteteve është e pranishme jo vetëm në periferitë e Europës, si në shtetet baltike, por gjithashtu mes shteteve të fuqishme të Europës, siç e dëshmon së fundi shqetësimi i drejtë i presidentit të Francës, z. Emmanuel Macron. Është e pritshme që periferia të njohë rrezikun më qartë se shtetet e vendosura në qendrën e kontinentit europian, qoftë edhe vetëm sepse e ka më afër atë. Por, në praktikë, është më me rëndësi kur njohja që ka periferia kuptohet nga qendra.

Shqetësimi i presidentit të Francës, ashtu si i atij të Polonisë apo atyre të shteteve baltike është i drejtë. Agresioni rus ndaj Ukrainës ishte i paprovokuar dhe mbetet gjithmonë i palegjitimuar, madje edhe në lidhje me ndonjë prej faktorëve që teoricienët e shtetit përdorin në mbështetje të tezës së tyre, se në vend të sovranitetit të mëtuar “absolutisht”, shtetet mund të kenë vetëm “sovranitet të kufizuar”. Pra, agresioni i fundit rus, ashtu si ata para tij në Gjeorgji dhe Krime, nuk është i legjitimuar as nga ligji hyjnor, as nga ligji moral e humanitar, as nga ligji ndërkombëtar, madje as nga ruajtja e pushtetit, pra nga ideja se ky agresion do të kishte si qëllim të Kremlinit forcimin e pushtetit dhe sundimit të tij mbi popullsinë e vet të pakënaqur. E vetmja doktrinë që e shpjegon agresionin e presidentit Putin, pa e legjitimuar gjithsesi, është ajo e paraardhësit jo fort të largët të tij, Leonid Brezhnjev, për “sovranitetin e kufizuar” të shteteve të “kampit të vet”. “Kampi socialist” i “disiplinonte” këto të fundit dhe i kthente ato në satelitë të Bashkimit Sovjetik, gjegjësisht të Rusisë. Mirëpo ai njihte sovranitetin e plotë të shteteve me regjim jo socialist. Ngjarjet e dekadave të fundit, që zënë fill me Gjeorgjinë e

vlerat e saj, mënyrat e saj të jetesës” apo konferenca e shtypit me presidentin gjerman, Frank-Walter Steinmeier, në Berlin në maj 2024, gjatë së cilës ai shpjegon se “përballë armiqve brenda dhe jashtë... jetojmë një çast të Europës sonë, që është ekzistencial, sepse e besoj me të vërtetë se Europa mund të vdesë”.

Krimenë dhe vijojnë me Ukrainën, janë dëshmi se Rusia e ka bindur veten për më shumë: të gjitha shtetet e Europës duhet të jenë satelitë të saj. Kjo bindje ruse, që gjen mishërimin e vet te presidenti Putin, u afishua nëpër rrugët e qyteteve kryesore të Rusisë. Është e vështirë të mohohet se ky deklaram nuk shpall shenjën e pjesëmarrjes të një pjese të popullit rus në direktivën: “Nuk ka kufij për Rusinë¹²”!

Mirëkuptimi “demokratik” i Brezhnjev!

Republika e Kosovës ndodhet përballë praktikave të përditshme të agresionit serb kundër sovranitetit të saj, agresion me synime që duket se ngjajnë me ata që nxjerr në plan të parë Rusia në luftën e saj në Ukrainë. Pa u kthyer prapa në më shumë se dy dekadat pas luftës së 1998-1999, gjatë së cilave Serbia mori peng veriun e Kosovës për të krijuar një situatë ndarjeje *de facto*, qeveria aktuale, në pushtet që prej marsit 2021, u desh të pësojë rezistencën e Serbisë, që pengon integrimin e popullsisë së Veriut me shumicë serbe në një pjesë të Kosovës - shtet i pavarur dhe me të drejtën për të ushtruar sovranitetin e vet që prej Deklarimit të Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kështu, gjatë këtij mandati mund të përmendim, për shembull, krizat e shkaktuara nga refuzimi i zbatimit të ligjeve të Kosovës, si në rastin e zëvendësimit të targave të paligjshme të qytetarëve serbë të Kosovës, po ashtu edhe në ndërprerjen e përdorimit prej këtyre të fundit të dinarit serb, valutë jozyrtare brenda Kosovës. Në të dyja këto raste bëhet fjalë për cenimin e vetë konceptit të sovranitetit, për agresionin ndaj këtij koncepti¹³. Të dy shembujt prekin integritetin e

¹² Duke iu referuar kësaj fraze të Vladimir Putinit, të shprehur si nën tonin e shakasë dhe të përçarur nga shumë medie ndërkombëtare, më 24 nëntor 2016, kur, gjatë një ceremonie të shoqërisë ruse të gjeografisë të transmetuar në televizion, ai deklaroi lidhur me kufijtë, se ata “nuk mbarojnë askund”. Lidhur me këtë “aderim” mund t’i referohemi edhe ndjenjës së optimizmit që sundon në popullsinë ruse sipas një analize të botuar prej kolektivit Coruscant: “Life Has Become Better, Life Has Become Happier: Why are Russians More Optimistic Than Before The War”, nga Sergueï Shelin, e rimarrë në “Les Grands Dossiers de diplomatie”, nr. 81, gusht-shtator 2024, me titullin “A janë rusët më optimistë se para luftës”?

¹³ Në të dyja rastet bëhet fjalë përkatësisht për zbatimin, aktualisht efektiv, pas shumë tensionesh e marrëveshjes mes Serbisë dhe Kosovës për targat e makinave të pakicës serbe në kornizat e dialogut nën ndërmjetësimin europian dhe për kërkimin e zgjidhjes për zbatimin e një direktive të Bankës Qendrore të Kosovës lidhur me ilegalitetin e përdorimit të monedhës së përdorur në Serbi, dinarit serb. Direktiva e bën euron të

ushtrimit të ligjit të Kosovës dhe nxjerrin në pah ndërhyrjen e shtetit të Serbisë.

Janë edhe më të rënda aktet e agresionit fizik të kryer gjatë vitit 2023¹⁴ kur:

- më 29 maj, minoriteti serb manifestonte dhunshëm (duke shkaktuar tridhjetë të lënduar mes ushtarëve të NATO-s) kundër vendosjes së kryetarëve shqiptarë të komunave, të dalë nga zgjedhjet e parakohshme, të shtyra në kohë dhe më pas të bojkotuara prej serbëve kosovarë;

- më 14 qershor, patrulla me tre policë të Kosovës rrëmbehet në afërsi të kufirit dhe më pas mbahet në Serbi për më shumë se një javë;

- më 24 shtator, një komando i armatosur rëndë nga Serbia vrau në pritë një oficer policie të Kosovës, para se ai të strehohej në manastirin ortodoks të Banjskës e të shihte dështimin e sulmit të vet, ndërsa planet e zbuluara më vonë qëndronin në rivendosjen e vazhdimit të kontrollit të Veriut si në shërbim të Serbisë, ashtu dhe të krimit të organizuar¹⁵.

Sigurisht që Serbia nuk i konsideron tërë këto akte si cenim të sovranitetit, sepse nuk e njeh Kosovën si shtet sovran. Por është po aq e sigurt se, sa më shumë që ajo ndihet e mbështetur apo e kuptuar nga demokracitë që e kanë njohur Kosovën (të cilat sot duket se janë të shqetësuara për sovranitetin e tyre), aq më shumë dobësohet vetë ideja e sovranitetit. Këtë e dëshmon fakti se sa më shumë që sjellja agresive e Serbisë së presidentit Aleksandër Vuçiq ka fituar njëfarë mirëkuptimi kundër sovranitetit të shteteve të tjera të rajonit, aq më shumë është rritur ajo sjellje.

vetmen monedhë legale në përdorim, e është çështje tjetër, që përbën sot burim kërcitjesh me komunitetin serb dhe komunitetin ndërkombëtar.

¹⁴ Shih për këtë "Des heurts dans le nord du Kosovo font plusieurs dizaines de blessés", RFI, 29 maj 2023; "Pic de tensions après l'arrestations de policiers kosovars par Belgrade", L'Express prej AFP, 14 qershor 2023; Jean-Baptiste Chastand, "Au Kosovo, quatre morts dans l'attaque d'un commando serbe", *Le Monde*, 25 shtator 2023.

¹⁵ Komandoja udhëhiqej nga biznesmeni Milan Radoičić, i njohur për veprimtarinë e tij ilegale në Serbi, Kosovë dhe Mal të Zi. Ai është i afërt me pushtetin në Beograd, për të cilin ka ushtruar për vite të tëra kontrollin mbi popullsinë serbe në Veri. Qeveria e Kosovës ka kryer prej asaj dite konfiskimin e të gjitha pasurive të tij në vend, si dhe ka kërkuar më kot ekstradimin e tij, ndërsa ky jeton i lirë në Serbi.

Kjo tregon një përsëritje të asaj që ka ndodhur në fillim të shpërbërjes së Jugosllavisë, në fund të viteve 1980, kur Kosova ishte e para që e pagoi. Porse tani nuk është më vetëm Kosova, por janë po ashtu të gjitha shtetet e këtij rajoni periferik, që po ngrenë zërin dhe po dëshmojnë me forcë agresionin serb kundër sovranitetit të tyre. Pra, në Ballkanin Perëndimor nuk preket vetëm Kosova, por gjithashtu edhe Veriperëndimi me Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi e deri në Juglindje, me Maqedoninë e Veriut. Për më tepër, këta dy të fundit janë anëtarë të NATO-s dhe të renditur qartë, ashtu si Kosova, përkrah demokracive kundër agresionit rus ndaj sovranitetit të Ukrainës.

Vetë shtetet e konsideruara si periferike për qendrën e gravitetit, pra shtetet themeluese të Bashkimit European, duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me Rusinë, meqë janë kufitare ose më të afërta gjeografikisht me të, zotërojnë një dije dhe përvojë specifike. Sa më shumë mirëkuptim shfaqin shtetet e qendrës lidhur me sulmin ndaj sovranitetit të tyre nga Rusia, aq më shumë rritet ky sulm - e pamë këtë me Gjeorgjinë dhe Krimenë - aq sa sovraniteti i shteteve nis të ndihet i kërcënuar deri në përfundim të Kontinentit European.

Si rezultat, masat shtrënguese ndaj Kosovës pas vendosjes së kryetarëve shqiptarë të komunave në Veri¹⁶, masa në fuqi edhe sot, me gjithë aktet e agresionit territorial të përmendur më sipër dhe të pandëshkuar, bëjnë që periferive t'u duket sikur demokracitë kanë rikthyer në këtë shekull brezhnjevizmin që këshillon "sovranitetin e kufizuar" për shtetet e "kampit të vet". Ironike dy herë!

¹⁶ Pas përballjeve në nëntor 2022 mes policisë së Kosovës dhe popullsisë serbe në Veri të vendit, dhe pas dorëheqjes masive të serbëve prej institucioneve lokale nën presionin e Partisë "Lista serbe", e drejtuar nga Beogradi, u organizuan zgjedhjet komunale më 23 prill 2023 në katër komuna të Veriut. Të bojkotuara prej partisë kryesore serbe, LS, votimi përfundoi me zgjedhjen e kryetarëve shqiptarë, me pjesëmarrje rreth 3,5%. Hyrja me forcë në ndërtesë e një prej kryetarëve prodhoi dhunë, dhe forcat e NATO-s ndërhyjnë në mbështetje të policisë së Kosovës, duke shkaktuar rreth 80 të lënduar, prej të cilëve tridhjetë në radhët e NATO-s. Që prej asaj dite, kundrejt Prishtinës u ndërmorën "masa ndëshkimore", që ngrinë financimet europiane, sepse veproi pa koordinimin me partnerët ndërkombëtarë. Shih reagimin e BE-së: Jorge Liboreiro, "L'UE appelle la Serbie et le Kosovo à être plus raisonnables et à engager des négociations", *Euronews*, 19 qershor 2023, por edhe "Cette résolution du Parlement européen" më 19 tetor 2023, që "sheh me keqardhje masat negative të marra kundër Kosovës nga Këshilli" (neni 21)

Putini e ka zgjeruar këtë direktivë për shtetet e kampit të kundërt.

Rusia dhe Serbia: agresione me tipare analoge?

Pavarësisht sa i shpeshtë dhe sa i përditshëm është, agresioni i Serbisë kundër Kosovës tregon një qasje të ngjashme me atë të Rusisë kundër Ukrainës, në atë se është sa i paprovokuar, aq dhe i palegjitimuar. Presidenti Putin përpiqet më kot të vendosë analogji mes Kosovës dhe Krimesë apo pjesësh të tjera territoriale të Ukrainës. Ai rreket më kot, sepse ndryshe nga Rusia kundër Ukrainës, nuk ka analogji të mundshme me një Shqipëri që do të kishte hyrë në territorin e Kosovës, me një sulm që do të kishte për synim Serbinë. Përkundrazi, në origjinë të shpërbërjes së Jugosllavisë ishte Serbia me ndërmarrjen e agresioneve ushtarake kundër të gjitha republikave të tjera, nisur nga skaji më verior me Slloveninë, para se të vazhdonte më në jug përmes Kroacisë, Bosnjës e Hercegovinës deri në Kosovë. Megjithatë, është për të ardhur keq që brenda kancelarive europiane janë të rrallë zërat që ngrihen për të denoncuar tipare të ngjashme mes agresioneve të kryer nga Rusia dhe Serbia. I vetmi “legjitimitet” që Serbia i ka dhënë vazhdimisht vetes për të ndërmarrë agresionet e saj bazohet në argumentet etno-raciste, domethënë ndjenja e superioritetit ndaj popujve të tjerë, ndjenjë që politika e Beogradit e ka nxitur shpesh në popullin serb¹⁷. Në mënyrë të ngjashme me devizën e përmendur të Putinit mbi kufij “që nuk mbarojnë askund”, racizmi në Serbi shprehej në devizën e Millosheviçit: “*Ku gjendet një varr serb, është Serbi*”¹⁸, dhe më pas në devizën e ministrit të propagandës së tij, sot president i Serbisë, Aleksandër Vuçiq: “*Për një serb të vvarë do të vrasim 100 myslimanë*”¹⁹.

¹⁷ Përveç asaj çka vijon në tekst, le të kujtojmë memorandumun e historianit Vaso Çubriloviç, më 7 mars 1937, mbi “zgjidhjen e vetme” të mendueshme sipas tij dhe Akademisë së Shkencave: ajo e spastrimit të shqiptarëve të Kosovës jugosllave, duke u justifikuar se në atë kohë Gjermania po vepronte njësoj me çifutët dhe se Rusia po shtynte me miliona banorë drejt shpërnguljes. Memorandum i ribotuar nga antropologu dhe gjuhëtari kanadez Robert Elsie (1950-2017), specialist i letërsisë dhe i folklorit shqiptar: 1937; Vaso Cubrilovic: *The Expulsion of the Albanians. Ridëgjo podcastin me katër episode në “France Culture”*: Slobodan Milošević, le nettoyeur des Balkans, 2023.

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Cituar në fjalim: Vučić : Si vous tuez un Serbe, nous tuons cens musulmans !, 20 korrik 1995, pak pas gjenocidit të Srebrenicës (11-16 korrik 1995).

Ashtu si agresioni rus kundër Ukrainës, agresioni serb kundër sovranitetit të Kosovës nuk ka asnjë prej epërsive, që do të mund ta kufizonin *teorikisht* ligjin pozitiv të Kosovës (sovranitetin). Pra, edhe pse mund të ketë arsye për mbajtjen me çdo kusht të të njëjtit tip pushteti brenda Serbisë, qeveria aktuale e saj nuk ka as epërsinë e ligjit hyjnor, as të ligjit moral, humanitar dhe ndërkombëtar. Ashtu si në rastin e Putinit, mungesa e respekti ndaj së drejtës e bën të kotë përpjekjen e Vuçiqit për të vendosur analogji për të denigruar ndërhyrjen e NATO-s në vitet 1990 kundër regjimit serb, regjim i segregimit sundues asokohe në Kosovë, si dhe i krimeve në masë dhe i gjenocidit të kryer në Ballkan. Në kuadrin e bombardimeve ajrore të saj në Kosovë, veprimi i NATO-s bazohej në epërsinë e ligjit moral e humanitar dhe, gjithashtu, mbi epërsinë e së drejtës ndërkombëtare kundër gjenocidit, qoftë edhe kur shteti gjenocidal i quan *viktimat shtetas të vet*. Kjo ndërhyrje u bë e mundur, vetëm sepse në Bosnjë dhe Hercegovinë bashkësia ndërkombëtare u dëshmuar e pafuqishme përballë një Serbie, që në atë kohë kishte ngritur të ngjashmit e “kampeve të shfarosjes” dhe kishte organizuar “spastrimin etnik” të territoreve që i pretendonte si të sajat²⁰.

Në fakt, Serbia nuk tregon asnjë shenjë serioze të respektit për të drejtën më të vogël. Për shembull, më 23 maj 2024, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara adoptoi një rezolutë për ta kthyer 11 korrikun në ditën ndërkombëtare të përkujtimit të gjenocidit të kryer në Srebrenicë në 1995-ën, përkundër fushatës diplomatike intensive nga ana e Serbisë për ta penguar adoptimin (duke shtuar edhe mbështetjen e Hungarisë së presidentit Viktor Orbán)²¹. Ky qëndrim i shtetit serb, trashëgimtar i drejtpërdrejtë i regjimit kriminel të Slllobodan Millosheviqit, duke nisur që me presidentin Vuçiq, siç u tha më lart, është vetëm vazhdim i atij negacionizmi shtetëror, që kriminelët e luftës i bënë heronj, si presidentin e mëparshëm serb Millosheviq, gjeneralin Ratko Mlladiq, i dënuar përfundimisht në qershor 2021 me dënim të përjetshëm nga Gjyqi Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ose Vojislav

²⁰ Pas dështimit të misionit të vëzhgimit të organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Europë [OSBE] në Kosovë, 1998.

²¹ Jean-Baptiste Chastand, “La commémoration du génocide de Srebrenica: la communauté internationale passe en force sur fond de polarisation”, *Le Monde*, 24 maj 2024.

Sheshelin, fillimisht i dënuar e më pas i liruar. Partia e këtij të fundit u bashkua me atë të presidentit aktual zyrtarisht gjatë zgjedhjeve komunale, dhe jozyrtarisht gjatë atyre legislative në dhjetor 2023²².

Sovraniteti i Perëndimit mbrohet në Kosovë

Tani që shtetet më të fuqishme në Europë dhe brenda BE-së ndihen të shqetësuara për sovranitetin e tyre, për shkak të agresionit rus, shpresojmë të kuptojnë, më në fund, se si ndihet popullsia në Kosovës përballë agresionit të përditshëm të Serbisë. Shpresojmë që disa shtete anëtare të heqin dorë prej mungesës së qëndrimit, ose madje mirëkuptimit ndaj Serbisë.

Republika e Kosovës e kuptoi menjëherë agresionin e Rusisë dhe filozofinë prapa tij, prandaj dhe iu bashkua menjëherë e pa lëkundje aleatëve perëndimorë, jo vetëm për denoncimin deklarativ të agresionit rus, siç e bëri edhe Serbia, por në të gjitha masat e sanksionet ndaj politikës agresive ruse dhe ndihmave për Ukrainën, diçka që nuk e bëri Serbia e Vuçiqit, e cila tashmë ka një qeveri të përbërë me ekstremistë prorusë dhe me ministra të vendosur në “listën e zezë” të SHBA-së²³.

Njësoj siç iu bashkua Kosova sanksioneve të demokracive kundër agresionit rus, po ashtu pritet që aleatët demokratë, krahas Ukrainës, të mbështesin sovranitetin e Kosovës kundër çdo forme agresioni serb. Vetëm kështu ata mund të vendosen bashkërisht kundër një racizmi të ndërtuar mbi mite e të propaganduar nga qeveri dhe ministra si e ardhmja e botës, më saktë atë që presidenti Macron e konsideron *fundi i qytetërimit të Europës*.

Të gjitha vendet demokratike i kanë kërkuar Kosovës vendosjen e sundimit të ligjit si kusht i afrimit me to, dhe veçanërisht me BE-në. Mirëpo, kur sundimi i ligjit po shtrihej barabar brenda gjithë territorit të Kosovës, vendet demokratike morën masa kundër shtrirjes së sundimit të barabartë të ligjit dhe në të gjithë territorin, siç ndodhi me rastin e cituar më lart të kryetarëve të komunave. Çdo përpjekje e vendosjes së rendit

²² Milica Cubrilo, “En Serbie, le retour en grâce du criminel de guerre Vojislav Seselj”, *Le Figaro*, 15 dhjetor 2022.

²³ “U.S. “Disappointed” proposed Serbian Government Includes Blacklisted Individuals”, RFE/RL’s Balkan Service, 1 maj 2024.

demokratik dhe publik të ushtrimit të ligjshëm të sovranitetit të Kosovës në pjesën veriore të territorit të saj (dhe kjo nis me çështjen e targave të automjeteve) u interpretua si provokim dhe rrezikim i stabilitetit. Përndodh e njëjta gjë me rihapjen e urës së Mitrovicës.

Ironikisht, argumenti i dhënë nga demokracitë perëndimore ishte analog me atë që ka përdorur Putini me vite kundra NATO-s. Anëtarësimi në NATO (dhe në BE) i vendeve sovranë, por në kufi me Rusinë, interpretohej nga Putini si provokim ndaj Rusisë dhe përshkallëzim i konfliktit kundër saj. Në analogji me këtë, shtrirja e sundimit të ligjit brenda territorit të Kosovës, përfshirë edhe territoret pranë kufirit me Serbinë, u perceptua nga Quinti dhe Bashkimi Europian si provokim i rrezikshëm për Beogradin dhe përshkallëzim i konfliktit me Serbinë.

Nisur nga ky perceptim që u kundërvihet interesave të Kosovës sovranë, demokracitë europiane që kanë njohur pavarësinë e saj, e gjykuan Kosovën si përgjegjëse për akte të pakoordinuara dhe për destabilizim, duke vendosur me një cektësi turbulluese masa ndëshkimore ndaj saj. Këto masa sot ndëshkojnë jo vetëm procesin e integritetit në BE, por gjithashtu projektet e zhvillimit europian dhe të dyanshëm, ndërkohë që demokracitë nuk dinë më si t'i heqin këto masa pa unanimitetin e shteteve anëtare. Kështu që, për sa kohë që qeveria nuk ka asnjë vështirësi për të vijuar politikën e shtrirjes së pranisë së shtetit (të shtetit të së drejtës dhe të shërbimit publik) në veri të Kosovës²⁴ – njoftimi dhe përgatitja e rihapjes së urës së Mitrovicës është shembulli më i fundit – shtetet anëtare që kanë njohur sovranitetin e Kosovës ndiejnë se kanë rënë në kurthin e burokracisë së rëndë komunitare!

Del në pah përfundimisht, se në pikëpyetje nuk është cilësia e zbatimit të ligjit dhe e demokracisë në Kosovë, as pse ligji zbatohet edhe mbi pakicën serbe, aq më tepër që shumica e pakicës serbe nuk jeton në veri, dhe shumica e komunave me shumicë serbe nuk gjenden në veri, por në pjesën tjetër të territorit të Kosovës. I vetmi dallim me pjesët e tjera është se ajo pjesë ndodhet në kufi me Serbinë. Dikur shqetësim për

²⁴ Shih njoftimin e fundit të gushtit mbi mbylljen në Veri të Kosovës së pesë institucioneve të tjera paralela të lidhur me Serbinë: "The Government of Kosovo confirmed the Closure of Five parallel Serbian Institution in the North", *Sarajevo Times*, 31 gusht 2024.

demokracitë ishte fakti, se “*sundimi i ligjit nuk është efektiv në të gjithë Kosovën, veçanërisht në Veri*”²⁵. Ndërsa tani që po bëhet efektiv edhe në Veri, në përputhje me parimet demokratikë dhe të së drejtës të promovuar nga shtetet perëndimore e të kërkuar për anëtarësim në BE dhe NATO, po të njëjtat shtete radhiten me Serbinë dhe Rusinë, në tryshinë që ka për qëllim kufizimin e përdorimit të sovranitetit të Kosovës.

Do të ishte mirë të rikujtonim se demokracia ka fituar përballë autokracive sa herë që ka besuar se sovraniteti i shtetit dhe sundimi i ligjit demokratik nuk bien ndesh mes tyre. Prandaj ende nuk shohim në horizont ndonjë arsye për të besuar të kundërtën, pra se “sovraniteti i kufizuar” i një shteti të dobët demokratik do të qetësonte presionin autokratik të një shteti më të fortë. Aq më pak kur ekzistojnë arsye, që të na sigurojnë fitoren e demokracisë e të paqes në rrafsh ndërkombëtar kundrejt shteti autokratik, pasi demokracia dhe paqja tanimë janë të reduktuara në mbijetesë. Prandaj, ashtu si dikur, edhe sot në Veri të Kosovës, me vullnetin për të pohuar sovranitetin dhe luftën ndaj krimit të organizuar që mbretëroi aty për dy dekada, me vullnetin për shtrirjen e shtetit të së drejtës, qeveria e Kosovës ka për synim të vendosë në fund të procesit një rend demokratik afatgjatë.

Prandaj, edhe pse është herët të nxirret ndonjë përfundim i qëndrueshëm, studimi i parë që UNDP-ja ka bërë lidhur me opinionin e qytetarëve serbë, pas shtrirjes së sundimit të ligjit në Veri, dëfton se ata ndihen të sigurt²⁶. Sigurisht, krahasuar me cilësinë e demokracisë në vendet skandinave, mbetet shumë punë për t’u kryer në Kosovë. Megjithatë, në krahasim me Serbinë, (madje edhe me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor), Kosova listohet shumë më lart në klasifikimet ndërkombëtare të referencës, ndërkohë që prirja e zhvillimit të Kosovës vlerësohet kah demokracia, ajo e Serbisë vlerësohet kah autokracia²⁷.

²⁵ Shih komunikimin e Komisionit të Këshilli dhe Parlamenti Europian, “Enlargement Strategy and Main Challenges 2009-2010”, COM(2009)533 final.

²⁶ UNDP, Public Pulse Brief # 25, 28 shkurt 2024, <https://www.undp.org/kosovo/press-releases/undp-publishes-public-pulse-brief-25>.

²⁷ Shih https://atlas.bti-project.org/1*2024*CV:CTC:SELRKS*CAT*RKS*REG:TAB; po ashtu, HRW Report, countries, 2021, 2022, 2023, 2024; Freedom House – *Freedom in the World*, 2022-2023, ku Serbia përfshihet në vendet me rënien më të madhe të demokracisë, f. 3 dhe 7.

Duhet nënvizuar po ashtu, se shoqëria civile serbe nuk ngurroi të mobilizohet kundër dhunës sistematike gjatë vitit 2023, apo edhe në javët e fundit kundër katastrofës ekologjike, ku mund të shpjerë projekti i minierës së litiumit (projekt i mbështetur nga kancelari gjerman²⁸). Për opozitën qytetare serbe ishte dëshpëruese që nuk e ndjeu mbështetjen e shpresuar nga ana e demokracive perëndimore përballë autoritarizmit të Vuçiqit. Protestat e opozitës “Serbia kundër dhunës”, të filluara në maj 2023 dhe të organizuara përgjatë tre muajve, edhe pse u shtrinë në tërë qytetet kryesore të Serbisë, u gjendën para një indiference europiane pothuajse të përgjithshme, ashtu siç mbetën pa efekt ato që u organizuan sërish në dhjetor të po të njëjtit vit kundër manipulimit të votave në zgjedhjet parlamentare²⁹.

Përkundrazi, menjëherë pas formimit të qeverisë nga partia e Vuçiqit, komisioneri i BE-së për Punët e Jashtme dhe Sigurinë, Josep Borrell, deklaroi se “mezi pret të punojë me qeverinë e Serbisë”³⁰, përbërjen dhe natyrën e së cilës e thamë se cila është: *postet e larta i mbajnë elementët më radikalë prorusë, mbështetës të presidentit Vladimir Putin, përfshirë të famshmin Aleksandër Vulin, edhe pse vetë SHBA-ja e ka renditur në listën e zezë të saj*.

Në këtë kontekst politik duket se është e rrezikshme për opinionin publik serb të mbështesë sovranitetin e Kosovës dhe demokratizimin e saj. I fundit që e provoi, në shkurt të këtij viti, është politikani properëndimor Nikola Sandulović, i cili u rrah deri në humbjen e vetëdijes, sepse “guxoi të kërkojë falje për krimet në Kosovë” dhe të vendosë lule në varrin e një vajze shtatëvjeçare të vrarë nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës së vitit 1999³¹.

Në këtë kontekst, fqinjët e Serbisë mund të shqetësohen ligjshëm për qëndrueshmërinë e vendimit të Francës për shitje të avionëve të luftës

²⁸ Jean-Baptiste Chastand, “L’Allemagne mise sur la Serbie pour approvisionner son industrie automobile en lithium”, *Le Monde*, 19 korrik 2024.

²⁹ “Élections en Serbie: de nouvelles manifestations de l’opposition contre la fraude électorale présumée”, *Le Monde* me AP dhe AFP, 24 dhjetor 2023; Komunikatë shtypi e Parlamentit Europian, 8 shkurt 2024.

³⁰ Tweet i Josep Borrell, ose *Radio Slobodna Evropa*, 3 maj 2024.

³¹ Shih <https://www.theguardian.com/world/2024/feb/04/serbian-opposition-leader-secret-service-ordeal-nikola-sandulovic-kosovo-crimes-balkans>

(*Rafale*) Serbisë, si dhe të dyshojnë po ashtu, për argumentin e dhënë nga presidenti i Republikës, Emmanuel Macron, që vlerëson se kjo kontratë mundëson “radhitjen” e Serbisë me Bashkimin Europian. Ndërkaq, kur pyetej lidhur me sanksionet që Serbia nuk i zbaton ndaj Rusisë, presidenti francez më 29 gusht përgjigjej në Beograd, se “*nuk kemi për të dhënë leksione. Serbia nuk është në BE. Pra, ajo është sovrane në politikën e saj të sanksioneve dhe kjo është gjë e mirë*³²”. Fare mirë mund të mendohet reciprokisht, se Kosova është në të drejtën e saj të kërkojë respektimin e sovranitetit të ushtruar në të gjithë territorin e vet.

Pavarësisht kësaj dhe me gjithë shpërfilljen e sovranitetit nga demokracitë që e kanë njohur Kosovën si vend sovran, ne jemi të vendosur të qëndrojmë fort në krah të qytetërimit europian, vlerave europiane, vlerave demokratike, respektimit të të drejtave të njeriut, të shteteve e të barazisë së popujve. Sipas nesh, refuzimi i sovranitetit të Kosovës nga Serbia autokratike sigurisht që mund të vonojë përplotësimin e aspiratave demokratike të shtetit tonë, por nuk mund të ndalë procesin. Duke qenë të vendosur në periferi të demokracive dhe duke qenë fqinj i një vendi autokratik si Serbia, Kosova, po aq sa Ukraina, i njeh mirë pasojat e agresioneve të pësuar mbi sovranitetin. Këto pasoja duhet të shihen si në pasqyrë prej shteteve të tjera europiane, që njohin dhe u tremben agresioneve kundër sovranitetit të vet.

Prandaj jemi të bindur se, të bashkuar, mund t’i bëjmë ballë këtij rreziku ruso-serb, që rrënon sovranitetin e shteteve dhe qytetërimit europian. Nuk do të jetë hera e parë që qytetërimi europian do të rilindë edhe më i fortë pas agresioneve të tilla, por historia na mëson se është më mirë të parandalohet fronti agresiv ruso-serb. Ne e kuptojmë mirë se sjellja e diplomacive perëndimore mbështetet në besimin, e kotë sipas nesh, se duke mirëkuptuar Serbinë autokratike, kjo do të shtyhet drejt aleancës me Europën demokratike më shumë se me Rusinë diktatoriale. Fatkeqësisht, detyrohemi të konstatojmë, se Serbia gjithmonë është gjendur më afër Europës, kur Europa kultivonte afërsinë me Rusinë. Por më mirë është me qenë të bindur se Serbia do të jetë gjithnjë në krah të

³² Jean-Baptiste Chastand, “En vendant des avions Rafale à la Serbie, Emmanuel Macron espère éloigner Belgrade de Moscou”, *Le Monde*, 13 gusht 2024.

Rusisë dhe do të lidhet me botën europiane demokratike vetëm nëse Rusia bëhet demokratike, hipotezë shumë e largët sot për sot.

Në fund, është më e mundur të besohet se Hegeli kishte të drejtë, kur pohonte se *historia na mëson që nuk mësojmë prej saj*, sepse duket qartë se është mungesa e të mësuarit prej historisë, ajo që e bën të mundur përsëritjen e saj, më shpesh si tragjedi sesa si komedi.

* Ky artikull është botuar në frëngjisht, në “Jean Jaures”, më datë 05.09.2024 dhe mund ta gjeni këtu: <https://www.jean-jaures.org/publication/ce-que-nous-enseigne-le-conflit-au-kosovo-avec-la-serbie-sur-notre-souverainete/>

1.3 Profesor Abdulla MEHMETI

Krahina e Sanxhakut rikthehet në identitetin e natyrshëm

Krahina e Sanxhakut, e njohur si Sanxhaku i Pazarit të Ri, ose vetëm si Sanxhaku, historikisht paraqet një krahinë të veçantë, e cila përfshin pjesën jugperëndimore të Serbisë së sotme dhe pjesën veriore të Malit të Zi të sotëm. Krahina e Sanxhakut, me ekzistimin e saj për një periudhë të gjatë, është zhvilluar në njësi territoriale, etnike, kulturore, konfesionale, historike dhe administrative më vete, me qendër qytetin e Pazarit të Ri.

Sanxhaku ka një sipërfaqe prej më tepër se 8,687 km² dhe 530 mijë banorë. Kryeqyteti është Pazarit i Ri. Kjo krahinë aktualisht kufizohet me Serbinë, Malin e Zi, Kosovën, Bosnjë-Hercegovinën dhe Shqipërinë. E përbëjnë këto qytete: Briboji, Gradaci, Prijepolja, Varoshi i Ri, Plevnja, Sjenica, Pazarit i Ri, Tutini, Bellopolja (Fushëbardhi), Berana, Rozhaja, Andieva, Plava dhe Gucia.

Që t'i kuptojmë drejt rrjedhat e sotme, duhet të thellohemi në të kaluarën e largët të kësaj krahine, e cila njihet si njësi e veçantë territoriale që nga shekujt XII dhe XIII të erës së re, ndërsa mbështetur në studimet më të reja historike dhe arkeologjike vërtetohet se ilirët kanë qenë të pranishëm dhe e kanë dominuar këtë hapësirë së paku 4000 vjet para erës së re.

Përgjatë historisë, sa herë u janë krijuar mundësitë, banorët vendas të krahinës së Sanxhakut i kanë shprehur aspiratat, disponimin dhe përcaktimin e tyre për një Sanxhak autonom dhe të lirë.

Këtë përcaktim, pas rënies së Perandorisë Osmane, e cila sundoi në këto hapësira gjatë pesë shekujve të kaluar, banorët e Sanxhakut e kanë shprehur fillimisht në Konferencën e Sjenicës, e mbajtur mes datës 8 dhe 25 gusht të vitit 1917, ku mes të tjerash u soll edhe një rezolutë, me të cilën, dy pjesët e aneksuara të Sanxhakut nga Serbia dhe Mali i Zi, sipas vendimeve të konferencave të njohura ndërkombëtare të viteve 1878 dhe 1913, t'i bashkëngjiten Bosnjë-Hercegovinës, “meqë sipas historisë dhe gjuhës i takojnë asaj, jo Serbisë dhe Malit të Zi”, kurse në rastin më të

fundit, nëse kjo nuk realizohet, nga faktori ndërkombëtar të kërkohet njohja e Autonomisë së Sanxhakut.

Nga viti 1877 deri më 1913, Sanxhaku ka qenë njësi e veçantë, i njohur si Sanxhaku i Pazarit të Ri, në kuadër të Vilajetit të Kosovës, së bashku me 5 sanxhaqe të tjera të banuara kryesisht me shqiptarë, me një numër të vogël të banorëve me përkatësi të tjera etnike, si: boshnjakë, bullgarë, serbë, vlleh, romë etj.

Pas shumë përpjekjeve për t'u shkëputur nga kthetrat e sundimit të dhunshëm serb, Sanxhaku më 1943-1945 u shpall njësi e veçantë administrative dhe territoriale në kuadër të federatës së atëhershme jugosllave, e cila funksionoi dy vjet si e tillë, që me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe krijimin e ish-Jugosllavisë u shua me dhunë nga regjimi komunist i asaj kohe, për shkak të ndikimit të fuqishëm të politikës ekspansioniste serbe mbi krahinën e Sanxhakut, dhe jo vetëm të tij.

Këshilli Kombëtar i Sanxhakut, i përbërë nga subjektet e reja politike dhe forcat përparimtare të vendit, me fillimin e periudhës së pluralizmit në hapësirat e ish-Jugosllavisë, më 25, 26 dhe 27 tetor 1991 organizoi Refenderumin për Autonomi të Sanxhakut, në bazë të të cilit Kuvendi për Autonominë e Sanxhakut, më 11 janar 1992 solli vendim për njohjen e Statusit Special të Sanxhakut, si formë e vetëpërcaktimit dhe zgjidhje optimale në rrethanat e reja pas shkatërrimit të ish-Federatës Jugosllave, siç thuhet: *“Për popullin mysliman, i cili është autokton në këto troje”*.

Rrethanat historike dhe pozita gjeografike specifike gjithmonë kanë qenë të padrejta për krahinën e Sanxhakut, e cila edhe përkundër përpjekjeve dhe sakrificave të mëdha nuk arriti të krijojë njësi të veçantë administrative territoriale të qëndrueshme, as t'i bashkëngjitet ndonjërit nga shtetet fqinje, me të cilat natyrshëm e lidhin përkatësia etnike, besimi fetar, traditat, zakonet dhe veçoritë të tjera, për shkak të rrethanave historike, si dhe duke u lëkundur mes identitetit fetar e gjuhësor të lidhur me Bosnjë-Hercegovinën, dhe përkatësisë etnike shqiptare dhe të kaluarës së përbashkët historike, me Kosovën, përkatësisht me popullin që e lidh natyrshëm gjeneza ilire e popullsisë së Sanxhakut, siç e pranojnë gjatë viteve të fundit shumica e intelektualëve, kreu fetar dhe një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së Sanxhakut.

Pavarësisht nga rrethanat e reja të krijuara pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe krijimit e shteteve të reja të pavarura, në kuadër të së cilave përfshihen qytetet dhe rajonet e kësaj krahine, Sanxhaku gjatë dy dekadave të fundit ka arritur të rizgohet në aspektin e vetëdijes kombëtare, me forcimin dhe rikthimin në identitetin e tij të natyrshëm, për të cilën dëshmi më e mirë janë themelimi i Universitetit në Pazarin e Ri dhe krijimi i Qendrës së veçantë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bosnjë-Hercegovinës në Pazar të Ri.

Se çfarë fati të ri do të sjellin integrimet e reja rajonale dhe globale për krahinën e Sanxhakut dhe popullin e saj, pritet të shihet në të ardhmen.

1.4 Kristina Nano

[Kandidate për doktoraturë, JMU, SHBA]

Shqipërisë dhe shqiptarëve u duhen liderë të bashkimit, jo të dasive!

Abstrakt

Historia e shqiptarëve është e mbushur me shembuj të qëndresës dhe potencialit për bashkim, por gjithashtu është karakterizuar nga përçarja dhe fragmentarizimi politik e shoqëror. Ky artikull analizon nevojën për një model të ri lidërshipi, i cili shkon përtej ndasive tradicionale dhe ndërton një ekosistem bashkëpunimi kombëtar. Duke u mbështetur në mendimet e filozofëve politikë, si Machiavelli, Aristoteli, Hobbes dhe Locke, artikulli argumenton se kohezioni dhe bashkëpunimi janë parakushtet kryesore për mbijetesën dhe suksesin e një kombi të vogël në një botë të ndërruar. Në epokën e teknologjisë dhe globalizimit, shqiptarët kanë mundësinë të krijojnë një model lidërshipi që promovon unitetin, sinergjinë dhe ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme. Artikulli propozon katër hapa kryesorë për të kaluar nga përçarja në bashkim, duke përfshirë rimodelimin e lidërshipit, edukimin qytetar, institucionalizimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërtimin e një vizioni të përbashkët. Në përfundim, theksohet se zgjedhja mes bashkimit dhe fragmentarizimit do të përcaktojë fatin e kombit shqiptar në shekullin XXI.

Fjalë kyç: lidërship, bashkim, kombëtar, vizion

Hyrje

Historia e shqiptarëve është një histori e qëndresës, por edhe e përçarjes. Ndërsa shpesh kemi qenë të gatshëm të sfidojmë fuqitë e mëdha për të ruajtur identitetin tonë kombëtar, paradoksisht nuk kemi arritur të krijojmë një unitet të qëndrueshëm mes nesh. Vetëmohimi i

Skënderbeut, Lidhja e Prizrenit, Shpallja e Pavarësisë dhe qëndresa ndaj regjimeve të huaja janë dëshmi të potencialit të madh të bashkimit shqiptar.

Por këto momente kanë qenë të rralla.

Më larg se pak kohë më parë kemi parë dështimin e tij, për shkak të fragmentarizimit të elitave politike dhe sociale, mungesës së një vizioni të përbashkët dhe tendencës për të ngritur mbi gjithçka interesat individualë mbi ata kombëtarë. Në epokën e re, ku rendi botëror po ndryshon me shpejtësi, Shqipëria dhe shqiptarët nuk mund të mbijetojnë si faktor pa një lidhësi të bashkimit.

Shekulli XXI nuk është më ai i liderëve providencialë, dominues dhe të izoluar, por i atyre që ndërtojnë ura, krijojnë sinergji dhe formojnë struktura të forta bashkëpunimi. Në një botë të ndërruar, ku kombet e vogla mbijetojnë vetëm përmes kohezionit të brendshëm dhe aftësisë për të krijuar aleanca të qëndrueshme, shqiptarët duhet të ngrihen mbi ndasitë e vjetra dhe të kultivojnë një model të ri lidhësi.

Ndërtimi i bashkimit: Mësime nga historia dhe filozofia politike

Mendimtarët më të mëdhenj të historisë kanë paralajmëruar mbi rreziqet e përçarjes dhe kanë vlerësuar vlerën e bashkimit. Niccolò Machiavelli, në veprën e tij “Princi”, thotë se “një popull i bashkuar është i pamposhtur, por një komb i ndarë është i gatshëm për të rënë pre e të huajve”, një fat ky që shqiptarët e kanë provuar shpesh. Aristoteli, duke studiuar modelet e sundimit, pohonte se “një komb është më i fortë, kur sundimtarët e tij ndajnë pushtetin dhe nuk e monopolizojnë atë për përfitime personale”.

Por pikërisht kjo ka qenë plagë e vjetër shqiptare, pasi liderët tanë shpesh kanë dashur të sundojnë dhe jo të shërbejnë, të ndajnë dhe jo të bashkojnë. Plutarku, në esenë e tij mbi udhëheqësit, thotë se “të ndash njerëzit për t’i sunduar, është mënyra më e shpejtë për ta bërë një komb të dobët”. Kjo filozofi është përdorur shpesh nga armiqtë tanë historikë, por tragjedia e shqiptarëve është se përçarja shpesh është bërë me duart tona.

Ndërsa ankohemi se “Fuqitë e Mëdha” na kanë mbajtur të ndarë, realiteti është se liderët shqiptarë shpesh kanë kontribuar në këtë ndarje,

duke ndërtuar struktura të pushtetit bazuar mbi lojalitete të vogla lokale, rajonale, partiake apo personale.

Madje, edhe Thomas Hobbes, i cili në “Leviathan” argumentonte për domosdoshmërinë e një lideri të fortë për të mbajtur rendin, e shihte autoritetin si një mjet për të unifikuar shoqërinë, jo për ta ndarë atë në fraksione kundërshtarë. Një lider i fuqishëm, sipas Hobbes-it, nuk është ai që sundon përmes frikës, por ai që krijon një harmoni sociale, ku njerëzit ndihen të përfaqësuar dhe të sigurt.

Në kontekstin shqiptar, kjo do të thotë se ne nuk kemi nevojë për liderë që imponojnë dominimin e tyre, por për liderë që krijojnë struktura të përhershme bashkëpunimi.

John Locke, babai i liberalizmit, argumentonte se një shoqëri që nuk është e mbështetur në vlera të përbashkëta dhe në një sens të përbashkët drejtësie, është e destinuar për të dështuar.

Shqiptarët, të shpërndarë në disa shtete dhe të ndarë shpesh politikisht e kulturalisht, kanë nevojë për një projekt të ri unifikues, një ide të madhe që tejkalon ndarjet dhe që shkon përtej kufijve artificialë.

Teknologjia dhe shoqëria moderne: Bashkimi përmes lidërsipit të ri

Në një botë të globalizuar, ku teknologjia ka bërë të mundur komunikimin e menjëhershëm dhe organizimin social në një shkallë të paparë më parë, shqiptarët kanë më shumë mundësi se kurrë për t'u bashkuar.

Por kjo nuk do të ndodhë automatikisht.

Duhet liderë të rinj, që nuk përdorin teknologjinë vetëm për të ndërtuar imazhe personale, por për të krijuar infrastrukturë të bashkëpunimit kombëtar. Pierre Teilhard de Chardin, një mendimtar i shekullit XX, argumentonte se “njerëzimi nuk do të mbijetojë, nëse nuk kalon nga konkurrenca në bashkëpunim, nga individualizmi në ndërtimin e inteligjencës kolektive”.

Ky koncept është më i rëndësishëm se kurrë për shqiptarët, të cilët për shekuj me radhë kanë vuajtur nga rivalitetet klanore dhe ndarjet e brendshme. Në një epokë ku kombet e vogla mbijetojnë vetëm nëse veprojnë si një trup i vetëm, shqiptarët nuk mund të vazhdojnë të operojnë si ishuj të shkëputur nga njëri-tjetri.

Liderët e së ardhmes duhet të krijojnë një rrjet kombëtar të bashkëpunimit intelektual, ekonomik dhe politik që tejkalon ndarjet e shteteve ku jetojnë shqiptarët. Kjo kërkon një qasje të re strategjike, ku prioritet nuk është pushteti personal, por krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm për fuqizimin kombëtar në arenën ndërkombëtare.

Nga përçarja në kohezion: Çfarë duhet të bëjmë?

1. Rimodelimi i lidërshiptit - Liderët e rinj shqiptarë duhet të jenë ndërtues të unitetit, jo figura që krijojnë kampe të ndara. Ky lidërshipt duhet të mbështetet mbi vlera, si meritokracia, transparenca dhe përkushtimi ndaj interesit kombëtar.

2. Edukimi i qytetarëve – Një shoqëri e informuar është më pak e manipulueshme nga liderët përçarës. Shqiptarët duhet të mësojnë të dallojnë liderët që i përçajnë për interesa personale nga ata që synojnë ndërtimin e një kombi të fortë.

3. Institucionalizimi i bashkëpunimit kombëtar – Duhet të krijohen institucione dhe mekanizma që forcojnë bashkëpunimin mes shqiptarëve kudo që jetojnë. Organizatat e diasporës, universitetet, bizneset dhe elitat intelektuale duhet të punojnë së bashku për të krijuar një ekosistem kombëtar, që e forcon identitetin shqiptar.

4. Ndërtimi i një vizioni të përbashkët për të ardhmen – Duhet një narrativë e re kombëtare, e bazuar jo mbi viktimizimin dhe ankesat ndaj historisë, por mbi një vizion për një të ardhme të përbashkët dhe të fuqishme.

Epoka e bashkimit ose dekadencia e përhershme

Historia na ka mësuar se kombet që qëndrojnë të ndarë për një kohë të gjatë ose asimilohen, ose humbasin rëndësinë e tyre.

Shqipëria dhe shqiptarët janë në një pikë kthese.

Modeli i vjetër i lidërshiptit përçarës është i konsumuar. Nëse duam një komb të fortë, të respektuar dhe të begatë, duhet të zgjedhim liderët e bashkimit, jo të dasive. Kjo është sfida dhe mundësia jonë më e madhe. Dhe koha për ta realizuar është tani.

Referenca

Aristotle. (350 BCE/1998). *Politics* (C. D. C. Reeve, Trans.) Hackett Publishing.

- Hobbes, T. (1651/1996). *Leviathan* (R. Tuck, Ed.) Cambridge University Press.

- Locke, J. (1689/1980). *Two treatises of government* (P. Laslett, Ed.). Cambridge University Press.

- Machiavelli, N. (1532/1988). *The prince* (Q. Skinner & R. Price, Trans.). Cambridge University Press.

- Plutarch. (75 CE/2004). *Plutarch's lives* (B. Perrin, Trans.). Harvard University Press.

- Teilhard de Chardin, P. (1955/2008). *The phenomenon of man* (B. Wall, Trans.). Harper Perennial.

Shënim: Kumtesë e lexuar [Skype] në konferencën shkencore: “Roli i shqiptarëve në rajon dhe qasja e administratës Trump - Një perspektivë e re”, mbajtur në Shkodër, më 13.03.2025, organizuar nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë [Prishtinë] në bashkëpunim me Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

1.5 Dr. Mentor BEQA

Shqipëria, si mund të jetë!?

Shqiptarët duhet të mendojnë për një strategji të madhe, të informuar nga vetëdija historike dhe realitetet objektive. Doktrina Koncentrike e Aleancave do të përbënte thelbin e kësaj strategjie, duke vepruar si një plotësim dhe jo si një alternativë e arkitekturës së sigurisë kolektive, në të cilën bën pjesë Shqipëria.

Mbijetesa jonë si komb është një mrekulli. Në trekëndëshin e popujve, kulturave dhe qytetërimeve të mëdha greke, latine dhe sllave, një popull relativisht i vogël, pa një gjuhë të shkruar, ka arritur t'u mbijetojë stuhive të historisë, ndërkohë që kultura më të mëdha janë arkivuar në historinë e hershme.

Në mungesë të një bërthame organizative politike - të paktën përgjatë pjesës më të madhe të historisë së njohur - shqiptarët, falë peshës së madhe gravitacionale që familja dhe fisi kishin në organizimin e jetës komunitare, zhvilluan shqisën e përshtatshmërisë. Ata ruajtën kohezionin e brendshëm organizativ komunitar dhe krijuan mekanizma të jashtëm për t'u përshtatur me rrethanat politike të krijuara, duke mbijetuar si një entitet i veçantë etnolinguistik brenda organizimeve të ndryshme perandorake. Ky ishte tharmi që, me mençuri, vetësakrificë dhe këmbëngulje u fermentua nga Rilindja Kombëtare për të ngjizur kombin politik shqiptar.

Pragmatizmi politik (të cilin do ta shqyrtojmë më në thellësi në një sprovë tjetër) shfaqet si vetia themelore në optikën që ka Rilindja për të ardhmen e Shqipërisë. Shqipëria e Rilindjes, si një ide kombëtare, mbështetej në tri premisa: (I) **shqipja** si tipar përcaktues i të qenit shqiptar; (II) **europianizmi** si model orientimi kulturor dhe politik; (III) **multikonfesionaliteti** si bashkëjetesë mes feve brenda kornizës politike të shqiptarësisë. Këto premisa përbënin bazën, mbi të cilën do të ndërtohej

kombi politik, i cili do të vetëpohohej në arenën e kombeve të qytetëruara.

Mes rilindësve ekzistonte një konsensus mbi perceptimin e popujve fqinj si armiq, në kuptimin shmitian të termit, duke përfshirë turqit, grekët, serbët dhe bullgarët. Kjo armiqësi nuk ishte ideologjike, por thjesht pragmatike, e lidhur me rrezikun që këto kombe përbënin për mbijetesën e kombit shqiptar. Sipas Sami Frashërit, turqit, në përpjekje për të mbrojtur bërthamën e Perandorisë, po sakrifikonin periferitë, një zhvillim fatal për shqiptarët; grekët synonin territoret jugore shqiptare; serbët kërkonin zgjerim nga veriu deri në Adriatik, ndërsa bullgarët shtriheshin nga veriu dhe juglindja mbi territoret e banuara nga shqiptarët. Në këtë perspektivë, shqiptarët, në rrethin e tyre të parë të drejtpërdrejtë, ndodheshin të rrethuar nga popuj që synonin të maksimizonin interesat e tyre territoriale në dëm të shqiptarëve.

Në një memorandum që qytetarët e Shkodrës i dërgonin Lord Beaconsfield-it (Benjamin Disraeli, kryeministër i Britanisë së Madhe) para Kongresit të Berlinit, artikulloheshin idetë bazë gjeopolitike të Rilindjes:

- Shqiptarët janë një popull i veçantë, unik dhe historik në trojet e tyre;
- Janë mjaftueshëm të fuqishëm për të luftuar dhe mbrojtur veten, por jo aq sa të kërcënojnë të tjerët;
- Fluiditeti i faktorit shqiptar nxit orekset e vendeve fqinje dhe krijon paqëndrueshmëri në rajon;
- Shqiptarët përbëjnë një barrierë natyrore kundër ekspansionit rus në Mesdhe.

Për shkak të këtyre arsyeve, Shqipëria duhej të vihej nën patronazhin e Britanisë së Madhe, si fuqia më e madhe jashtë-rajonale e kohës.

Thelbi i strategjisë së madhe të Rilindjes ishte krijimi i një entiteti politik kombëtar, i cili do të krijonte një ekuilibër fuqie në Ballkan dhe do të pengonte zgjerimin e popujve sllavë drejt Adriatikut. Ky projekt kombëtar mbështetej në patronazhin e fuqisë më të madhe jashtërajonale të kohës, Britanisë së Madhe, si dhe në aleancë me kombet europiane,

përfshirë Italinë. Një strategji e tillë do t'i sigurate Shqipërisë garanci ndaj ambicieve ekspansioniste të kombeve fqinje dhe do të shërbente si faktor stabilizues për të gjithë rajonin.

Strategjia e Rilindjes nuk u realizua, për shkak të ndarjes së territoreve dhe popullsisë shqiptare, çka prishi ekuilibrin rajonal. Shqipëria e mbetur politike u reduktua në një zonë tampon përgjatë brigjeve të Adriatikut, duke amortizuar interesat gjeopolitikë të fuqive të mëdha, si Rusia, Austro-Hungaria, Italia, si dhe ato të fuqive më të vogla rajonale.

Pjesa e mbetur e shekullit XX pasqyron këtë realitet material, i cili e bëri Shqipërinë vulnerabël ndaj interesave të fqinjëve dhe fuqive të treta. Mbijetesa e saj u diktua nga dy strategji të alternuara: herë nënshtrimi ndaj një fuqie dominuese, herë balancimi i fqinjëve përmes mbështetjes tek aktorë jashtërajonalë.

Gjysma e dytë e Luftës së Ftohtë solli një ngrirje të gjeopolitikës rajonale, për shkak të *status quo*-së në nivel ndërkombëtar. Kjo situatë i dha Enver Hoxhës hapësirën e nevojshme për ta izoluar Shqipërinë dhe për të konsoliduar regjimin e tij në kushtet e një vetëpërrjashtimi nga sistemet e mëdha të aleancave globale.

Rënia e Bashkimit Sovjetik shënon një moment historik të ri dhe një mundësi për të “hakmarrë” historinë në favor të kombit shqiptar. Triumfi i liberalizmit politik dhe dominimi i fuqisë amerikane krijuan kushtet për një rikonfigurim të Ballkanit në përputhje me interesat shqiptarë.

Shqipëria u pozicionua në një aleancë natyrore, ashtu siç kishin shpresuar rilindësit, por në vend të Britanisë së Madhe këtë rol tashmë e luante SHBA-ja. Në këtë kontekst, Kosova fitoi lirinë dhe më pas pavarësinë, ndërsa shqiptarët në Maqedoni u faktorizuan si një entitet shtetformues brenda Maqedonisë së Veriut. Momenti unipolar i dominancës amerikane dhe i rendit liberal ishte bekimi më i madh për shqiptarët, pavarësisht se përfitimet prej tij nuk u maksimizuan plotësisht.

Busulla e orientimit për Shqipërinë, Kosovën dhe shqiptarët në rajon u kthye drejt Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian. Strategjia e madhe përfshinte dy objektiva madhorë: a) anëtarësimin në NATO si garanci për sigurinë dhe b) anëtarësimin në Bashkimin Europian si garanci për demokracinë dhe prosperitetin ekonomik. Në këtë kontekst

nuk mund të kishte një alternativë tjetër ndaj këtyre objektivave strategjikë.

Si rrjedhojë, Shqipëria u kaplua nga një dembelizëm intelektual dhe një përgjumje strategjike. NATO-ja dhe BE-ja u shndërruan në përgjigje universale për të gjitha problemet, duke krijuar një ndjenjë sigurie, e cila pengoi zhvillimin e një mendimi kritik mbi të ardhmen. Kjo gjendje ishte e favorshme për aq kohë sa zgjati, por pakkush u shty të reflektonte mbi faktin se NATO-ja, deri diku edhe BE-ja, janë të lidhura ngushtë me supremacinë amerikane nga njëra anë, dhe me idenë e triumfit të liberalizmit, nga ana tjetër.

Sot, as njëra dhe as tjetra nuk janë më të sigurta. Shtetet e Bashkuara kanë filluar të ndiejnë barrën e tejshtirjes – një faktor që historikisht ka kontribuar në rënien e të gjitha perandorive – dhe po rivendosin prioritetet e tyre gjeopolitike. Në këtë rikonfigurim, Europa nuk është më në qendër të vëmendjes, e aq më pak Ballkani. Ndërkohë, vetë Europa po përballet me një moment polikrize, e cila kufizon aftësinë e saj për të menduar strategjikisht dhe për të operacionalizuar fuqinë e saj ekonomike në terma të politikës strategjike.

Shqipëria dhe shqiptarët gjenden pa një përgjigje të qartë ndaj këtij realiteti të ri. Mungesa e një mendimi strategjik e bën vendin të papërgatitur për të përballuar ndryshimet në ekuilibrat ndërkombëtarë.

Politika e madhe është e përqendruar në duart e kryeministrit, i cili operon kryesisht në terma elektorale dhe në funksion të zhvillimeve të momentit. Ndërkohë, strukturat e tjera, që në teori duhet të adresojnë pozicionin strategjik të Shqipërisë në kushtet e dinamikave të reja gjeopolitike ose funksionojnë si entitete implementuese, ose janë të përfshira në çështje teknike. Si rezultat, vendi mbetet pa një vizion të qartë dhe të operacionalizuar strategjikisht, çka e pengon të zbusë barrën e paparashikueshmërisë në zhvillimet gjeopolitike.

Shqiptarët duhet të mendojnë për një *strategji të madhe* të informuar nga vetëdija historike dhe realitetet objektive. Doktrina Koncentrike e Aleancave do të përbënte thelbin e kësaj strategjie, duke vepruar si një plotësim, dhe jo si një alternativë e arkitekturës së sigurisë kolektive në të cilën bën pjesë Shqipëria.

Kjo doktrinë do të funksiononte në tri nivele ose rrethe koncentrike:
- **Rrethi i parë** – Bërthama: përfshin Shqipërinë, Kosovën dhe shqiptarët në rajon. Shqipëria dhe Kosova përballen me imperativin historik të krijimit të një *strategjie të madhe* të përbashkët, e cila duhet të hedhë bazat e integritetit funksional dhe sektorial ndërmjet dy shteteve, si dhe të mbrojtjes së përbashkët, si një aspekt plotësues i sigurisë kolektive të NATO-s.

- **Rrethi i jashtëm** përfshin Shtetet e Bashkuara, NATO-n dhe Bashkimin European, duke përfshirë edhe fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale me vendet kryesore të BE-së, një dimension i neglizhuar në politikën e jashtme të Shqipërisë. Aleanca me SHBA-të duhet të shkojë përtej romantizimit të marrëdhënies së ndërtuar në momentin unipolar. Në kushtet e reja gjeopolitike, Shqipëria dhe Kosova duhet të zhvillojnë alternativa të përbashkëta për të ruajtur vëmendjen strategjike të SHBA-së, duke përfshirë elemente të ndërvlerësive ekonomike. Një opsion i tillë mund të jetë shndërrimi i një prej porteve shqiptare në hyrjen kryesore të gazit të lëngshëm amerikan në Europë, ndërsa Kosova mund të pozicionohet si një qendër shpërndarëse për Europën Qendrore dhe Veriore. Kjo do të krijonte një interes strategjik konkret, duke e integruar faktorin shqiptar në hartën e sigurisë energjetike të Perëndimit.

- **Rrethi i ndërmjetëm**, i cili ka qenë tërësisht i neglizhuar në mendimin strategjik shqiptar, duhet të fokusohet në forcimin e aleancave rajonale përtej kornizave formale të “fqinjësisë së mirë”, duke u mbështetur mbi parimin e interesit reciprok.

Në reflektim të parimit të kahershëm se nuk ka aleanca të përhershme, por interesa të përhershëm, shqiptarët ndodhen në një pozitë më të favorshme sesa në kohën e Rilindjes, pasi shumica e vendeve të rajonit nuk janë më armiq tradicionalë, por shtete me të cilat mund të ndërtohen marrëdhënie strategjike.

Një strategji e tillë do të krijonte një rrethim strategjik të Serbisë, duke shkurajuar çdo mendim aventuresk që mund të destabilizonte rajonin dhe ta rikthente atë në një gjendje hobsiane të konfliktit të përhershëm.

Brenda këtij rrethi, në nivelin e parë përfshihen vendet rajonale që janë anëtare të NATO-s, si Turqia, Kroacia dhe Bullgaria, të cilat

përfaqësojnë një bazë të fortë për sigurinë rajonale. Në këtë rreth hyn edhe Bosnjë-Hercegovina, e cila, megjithëse jashtë NATO-s, ndodhet në një pozitë, ku mund të kontribuojë në këtë ekuilibër strategjik.

Si përfundim, *strategjia e madhe* e shqiptarëve duhet të rifitojë një rol qendror në mendimin politik dhe gjeostrategjik të Shqipërisë dhe Kosovës. Në kushtet e një bote gjithnjë e më të paqëndrueshme, ku garancitë tradicionale të sigurisë dhe stabilitetit po rishkruhen, shqiptarët nuk mund të mbeten thjesht spektatorë të dinamikave globale dhe rajonale.

Doktrina Koncentrike e Aleancave ofron një model strategjik që kombinon integrimin e brendshëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, zgjerimin e aleancave rajonale mbi bazën e interesave të përbashkët dhe angazhimin e fuqishëm me aleatët perëndimorë, duke u pozicionuar si një faktor proaktiv dhe i pazëvendësueshëm në arkitekturën e sigurisë dhe të stabilitetit europian.

Në këtë kuadër, Shqipëria dhe Kosova duhet të dalin nga përgjumja strategjike, të tejkalojnë qasjet pasive dhe të ndërtojnë një politikë të jashtme dhe të sigurisë të mbështetur mbi autonomi strategjike të kushtëzuar, e cila nuk kërkon alternativa ndaj Perëndimit, por plotësime që rritin peshën dhe rolin shqiptar në rajon e më gjerë. Vetëm në këtë mënyrë, shqiptarët mund të transformojnë momentet historike në mundësi konkrete dhe të shmangin sërish rrezikun e mbetjes peng i forcave të tjera gjeopolitike.

1.6 Gjeneral Piro AHMETAJ

Shqipëri-Kosovë, dy vende sovrane – një Komb i vetëm

Paraprakisht më duhet që të falënderoj përزمërsisht medien brenda dhe jashtë vendit për publikimin (25 vitet e fundit) të dhjetëra vlerësimeve strategjike në fushën e reformave të sistemit të mbrojtjes dhe zhvillimit të interesave (mbarë) kombëtarë, me fokus situatën e sigurisë pas çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb (06/1999); progresin dhe sfidat për ndërrimin e paqes së qëndrueshme, si dhe agjendën e integritetit euroatlantik (NATO/BE) të vendeve të rajonit të Ballkanit.

Edhe pas daljes në rezervë, në kapacitetin (*forumin*) e ekspertit të fushës së SK-së, rajonit dhe NATO-s, jam përpjekur për të përfaqësuar dhe prezantuar me dinjitet interesat (mbarë) kombëtarë në: “*Dhjetëra konferenca të Këshillit të Atlantikut, Institutit të Luftës dhe panele të ekspertëve/kolegëve të sigurisë në Uashington, USA; Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani; Kolegjin e NATO-s, Romë, si dhe tri samitet e fundit të Aleancës Euroatlantike, Madrid, 22, Vilnius - 2023, Uashington, 2024 etj*”.

I. Konsiderata të përgjithshme

Përtej profecisë “*si mallkim*” të Nolit mbi shtazërinë e luftës me njëri-tjetrin (për kolltukët e politikës dhe zullumqarët e pushtetit), nuk mund të mohojmë, “*përkundrazi përulemi*” për të rënë, luftëtarët dhe sakrificat sublime të shqiptarëve në shekuj, por edhe për patriotët vizionarë, penat e forta, si dhe përpjekjet konstante për kohezion, që veçmas apo së bashku mbeten të skalitur në memorien e nderit të historinë sonë (mbarë) kombëtare.

Gjithsesi nuk mund të krenohemi as me patriotizma folklorikë, as me “*histori legjendare*”; as me paranojën se “*fajin e ka gjithmonë bota*”, anglo-amerikanët, francezët etj. Kjo, pasi megjithëse me histori, gjuhë, kulturë, rreziqe dhe interesa të përbashkët, fatkeqësisht Shqipëria dhe Kosova mbeten ende të ndara. Nuk kam thënë dhe them kurrë të “*qurravitemi, as të dorëzohemi dhe as t'i nxjerrim sytë e njëri-tjetrit*”. Në

të kundërt, e përsëris që gjaku, sakrificat, përpjekjet, arritjet (qoftë edhe modeste), si dhe problematikat ose “*mësimet e nxjerra*” duhet të na shërbejnë si bazë për jetësimin të një koncepti, projekteve, si dhe një matrice të përbashkët mes dy vendeve. Pa bërë kursesë gjykatësë e protagonistëve të historisë së (pa)lavdishme, por as profetin e ardhmërisë së ndritur, në vijim gjeni një përmbledhje gjeopolitike, duke përsëritur edhe më fortë rekomandimin për të hartuar, nënshkruar dhe jetësuar një strategji historike mes RSH-së dhe Kosovës: “**dy vende sovranë, një Komb i vetëm**”. Për më qartë, aplikimin e parimit bazë (*artikullit-5*) të NATO-s: “*Çdo sulm ushtarak ndaj tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës konsiderohet edhe si sulm ndaj sovranitetit të RSH-së dhe anasjelltas. Kështu edhe kundërpërgjigja do të jetë e përbashkët, proporcionale dhe shkurajuese*”!

Kjo platformë/përjasje, që për disa mund të tingëllojë shumë e fortë, mbetet një e drejtë legjitime për të aplikuar një koncept të avancuar “*smart*” mbi mbrojtjen e sovranitetit, si dhe zhvillimin e interesave kombëtarë, duke garantuar faktorët ndërkombëtarë se kjo qasje nuk mbart asnjë “*kërcenim*” ndaj vendeve të rajonit. Në të kundërt, synon kontribute shtesë për zhvillimin e masave të mirëbesimit reciprok, bashkëjetesës paqësore mes popujve, stabilitetin demokratik dhe agjendën e integritetit euroatlantik. Për më tepër, që kjo paketë mbetet e hapur ndaj çdo vendi të rajonit (përfshi Serbinë), për të përballur dhe adresuar bashkërisht sfidat ndaj terrorizmit, krimit të organizuar, trafikëve, emergjencave civile dhe politikën e sigurisë së BE-së (ESDP).

Në shtesë të sa e sa paranojave bolshevike të E. Hoxhës, ende nuk arrij të (*mirë*) kuptoj pse dhe kush (*në fakt askush*) i ka ndaluar qeveritë (*demokratike*) pas vitit 1991, që ende nuk ka një akademi shkencash, sistem shëndetësor, mbrojtje kibernetike, ambasada të përbashkëta etj. Gjithsesi, duhet mbajtur në konsideratë që partneriteti strategjik (*2 Shtete – 1 Komb i vetëm*) mes RSH-së dhe Kosovës tejkalon mandatet e disa qeverive, si dhe paranojën turkoshake të përjetësisë së (mbi) pushtetit.

II. Paketë me 10 projekte të përbashkëta

Projekti nr. 1: Krijimi i një Instituti të përbashkët të Studimeve Strategjike për zhvillimin e SSK, SU, PAZH, standardizimin e

doktrinae, rregullave të angazhimit etj., eksperiencë që duhet të institucionalizohet me një MoU.

Projekti nr. 2. projekt-pilot ose shembullor për modernizimin e *sistemit të mbrojtjes civile* me koncept; paketë ligjore, kapacitete, rregulla angazhimi, strukturë të përbashkët të komandim-kontrollit (C2), si dhe një matricë me masa të përshkallëzuara dhe përgjegjësi respektive. Ndërsa mbështetur edhe në eksperiencën e Italisë, Sllovenisë, Austrisë etj., në vartësi të Qendrës (mbarë) Kombëtare të Emergjencave Civile (QKEC) mund të ketë tri njësi logjistike (*force provider*), 6 baza territoriale dhe 12 degë të mbrojtjes civile të shtrira në të gjithë territorin e RSH-së dhe Kosovës.

Projekti nr. 3: Sistem të përbashkët për arsimimin, trajnimin/stërvitjen e personelit ushtarak dhe civil për Forcave të Armatosura të të dy vendeve. Synimi i këtij projekti: “një Kolegj/Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), një akademi oficerësh, një akademi nënoficerësh, një shkollë trupe, një poligon stërvitjeje, si dhe program të përbashkët master dhe doktoraturë.

Projekti nr. 4: Njësi/ekipe përbashkëta për operacione ndërkombëtare të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja apo koalicionet, përfshirë stërvitje të përbashkëta fillimisht në nivel toge e kompanie, stërvitje të shtabeve në qendrën e përbashkët të simulimit, si dhe certifikimin sipas standardeve të Aleancës.

Projekti nr. 5: *Task force* e përbashkët për mbështetjen Kosovës në pesë fushat e Planit të Veprimit për Anëtarësim në NATO (*politika, ekonomia, kuadri ligjor, financat dhe informacioni*); për pjesëmarrjen në iniciativat rajonale, si në SEDM/SEEBRIG, A5, në “*Balkan Battle Group të BE*”; qendrat e ekselencës së NATO-s etj.

Projekti nr. 6: Inteligjencën ushtarake dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar sipas standardeve të NATO-s, me qëllim zhvillimin e kapaciteteve, si dhe rregulla të përbashkëta angazhimi të inteligjencës për parandalimin e akteve terroriste, krimi, destabilitetit të shoqërisë demokratike, etj.

Projekti nr. 7: Struktura, plane, masa dhe procedura të përbashkëta/koordinuara prokurimesh për blerjen e armatimit, pajisjeve

dhe sistemeve madhore, të bazuara në standardet e NATO-s, në mënyrë që Forcat e Armatosurta të të dy vendeve të jenë të ndërveprueshme.

Projekti nr. 8: Mirëmbajtja e armatimit, e pajisjeve dhe e sistemeve ushtarake, si dhe një infrastrukturë e përbashkët për të shkatërruar municionet dhe armatimet e tepërta jashtë përdorimit të Forcave të Armatosura.

Projekti nr. 9: Vëzhgimi dhe policimi i hapësirës ajrore mbetet një nga projektet/sfidat më të vështira, më të kushtueshme dhe kështu të pamundura për secilin nga dy vendet tona. Prandaj Shqipëria dhe Kosova do të duhen të angazhohen bashkërisht (për t'u bërë pjesë me MoU e programeve rajonale (p.sh., me Kroacinë). Me mbarimin e misionit të KFOR-it, ende përgjegjës për hapësirën ajrore të Kosovës, Shqipëria duhet të mbështesë përfshirjen e Kosovës në iniciativën BRAD apo iniciativa të tjera.

Projekti nr. 10: Ngritja e një kapaciteti portualo-detar të Kosovës “*në ujërat e thella të Adriatikut (RSH)*”, të dedikuar për të mbështetur veprimtaritë ekonomike, por edhe të dislokimit strategjik të forcave ushtarake në operacionet ndërkombëtare etj. Për modalitetet, procedurat, bazën ligjore, vendndodhjen dhe aspekte të tjera do të duhet paraprakisht vullnet politik.

III. Mesazhe përmbledhëse

Qëllim i platformës historike “*2 Shtete – 1 Komb*”, si dhe i paketës me 10 projekte të përbashkëta: “*Zhvillimin e kapaciteteve, strategjive, doktrinave, standardizimin, planifikimin, prokurimet; emergjencat civile, të arsimimit, të stërvitjeve, pjesëmarrjes në misione kombëtare dhe ndërkombëtare, mirëmbajtjen, rreziqeve kibernetike, policimin ajror, situatat renegate etj*”. Ndërtimi i kapaciteteve më vete (nga RSH/Kosova), në optikën profesionale është thjesht mision i pamundur. Duke qenë kështu, njëherësh do të ishte edhe vijimësi e gabimeve historike, strategjike dhe gjeopolitike njëherësh.

As draft-platforma, as 10 projektet e përbashkëta nuk janë kurrësi përpjekje për të “*shpikur rrotën dhe as thirrur Eureka*”, pasi suksesi në këtë fushë me sensitivitet të lartë kombëtar, kërkon mentalitet të ri, besim reciprok, lidhësi të fortë dhe kohezion të shoqërive të dy vendeve. Për

më tepër, kjo platformë dhe 10 projektet do të duhen të konsultohen dhe të harmonizohen me përpjekjet dhe qëndrimin zyrtar të SHBA-së: *“Kosova mbetet modeli kur komuniteti ndërkombëtar drejtuar nga SHBA-ja, angazhohet për ruajtjen e interesave dhe vlerave të përbashkëta! NATO-ja do të duhet të qëndrojë në Kosovë derisa FSK-ja të ketë legjitimitetin dhe aftësitë për të marrë përgjegjësitë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe sigurisë së vendit”.*

Sa për *“merakun e sforcuar diplomatik”*, konfirmoj se kjo përqasje është aplikuar me sukses edhe nga shumë vende, p.sh., nga vendet e Beneluksit, (Belgjikë, Holandë, Luksemburg); Vendet Baltike (Lituan, Estoni dhe Letoni), si Kolegji Mbrojtjes (BALDEFCOL), Grup-Batalioni Përbashkët (BALTBAT), Policimi i Përbashkët Ajror (Baltik Air Policing); Vendet Nordike (Norvegji, Finlandë, Suedi); Sllovenia me Hungarinë, pa përmendur qasjen e dy vendeve të NATO-s (Turqisë dhe Greqisë) në raport me sovranitetin e Qipros, pra ndaj një vendi anëtar të BE-së!

Përtej *“armatosjes deri në dhëmbë”* të Serbisë, (keq)shpërdorimin e Beogradit për agjendën e Rusisë putiniste, si dhe zgjimit (apo blerjen) e aleancave historike, besoj edhe më fort se paqja mbetet misioni i vetëm, në interes të bashkëjetesës paqësore, sigurisë së jetës, pronës, mirëqenies së qytetarëve, si dhe ardhmërisë euroatlantike të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, pra Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë Veriore, Malit të Zi, Serbisë dhe Bonjë-Hercegovinës.

Ndërsa aktorëve dhe strategëve/kolegëve në rajon, Uashingtonit, Brukselit etj., do t’u sugjeroja që perspektivën e paqes, *status quo*-së dhe interesave gjeopolitikë në Ballkan, do të duhet t’i parakushtëzojnë jo me rikthimin e garës së armatimeve, por me *“imponimin”* e dy Masave të Mirëbesimit Reciprok, nëpërmjet së cilave Beogradi Zyrtar: *“(1) do të ruajë balancat e fuqisë ushtarake (Tanke, Mig -29, Rafale, raketa ruso-kineze etj.), deri në masën që të mos kërcënojë fqinjët (posaçërisht Kosovën); (2) nuk do të vendosen as instalime, as aktivitete ushtarake (20 km distancë ajrore dhe 5 km tokësore), në kufijtë ndërshtetërorë, të monitoruar nga USA/NATO/BE, si faktor kritik për paqen në rajon.*

Po ashtu, do t’i këshilloja vëllazërisht faktorët politikë të Tiranës dhe Prishtinës zyrtare, që *“rrokullimën mbas humbjes së luftës së Rusisë putiniste, riciklimi i aleancave historike, si dhe kërcënimet e Beogradit*

ndaj integritetit të Kosovës”, t’i adresojnë me përgjegjësi të lartë shtetërore për të ndërtuar “**Shqipërinë dhe Kosovën Demokratike**”, përtej prezencës së NATO-s (*që nuk mundet të jetë e përjetshme*), ku mbi të gjitha, qytetarët pavarësisht përkatësive etnike, fetare dhe politike të ndihen të barabartë para ligjit, si dhe në faktorizimin të rolit të Shqipërisë dhe Kosovës nga konsumatorë në “*Komb leader*” për paqen, stabilitetin demokratik dhe integrimin në NATO/BE.

Së fundmi, shpresoj që edhe ky produkt të kontribuojnë sadopak, për të përditësuar “*opinionin strategjik, zyrtar dhe publik*” në rrafshin mbarëkombëtar, rajonal dhe jo vetëm. Ndërsa përtej paragjykimeve (*nga cinikë që përdredhin jo vetëm të ndenjurat*), më duhet të rikonfirmoj se mbetem i përkushtuar për të kontribuar me eksperiencë dhe përgjegjësi shtesë në mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtarë, si dhe për forcimin e partneritetit strategjik me SHBA/NATO!

Autori: Gjeneral Piro Ahmetaj, ekspert për SK-në, rajonin dhe NATO-n,

Zëvendëspresident i Këshillit të Atlantikut, si dhe ish-Këshilltar për Sigurinë Kombëtare në PD,

Këshilltar i Presidentit; zv/SHSHPFA, përfaqësues ushtarak i RSH-së në SHAPE/NATO.

1.7 Dr. Jorgji KOTE

Gjeopolitika kërkon edhe mirëqeverisje

Në këto 10 vitet e fundit Shqipëria ka rritur ndjeshëm rolin e saj aktiv në skenën ndërkombëtare, duke forcuar imazhin dhe duke pasuruar përvojën diplomatike. Kryesimi për herë të parë i OSBE-së në vitin 2020, zgjedhja anëtar jo i përhershëm i KS të OKB-së (2022-2023), mikpritja në dy vitet e fundit i katër samiteve europiane të zhvilluara në Tiranë mbi Paktin e BE-së për rritjen ekonomike të rajonit, Procesi i Berlinit dhe i Mbështetjes së Ukrainës, kryesimi këtë vit i tri nismave të rëndësishme rajonale, disa vizita të shtetarëve më të lartë të huaj dhe, së fundi, çelja e negociatave të anëtarësimit në BE për grup-kapitujt e parë dhe të pestë më 15 tetor dhe 17 dhjetor janë dëshmi madhore bindëse të këtij realiteti pozitiv.

Prania jonë aktive në këto dhe forume të tjera të larta ka rëndësi për imazhin tonë diplomatik, për të shtuar përvojën me dosje të ndryshme dhe zgjerimin e kontakteve diplomatike. Padyshim që në këtë drejtim kanë meritën edhe qeveritë e mëparshme, se në diplomaci asgjë nuk realizohet brenda natës apo vitit, dh çdo arritje është produkt i demarsheve të shumta diplomatike për vite dhe dekada me radhë.

Megjithatë, sërish kjo nuk mjafton që të jesh apo të quhesh “aktor, ca më pak i rëndësishëm gjeopolitik”. Dihet se për realizimin e pikësnyimeve strategjike, kjo e fundit kërkon burime dhe nivele të larta të forcës politike, ekonomike, diplomatike dhe ushtarake, madhësinë gjeografike, demokracinë, stabilitetin politik dhe institucional, të cilat ne nuk i kemi as tani dhe as në një të ardhme të afërt.

Ja pse, për të qenë realistë, veç mesazheve kryesisht simbolike jo pa rëndësi në këto forume, nuk është se kemi luajtur ndonjë rol të qenësishëm, por thjesht kemi bërë detyrën që na takon si pjesëtarë të tyre. Aq e vërtetë është kjo, sa dhe sikur çdo vit të ishim në këto forume, apo dhe në krye të OKB-së, sërish nuk do të ishim aktorë, se siç thamë edhe më lart, nuk kemi këllqet dhe besueshmërinë e duhur politike.

Vërtet që në funksion të kësaj gjeopolitike vitet e fundit “kemi importuar” muxhahedinë, afganë dhe tani pritet të strehohmë deri 3000 refugjatë në muaj, që do të dërgohen nga Italia në Gjadër. Lajme këto, që kanë pushtuar faqet e para të medias ndërkombëtare. Por prapë edhe ato nuk na bëjnë dot aktorë. Në morinë dhe vëllimin e pafund të problematikave përkatëse, ato janë thjesht “një pikë uji në oqean”.

Nga ana tjetër, pse të mos e themi se këto raste dhe veprimtari gjeopolitike janë tejet joshëse për komoditetin dhe imazhin e liderëve tanë: udhëtime, vizita, dreka e darka, foto familjare, fjalë të bukura pa asnjë qeder, me batuta dhe fabula të përsëritura që thjesht i relaksojnë dëgjuesit. As organizimi i tyre, veç fondeve të majme, nuk u kushton ndonjë gjë të madhe dhe është shumë më lehtë sesa problemet dhe telashet e brendshme politike e sidomos ekonomike dhe sociale.

Ja, në maj të vitit 2025, kryeministri Rama ka ftuar në Tiranë 45 homologët e tij në Samitin e Komunitetit Politik Europian. Ky i fundit, një komunitet pa adresë, pa seli, pa instanca drejtuese, pa agjendë, me takime të lirshme mes tyre, “talk and eating”, siç i thonë, një drekë, fotot familjare dhe ca batuta si zakonisht. Por sa imazh dhe jehonë mund të ketë samiti i tij brenda vendit për qeverinë dhe Ramën, ca më tepër vetëm dy ditë përpara zgjedhjeve të reja parlamentare, ku e gjithë vëmendja do të jetë atje dhe jo te zgjedhjet. Ndaj është e vështirë të kuptohet se si do ta pranojnë liderët europianë ftesën për një datë të tillë problematike për vendin tonë. Më shumë besohet se atë ditë ata do të parapëlqejnë ta kalojnë në Bruksel, Strasburg dhe kryeqytetet e tyre, duke festuar ditën e Europës e ca më tepër, se pret puna për Tiranën dhe Samitin shëtitës të KPE-së!

Ndërkaq, ndoshta harrohet se edhe vendet e tjera, sidomos ato më të mëdha dhe më të fuqishme se ne në çdo aspekt bëjnë gjeopolitikën, por ato janë “pesha të rënda” strategjike dhe kryesorja është se i kanë vënë me kohë punët e tyre themelore në vijë. E kundërta ngjet me ne, kur spektaklet dhe simbolet e natyrës gjeopolitike “i shesin”, duhet thënë mjeshtërisht, si pjesë të një loje demokracie të madhe strategjike, veçse pa zgjidhur dhe duke lënë në hije apo pas dore problemet e shumta të brendshme, krizat, aferat dhe skandalet ulëritëse. Apo mjaftohemi me superreklamimin e arritjeve në fushën e turizmit, ndonëse dhe ky “low

cost”, të ndërtimeve gjigante, modernizimit të infrastrukturës në arteriet kryesore, aeroporte etj. Pa mohuar rëndësinë e tyre jetike, sërish edhe ato duhen parë bashkë me dritëhijet e tyre, si kostoja e tyre tejet e lartë, pasojë e aferave korruptive dhe ndikimi në mjedis, duke cenuar zhvillimin tonë të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Për këto dhe të tjera arsye, sado suksese të ketë gjeopolitika e një shteti, kur ajo nuk pasqyrohet në përmirësimin e qeverisjes së vendit, atëherë ajo kthehet në një luks, që pakkujt i hyn në punë! Përvoja ndërkombëtare dëshmon se, me gjithë rëndësinë e tyre, këtë mirëqeverisje nuk e garanton diplomacia dhe gjeopolitika, as samitet dhe arritjet në këto fusha. Ato ndihmojnë për ta përmirësuar qeverisjen dhe, në përgjithësi, zgjidhjen e tematikave të ndryshme, shmangien e pasojave negative nga krizat, konfliktet, luftërat etj. Ndaj ish-kryeministri emblematic britanik, William H. Gladstone, thoshte se “parimi i parë i politikës së jashtme është mirëqeverisja brenda vendit”. Kjo qeverisje e mirë dhe funksionale arrihet duke përmirësuar në vazhdimësi treguesit ekonomikë, financiarë dhe socialë, të konfirmuar nga Banka Botërore, BE-ja dhe agjencitë e njohura ndërkombëtare.

Mirëpo, po t’u hedhësh qoftë edhe një vështrim kalimthi këtyre treguesve, bindesh lehtë se këtu politikës sonë i “ka ngecur sharra në gozhdë”! Ato janë në një kontrast të thellë me sukseset tona gjeopolitike. Mjafton të ndiqni emisionet investigative “Fiks fare” dhe “Stop”, dhe do të shihni se si bashkitë tona nuk janë në gjendje apo vuajnë shumë për të mbushur dhe për të shtruar një rrugë të shkurtër fshati, për të sqaruar një çështje administrative, për pastrimin e mjedisit, sistemimin e ujërave të zeza, për të zgjidhur hallet e të moshuarve, menaxhimin e plehrave etj.

Mosqeverisja efektive, e përfshirë nga skandalet, shihet kudo, në fshat dhe në qytet. Më konkretisht, me gjithë rritjen e tyre, sipas revistës së specializuar “Monitor”, paga mesatare te ne është sa 30 për qind e mesatares rajonale, ndërsa në sektorin e tekstileve pagat janë 10 herë më të vogla se në Europë.

Gjithë zhurma dhe buja propagandistike qeveritare për rritjen e pensioneve gjatë këtij viti përfundoi me indeksimin rutinor 4 për qind dhe bonusin e fundvitit! Lidhur me ndihmën sociale, sipas Bankës

Botërore, Shqipëria renditet në tri vendet e fundit në Europë; ajo plotëson vetëm 20 për qind të nevojave të qytetarit!

Sa i takon shëndetësisë, sipas OBSH-së, Shqipëria zë vendin e fundit në Europë me vetëm 12 mjekë për 10 000 banorë! Askund nuk ndodh që të mbeten 400 pacientë me tumor në mëshirë të fatit, sepse mungojnë aparaturat përkatëse.

Më tej, të dhënat e fundit të EUROSTAT-it nxjerrin në pah dallime të mëdha mes nesh dhe vendeve të tjera lidhur me strukturën dhe dinamikën e çmimeve të artikujve ushqimorë, ku ne i kemi më të lartat në rajon. Veç mishit dhe peshkut, i jemi afruar shumë BE-së dhe për çmimet e vezëve, qumështit dhe djathit me 97 për qind të mesatares së saj! Ndërkohë, sipas EUROSTAT-it, Shqipëria renditet e dyta në Europë për çmimet më të larta të energjisë elektrike për familjarët. Ekonomia informale është mbi 50 për qind, nga 25 dhe 40 për qind në vitin 2007 dhe 2015 dhe nga 32 për qind, që është mesatarja e ekonomisë informale në 158 vende në botë!

Mungesa e mirëqeverisjes shfaqet edhe në nivelin e lartë të papunësisë, sidomos te të rinjtë, zyrtarisht me 20 për qind, por që realisht mund të jetë dy herë më e lartë! Vërtet që ka dhe vende të BE-së, të cilat kanë nivel të lartë papunësie, por ndryshe nga ne, ato kanë leva dhe mekanizma që i zbusin ndjeshëm efektet e papunësisë.

Këta dhe faktorë të tjerë kanë ushtruar ndikim të madh në vazhdimin e prirjeve të emigracionit të paligjshëm. Raporti më i fundit i OKB-së tregon se në 30 vitet e fundit janë larguar nga vendi ynë 1,2 milionë qytetarë, shumica dërmuese këto në 10-15 vitet e fundit, shifër rekord, duke u renditur në vendet e para në botë. Dhe, ndryshe nga vendet e tjera, shumica dërmuese e shqiptarëve kanë shkuar për azil të paligjshëm edhe me fëmijë, në pamundësi për të jetuar në vendin tonë jo vetëm nga ana ekonomike, por edhe për shumë arsye të tjera të njohura. Për pasojë, në renditjen botërore na e kalojnë vetëm Siria, Libia, Iraku dhe vende të tjera, që dihet tashmë se janë në gjendje lufte, ndërsa ne kemi çelur negociatat e anëtarësimit në BE!

Ca më keq akoma, në parashikimet e saj më të fundit, “The Economist” tregon se në 3 dekadat e ardhshme, pas Bosnjës me 37 për qind, ritmin më të lartë të tkurrjes së popullsisë pritet ta ketë vendi ynë

me 26 për qind! Duke ia kaluar edhe Kosovës me 11 për qind, ndërsa Mali i Zi vetëm me 3 për qind!

Duke parë këta tregues, shihet qartë edhe kontrasti i fortë midis vlerësimeve që liderët e SHBA-së dhe të BE-së bëjnë kur vijnë në Tiranë ndaj vendit dhe drejtuesve tanë më të lartë. Ky kontrast bie edhe më shumë në sy, kur i krahason ato me dokumentet e tyre zyrtare, veçanërisht me Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Progres-Raportet e BE-së, me plot vërejtje, kritika, qortime dhe detyra.

Është pikërisht ky kontrast, që nxjerr më shumë në pah hendekun e madh midis suksesit tonë gjeopolitik me performancën e dobët të brendshme, me arritje, por edhe shumë dështime, sidomos kur vjen puna te krimi i organizuar dhe korrupsioni, dy të këqijat më të mëdha, të cilat komprometojnë edhe arritjet e pamohueshme!

Dëgjohet shpesh pohimi justifikues, se edhe jashtë ka krim dhe korrupsion. Po, por atje krimi dhe korrupsioni i çdolloji ndëshkohet ashpër dhe nuk bëhet fjalë që bartësit e tij të hyjnë në Kuvend dhe në pushtetin lokal, si te ne! Bërtasim me të madhe, se reformën tonë në drejtësi nuk e kanë bërë as vende anëtare të BE-së, mirëpo harrojmë se askund në BE nuk ka pasur e as nuk ka një vend tjetër me një shkallë aq të madhe krimi dhe korrupsioni!

Përfundimisht, le të ritheksojmë se po, ka arritje dhe ka ende më shumë vend për të qenë shumë më aktivë në skenën ndërkombëtare. Veç kjo larg gjigantomanisë, zhurmës dhe bujës propagandistike dhe manive të tjera populiste për t'u dukur; politika jonë e jashtme dhe diplomacia të jenë me këmbë në tokë, jo të shërbejnë si gjethe fiku apo kopertinë për dështimet e brendshme dhe për forcimin e pushtetit në dëm të parimeve dhe vlerave demokratike, por të ndihmojnë dhe të kontribuojnë për një nivel me dinjitoz jetese, për siguri, për reforma europiane, për imazh, për pensione të mjaftueshme, për pastrimin nga krimi dhe korrupsioni, për shtetin e së drejtës dhe për përsheptimin e anëtarësimit në BE. Vetëm kështu, Shqipëria do të ketë imazhin e saj të vërtetë dhe të besueshëm brenda vendit e, për rrjedhojë, edhe jashtë tij. Le ta mbyllim shkrimin me thënien e famshme të Hubert H. Humphrey se, *“politika e jashtme nuk është gjë tjetër, por politikë e brendshme me kapelë”*.

1.8 Arbër ZAIMI, politolog

Shenjë e kombit dhe e qytetërimit

“S’ka komb shqiptar, ka vetëm fise shqiptare.” – **Nikolla Pashiq**

“Dua je Nënë n Shqipëri, sepse ajo nuk do të vdesë kurrë!”

– **Adem Demaçi**

“Shqipërinë e pabërë bëje Shqipëri të bërë. Bëje ose vdis!”

– **Ukshin Hoti**

“Ne, sikurse të parët tanë, luftuam për atdheun e të gjithë shqiptarëve!”

– **Adem Jashari**

Është e lehtë të gjesh deklarata e citime autorësh serbë, të famshëm e jo të famshëm, ku mohohet ose poshtërohet qenia shqiptare. Të rrallë janë, e megjithatë ekzistojnë e duhen nderuar, edhe autorët serbë, që pa drojë e kanë mbrojtur barazinë mes kombeve dhe e kanë kundërshtuar shkeljen e shqiptarëve. Sidoqoftë, linja dominuese në Beograd ka qenë gjithnjë ajo e ekspansionit të shtetit serb në kurriz të shqiptarëve, linjë herë me tendenca asimiluese, herë spastruese. Për këtë arsye zgjodha të vë në krye të shkrimit citimin nga Nikolla Pashiqi, kryeministri jetëgjatë serb, i cili e ka mbajtur atë pozitë disa herë në fund të shekullit XIX e në fillim të shekullit XX. Pikërisht gjatë viteve kur Serbia pushtoi e spastroi shumë territore, që deri atëherë ishin banuar kryesisht prej shumicave të pastra shqiptare, në Sanxhakun e Nishit, por edhe më vonë, më 1912, kur i pushtoi edhe trojet e tjera shqiptare të Kosovës së sotme, Sanxhakut dhe pjesët shqiptare të Maqedonisë së Veriut, troje ku edhe pse u zbatuan politikat spastruese e asimiluese, nuk patën po aq sukses sa në Sanxhakun e Nishit. Pashiqi ishte prijës edhe gjatë ekspansionit më të madh që Serbia pati në shek. XX, kur u krijua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, e cila mbahet në kujtesën popullore të shqiptarëve si “Jugosllavia e Parë”. Me krijimin e Jugosllavisë, Pashiqi siguroi për vete një vend tepër të rëndësishëm në historinë moderne serbe, sepse ky shtet, për nga territori, demografia, ekonomia dhe pozita strategjike, kishte mundësi të projektohej si një fuqi europiane. Ndaj, në fillim të këtij

shkrimi po marr pikërisht deklaratën e atij që e rriti dhe forcoi ëndrrën ekspansioniste serbomadhe. Është interesante, por deklarata e Pashiqit për shqiptarët nuk dallon shumë, as në frymë e as në përmbajtje, me ato që u thanë shtatëdhjetë vite më vonë prej Millosheviqit, njeriut që e drejtoi Serbinë përgjatë prishjes së Jugosllavisë. Dikush që nuk i njeh rrethanat do të mund të mendonte se Pashiqi e Millosheviqi janë antipode (njëri drejtoi përgjatë kohës kur u rrit e u forcua një shtet, ndërsa tjetri drejtoi përgjatë kohës kur po ai shtet u copëtua e u prish), por Pashiqi e Millosheviqi janë e njëjta gjë: të dy luftuan mizorisht për të njëjtin projekt të ndërtuar mbi vuajtjet, shtypjet e zhdukjet e popujve të tjerë dhe të kundërshtarëve.

Linja politike Pashiq-Millosheviq, e cila përgjatë komunizmit e kaloi stafetën te Rankoviqi mizor, nuk ka qenë vetëm linjë e politikanëve të etur për pushtet. Ka qenë edhe linjë e përqafuar nga shumë artistë, intelektualë, shkencëtarë, shkrimtarë e poetë, deri edhe nga nobelisti i vetëshpallur serb, Ivo Andriq, autor i disa faqeve të turpshme për zgjidhjen e “problemit shqiptar”.

Shqiptarët e mbetur nën Jugosllavi rezistuan në tri mënyra:

- *E para* ishte rezistenca e së vërtetës së shpirtit të pathyeshëm shqiptar, përfaqësuar nga qindra të burgosur politikë. Ndër ta më i artikuluar i më vizionari, për pasojë edhe më gjatë i burgosuri, ishte Adem Demaçi.

- *E dyta* ishte rezistenca e argumentit shkencor, historik e akademik, përfaqësuar nga dhjetëra profesorë që u ngritën intelektualisht më shumë sesa lejonte servilizmi, përfaqësuar në shkallën më të lartë nga Ukshin Hoti, edhe ai i burgosur e më pas i zhdukur nga dora e regjimit.

- *Rezistenca e tretë*, ajo e zjarrit të pushkës, u përfaqësua nga mijëra djem e vajza të popullit, që rrokën armët qysh prej vitit 1913, e që dolën masivisht në mal e në luftë guerile në vitet 1998-1999. Ata djem e vajza i përfaqëson më së miri heroi i sakrificës sublime, Adem Jashari, i cili ra me armë në dorë bashkë me gjithë familjen e tij më 7 mars 1998.

Cili është kuptimi i asaj që thoshte Pashiqi? Që shqiptarët janë pikë e pesë. Që janë pa ndjenjë kombëtare e janë thjesht fise. Për ta më i rëndësishëm është kushëri sesa bashkëkombasi. Më i rëndësishëm është kumbara ose shoku e miku, me të cilin hanë bukë e pinë raki, sesa një i

panjohur qindra kilometra larg, që flet në gjuhën e tyre. Shqiptarët nuk kanë interesa të përbashkët, thotë Pashiqi, por vetëm interesa të atypëratyshëm, të ngushtë, të vegjël. Interesat e përbashkët janë ata që shquajnë kombet prej jokombeve. Në fakt, sipas logjikës raciste (që sot po fiton sërish terren nëpër botë), interesat e përbashkët janë prerogativë të të qytetëruarve, ndërsa ata që nuk mund të kenë të tillë janë të paqytetëruar. Duke qenë se interesat e përbashkët çojnë te forca e përbashkëta, koncepti i qytetërimit bën qark të shkurtër me atë të forcës. E racistët mund ta mendojnë (nëse nuk e thonë), se forca është shenjë qytetërimi, ndërsa dobësia shenjë e mungesës së tij. Të gjitha këto janë brenda thënies së Pashiqit, se shqiptarët nuk janë komb, po thjesht fise. Memorandumi i mëvonshëm i Çubrilloviqit s'është gjë tjetër, veçse shtjellim i kësaj thënieje. Çubrilloviqi, akademik e politikan, shkruante se serbët mund ta zgjidhin lehtë "problemin shqiptar", duke paguar për t'i përçarë shqiptarët: korrupsioni i madh, lakmia për para, prona e vese, tipar gjithaq i njohur i të paqytetëruarve.

Përçarja që serbomëdhenjtë impononin te shqiptarët kishte disa elemente. Përçarja religjioze nuk pati sukses të madh, sepse shqiptarët, ndryshe nga sllavët e jugut, nuk e kanë identitetin kombëtar të ndërtuar mbi ekskluzivitetin fetar, kështu që u vu theksi te përçarja krahinore, duke i ndarë shqiptarët e Jugosllavisë në tri republika, duke mos lejuar krijimin e institucioneve të përbashkëta e gjithëpërfshirëse, e sidomos duke i fryrë përçarjes midis shqiptarëve të Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Jugosllavia kishte interes të madh për të nxitur vetëdeklarimin e shqiptarëve si turq ose si sllavë myslimanë (gjë që shihet te ndryshimi i mbiemrave gjatë asaj kohe); kishte interes në provokimet me natyrë fetare mes katolikëve e myslimanëve shqiptarë, teksa ortodoksët i sllavizoi përmes kishës pravosllave; kishte interes të vinte në dukje se si shqiptarët e Maqedonisë ishin ndryshe nga ata të Kosovës, e ata të Malit të Zi gjithashtu ndryshe, por në mënyra të tjera, e më të ndryshmit prej të gjithëve ishin ata nga Shqipëria. Bimë të këtyre farave të këqija, që u mbollën gjatë periudhës jugosllave, ende mbijnë sot midis nesh, madje përqafohen si fakte të pandryshueshme, por ne shqiptarët jemi të ndryshëm nga vetvetja, nuk jemi një komb, por jemi po aq kombe sa ka dashur Pashiqi e Titoja.

Shqiptarët, të cilët për shekuj e shekuj kishin jetuar pa kufij mes njëritjetrit, na paskan ndryshuar aq shumë gjatë Jugosllavisë, këtij shteti që sundoi për më pak se 85 vjet mbi një pjesë të kombit shqiptar. Pra, kombi, kjo pjellë e mijëvjeçarëve, që ka parë perandori të ngrihen e të bien, na u shkombëtarizua për më pak se një shekull e na u krijuan kombe të reja, sepse kështu deshi një shtet apo një tjetër. Pretendim arrogant!

Adem Demaçi, i njohur edhe si Demë Dema, në romanin e vet autobiografik “Dashuria kuantike e filanit” tregon një histori të veçantë. Përballja e tij me përçarjen që përpiquej të mbillte Jugosllavia për shkombëtarizimin e shqiptarëve vjen përmes një figure me pretendime të larta intelektuale e kinse jonacionaliste, si shkrimtari serb Dobrica Qosiq (me të cilin shumë më vonë bën një letërkëmbim polemik edhe Ismail Kadareja). Ja çfarë shkruhet në romanin e Demaçit:

“Nga Beogradi na kishte ardhur ‘mysafir’, - shkrimtari-partizan Dobrica Qosiqi. - Partia e kishte dërguar që të na mbante vajzë se si ne, shkrimtarët e Kosovës, duhet ta krijojmë letërsinë tonë. Ai, në zjarrin e fjalës së vet, duke rrahur foltoren me grusht, ashtu partizançe, në gjuhën e vet, ndër shumë gjëra të tjera, tha: ...Futeni plugun thellë dhe hapeni hullinë e parë! Nisjani nga fillimi dhe krijojeni letërsinë tuaj këtu, në gjuhën tuaj, por në frymën e patriotizmit socialist jugosllav!”

Këtë tha shkrimtari-partizan nga Beogradi dhe shkoi e u ul në podium krahas Dushan Mugoshës-Duçit. Pa djathtas-majtas. Të gjithë rrahin shuplakat, përveç Zekeria Rexhës, Esad Mekulit dhe meje... Dushan Mugosha-Duçi hapi diskutimin. U ngritën disa sahanlëpirës, disa të mjerë, disa kalemxhinj e disa lustraxhinj. Vetëm i binin djathtas-majtas e i silleshin vërdallë muhabetit. Disa, madje, i binin edhe me mistri asaj që tha Dobrica Qosiqi, por askush nuk e tha atë që kërkonte momenti. Ngrita dy gishta. Duçi ma dha fjalën. Duke dalë në foltore, me vete thashë: “Hajde, ndihmo i madhi Zot!” dhe nisa fjalën time:

– ... Ne nuk kemi nevojë që ta fillojmë letërsinë tonë nga e para. Si duket, shkrimtari nga Beogradi, Dobrica Qosiq, nuk e ditka se ne e kemi letërsinë tonë. Ne duhet vetëm të vazhdojmë atje ku e kanë lënë shkrimtarët tanë të mëdhenj, si Pjetër Budi, Frang Bardhi, De Rada, Naimi, Çajupi, Mjedja, Asdreni, Noli, Migjeni, Luigj Gurakuqi, Mihal

Grameno, Lasgush Poradeci, Sterjo Spasse, Mitrush Kuteli e shumë të tjerë...

Duçi as nuk më shau, as nuk më tha faleminderit për fjalën time. Gjysma e të pranishmëve rrahu shuplakat, gjysma tjetër jo. Mirëpo, në atë ftohtësi të akullt, ishte si një lule që çel pranverën e hershme thirrja e qartë, ndonëse e vetmuar, por fort domethënëse e profesor Zekeria Rexhës:

– Bravo Filan!...

Në drekën që kishte shtruar Komiteti për nder të shkrimtarit-partizan nga Beogradi, mua nuk më ftuan. Por as edhe nuk më nganë më tutje. Vazhdova punën ku isha. Mirëpo “partiashët” dy herë bënë përpjekje që të më bindnin që të hyja në parti... Refuzova të dyja herët...”

Fillimisht iu propozua shkombëtarizimi. Adem Demaçi nuk e pranoi, me zemrën e pastër dhe mendjen e kthjellët të shqiptarit që nuk heq dot dorë nga Nëna Shqipëri. Meqë nuk e pranoi kërkesën, atëherë i vjen oferta për t’u futur në parti, për t’u bërë dikush, për të vendosur vetveten përpara kombit. As këtë nuk e pranoi Demaçi. Këtu filloi cikli i burgjeve të tij, që zgjati 28 vjet. Thuajse tri dekada kurrë pa u epur, pa u përkulur, pa u përshtatur. Në burgjet e Jugosllavisë, përballë gardianëve që “bënin detyrën”, bashkë me shumë shqiptarë të tjerë të burgosur, sepse Demaçi s’qe i vetmi që kërkonte liri e bashkim kombëtar, por u bë vigani i qëndresës shqiptare, hero i gjallë, dëshmia se si lartësia e shpirtit njerëzor nuk thyhet nga dhuna e tiranive dhe pushteteve gjakatare.

“Shqiptarët më gatuan për të mirën e vet, e pushtuesit serbë më kalitën e më farkuan për të zezën e vet”, thoshte Adem Demaçi, i paepuri, progresisti, qëndrestari, njeriu që kurrë nuk e tradhtoi as idealin, as bashkësinë, as vetveten. Më vonë, kur Kosova u çlirua e u pavarësua, një polic serb e pati pyetur Adem Demaçin në kufi, teksa ky po shkonte për të mbajtur një ligjëratë në Beograd, se a mundej ai të kthehej në Kosovë ku jetonte dikur. Demaçi e pati pyetur policin: “Çfarë pune ke bërë në Kosovë?”. Pasi ai kishte treguar se kishte qenë polic gjithmonë, Demaçi ishte përgjigjur: “Por, policët në kohën e regjimit kanë bërë krime”. Polici ishte përgjigjur se kishte bërë vetëm detyrën dhe se s’qe fajti i tij. Me ironi të hollë Demaçi i tha: “Mirë, kthehu, por ki parasysh se sot Kosova ka plot djem që kryejnë detyrën”. E, pra, qëndresa e tij përballë

regjimit është shembulli i qytetërimit të mirëfilltë, ndërsa kryerja e detyrave çnjerëzore dhe zbatimi i urdhrave kriminalë janë shenjë e mungesës së çdo qytetërimit. Po të jetë puna për “zbatuesit e detyrave”, kurrë drejtësi, paqe e zhvillim nuk mund të ketë.

Adem Demaçi e ka denoncuar dhunën dhe shtypjen, jo ndaj vetë atij, por ndaj popullit të vet, pa iu trembur burgut. Ai i thoshte të motrës: *“Po na vranë mirë, vdesim për lirinë e Kosovës. Por edhe po mbijetuar, prapë mirë, e gëzojmë lirinë bashkë me të tjerët!”*. Çlirimin ia vuri detyrë vetes dhe trupin e vet e bëri banesë të idesë. Edhe në fund të jetës, kur kishte vështirësi në të folur, një ndër togfjalëshat që e shqiptonte qartë e rrjedhshëm ishte “Nana Shqipni”. Asaj ia kishte blatur jetën. Për “Nënë Shqipëri”, konceptin që nuk përmblihet në kufijtë e Shqipërisë së sotme, foli edhe argumenti shkencor i Ukshin Hotit, edhe ai ushtarak i Adem Jasharit.

Ata vazhdimisht e kundërshtuan Serbinë pushtuese, kolonizuese e shtypëse, pa shfaqur kurrë urrejtje a esencializim ndaj serbëve. E deshën popullin e vet të lirë dhe u angazhuan për lirinë me çdo çmim, por nuk ia dëshiruan robërimin e fatkeqësinë askujt. Ky është qytetërimi i vërtetë. Në fakt, kjo është edhe forca e vërtetë. Forca për të vrarë e për të spastruar nuk është gjë tjetër, veçse shpërthim i dobësisë, i sëmundjes, i frustrimit.

Ata e deshën plotësisht sovranitetin e kombit të vet, jo si izolim, por si e vetmja mënyrë për hapje e paqe. Veç kur kombet e Ballkanit ta njihnin njëri-tjetrin si të barabartë, e të hiqnin dorë prej pretendimeve hegjemonizuese, do të bëhej i mundur bashkëveprimi fqinjësor e miqësor mes tyre.

Ata nuk u bënë kurrë kryeministra a presidentë, sepse nuk rendën pas pushtetit e nuk i pranuan ofertat për të hyrë në parti. Por, autoriteti i tyre i përbashkon shqiptarët dhe ata do të mbahen mend si shënjuet të kohës së tyre, më shumë se secili pushtetar mendjemadh.

Adem Demaçi, Ukshin Hoti, Adem Jashari e qindra të tjerë janë mishërimi i qëndresës shqiptare, veprimtarë të pathyeshëm çlirimtarë, të burgosur politikë e luftëtarë, intelektualë e shkrimtarë guximtarë, tribunë popullorë, që do të mbeten frymëzim për cilindo shqiptar që dëshiron t’i hyjë rrugës vetësakrifikuese për emancipimin e popullit tonë, luftës e

përpjekjes gjer në barazi me popujt e tjerë. Ata janë një ndër pikat kulmore të qenies shqiptare e të asaj njerëzore. Në kohërat kur tradhtia është “demokratizuar”, e kur shitblerja e njerëzve dhe e parimeve imponohet si “normalitet”, të paepurit janë fanari ynë i vetëm dhe shenjë se, për inat të Pashiqit e pasardhësve të tij, ne jemi komb.

Lavdi e jetës dhe veprës së tyre e qofshin të paharrueshëm sa të jenë gjallë shqiptarët!

1.9 Dr. Agim KRASNIQI

Bashkimi kombëtar: e drejta historike përballë sfidave gjeopolitike

Abstrakt

Ky punim trajton në mënyrë ndërdisiplinore çështjen e bashkimit kombëtar të shqiptarëve, duke u mbështetur në argumente historike, juridike dhe gjeopolitike. Duke analizuar dokumentet esenciale të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën, punimi argumenton se e drejta për vetëvendosje dhe për bashkim kombëtar është e legjitimuar në të drejtën ndërkombëtare, për aq kohë sa realizohet në mënyrë paqësore dhe demokratike.

Në rrafshin gjeopolitik theksohet epërsia strategjike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Ballkan pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe rënies së Perandorisë Sovjetike, si dhe fakti që shqiptarët përfaqësojnë aleatin më të natyrshëm, më të besueshëm dhe më të përkushtuar ndaj vlerave perëndimore në rajon. Fuqizimi i faktorit shqiptar paraqitet si domosdoshmëri për ndërtimin e rendit të ri ndërkombëtar të qëndrueshëm në Europën Juglindore.

Ky punim thekson qasjen pragmatike të administratës “Trump” si model për zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara ndërkombëtare përmes vendimeve të guximshme dhe strategjike, duke e paraqitur këtë si një mundësi për avancimin e bashkimit kombëtar shqiptar. Gjithashtu analizon qëndrimin e elitave politike dhe të opinionit publik në Shqipëri e Kosovë, duke theksuar nevojën për një strategji të përbashkët kombëtare në rrafshin diplomatik dhe shkencor, për afirmimin paqësor dhe të legjitimuar ndërkombëtarisht të së drejtës për bashkim.

Fjalë kyç: bashkim kombëtar, vetëvendosje, shqiptarë, SHBA, pragmatizëm diplomatik, e drejta ndërkombëtare, Trump, rend i ri ndërkombëtar.

1. Hyrje

Çështja e bashkimit kombëtar të shqiptarëve nuk është thjesht aspiratë e mbetur nga shekujt, por e drejtë historike, natyrore dhe morale, që buron nga përkatësia etnike, kulturore dhe gjuhësore e një kombi të ndarë me dhunë nga rrethanat e padrejta të historisë. Bashkimi i shqiptarëve, ndonëse për dekada është ndaluar apo heshtur nga aktorë të ndryshëm politikë, vazhdon të jetojë si ideal i gjallë në vetëdijen kolektive të kombit shqiptar. Ky punim synon të analizojë këtë të drejtë në tri rrafshes esenciale: *historik, juridik dhe gjeopolitik*, duke sjellë një reflektim të ri mbi legjitimitetin e kërkesës për bashkim kombëtar në kontekstin aktual ndërkombëtar. Rëndësia e kësaj teme është theksuar veçanërisht pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 dhe zhvillimeve të mëvonshme në rajon. Për shqiptarët, ekzistenca e dy shteteve të pavarura shqiptare në Ballkan është arritje historike, por njëkohësisht paraqet sfidë për të menduar rreth mënyrave të bashkëjetesës dhe bashkërendimit kombëtar në rrafshin institucional, ekonomik dhe diplomatik. Ndërkohë që shtetet e tjera në rajon i kanë realizuar objektivat e tyre kombëtarë, shqiptarët mbeten ende të ndarë në disa shtete, si pasojë e padrejtësive të trashëguara nga Konferenca e Londrës më 1913 dhe rendit gjeopolitik të vendosur nga Fuqitë e Mëdha (Schmitt, 2009; Malcolm, 1998). Në këtë kuptim, qasja analitike që do të ndiqet në këtë punim është ndërdisiplinore.

- *Së pari*, qasja **historike** do të ndriçojë periudhat kyç të formësimit të vetëdijes kombëtare shqiptare dhe aktet e rëndësishme për bashkimin kombëtar, siç është Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

- *Së dyti*, qasja **juridike** do të mbështetet në të drejtën ndërkombëtare, sidomos në parimet e Kombeve të Bashkuara që e njohin të drejtën për vetëvendosje si parim universal (United Nations, 1945; International Covenant on Civil and Political Rights, 1966).

- *Së treti*, qasja **gjeopolitike** do të analizojë faktorët që ndikojnë në (mos)realizimin e kësaj të drejte, përfshirë rolin e aktorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë, dhe perceptimin e bashkimit shqiptar në kontekstin e stabilitetit në Ballkan.

Punimi do të trajtojë edhe realitetin aktual shqiptar në Kosovë dhe Shqipëri, përfshirë diskutimet publike, qasjen e elitave politike dhe

intelektuale, si dhe mundësitë që ofron **bashkimi funksional** në mungesë të bashkimit *de jure*. Kjo qasje do të mundësojë kuptim më të thelluar të bashkimit kombëtar jo vetëm si projekt politik, por si një çështje themelore e drejtësisë historike dhe e legjitimitetit ndërkombëtar.

2. E drejta historike për bashkim

E drejta historike e shqiptarëve për bashkim kombëtar është ndër të drejtat më legjitime dhe më të mohuara në historinë moderne të kombeve europiane. Populli shqiptar, autokton në Gadishullin Ilirik, me gjuhë, kulturë dhe identitet të vetin të formuar ndër shekuj, është ndër rastet më të qarta, ku e drejta për të qenë i bashkuar është shtypur përmes vendimeve të jashtme dhe imponimeve të dhunshme diplomatike. Që nga shpërbërja e Perandorisë Osmane e deri te shpallja e Pavarësisë më 1912, shqiptarët janë përpjekur me të gjitha mjetet për të ndërtuar një shtet të përbashkët kombëtar.

2.1. Argumentet historike për unitetin kombëtar të shqiptarëve

Qysh në fund të shekullit XIX, me formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878, shqiptarët manifestuan qartë vullnetin e tyre politik për të mbrojtur tërësinë e trojeve të tyre dhe për të krijuar administrim të përbashkët kombëtar (Clayer, 2008). Ky organizim nuk ishte rebelim i rastësishëm, por ishte akt politik i menduar në mënyrë moderne, që synonte krijimin e shtetit shqiptar në kufijtë etnikë, duke u mbështetur në identitetin e përbashkët dhe trashëgiminë historike. Kjo aspiratë u përforcua më tej me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, akt themelor që synonte bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. Përfaqësuesit e viseve shqiptare nga të gjitha anët, Kosova, Çamëria, Ilirida, Malësia, Plava, Gucia e Ulqini, kontribuan në këtë akt të rëndësishëm, duke e dëshmuar qartë vullnetin për bashkim kombëtar (Frashëri, 2012).

2.2. Copëtimi i trojeve shqiptare në Konferencën e Londrës (1913)

Megjithatë, vetëm pak muaj më vonë, ky projekt kombëtar u copëtua nga një vendim tragjik dhe historikisht i padrejtë: **Konferenca e Ambasadorëve në Londër**, e mbajtur në vitin 1913, që e ndau territorin

etnik shqiptar në pesë shtete të ndryshme Shqipëri, Serbi, Mali i Zi, Greqi dhe më vonë Maqedoni, pa marrë parasysh vullnetin e popullsisë autoktone dhe pa mbajtur asnjë referendum popullor (Puto & Maurizio, 2009). Ky vendim ishte shkelje flagrante e parimeve të vetëvendosjes dhe integritetit të kombit shqiptar. Fuqitë e Mëdha, në vend që të përkrahnin të drejtën e shqiptarëve për të pasur shtetin e tyre të unifikuar, vepruan sipas interesave gjeopolitikë të kohës. Ky vendim i padrejtë krijoi plagë të thella, që kanë mbetur të hapura deri në ditët e sotme, duke sjellë vuajtje kolektive, diskriminim dhe përpjekje për asimilim në trojet shqiptare të mbetura jashtë shtetit shqiptar.

2.3. Roli i Fuqive të Mëdha dhe padrejtësitë historike

Roli i Fuqive të Mëdha në ndarjen e trojeve shqiptare ishte vendimtar dhe tragjik. Shumica e vendimeve u diktuan nga interesat e Francës, Britanisë, Austro-Hungarisë dhe Rosisë, të cilat u përpoqën të krijonin balancë force në Ballkan, duke shpërfillur tërësisht të drejtat natyrore të popujve (Schmitt, 2009). Veçanërisht Rusia dhe Franca përkrahën synimet territoriale të Serbisë dhe Greqisë në dëm të shqiptarëve. Kjo padrejtësi nuk ishte thjesht pasojë e luftërave ballkanike, por ishte akt i qëllimshëm për të kufizuar shqiptarët si faktor politik në rajon. Edhe më vonë, gjatë periudhës së Jugosllavisë, shqiptarët e Kosovës u mbajtën nën shtypje, pa të drejtë shtetformimi, në kundërshtim me çdo standard ndërkombëtar për popujt autoktonë dhe identitetet kombëtare (Malcolm, 1998).

Ky kapitull dëshmon se e drejta për bashkim kombëtar nuk është konstrukt politik artificial, por domosdoshmëri historike dhe kërkesë për drejtësi. Historia flet qartë: shqiptarët kanë vepruar gjithnjë si komb i vetëm, me identitet të përbashkët dhe me aspiratë të qartë për të qenë bashkë në një shtet të përbashkët.

3. Bashkimi kombëtar në të drejtën ndërkombëtare

Aspirata e shqiptarëve për bashkim kombëtar nuk është vetëm e drejtë historike dhe morale, por gjen mbështetje të qartë edhe në parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare. E drejta për vetëvendosje, si një nga parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, e garantuar në **Kartën e**

OKB-së (1945), në **Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike** (1966) dhe në **Deklaratën për Dhënien e Pavarësisë Kombeve Koloniale** (1960), u njeh popujve të drejtën për të përcaktuar vetë statusin e tyre politik dhe të ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor.

3.1. Parimi i vetëvendosjes dhe legjitimiteti i bashkimit

Neni 1(2) i Kartës së OKB-së përcakton qartë, se qëllimi i organizatës është: *“Të zhvillojë marrëdhënie miqësore ndërmjet kombeve, të bazuara në respektimin e parimit të barazisë së të drejtave dhe të vetëvendosjes së popujve...”* (United Nations, 1945). Ky parim nuk është slogan idealist, por është normë juridike e detyrueshme, e aplikuar në qindra raste në botë, ku popuj të nënshtruar kanë fituar të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje apo bashkim me entitete të tjera shtetërore.

Populli shqiptar në Kosovë, i cili më 17 shkurt 2008 shpalli në mënyrë të njëanshme pavarësinë nga Serbia, e bëri këtë akt në përputhje me këtë të drejtë themelore. **Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë**, në opinionin e saj këshillues më 22 korrik 2010, deklaroi se: *“Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare”* (ICJ, 2010). Ky vendim është një precedent juridik i pakundërshtueshëm, që vërteton se popujt që kanë kaluar nëpër procese të shtypjes dhe mohimit të të drejtave, kanë të drejtë të krijojnë ose të bashkohen me shtete të tjera sipas vullnetit të tyre. Në këtë dritë, nëse populli shqiptar, në të dyja anët e kufirit Shqipëri-Kosovë, shpreh përmes referendumit të lirë dhe demokratik vullnetin për bashkim, ky akt është plotësisht legjitim sipas të drejtës ndërkombëtare, për aq kohë sa ai realizohet pa dhunë dhe me respektim të normave demokratike.

3.2. Të drejtat e kombeve dhe parimi i integritetit territorial

Argumenti kryesor, që zakonisht përmendet kundër bashkimeve të tilla, është **integriteti territorial** i shteteve ekzistuese. Megjithatë, të drejtat e popujve dhe integriteti territorial nuk janë në kundërshtim absolut: ato duhet të balancohen, dhe kur një shtet mohon në mënyrë sistematike të drejtat themelore të një populli, atëherë parimi i vetëvendosjes prevalon (Crawford, 2006). Kjo është parë në rastin e

Eritresë, Sudanit të Jugut dhe, së fundmi, me referendumet e kontrolluara ndërkombëtarisht në Timorin Lindor dhe në Slloveni.

Në vitet 1989-1999 Kosova përjetoi represion sistematik, shkelje masive të të drejtave të njeriut, heqje të dhunshme të autonomisë kushtetuese, spastrim etnik dhe gjenocid të dokumentuar ndërkombëtarisht, kushte të cilat plotësojnë të gjitha kriteret e së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje, ashtu siç parashikohet në të drejtën ndërkombëtare dhe në rezolutat përkatëse të Kombeve të Bashkuara (UNSC, 1999; ICJ, 2010). Akti i shpalljes së Pavarësisë më 17 shkurt 2008 u mbështet në vullnetin e popullit dhe në parimin e *remedial secession*, i cili e legjitimon shkëputjen, kur popujt përballen me represion të vazhdueshëm dhe mungesë të përfaqësimit demokratik. Prandaj, tani që Kosova është shtet i pavarur, e drejta për të bashkuar vullnetarisht fatin me Republikën e Shqipërisë, nëse ekziston një konsensus i qartë popullor, nuk përbën kërcënim për integritetin territorial të ndonjë shteti tjetër, përkundrazi, është realizim i drejtë dhe paqësor i aspiratës kombëtare shqiptare.

Për këtë qëllim, ndonëse **neni 1, paragrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës** përcakton se *“Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti”*, ky nen nuk përjashton të drejtën e popullit të Kosovës që, përmes **shprehjes së lirë dhe demokratike të vullnetit në një referendum gjithëpopullor**, të kërkojë rishikim të rendit kushtetues për të avancuar aspirata të reja në përputhje me rrethanat politike dhe kombëtare.

Në të njëjtën kohë, **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, në preambulën e saj, afirmon qartazi aspiratën shekullore për **bashkim kombëtar**, duke theksuar: *“...me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar...”*

Ky formulim nuk është vetëm simbolik, por bart **një detyrim kushtetues dhe moral**, që shteti shqiptar të mbrojë interesin kombëtar në tërësinë e tij, përfshirë edhe të drejtën për bashkim me pjesët e tjera të kombit, nëse një proces i tillë buron nga vullneti i popullit përmes mjeteve demokratike.

Nëse Kushtetutës së Kosovës i ndalohet të iniciojë bashkimin, atëherë Republika e Shqipërisë, në përputhje me preambulën e saj dhe të drejtën ndërkombëtare, ka të drejtë legjitime të propozojë një bashkim me Kosovën, si realizim i aspiratës kombëtare të shprehur qartë në aktin themeltar të shtetit. Në këtë logjikë, një bashkim eventual nuk do të ishte aneksim, por shprehje e ndërsjellë dhe e barabartë e vullnetit kombëtar, duke përbërë një prelud juridik, politik dhe moral për një bashkim të drejtë dhe të qëndrueshëm.

3.3. Raste krahasimore: Gjermania, Vietnami, Sudani i Jugut

Historia moderne njih bashkime kombëtare të suksesshme, të përkrahura ose të njohura nga bashkësia ndërkombëtare:

- **Gjermania Lindore dhe Perëndimore** u bashkuan më 1990 në një proces të drejtuar nga vullneti popullor dhe i pranuar ndërkombëtarisht, përkundër kundërshtimeve fillestare të disa fuqive (Garton Ash, 1993).
- **Vietnami i Veriut dhe i Jugut** u bashkuan pas një periudhe konflikti dhe më pas u njohën ndërkombëtarisht si një shtet i vetëm.
- **Sudani i Jugut**, pas referendumit të vitit 2011 të mbikëqyrur nga OKB-ja, u nda nga Sudani dhe u pranua si anëtar i Kombeve të Bashkuara në korrik të atij viti.

Në të gjitha këto raste, vullneti i qytetarëve u vendos mbi kufijtë artificialë apo kundërshtimet politike të jashtme. Shqiptarët, si komb i ndarë në mënyrë të padrejtë, kanë të njëjtin të drejtë për të vendosur vetë për fatin e tyre.

4. Sfidat gjeopolitike aktuale

Bashkimi kombëtar i shqiptarëve nuk është vetëm një çështje e së drejtës historike dhe juridike; ai është, mbi të gjitha, një çështje gjeopolitike me ndikim të thellë rajonal dhe ndërkombëtar. Kjo është arsyeja pse, përkundër legjitimitetit të padiskutueshëm të aspiratës shqiptare për bashkim, procesi në fjalë është i shoqëruar me sfida

komplekse, që burojnë nga qëndrimet e shteteve fqinje dhe interesi i faktorit ndërkombëtar për “stabilitetin në Ballkan”. Megjithatë, stabiliteti i vërtetë nuk mund të ndërtohet mbi padrejtësi të vjetra dhe kufij të imponuar me dhunë, por duhet të bazohet mbi drejtësinë historike dhe respektimin e vullnetit të lirë të popujve.

4.1. Qëndrimi i shteteve fqinje: Serbia, Greqia, Maqedonia e Veriut

Serbia, që historikisht ka qenë një nga përfitueset më të mëdha nga copëtimi i trojeve shqiptare në vitin 1913, kundërshton çdo ide të bashkimit kombëtar të shqiptarëve, duke e konsideruar atë si kërcënim për integritetin territorial të saj, në veçanti për shkak të humbjes së Kosovës. Megjithatë, nuk mund të ketë drejtësi ndërkombëtare, përderisa një shtet që ka kryer krime kundër njerëzimit në Kosovë, siç janë dokumentuar nga Tribunalet Ndërkombëtare (ICTY, 2001), kërkon të ketë të drejtën e fjalës mbi të ardhmen e popullit që e ka shtypur.

Greqia, nga ana tjetër, ka pasur historikisht qëndrime hegjemoniste mbi territoret e Çamërisë dhe kundërshton çdo rritje të influencës shqiptare në rajon. Qëndrimi i saj reflekton frikën nga rishikimi i së kaluarës dhe nga kërkesa për drejtësi historike për komunitetet shqiptare në Greqi, të zhdukura me dhunë pas Luftës së Dytë Botërore (Manta, 2009).

Maqedonia e Veriut, ndonëse ka bashkëjetesë të ndërlikuar etnike me shqiptarët, është rast delikat. Ndërsa shqiptarët përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë dhe kanë ndikuar ndjeshëm në shtetformimin e saj, qasja zyrtare shpesh mbetet ngurruese, e frikësuar nga mundësia e bashkimit të shqiptarëve në një entitet më të fuqishëm rajonal.

4.2. Roli i faktorit ndërkombëtar: BE, SHBA, NATO

Bashkimi Europian ka mbajtur qëndrime të kujdesshme ndaj temës së bashkimit kombëtar të shqiptarëve, duke i paraprirë çdo zhvillimi që mund të interpretohet si “ndryshim kufijsh”. Politika e tij është ndërtuar mbi narrativën e **mosndryshimit të kufijve në Ballkan**, një parim që buron nga frika e destabilizimit dhe e rihapjes së konflikteve etnike. Megjithatë, kjo qasje nuk ka bazë të qëndrueshme, përderisa BE-ja ka

pranuar rastin e bashkimit të Gjermanisë në vitin 1990 dhe pavarësinë e shteteve të reja, si Kroacia, Sllovenia apo Kosova.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleat i ngushtë i shqiptarëve në çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, kanë ruajtur një pozicion neutral në raport me bashkimin kombëtar, duke mbështetur funksionalitetin dhe sovranitetin e shteteve ekzistuese. Megjithatë, SHBA-ja ka treguar në të kaluarën se, nëse vullneti i popujve është i qartë dhe i shprehur në mënyrë paqësore e demokratike, atëherë interesi i tyre është që Ballkani të jetë stabil mbi baza reale, jo mbi *status quo* të padrejtë (Clark, 2000). NATO-ja, si strukturë e sigurisë që përfshin disa nga shtetet ku jetojnë shqiptarët, ka qenë e kujdesshme në ruajtjen e balancave etnike dhe shtetërore në rajon. Por një bashkim i koordinuar dhe i mbështetur në ligj ndërkombëtar, nuk do ta rrezikonte sigurinë rajonale; përkundrazi, do të sillte më shumë kohezion ndërshqiptar dhe stabilitet të qëndrueshëm.

4.3. Frika nga precedenti: “ndryshimi i kufijve në Ballkan”

Justifikimet më të zakonshme që përdoren nga komuniteti ndërkombëtar për të frenuar bashkimin kombëtar të shqiptarëve është frika nga “hapja e Kutisë së Pandorës” në Ballkan. Por ky argument është i pabazë dhe hipokrit. Kufijtë në Ballkan janë ndryshuar vazhdimisht në dekadat e fundit: nga shpërbërja e Jugosllavisë, ndarja e Malit të Zi nga Serbia më 2006, e deri te Pavarësia e Kosovës më 2008. Nuk mund të ketë standarde të dyfishta: nëse pavarësia e Malit të Zi u pranua me 600 000 banorë, dhe ajo e Kosovës me 1,8 milionë banorë, pse bashkimi i dy shteteve shqiptare me vullnet të lirë duhet të përjashtohet si e pamundur? Prandaj, frika nga ndryshimet e kufijve nuk mund të shërbejë si justifikim për të mohuar të drejtën e një kombi për bashkim.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas fitores në Luftën e Ftohtë dhe kolapsit të Bllokut të Lindjes, kanë konsoliduar rolin e tyre si fuqia gjeopolitike dominuese në Ballkan dhe më gjerë. Rënia e Perandorisë Ruse dhe shpërbërja e Jugosllavisë i hapën rrugë një arkitekture të re të sigurisë në Europën Juglindore, në të cilën shqiptarët janë shndërruar në aleatin më të natyrshëm, më të besueshëm dhe më properëndimor në rajon. Duke qenë të shpërndarë në disa shtete, me dy shtete shqiptare

tashmë të pavarura, shqiptarët përfaqësojnë faktorin e stabilitetit dhe bashkëpunimit euroatlantik, jo një kërcënim për rajonin.

Në këtë kontekst, fuqizimi i faktorit shqiptar në rajon nuk është vetëm legjitim, por është domosdoshmëri strategjike për SHBA-në dhe Perëndimin, sidomos në kuadër të përpjekjeve për të ndërtuar një **rend të ri ndërkombëtar**, ku Ballkani të mos mbetet më arenë ndikimi ruso-kinez, por zonë e sigurt e ndikimit perëndimor.

Me këtë në mendje, shqiptarët duhet të shfrytëzojnë momentumin e ardhjes së presidentit Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, i cili njihet për pragmatizmin në vendimmarrje dhe për qasjen transaksionale dhe të drejtpërdrejtë ndaj politikës së jashtme. Administrata “Trump” ka treguar se preferon marrëveshje të qarta, të mbështetura në interesa strategjike dhe besueshmëri reciproke, siç u dëshmuua edhe në iniciativat në Lindjen e Mesme (marrëveshjet *Abraham*) dhe në përfshirjen në dialogun Kosovë-Serbi (Marrëveshja e Uashingtonit, 2020).

Në këtë frymë, shqiptarët mund dhe duhet të ofrohen si partner i padiskutueshëm i SHBA-së në Ballkan, jo vetëm për të ruajtur *status quo*-në, por për ta orientuar rajonin drejt një të ardhmeje të sigurt euroatlantike. Qartësimi i kësaj aleance strategjike, përmes diplomacisë aktive dhe projekteve të përbashkëta zhvillimore e ushtarake, është çelës për t’i dhënë formë aspiratës për bashkim kombëtar në një kontekst të ri global.

Administrata e Presidentit Donald Trump ka demonstruar qasje pragmatike në politikën e jashtme, duke ndërmarrë vendime të guximshme që kanë ndryshuar dinamikat ndërkombëtare. Një nga këto vendime ishte njohja zyrtare e Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit më 6 dhjetor 2017, duke e bërë SHBA-në vendin e parë që ndërmori një hap të tillë. Ky veprim u pasua nga zhvendosja e ambasadës amerikane nga Tel Avivi në Jerusalem më 14 maj 2018. Një tjetër arritje e rëndësishme ishte ndërmjetësimi i Marrëveshjeve të Abrahamit, të cilat çuan në normalizimin e marrëdhënieve diplomatike midis Izraelit dhe disa vendeve arabe, përfshirë Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahrejin. Këto marrëveshje kanë hapur rrugën për bashkëpunim më të ngushtë ekonomik dhe strategjik në Lindjen e Mesme.

5. Realiteti shqiptar: mes dëshirës dhe racionalitetit politik

Bashkimi kombëtar i shqiptarëve më shumë se koncept historik ose juridik, është **ndjenjë e gjallë**, që përcjell brez pas brezi frymën e një kombi të ndarë padrejtësisht, por që aspiron të bashkohet në emër të drejtësisë, dinjitetit dhe përparimit të përbashkët. Megjithatë, përballë kësaj ndjenje të thellë e të rrënjësuar në ndërgjegjen kolektive, qëndron realiteti i ndërlikuar politik dhe institucional, që kërkon balancë mes dëshirës kombëtare dhe racionalitetit politik.

5.1. Diskursi mbi bashkimin në Kosovë dhe Shqipëri

Në Kosovë dhe Shqipëri, bashkimi kombëtar nuk është më një temë tabu, përkundrazi është bërë pjesë e debatit publik, akademik dhe politik. Sipas disa sondazheve të viteve të fundit, mbi 75% e shqiptarëve në Kosovë dhe rreth 65% në Shqipëri shprehen të gatshëm të mbështesin një bashkim të të dy shteteve, nëse ai realizohet përmes referendumit të lirë dhe pa pasoja destabilizuese (IDRA, 2020; KDI, 2021). Kjo gatishmëri popullore, e cila ka qëndrueshmëri ndër breza, tregon se bashkimi kombëtar nuk është thjesht nostalgji romantike e së kaluarës, por projekt i mbështetur në realitetin e sotëm. Gjeneratat e reja e shohin atë si mundësi për rritjen e fuqisë politike, ekonomike dhe gjeostrategjike të shqiptarëve në rajon.

5.2. Qasja e elitave politike dhe intelektuale

Elitat politike shqiptare, megjithëse retorikisht e përkrahin idenë e bashkimit, nuk kanë zhvilluar ndonjë strategji të qartë institucionale për ta realizuar atë, qoftë edhe në mënyrë graduale. Në disa raste, çështja është përdorur në mënyrë populiste gjatë fushatave elektorale, por pa vullnet të sinqertë për veprim konkret. Përgjashtim bëjnë disa figura vizionare, që kanë artikuluar qartë nevojën për një qasje të përbashkët kombëtare në politikën e jashtme, në mbrojtje, arsim dhe ekonomi. Intelektualë e akademikë kanë kontribuar me projekte konkrete për integrim funksional, duke sugjeruar që, përpara se të vijë bashkimi *de jure*, të ndërtohet një platformë e integruar për bashkëpunim të thelluar institucional midis Shqipërisë dhe Kosovës.

5.3. Perceptimi i opinionit publik

Shqiptarët në të gjitha trevat etnike kanë treguar ndjenjë të thellë të identitetit të përbashkët, pavarësisht kufijve shtetërorë. Festat kombëtare, gjuha, simbolet, letërsia dhe muzika janë dëshmi të unitetit kulturor që ruhet gjallë. Në mediet sociale dhe platformat digjitale, të rinjtë shqiptarë nga Tirana, Prishtina, Tetova, Ulqini dhe Presheva ndajnë përditë përkatësinë e përbashkët, duke treguar se kombi shqiptar është **realitet socio-kulturor përtej kufijve politikë**.

Përkundër kësaj, ekziston mungesë edukimi institucional rreth temës së bashkimit kombëtar, veçanërisht në sistemin arsimor. Kurset e historisë dhe të edukatës qytetare shpesh shmangin trajtimin serioz të kësaj teme, duke e lënë atë të mbështetet vetëm në ndjesinë emocionale dhe jo në argumentin shkencor.

5.4. Dilema: bashkimi de jure vs bashkimi funksional

Në rrethanat aktuale ndërkombëtare, ku bashkësia euroatlantike preferon stabilitetin afatshkurtër ndaj drejtësisë historike, **bashkimi de jure**¹ mund të jetë një proces i ngadaltë dhe i kushtëzuar. Por kjo nuk përjashton mundësinë, madje nxit nevojën që shqiptarët të ndërtojnë **bashkimin funksional**², duke unifikuar politikat publike në fusha kyç si:

- Arsimi (njësimi i kurrikulave dhe diplomave),
- Ekonomia (zona e përbashkët tregtare dhe fiskale),
- Mbrojtja (doktrina e përbashkët ushtarake dhe emergjencave),
- Diplomacia (koordinimi në organizata ndërkombëtare),
- Kultura dhe sporti (ligat e përbashkëta dhe institucionet e përbashkëta kulturore).

Ky model i integritimit gradual, i quajtur ndryshe *bashkimi funksional*, është përdorur me sukses edhe në rastin e dy Gjermanive gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, përpara bashkimit formal në vitin 1990 (Garton Ash, 1993). Kjo strategji ofron një rrugë të mençur, realiste dhe të qëndrueshme drejt realizimit të aspiratës kombëtare.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Bashkimi kombëtar i shqiptarëve nuk është koncept abstrakt apo dëshirë utopike, por e drejtë e patjetërsueshme historike, politike dhe njerëzore, e mbështetur në fakte historike, precedentë të së drejtës ndërkombëtare dhe në vullnetin e qëndrueshëm të një kombi që është ndarë padrejtësisht nga rrethanat e gjeopolitikës europiane. Ky punim ka argumentuar se shqiptarët, si popull autokton në Ballkan, kanë qenë viktimë e vendimeve të padrejta të Konferencës së Londrës (1913) dhe të regjimeve që mohuan të drejtat e tyre kolektive. Megjithatë, ideali i bashkimit kombëtar ka mbijetuar dhe mbetet një bosht themelor i vetë identitetit shqiptar.

Në aspektin historik, shqiptarët kanë dëshmuar qartë përmes Lidhjes së Prizrenit, shpalljes së Pavarësisë më 1912 dhe rezistencës së vazhdueshme në Kosovë, Preshevë, Maqedoni dhe Çamëri, se bashkimi kombëtar nuk është shpikje politike moderne, por e drejtë e trashëguar ndër breza.

Në aspektin juridik, e drejta për vetëvendosje, e sanksionuar në dokumentet themelore të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Kartën e OKB-së (neni 1, paragrafi 2) dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 1), u jep shqiptarëve të drejtën të përcaktojnë vetë të ardhmen e tyre politike. Kosova në periudhën 1989-1999 përjetoi represion sistematik, heqje të dhunshme të autonomisë, spastrim etnik dhe gjenocid të dokumentuar ndërkombëtarisht, kushte që plotësojnë kriteret për të drejtën e shkëputjes si formë të vetëvendosjes së domosdoshme. Shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008 u gjykua nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke vendosur se *“shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur asnjë normë të së drejtës ndërkombëtare”*.

Prandaj, tani që Kosova është shtet i pavarur, e drejta për të bashkuar vullnetarisht fatin me Republikën e Shqipërisë, nëse ekziston konsensus i qartë popullor, nuk përbën kërcënim për integritetin territorial të ndonjë shteti tjetër, por përkundrazi, përbën realizim të drejtë dhe paqësor të aspiratës kombëtare shqiptare. Megjithëse neni 1, paragrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës përcakton se *“Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe*

nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti”, ky nen nuk përjashton mundësinë që, përmes një referendumi gjithëpopullor të lirë dhe demokratik, qytetarët të kërkojnë ndryshim të rendit kushtetues në përputhje me vullnetin e shumicës.

Nga ana tjetër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në preambulën e saj, afirmon qartazi se populli shqiptar ka një “aspiratë shekullore për identitetin dhe bashkimin kombëtar”. Ky formulim nuk është deklarativ, por përbën detyrim kushtetues substancial, që i jep Shqipërisë të drejtën për të propozuar bashkimin me Kosovën, nëse ky hap bëhet në përputhje me vullnetin popullor të dyanshëm dhe në respekt të parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Në aspektin gjeopolitik, theksohet se shqiptarët përfaqësojnë aleatin më të qëndrueshëm të Perëndimit në Ballkan. Pas rënies së Bllokut të Lindjes dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë konsoliduar epërsinë e tyre në rajon. Në këtë arkitekturë të re të sigurisë, shqiptarët janë partnerë strategjikë të natyrshëm, që kontribuojnë në stabilitet, demokraci dhe orientim euroatlantik.

Administrata e Presidentit Donald Trump ofroi një model të qartë të pragmatizmit diplomatik në politikën ndërkombëtare, përmes vendimeve të drejtpërdrejta dhe të guximshme, si: njohja zyrtare e Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit (2017); zhvendosja e ambasadës amerikane nga Tel Avivi në Jerusalem (2018); ndërmjetësimi i Marrëveshjeve të Abrahamit mes Izraelit dhe shteteve arabe, si dhe njohja e Kosovës nga Izraeli në vitin 2020, si pjesë e marrëveshjes së Uashingtonit, me kërkesën direkte të administratës “Trump”. Ky veprim kishte vlera të trefishta për shqiptarët: 1) tregoi se qasja pragmatike e SHBA-së mund të sjellë njohje të rëndësishme ndërkombëtare për Kosovën dhe, rrjedhimisht, të përforcojë legjitimitetin e saj ndërkombëtar; 2) konfirmoi që Kosova është pjesë e një arkitekture më të gjerë të stabilitetit global që mbështetet nga SHBA-ja; dhe 3) tregoi se shqiptarët janë përfitues të drejtpërdrejtë të vendimmarrjeve strategjike amerikane në Ballkan. Kjo logjikë vendimmarrjeje e drejtpërdrejtë, e mbështetur në interesa të qartë strategjike dhe në qëndrueshmëri politike, është mundësi që faktori politik shqiptar duhet ta kuptojë dhe ta shfrytëzojë, në funksion të

avancimit të bashkimit kombëtar në një rend të ri ndërkombëtar, ku shqiptarët janë më të bashkuar, më të organizuar dhe më të përfaqësuar.

6. Rekomandime për veprime strategjike

6.1. Theksimi i së drejtës historike të shqiptarëve

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe institucionet e Kosovës duhet të ndërtojnë një platformë të përbashkët të argumentimit historik dhe shkencor mbi të drejtën e shqiptarëve për bashkim, e bazuar në dokumente arkivore, të dhëna statistikore dhe burime ndërkombëtare. Historia duhet të kthehet në instrument legjitimiteti dhe diplomacie, jo vetëm kujtese.

6.2. Kërkesa për respektim të vullnetit të lirë të popujve

Duhet të artikulohet qartë në nivel ndërkombëtar e drejta e shqiptarëve për vetëvendosje dhe për bashkim të mundshëm nëpërmjet referendumit demokratik, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Çdo përpjekje për ta konsideruar këtë akt si kërcënim për stabilitetin duhet të kundërshtohet me argumente juridike dhe me precedentë të njohur nga komuniteti ndërkombëtar.

6.3. Nevoja për një strategji të përbashkët kombëtare në rrafshin ndërkombëtar

Kosova dhe Shqipëria duhet të harmonizojnë politikën e jashtme dhe diplomacinë publike, duke vepruar si një trup i vetëm në mbrojtje të interesave kombëtarë. Bashkëpunimi në organizata ndërkombëtare, koordinimi i qëndrimeve në raport me çështje rajonale dhe lobimi i përbashkët, janë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një blloku kombëtar shqiptar në politikën ndërkombëtare.

6.4. Roli i akademisë dhe institucioneve kërkimore për sjelljen e argumenteve shkencore

Universitetet shqiptare dhe qendrat kërkimore duhet të investojnë më shumë në studime strategjike, historike dhe juridike, që dokumentojnë të drejtën e bashkimit kombëtar, të përkthehen në gjuhë të huaja dhe të

shpërndahen në forumet ndërkombëtare. Nevojitet ndërtimi i një narrativi shkencor të përbashkët, që mbështet aspiratat kombëtare me fakte dhe legjitimitet ndërkombëtar.

Si përfundim, bashkimi kombëtar i shqiptarëve nuk është kërcënim për askënd, është kërkesë për drejtësi, dinjitet dhe të drejtën për të jetuar si komb i lirë e i bashkuar në trojet e veta. Historia dhe e drejta janë në anën e shqiptarëve. Sfida mbetet organizimi, strategjia dhe besimi i palëkundur se bashkimi nuk është vetëm i mundur, por i domosdoshëm.

Referenca

- Clayer, N. (2008). *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë*. Tiranë: AIIS.
- Clark, W. (2000). *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the Future of Combat*. New York: PublicAffairs.
- Crawford, J. (2006). *The Creation of States in International Law* (2nd ed.). Oxford: Oxford University Press.
- European Commission. (2008). *Kosovo under UNSCR 1244/99 - Progress Report*.
- Frashëri, K. (2012). *Shpallja e Pavarësisë dhe diplomacia shqiptare 1912-1914*. Tiranë: Toena.
- Garton Ash, T. (1993). *In Europe's Name: Germany and the Divided Continent*. New York: Random House.
- IDRA Research & Consulting. (2020). *Sondazhi Kombëtar mbi Integrimin Shqipëri-Kosovë*. Tiranë-Prishtinë.
- International Court of Justice (ICJ). (2010). *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo* [Advisory Opinion]. <https://www.icj-cij.org>
- International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY). (2001). *Milošević Indictment*. <https://www.icty.org>
- KDI - Këshilli Demokratik i Kosovës. (2021). *Perceptimi i opinionit publik për bashkimin kombëtar*; Prishtinë.
- Malcolm, N. (1998). *Kosovo: A Short History*. New York: New York University Press.
- Manta, E. (2009). *The Cham Issue: The Last Taboo in Greek-Albanian Relations*. *Balkan Studies*, 50(2), f 267-284.

- Presidential Proclamation Recognizing Jerusalem as the Capital of the State of Israel and Relocating the United States Embassy (2017). *The White House*.
- President Donald J. Trump Keeps His Promise to Open U.S. Embassy in Jerusalem, Israel (2018). *The White House*.
- Puto, A., & Di Lellio, A. (2009). *The London Conference and the Albanian Question: The Albanian State and its Borders*. East European Quarterly, 43(3), f. 299-322.
- Republic of Albania. (1998). *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, preambula.
- Republic of Kosovo. (2008). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 1, paragrafi 3.
- Schmitt, O. J. (2009). *Kosova: Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Tiranë: AIIS.
- *The White House* (2017). *Presidential Proclamation Recognizing Jerusalem as the Capital of Israel*.
- *The White House* (2018). *U.S. Embassy in Jerusalem, Israel*.
- United Nations (1945). *Charter of the United Nations*, Article 1(2).
- United Nations (1960). *Declaration on the Granting of Independence to Colonial Countries and Peoples* (UNGA Resolution 1514).
- United Nations (1966). *International Covenant on Civil and Political Rights*, Article 1. <https://www.ohchr.org>
- United Nations Security Council (1999). *Resolution 1244 on Kosovo*.
- Wikipedia (n.d.). *Abraham Accords*. Retrieved from. https://en.wikipedia.org/wiki/Abraham_Accords

1 I referohet bashkimit të plotë dhe zyrtar të dy entiteteve shtetërore në një shtet të vetëm të pranuar nga rendi ndërkombëtar, përmes procesit kushtetues, referendumit apo traktatit të bashkimit, me pasoja të plota juridike dhe sovraane në sistemin ndërkombëtar.

2 Bashkimi funksional: Nënkupton procesin e afrimit ndërmjet dy ose më shumë shteteve përmes unifikimit të politikave publike dhe institucioneve në fusha të caktuara (arsimi, ekonomia, mbrojtja,

kultura etj.), pa realizuar ende një bashkim formal juridik. Ky model është përdorur, ndër të tjera, edhe nga dy Gjermanitë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë përpara bashkimit zyrtar më 1990.

1. 10 Arian GALDINI

Neoshqiptarizmi si thirrje e kohës

Në panoramën e mendimit politik shqiptar, libri “Neoshqiptarizmi” i Arian Galdinit shfaqet si një manifest i një rinisjeje kombëtare dhe intelektuale, një përpjekje për të rikthyer shqiptarizmin si një vizion dhe projekt të qëndrueshëm politik dhe kulturor.

Ky tekst, i mbështetur mbi një analizë historike, ideologjike dhe filozofike të thelluar, synon të ndërtojë një qasje të re për të ardhmen e kombit shqiptar, duke lidhur traditën me modernitetin, identitetin kombëtar me progresin dhe patriotizmin me angazhimin politik të ndriçuar.

Në thelbin e tij, “Neoshqiptarizmi” është një përpjekje për të sintetizuar trashëgiminë historike dhe mendimin politik shqiptar me kërkesat e kohës moderne. Në këtë drejtim, Galdini ndjek një linjë të mendimit, që ngjason me konservatorizmin ndriçues të filozofëve, si Edmund Burke, i cili argumentonte se një komb duhet të ruajë thelbin e tij tradicional, ndërsa përshtatet me ndryshimet historike.

Kjo është një doktrinë që synon të jetë një rikthim në vlera, por pa u kthyer në një nostalgji të verbër. Në këtë kontekst, Galdini e sheh neoshqiptarizmin si një projekt të pashmangshëm për shqiptarët e shekullit XXI, duke ndërtuar mbi shtyllat e Rilindjes Kombëtare dhe mendimtarëve të mëdhenj shqiptarë, si Sami Frashëri, Fan Noli, Faik Konica, At Gjergj Fishta dhe Mithat Frashëri.

Kjo është një përpjekje për të ringjallur mendimin politik shqiptar, duke e çliruar atë nga dogmat ideologjike dhe duke e vendosur në shinat e një vizioni të qartë kombëtar. Një nga aspektet më të rëndësishme të “Neoshqiptarizmit” është përpjekja për të rizbuluar dhe riafirmuar rrënjët e identitetit shqiptar. Siç argumenton Samuel Huntingtoni te “Përplasja e qytetërimeve”, kombet që nuk njohin dhe nuk afirmojnë identitetin e

tyre, rrezikojnë të humbasin në vorbullën e globalizmit. Galdini e ndjek këtë logjikë, duke theksuar se shqiptarët duhet të njohin dhe mbrojnë trashëgiminë e tyre për të qenë faktorë në arenën ndërkombëtare. Në këtë pikë, ai ndjek një linjë mendimi të Sami Frashërit, i cili në veprën e tij *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”* argumentonte se shqiptarët duhet të zhvillojnë një vetëdije kombëtare, që bazohet në njohjen e së kaluarës dhe ndërtimin e një të ardhmeje mbi këtë themel. Një aspekt kritik i “Neoshqiptarizmit” është vizioni i tij për lidërsipin.

Galdini propozon një model të udhëheqjes me vlera, ku politika nuk shihet si një instrument pushteti, por si një akt përgjegjësie ndaj kombit. Ky është një koncept i ngjashëm me atë që promovonte Maks Veber me idenë e “etikës së përgjegjësisë”, ku liderët duhet të jenë të përkushtuar ndaj kauzave dhe jo thjesht ndaj interesave të ngushtë personalë apo gruporë.

Në këtë aspekt, “Neoshqiptarizmi” paraqitet si një thirrje për një elitë të re, e cila të ketë një kombinim të dijes, integritetit dhe përkushtimit ndaj kombit. Kjo është një qasje që sfidon realitetin aktual politik shqiptar, ku shpesh lidërsipi shihet si një mjet për të ruajtur *status quo*-në dhe jo si një forcë transformuese. Ndërsa “Neoshqiptarizmi” është një doktrinë që afirmon identitetin kombëtar dhe nuk është një izolim nga bota.

Përkundrazi, Galdini argumenton për një Shqipëri që është pjesë e Perëndimit, duke ndjekur frymën e Arbën Xhaferit, i cili theksonte se shqiptarët duhet të jenë pjesë e botës perëndimore pa humbur identitetin e tyre. Në këtë kuptim, “Neoshqiptarizmi” ngjan me konceptin e sovranizmit të ndriçuar, i cili promovon mbrojtjen e sovranitetit kombëtar, por pa refuzuar bashkëpunimin dhe integrimin ndërkombëtar. Në përfundim, “Neoshqiptarizmi” është më shumë se një analizë politike, është një thirrje për zgjim kombëtar.

Galdini kërkon të krijojë një vetëdije të re shqiptare, e cila të jetë e mbështetur mbi vlerat e qëndrueshme të kombit, por njëkohësisht e aftë të përballojë sfidat e kohës moderne. Kjo doktrinë është një përgjigje ndaj krizës së identitetit dhe mungesës së vizionit, që shpesh ka karakterizuar skenën politike shqiptare

Në këtë kuptim, “Neoshqiptarizmi” mund të shihet si një rinisje, një përpjekje për të ringjallur frymën e shqiptarizmit në një epokë të re. Libri “Neoshqiptarizmi” është një kontribut i rëndësishëm për mendimin politik shqiptar dhe një thirrje për një shqiptarizëm të ri, më të vetëdijshëm, më të guximshëm dhe më të lidhur me rrënjët e tij historike.

Duke u mbështetur në traditën e mendimtarëve më të mëdhenj shqiptarë dhe duke e përshtatur këtë trashëgimi me sfidat e shekullit XXI, Galdini krijon një platformë të fuqishme për një Shqipëri të ndërgjegjshme dhe aktive në arenën ndërkombëtare.

Në një kohë kur shqiptarët përballen me sfida të mëdha politike, ekonomike dhe kulturore, “Neoshqiptarizmi” është një ftesë për të menduar, vepruar dhe ndërtuar një të ardhme mbi themelet e vlerave më të mira kombëtare.

II. GJEOPOLITIKA RAJONALE

2.1. Dr. Sadri RAMABAJA

Aleanca ushtarake shqiptaro-kroate: produkt i lëvizjeve të reja gjeopolitike

Tirana, Prishtina dhe Zagrebi hedhin hapin historik: krijojnë aleancën ushtarake në përballje të ekspansionit serb. Sfondi i saj është ndryshimi i rrethanave gjeopolitike dhe rritja e rrezikut të sigurisë në Europën Juglindore.

Agjenda serbe vs agjenda shqiptare

Ndryshimet globale që po imponon lufta në Ukrainë dhe sidomos rikthimi i Donald Trump-it në Shtëpinë e Bardhë, pasqyrohen edhe në lëvizjet e reja me karakter gjeopolitik në rajone, siç është Europa Juglindore, alias Siujdhesa Ilirike.

Ky ndryshim në realitet kishte filluar të ngjizej një vit më parë, megjithëse si ide daton që prej vitit 2012, por asaj do t'i kthehet qeveria aktuale e Kosovës me seriozitetin më të madh, duke punuar për këtë plan në relacionin Prishtinë-Zagreb deri në detaje. Ndërkaq, ajo do t'i imponohej Tiranës zyrtare, atëherë kur lidershipi do ta kuptonte se ka marrë fund epoka kur Serbia impononte agjendën politike në Ballkan.

Ajo agjendë kishte shtyrë përpara dy procese, nga të cilat Serbia duhej të dilte fituese:

1. Ndarja e Kosovës, përmes të të ashtuquajturit *proces të ripërkufizimit të kufijve* me shqiptarët, siç e cilësonte pala serbe, ose të shkëmbimit të territoreve, siç e cilësonin marionetat e Beogradit në Prishtinë.

2. “Ballkani i Hapur”, si ide për faktorizimin e Serbisë në rajon dhe “konservimin” e statusit të Kosovës si territor!

Këto dy procese kishin marrë fund që atëherë, kur në Kosovë kishte fituar revolucionin i heshtur i 14 shkurtit 2021, duke dërguar në opozitë forcat politike dhe eshalonin e vjetër politik. Në korrik të vitit 2023, kryeministri Edi Rama pati deklaruar se nisma “Ballkani i Hapur” e

kishte përmbushur misionin e saj për të shtyrë përpara Procesin e Berlinit dhe se tani fokusi kryesor duhet të ishte ky proces.

Ndërkohë, në një konferencë për shtyp në fund të dhjetorit 2023, Rama do t'i rikthehej sërish asaj ideje, duke i bërë një interpretim deklaratës së tij të korrikut dhe duke e trajtuar si keqinterpretim nga palët, që e kishin cilësuar atë si një lloj daljeje të lehtë të Shqipërisë nga nisma për “Ballkanin e Hapur”. Në këtë konferencë me media ai theksoi, se kjo nismë vazhdon dhe nuk mund të mbyllet nga një palë e vetme.

Pavarësisht këtyre luhatjeve dhe mëdyshjeve, që në prapavijë mund të kishte elemente shantazhi, po çante tutje përpara ideja për realizimin e një aleance ushtarake me karakter strategjik, që do t'i stivonte në sirtarët e historisë që të dyja idetë e agjendës serbe: atë për aneksimin e veriut të Kosovës dhe “Ballkanin e Hapur”, por edhe do ta përmbyste historinë e aleancave ushtarake në Ballkan.

Përmbysja e historisë

Le të kujtojmë se aleanca e parë ushtarake në Ballkan ishte **Lidhja Ballkanike**, e krijuar në fillim të shekullit XX. Kjo aleancë u formua në vitin 1912 mes **Serbisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë**, që në aparençë kishte luftën kundër Perandorisë Osmane, por në realitet po bëhej që të realizonte projektin shoven për copëtimin e tokave shqiptare dhe ekspansion të secilit nga anëtarët e aleancës në dëm të gjeografisë shqiptare. Kjo aleancë qe krijuar me nxitjen e **Rusisë**, e cila kërkonte të dobësonte Perandorinë Osmane dhe të forconte ndikimin e saj në rajon. Si e tillë ajo provokoi **Luftën e Parë Ballkanike (1912-1913)**, në të cilën aleatët fituan territore të mëdha në dëm të shqiptarëve. Ndërkaq do të shpërbëhej pas Luftës së Dytë Ballkanike (1913), kur Bullgaria do të shpërfaqte pakënaqësitë e saj me ndarjen e presë dhe do të hidhet në luftë kundër ish-aleatëve të saj për ndarjen e territoreve.

Por le të kujtojmë faktin, që kësaj aleance i kishte paraprirë një aleancë tjetër dypalëshe, *ajo greko-serbe*, që rezultoi me një Marrëveshjen Greko-Serbe të nënshkruar në vitin 1867 në Wesllau, Vjenë, ku u ndanë sferat e influencës mbi territorin shqiptar.¹

Ndërkohë, aleanca shqiptaro-kroate e krijuar nuk ka kurrfarë pretendimesh territoriale as ndaj Serbisë e as ndaj ndonjë shteti tjetër në

rajon. Përkundrazi, ajo po krijohet si aleancë mbrojtëse dhe kundër ekspansionit serb, që tashmë është proklamuar përmes Deklaratës Politike të qershorit të vitit 2024, të miratuar në Kuvendin e Madh Serb në Beograd, që ka për objektiv realizimin e së ashtuquajturës “Bota Serbe”.

Deklaratën trelaterale për aleancë ushtarake² e nënshkruan në Tiranë tre ministrat e Mbrojtjes të vendeve përkatëse në mënyrë krejt solemne, pas pritjes solemne nga ana e ministrit shqiptar të Mbrojtjes, Pirro Vengu, me nderime të larta ushtarake të homologëve të tij nga Kosova, Ejup Maqedonci dhe atij nga Kroacia, Ivan Anushiq.

Sipas nënshkruesve, **sfondi i bashkëpunimit të planifikuar është “ndryshimi i rrethanave gjeopolitike dhe rritja e rrezikut të sigurisë në Europën Juglindore”.**

Në të ardhmen do të ketë bashkëpunim në të dyja nivelet e armatimit dhe stërvitjes së ushtarëve, me qëllim që ushtritë pjesëmarrëse të jenë “më kompatible” në përballje të çfarëdo mësymjeje nga ana e Serbisë. Në një fazë krizash rajonale dhe ndërkombëtare, *status quo*-ja në Ballkan nga ana e Serbisë, siç paralajmërojnë zhvillimet në Republikën Sërbska në BeH, po vihet në pikëpyetje. Kjo aleancë e re ushtarake do të duhej të shihej si kundërpërgjigje e duhur dhe në kohën e duhur ndaj politikave ekspansioniste të Serbisë.

Reagimi irracional i Beogradit

Beogradi reagoi ashpër menjëherë. Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, deklaroi në mbledhjen e nënshkrimit: *“Ne i kemi kuptuar ata dhe jemi shumë të shqetësuar”*.³ Ndërkaq, i ndodhur nën presionin e brendshëm, për shkak të protestave të vazhdueshme në vend, ai theksoi: *“Ne kemi doktrinën tonë dhe jam i sigurt se do të kemi sukses në ruajtjen e stabilitetit dhe të mbrohmë kundër çdo agresori të mundshëm ushtarak”*.⁴ Ndërkaq, pas kësaj deklarate pasoi ajo e Ministrisë së Jashtme të Beogradit, ku theksohej se Serbia ishte “garantuese e paqes dhe e neutralitetit ushtarak në Ballkan” dhe për këtë arsye ishte “veçanërisht e shqetësuar që kjo aleancë ushtarake u formua pa konsultim me Beogradin”.⁵

Beogradi ende e konsideron Kosovën si territor të tij, duke e mbajtur atë jo vetëm në preambulën e Kushtetutës, por edhe si substrat substancial të saj. Ndërkaq, çfarëdolloj përpjekjeje për ta forcuar sistemin mbrojtës të Kosovës, rrjedhimisht edhe pjesëmarrjen e Kosovës në këtë aleancë ushtarake, sipas Ministrisë së Jashtme serbe, do të ishte “goditje e drejtpërdrejtë për rendin juridik ndërkombëtar dhe kërcënim për paqen në rajon”!⁶

Në anën tjetër, armatimin dhe militarizimin e Kosovës, Beogradi pretendon ta propagandojë si kërcënim për minoritetin serb që jeton në Kosovë. Retorika politike serbe po përgatit kështu terrenin për të ndërtuar alibinë e duhur për ndërhyrje ushtarake, disi ngjashëm me atë ruse në Ukrainë.

Çka fshihet pas retorikës serbe?

Retorika e Beogradit, që e paraqet Serbinë si “garantuese të paqes dhe neutralitetit ushtarak në Ballkan”, e shpërfaqur tani, mund të lexohet në disa mënyra, duke pasur parasysh kontekstin historik dhe politik të rajonit. Kjo deklaratë duket se shërben për disa qëllime strategjike dhe propagandistike:

1. Viktimizim dhe legjitimitet ndërkombëtar – Serbia shpesh e portretizon veten si faktor stabiliteti në Ballkan, ndërsa në të njëjtën kohë akuzon fqinjët për destabilizim. Duke pretenduar neutralitet ushtarak, ajo përpiket të krijojë një imazh të moderuar përpara fuqive ndërkombëtare, veçanërisht BE-së dhe SHBA-së.

2. Kundërshtim ndaj integriteteve rajonale të Kosovës – Aleanca ushtarake trepalëshe (Zagreb-Tiranë-Prishtinë) përfaqëson një sfidë të drejtpërdrejtë për Serbinë, sepse e forcon pozitën e Kosovës si një subjekt i pavarur në skenën ndërkombëtare. Duke e paraqitur këtë aleancë si kërcënim, Serbia synon të minojë legjitimitetin e saj.

3. Frikësimi dhe retorika nacionaliste e brendshme – Kjo qasje i shërben politikës së brendshme të Serbisë, duke forcuar narrativën se vendi është i rrethuar nga forca armiqësore dhe se

duhet të jetë vigjilent. Kjo ndihmon qeverinë aktuale të justifikojë politikat e saj dhe të ruajë mbështetjen popullore.

4. Lidhja me aleatët tradicionalë – Duke e portretizuar aleancën shqiptaro-kroate si një kërcënim, Serbia kërkon të justifikojë afrimin me Rusinë dhe Kinën, duke paraqitur veten si një vend që mbetet i pavarur nga NATO dhe ndikimi perëndimor.

Në realitet, kjo retorikë është një përpjekje për të penguar afrimin e vendeve të rajonit me NATO-n dhe BE-në, ndërsa në të njëjtën kohë fsheh politikat ekspansioniste të Serbisë dhe përpjekjet e saj për ndikim në Ballkan, veçanërisht në Bosnjë dhe Kosovë. Le të kujtojmë faktin se Serbia aktualisht, me ndihmën e aleatëve të saj (Rusisë, Kinës dhe disa shteteve perëndimore, me theks Franca) ka arritur të modernizojë Forcat e Armatosura. Në fushën e shpenzimeve të mbrojtjes, “Trading Economics” vuri në dukje një rritje në 2135,80 milionë dollarë në vitin 2023, nga 1723,50 milionë dollarë në vitin 2022. Historikisht, buxheti i Serbisë ka pasur rritje të konsiderueshme. Për shembull, buxheti u rrit nga 1,14 miliardë dollarë në vitin 2019 në 1,43 miliardë dollarë në vitin 2022, duke reflektuar një prirje të rritjes së investimeve ushtarake.⁷

Përgjigja e rreptë e Kroacisë

Kryeministri kroat, Andrej Plenković, duke mos përfillur fare gjuhën diplomatike, i dha një përgjigje të rreptë Beogradit. Ai tha troç, se Zagrebi për marrëveshjen e fundit ushtarake me Kosovën dhe Shqipërinë “nuk ka nevojë ta pyesë Serbinë apo NATO-n”. Plenković iu përgjigj deklaratës së presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë se Kroacia, Shqipëria dhe Kosova shkelën marrëveshjen e vitit 1996 dhe hapën një garë armësh.

“Shpresoj se dikush do të marrë pesë minuta kohë për të lexuar tekstin e marrëveshjes ndërmjet Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës”, ka thënë Plenković, duke shtuar se me këtë akt, palët “krijuan një dokument që ndihmon përpjekjet e tyre për reforma”. Si i tillë dokumenti “nuk është i një natyre armiqësore. Unë e kuptoj që duhet kërkuar një armik më tej, por kjo marrëveshje nuk është e natyrës armiqësore. Kroacia nuk

ka nevojë të pyesë askënd për këtë, as Serbinë dhe as NATO-n”, u shpreh troç Plenkoviq.

Ndërkaq, Ministria kroate e Mbrojtjes nënshkrimin e memorandumit trelateral e cilësoi si produkt të “një interesi të madh për stabilitetin dhe sigurinë në këtë pjesë të Europës dhe veçanërisht në Kosovë”. Këto deklarata megjithatë, nuk kanë gjasa të reduktojnë zemërimin e Beogradit.

Ja disa nga arsyet që merr në konsideratë Beogradi:

- *së pari*, sepse Kroacia, të cilën Vuçiqi e ka pranuar se është e fortë ushtarakisht, sipas Beogradit, po na krijuaka një aleancë pas shpinës së Serbisë, që përfshin edhe vende të tjera fqinje;
- *së dyti*, sipas logjikës serbe dhe aleatëve të saj, para së gjithash ai rus, ky fakt nxit rivalitetin historik mes dy ish-republikave ish-jugosllave.

Kosova si faktor paqeje dhe ekuilibri në rajon

Është mëse e qartë, se Prishtina mund dhe duhet të jetë përfutësja më e madhe e kësaj aleance. Ministri kroat i Mbrojtjes, Ivan Anushiq, pas nënshkrimit theksoi në terma jo vetëm të përgjithshëm: “*Me qëllim të zgjerimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, ne dëshirojmë të ndajmë njohuritë dhe përvojën tonë me partnerët dhe të forcojmë bashkëpunimin ndërmjet industrive të mbrojtjes të vendeve tona*”. Anushiq deklaroi shprehimisht, se qëllimi ishte “të mbështesim Kosovën dhe Shqipërinë në rrugën e tyre euroatlantike”.

Anushiq në deklaratën në fjalë paralajmëroi se kjo aleancë nuk do të duhej të mbetet vetëm një aleancë trepalëshe: “*Ka partnerë të tjerë nga NATO-ja dhe BE-ja, që janë të interesuar të marrin pjesë në iniciativë*”, tha Anushiq. Se kush mund t’i bashkohet aleancës duket qartë nga deklarata me nuanca e tone trishtimi të Ministrisë së Jashtme të Serbisë: Bullgaria.

Prandaj ministri i Jashtëm i Serbisë, Marko Gjuriq, e kombinoi këtë paralajmërim me një kërkesë që merr diçka nga retorika politike, kur apeloj për sqarim: “*Nëse kjo marrëveshje, siç pretendohet, nuk është e drejtuar kundër askujt, ne kërkojmë një shpjegim se përse Serbia është e përjashtuar nga çdo negociatë për sigurinë kolektive në rajon*”.

Beogradi tani e ka të qartë, se dekada e tretë e shekullit XXI po përmbys plotësisht historinë e fillimshekullit XX, kur aleancat ndërtoheshin për ekspansion të Serbisë në dëm të tokave shqiptare. Kosova ka kohë që me strategjinë e saj, me këtë aleancë, gradualisht po shndërrohet në faktor paqeje dhe krijimit të balancave të reja në rajon.

1. Kolonel Dr.SC. Veip Proda, TRIPTIK - Jetëshkrim i shkurtër me rastin e 80-vjetorit të lindjes, Tiranë 2023, f. 160.

2. Shih tekstin e plotë të deklaratës:
<https://ishgj.net/aktualiteti/deklarata-trelaterale-e-aleances-ushtarake-shqiptaro-kroate/>

3. <https://www.gazetaexpress.com/reagon-vuciq-pushteti-e-ka-kuptuar-mesazhin-e-ketij-numri-te-madh-te-njerezve-por-qytetaret-sduan-revolucion/>

4. Po aty.

5. Po aty.

6. https://www.aa.com.tr/sq/ballkani/serbia-e-quan-provokim-marr%C3%ABveshjen-e-mbrojtjes-shqip%C3%ABri-kosov%C3%AB-kroaci-/3513643?utm_source=chatgpt.com

7. Dr. Selim Ibraimi: https://portalb.mk/forcimi-i-sigurise-pakti-kroaci-shqiperi-kosove/?fbclid=IwY2xjawJNhNxleHRuA2FlbQIxMQABHYhfl1OIhcq1Cce-MP0BgBxQR53KgRjIMSjCWHf2j4_UP0CwFXw67KwgSQ_aem_rmesksMXnqBW2ltYmxnD4A

2.2 Dr. Gurakuq KUÇI

Ballkani Perëndimor në udhëkryq: një front i vjetër lufte në kompozicionet e reja gjeopolitike

Abstrakt

Ballkani Perëndimor po transformohet në një nga frontet kryesore të përplasjes midis fuqive globale, ku strategjitë hibride të Rusisë dhe Serbisë sfidojnë drejtpërdrejt stabilitetin dhe sovranitetin e vendeve të rajonit. Ky punim analizon dimensionet komplekse të kësaj lufte hibride, duke u përqendruar në sulmet e fundit në Banjskë dhe Zveçan, që shënojnë një përshkallëzim të qëllimshëm për të destabilizuar Kosovën. Përmes përdorimit të manipulimeve demografike, sabotimit të infrastrukturës kritike dhe provokimit të tensioneve etnike, Rusia dhe Serbia po e përdorin Ballkanin si një fushëbetejë për të promovuar projektet e tyre strategjike, si “Srpski Svet” dhe “Ruski Mir”.

Duke e krahasuar këtë qasje me rastet në Gjeorgji dhe Ukrainë, punimi evidenton përdorimin e mjeteve hibride, nga narrativat propagandistike të ndërhyrjet e drejtpërdrejta, si një model për të minuar strukturat demokratike dhe për të rritur ndikimin në rajon.

Fjalë kyç: Mali i Zi, Kosova, terrorizmi, lufta hibride, Ukraina, Rusia, Serbia, NATO-ja

Ballkani Perëndimor në udhëkryq: një front i vjetër lufte në kompozicionet e reja gjeopolitike

Lufta hibride ka bërë një tranzicion nga të qenit thjesht një shqetësim teorik në një strategji të shumanshme dhe të përhapur, që ndikon rrënjësisht në strukturën e shoqërive moderne. Ajo ka kapërcyer kufijtë e propagandës dhe të dezinformimit, duke i transformuar këto mjete në armë të fuqishme për të ndikuar në proceset demokratike dhe në vendimmarrjen qeveritare. Në këtë kontekst, Ballkani Perëndimor përfaqëson një laborator dinamik, ku manifestohen në mënyrë të qartë strategjitë hibride, të cilat jo vetëm që sfidojnë stabilitetin e rajonit, por edhe rikonfigurojnë peizazhin e tij politik dhe shoqëror.

Fenomeni i “Srpski Svet” (Bota Serbe) dhe “Ruski Mir” (Bota Ruse) përbëjnë dy nga strategjitë më të dukshme që operojnë në këtë hapësirë. Të ndërtuara mbi synimet e multipolarizimit global, këto projekte janë pjesë integrale e strategjisë euroaziatike të Rusisë, e cila kërkon të sfidojë dominimin perëndimor dhe të zgjerojë ndikimin e saj në rajon. Multipolarizimi ka evoluuar nga një ide e thjeshtë teorike në një realitet të karakterizuar nga veprime konkrete dhe ndërhyrëse, siç ilustron nga iniciativat e ndërmarra nga vendet e BRICS-së, të cilat synojnë qartazi të riformësojnë ekuilibrin global të pushtetit.

Një shembull domethënës i kësaj dinamike është përmbyjsja e strukturave properëndimore në Mal të Zi, një proces që ka qenë produkt i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë nga Rusia dhe Serbia. Pas këtyre zhvillimeve, strategjia e radhës duket të jetë krijimi i një kuadri ligjor, që do të lejojë qytetarët serbë të Malit të Zi të marrin automatikisht shtetësinë serbe. Ky hap vjen në vijim të një narrative më të gjerë të ndikimit demografik dhe politik, të cilën e mbështesin të dhënat e fundit të censusit. Rezultatet e tij tregojnë një rritje të numrit të qytetarëve që identifikohen si serbë, duke krijuar kështu një bazë demografike, që favorizon ambiciet strategjike të Beogradit dhe Moskës.

Kjo ndërthurje e ndikimit të fshehtë, demografisë së manipuluar dhe ndërhyrjeve politike përbën një sfidë serioze jo vetëm për vendet e rajonit, por edhe për arkitekturën më të gjerë të sigurisë euroatlantike. Në këtë kontekst, lufta hibride në Ballkanin Perëndimor paraqitet si një model i qartë i strategjive komplekse hibride, të cilat kërkojnë një analizë të thelluar dhe një përgjigje të koordinuar nga aktorët ndërkombëtarë.

Ligji për dështetësinë në Mal të Zi: taktikë për zgjerimin e “Botës Serbe”

Në maj të vitit 2024, Instituti për Studime të Luftës Hibride “OCTOPUS” publikoi një studim shkencor, që analizonte strategjinë gjeopolitike të Rusisë dhe Serbisë kundër Malit të Zi, duke u fokusuar në luftën hibride si një mjet për të ndikuar në demografinë dhe strukturën politike të vendit. Ky studim ndriçon mënyrën se si Rusia dhe Serbia po përdorin *inxhinieringun etnik* dhe ndikimin politik për të fuqizuar identitetin serb dhe për të konsoliduar konceptin e “botës serbe”. Një nga


mjetet kryesore të kësaj strategjie është kërkesa për futjen e dyshtetësisë për qytetarët serbë të Malit të Zi.

Aktualisht, Mali i Zi ka një qëndrim strikt ndaj dyshtetësisë. Sipas legjislacionit në fuqi, një qytetar i huaj që kërkon shtetësinë malaziasë duhet të dorëzojë shtetësinë e tij të mëparshme. Kjo dispozitë ligjore përbën një pengesë për implementimin e propozimeve të partive proserbe dhe proruse, të cilat kërkojnë që qytetarët malazezë me origjinë serbe të kenë të drejtën për të pasur shtetësi të dyfishtë, përfshirë atë të Serbisë.

Këto përpjekje vijnë si pjesë e një strategjie më të gjerë për të ndryshuar balancën demografike dhe politike në Mal të Zi, duke forcuar ndjeshëm lidhjet mes komunitetit serb dhe Serbisë. Ky skenar krijon një bazë të favorshme për manipulimin politik dhe rritjen e ndikimit të Beogradit në Mal të Zi.

Statistikat demografike dëshmojnë ndryshime të thella në përbërjen etnike të Malit të Zi gjatë dekadave të fundit. Në censusin e fundit, 41,12% e popullsisë u deklarua si malaziasë, ndërsa 33% si serbe, një rritje prej 4% krahasuar me censusin e vitit 2011. Ky ndryshim është veçanërisht domethënës, kur krahasohet me të dhënat historike:

- **1948:** 1,8% serbë
- **1971:** 7,5% serbë
- **1991:** 9,3% serbë
- **2003:** 32% serbë
- **2011:** 28,7% serbë



Popullsia Serbe gjatë periudhave

Figura 1: Popullsia serbe gjatë vitit **2024**: 33% serbë

Këto shifra tregojnë një rritje disproporcionale të komunitetit serb, sidomos pas shkatërrimit të Jugosllavisë. Ky trend ka implikime të rëndësishme, duke sugjeruar një strategji të mirëmenduar për të ndryshuar përbërjen etnike dhe për të përmbysur dominimin politik të malazezëve.

Rezultatet e censusit të fundit dhe tendencat e rritjes së komunitetit serb përbëjnë një tregues të qartë të asaj që mund të cilësohet si *inxhiniering etnik*. Qëllimi kryesor është krijimi i një baze demografike, që do të mundësonte realizimin e objektivave të mëdhenj strategjikë:

1. Referendumi për bashkimin me Serbinë: Një skenar i mundshëm, ku Serbia përdor shumicën demografike për të organizuar një referendum për bashkim me Malin e Zi.

2. Ndarja e një pjese të territorit me referendum: Skenari tjetër është kur një pjesë e Malit të Zi, e dominuar nga shumica serbe dhe shumica proserbe dhe proruse, organizon referendum për ndarje.

3. Ndryshimi i rrethanave gjeopolitike: Në rast të tensioneve ndërkombëtare, një invazion i Serbisë ndaj Malit të Zi mund të justifikohet mbi bazën e “mbrojtjes” së komunitetit serb.

4. Zgjerimi i identitetit serb: Përmes kulturës, fesë dhe politikave, promovohet një identitet serb i fuqizuar në Mal të Zi.

Kjo strategji nuk është thjesht një çështje demografike apo ligjore. Ajo më tepër paraqet një kërcënim serioz për sovranitetin e Malit të Zi. Me rritjen e ndikimit serb në strukturën etnike dhe politike të vendit rrezikohet stabiliteti i brendshëm dhe integriteti territorial i Malit të Zi. Në veçanti, ndërhyrjet hibride të Serbisë dhe Rusisë përmes dezinformimit, presionit diplomatik dhe nxitjes së ndarjeve etnike synojnë të minojnë strukturat demokratike të vendit.

Përpyekjet e *inxhinieringut etnik* dhe social në Mal të Zi nuk do të ndalen, ngase ky vend përbën komponentin substancial të kompletimit të ëndrrës për “Botën Serbe” dhe përbën rrugën aktuale më të lehtë të Rusisë për dalje në det në ujëra të ngrohta.

Lufta hibride dhe strategjitë gjeopolitike të Rusisë dhe Serbisë

Në një kontekst më të gjerë, Serbia dhe Rusia kanë përfituar nga pasiguria gjeopolitike globale për të rritur ndikimin e tyre në Ballkan. Me ardhjen e Donald Trump në pushtet, Serbia e pret si një pavarësi më e madhe veprimi në Ballkanin Perëndimor, ndërkohë që Perëndimi është i preokupuar me konflikte dhe sfida të tjera, si Lindja e Mesme, lufta në Ukrainë dhe konkurrenca me Kinën. Këto përparësi taktike i kanë mundësuar Serbisë dhe Rusisë të rritin përfshirjen e tyre në Ballkan, duke e shndërruar rajonin në një zonë poroze ndaj ndikimeve të luftës hibride.




Figura 2: Lufta hibrde dhe strategjitë gjeopolitike të Rusisë dhe Serbisë

Nga një këndvështrim strategjik, Rusia dhe partnerët e saj në BRICS punojnë për një botë multipolare, që sfidon hegjemoninë e Perëndimit. Nëse plani i multipolarizimit arrin sukses, ai mund “ta detyrojë” Perëndimin të tërhiqet nga disa zona, potencialisht duke përfshirë Ballkanin. Ky vakuum potencial do të krijonte kushte të favorshme për Rusinë dhe Serbinë, që të shtyjnë përpara interesat e tyre në “Rimlandin Ballkanik”, një hapësirë strategjike me rëndësi për kontrollin e lidhjeve midis Lindjes dhe Perëndimit.

Strategjia e Aleksandër Dugini për një Europë të lirë nga influenca amerikane përbën një bazë ideologjike për qasjen ruse. Kjo ide ka gjetur mbështetje edhe në narrativat e presidentit Putin, i cili ka theksuar në mënyrë të përsëritur se Europa do të arrijë një pikë, kur nuk do të jetë më “vasale” e SHBA-së. Nëse ndasitë midis Europës dhe SHBA-së thellohen, madje edhe në një masë të vogël, kjo mund të krijojë hapësirë për Putinin që të avancojë strategjitë e tij. Për më tepër, një tërheqje graduale e interesit amerikan nga kontinenti do të përforconte pozitat e Serbisë, duke e lejuar atë të shtyjë përpara interesat e saj në rajon.

Në këtë kontekst, Ballkani mbetet një pikë nevralgjike në hartën e përplasjeve globale. Lufta hibride që zhvillohet në këtë rajon nuk përfaqëson vetëm një përpjekje për të ruajtur ndikimin lokal, por një pjesë të një strategjie globale për të sfiduar Perëndimin.

Mësime nga Gjeorgjia dhe Ukraina: paralele me strategjitë hibride në Ballkan

Lufta hibride nuk është më në termat e “kërcënimit”, por në terma realë dhe të prekshëm. Një shembull krahasues i Ballkanit Perëndimor është edhe lufta hibride e Rusisë në Gjeorgji dhe Ukrainë, dy raste ku taktikat hibride kanë sjellë destabilizim të rëndë dhe ndërhyrje territoriale. Në Gjeorgji, ndërhyrjet hibride filluan me mbështetjen e separatistëve në Osetinë e Jugut dhe Abkhazi, duke u përshkallëzuar në konfliktin e vitit 2008. Rusia përdori një kombinim të dezinformimit, presionit diplomatik dhe ndërhyrjeve ushtarake për të dobësuar sovranitetin e Gjeorgjisë dhe për të mbajtur nën kontroll këtë vend strategjik në Kaukaz.

Në Ukrainë, fillimi i konfliktit hibrid u shënua nga aneksimi i Krimesë në vitin 2014 dhe mbështetja për separatistët në rajonin e Donbasit. Lufta hibride në Ukrainë përfshiu një gamë të gjerë mjetesh, si sulmet kibernetike kundër infrastrukturës kritike, fushata masive dezinformimi dhe shfrytëzimi i pakënaqësive lokale për të krijuar përçarje sociale dhe politike. Rusia ndërtoi një narrativë, që promovonte mbrojtjen e popullsisë ruse dhe rusishtfolëse, një strategji që ngjan me përpjekjet për të fuqizuar komunitetet serbe në Mal të Zi dhe në

Kosovë.

Këta shembuj ofrojnë një model për të kuptuar se si ndërhyrjet hibride në Ballkan mund të avancohen nga Serbia dhe Rusia. Në të dyja rastet, në Gjeorgji dhe Ukrainë, elementet kyç kanë qenë:

1. Përdorimi i demografisë si mjet politik: Në të dyja vendet, Rusia ka shfrytëzuar komunitetet rusishtfolëse si bazë për legjitimimin e ndërhyrjeve.

2. Narrativa kulturore dhe historike: Promovimi i “unitetit historik dhe kulturor” ka qenë një justifikim për të ndikuar në sovranitetin e këtyre vendeve.

3. Kombinimi i mjeteve hibride dhe tradicionale: Nga dezinformimi dhe sulmet kibernetike te ndërhyrjet ushtarake të drejtpërdrejta.

Në këtë kontekst, paralelja me Ballkanin është evidente. Nëse skenarët në Gjeorgji dhe Ukrainë shërbejnë si precedentë, rreziqet për Malin e Zi, Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën janë të mëdha, veçanërisht nëse komunitetet lokale shfrytëzohen si mjet për të krijuar përçarje dhe destabilizim. Mësimi kryesor nga këto raste është se një reagim i vonuar nga Perëndimi vetëm sa i përforcon këto strategji hibride dhe i hap rrugë përshkallëzimit të mëtejshëm.

Lufta hibride ruso-serbe kundër Kosovës përmes manipulimit zgjedhor dhe sulmit terrorist


Përpjekjet hibride të Rusisë dhe Serbisë për të destabilizuar Kosovën kanë marrë forma gjithnjë e më komplekse, duke përfshirë manipulimin

zgjedhor, përdorimin e dhunës për të krijuar pasiguri dhe për të çuar përpara planet për ndarjen e Kosovës. Këto strategji përfaqësojnë një përpjekje të qartë për të minuar sovranitetin e Kosovës dhe për të krijuar hapësirë për ndërhyrje politike dhe sociale në dëm të stabilitetit rajonal. Rasti i manipulimit zgjedhor përmes *Listës Serbe* dhe dy sulmet terroriste, në Banjskë dhe Zveçan, janë shembuj të qartë të këtyre përpjekjeve.

Lufta hibride ruso-serbe në Kosovë nëpërmjet manipulimit të zgjedhjeve elektorale

Në zgjedhjet parlamentare të Kosovës, të mbajtura më 14 shkurt 2021, *Lista Serbe* siguroi 10 ndjenjëset e rezervuara për komunitetin serb, duke forcuar rolin e saj si një instrument politik i drejtuar nga Beogradi. Por strategjia e saj shkoi përtej këtyre 10 ndjenjëseve, duke synuar të manipulojë sistemin zgjedhor për të zënë ndjenjëse të tjera të rezervuara për komunitetet joshumicë, si boshnjakët, romët, ashkalinjtë dhe egiptianët. Përmes transferimit të votave nga komuniteti serb drejt kandidatëve të lidhur me *Listën Serbe*, kjo parti kërkoi të arrinte deri në 17 ndjenjëse në Kuvendin e Kosovës. Ky manipulim zgjedhor përbën një formë të luftës hibride institucionale, ku instrumentet demokratike përdoren për të minuar vetë demokracinë. Nëse kjo strategji do të realizohej, ajo do t'i jepte Serbisë një ndikim të paprecedentë në vendimmarrjen parlamentare dhe qeveritare të Kosovës, duke krijuar mundësi për të bllokuar vendime kritike ose për të përforcuar pozitat e strukturave paralele serbe në veri dhe gjithandej Kosovës në zonat e banuara me shumicë serbe. Kjo qasje përputhet me taktikat që Rusia dhe Serbia kanë përdorur edhe në vende të tjera të Ballkanit, si në Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë, ku partitë proserbe kanë manipuluar proceset politike për të dobësuar institucionet kombëtare dhe për të rritur ndikimin e Beogradit dhe të Moskës.

Sulmi terrorist në Banjskë: një provokim me përmasa hibride



*Figura 3: Lufta hibrade ruso-serbe kundër Kosovës
përmes manipulimit zgjedhor dhe sulmit terrorist*

Sulmi terrorist në Banjškë, ku një grup i armatosur serbësh me në krye Millan Radoviqin sulmoi policinë e Kosovës më 24 shtator 2023, përfaqëson një tjetër përshkallëzim të përpjekjeve hibrade të Serbisë. Ky sulm terrorist, i cili la pas viktima dhe tensione të thella, ishte një përpjekje e qartë për të destabilizuar Kosovën dhe për të krijuar një justifikim për ndërhyrje të mëtejshme.

Sulmi u karakterizua nga elemente të shumta të luftës hibrade, si:

1. Organizimi i grupeve të armatosura nga struktura paralele serbe: Këto grupe janë pjesë e një strategjie më të gjerë për të ruajtur ndikimin e Serbisë në Veri të Kosovës, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve kosovare dhe ndërkombëtare për t'i çmontuar.

2. Mbështetja e heshtur e Moskës: Rusia, përmes propagandës dhe kanaleve të saj diplomatike, e përdori këtë incident për të paraqitur një narrativë, e cila fajësonte institucionet kosovare për “shtypjen” e pakicës serbe, duke ndihmuar në ndarjen e opinionit ndërkombëtar.

3. Krijimi i tensioneve etnike: Sulmi synonte të provokonte një reagim të dhunshëm nga autoritetet kosovare, duke nxitur përçarje midis komuniteteve dhe duke e bërë më të vështirë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në Veri, që do të çonin në ndarjen e Kosovës.

Sulmi në Banjskë rikujton taktikat e përdorura nga Rusia në Ukrainë dhe Gjeorgji, ku grupe të armatosura lokale u përdorën për të krijuar destabilizim, duke hapur rrugën për ndërhyrje të mëtejshme politike dhe diplomatike.

Sulmi në Zveçan: strategjia hibride sipas modelit rus

Sulmi i fundit në Zveçan, që goditi kanalin e Ibër Lepencit, burim kyç për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për prodhimin e energjisë elektrike të Korporatës Energjetike të Kosovës, shënoi një tjetër hap në strategjinë hibride të Serbisë ndaj Kosovës, gjithnjë me një strategji hibride adaptuese. Kryetari i Komisionit të Punëve të Jashtme në Bundestagun e Gjermanisë, Micheal Roth, këtë akt e quajti një metodë terroriste ruse kundër një vendi sovran në zemër të Europës. Ky sulm, i ngjashëm me sulmet mbi infrastrukturën energjetike në Ukrainë dhe dëmtimet e kablllove nënujore në Detin Baltik, përfaqëson një përpjekje për të përdorur kaosin energjetik dhe presionin psikologjik si mjete për destabilizim.

Ndryshe nga sulmi në Banjskë, i cili u përqendrua te përpjekjet për ndarje territoriale dhe krijimin e një baze për tendenca separatiste, sulmi në Zveçan synonte dobësimin e infrastrukturave jetike të Kosovës. Kjo përpjekje kishte për qëllim, që nëpërmjet kaosit të sigurisë shumë-nivelëshe, të krijonte një mjedis të favorshëm për veprime të mëtejshme nga grupet e armatosura serbe, një pjesë aktive brenda Kosovës dhe një pjesë tjetër e pozicionuar në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sulmi nënvizonte përdorimin e mjeteve të luftës hibride, ku

përmes ndërthurjes së kaosit psikologjik, energjetik, ekonomik dhe kërcënimeve të sigurisë, Serbia vazhdon të minojë sovranitetin dhe stabilitetin e Kosovës.

Pastaj, Kosova duke u futur në një kaos me një Veri të dalë nga kontrolli, krizë energjetike, mungesë të ujit të pijshëm, të krijonte edhe një krizë të rëndë politike, sociale dhe ekonomike, që do të dërgonte drejt një polarizimi të skajshëm dhe dështimi të shtetit të Kosovës.

Kjo ngjarje përforcon modelin e mirënjohur të konflikteve hibride të përdorura nga Rusia në Gjeorgji dhe Ukrainë, ku infrastruktura kritike shërben si objektiv për të gjeneruar destabilizim dhe për të arritur përfitime strategjike. Në këtë kuptim, sulmi në Zveçan nuk duhet parë si një incident i izoluar, por si pjesë e një strategjie të qëllimshme, që kërkon përshkallëzimin e tensioneve në rajon dhe rikthimin e ndikimit serb në Veriun e Kosovës.

Rezistenca e SHBA-së kundër trekëndëshit ruso-serb në Ballkanin Perëndimor

Në Ballkanin Perëndimor, trekëndëshi strategjik i Serbisë është Republika Sërpska, Mali i Zi dhe Kosova. Ndërsa te Republika Sërpska veprimet i ka më të lehta, te Mali i Zi veprimet duhet t'i bëjë në formë hibride, duke shfrytëzuar mekanizmat politikë, juridikë, ekonomikë dhe ushtarakë, që riformësojnë kompozicionin deri në vënien jashtë loje të NATO-s. Për sa i përket Kosovës, shumica e opsioneve të mëparshme janë bllokuar që pas dështimit të sulmit terrorist në Banjskë. Në këtë situatë, opsioni më i mundshëm për Serbinë duket të jetë përshkallëzimi i luftës hibride, duke nxitur kaos dhe duke pritur mundësinë e një konflikti global. Në këtë skenar shpresohet që, në emër të shmangies së një tragjedie më të madhe, fuqitë perëndimore të detyrohen të pranojnë ndarjen e Kosovës.

Në këtë kontekst, një citim i bërë nga ish-presidenti amerikan, Donald Trump, në vitin 2018, për Malin e Zi merr një kuptim më të thellë: *“Mali i Zi është një vend i vogël, me njerëz shumë të fuqishëm dhe agresivë. Ata mund të bëhen agresivë dhe urime, ju jeni në Luftën e Tretë Botërore”*. Ky vlerësim, që tërthorazi përfshin edhe Shqipërinë si pjesë të këtij

ekuacioni, reflekton një perceptim të brishtësisë së rajonit dhe potencialin e tij për eskalim në konflikt global.




Figura 4: Rezistenca e SHBA-së kundër trekëndëshit ruso-serb në Ballkanin Perëndimor

Paralelja me Luftën e Parë Botërore, e cila filloi kur Rusia i erdhi në ndihmë Serbisë kundër Austro-Hungarisë, ngre një pyetje interesante: *A mund të fillojë Lufta e Tretë Botërore nëse SHBA-ja vendos të mbështesë Malin e Zi kundër një aleance ruso-serbe?* Ky skenar thekson rëndësinë e nenit 5 të Kartës së NATO-s, i cili parashikon mbrojtjen e përbashkët të aleatëve në rast të një sulmi të armatosur. Natyrisht, neni 5 funksionon vetëm nëse vendet agresore (veçanërisht Rusia) besojnë se SHBA-ja është vërtet serioze për të. Nëse Rusia mendon se Trump-i nuk do të hyjë në luftë për të mbrojtur anëtarët më të vegjël të NATO-s, atëherë mundësitë për konflikt rriten.

Nëse rezistenca ndaj ndikimeve ruso-serbe dështon, Ballkani Perëndimor mund të shndërrohet në një arenë të re të ndarjes midis Lindjes dhe Perëndimit. Në vend që kjo ndarje të ndodhë si në Gjermaninë e Luftës së Ftohtë, një “perde e re e hekurt” mund të

vendoset në Ballkan, duke thelluar polarizimin dhe duke ndryshuar arkitekturën e sigurisë në rajon. Për të shmangur këtë, aktorët perëndimorë duhet të jenë të vendosur në parandalimin e përshkallëzimit dhe në mbështetjen e qëndrueshmërisë rajonale përmes një qasjeje të koordinuar dhe të ekuilibruar.

Përfundime

Ballkani Perëndimor mbetet një pikë kyç në dinamikat gjeopolitike ndërkombëtare, ku tensionet e trashëguara historikisht kombinohen me kërcënimet moderne të luftës hibride. Lufta hibride, si një strategji e sofistikuar dhe shumëdimensionale, ka tejkaluar kornizat e zakonshme të konflikteve të mëparshme, duke u bërë një mjet për të ndikuar në strukturat politike dhe sociale të rajonit. Serbia dhe Rusia përdorin këto taktika për të realizuar agjendat e tyre në rajon, duke sfiduar drejtpërdrejt sovranitetin dhe stabilitetin e vendeve, si Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina.

Një ndër strategjitë më të dukshme të këtij fenomeni është implementimi i projektit “Srpski Svet”, i cili synon krijimin e një baze demografike dhe politike, që mbështet interesat e Beogradit dhe Moskës. Kjo arrihet përmes *inxhinieringut demografik*, manipulimeve zgjedhore dhe narrativave historike e kulturore që promovojnë identitetin serb dhe lidhjet e tij me Rusinë. Në mënyrë të ngjashme, taktikat hibride të përdorura në Gjeorgji dhe Ukrainë ofrojnë një model të qartë, për të kuptuar potencialin e përshkallëzimit të tensioneve në Ballkan, duke përfshirë përdorimin e demografisë, narrativave ideologjike dhe mjeteve hibride.

Gjithashtu, është e qartë se këto përpjekje nuk janë të kufizuara vetëm në aspekte demografike apo juridike. Përkundrazi, ato përfaqësojnë një kërcënim shumëdimensional, që rrezikon arkitekturën e sigurisë rajonale dhe integrimin euroatlantik të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Manipulimi i proceseve demokratike dhe krijimi i tensioneve etnike përmes mjeteve hibride thekson domosdoshmërinë për një reagim të shpejtë dhe të koordinuar nga aktorët perëndimorë.

Përvoja nga konfliktet hibride në Gjeorgji dhe Ukrainë tregon se një reagim i vonuar vetëm sa përforcon strategjitë e agresorëve dhe krijon

hapësirë për destabilizim të mëtejshëm. Në këtë drejtim, angazhimi i vazhdueshëm i NATO-s dhe i Bashkimit European në mbështetje të stabilitetit të Ballkanit është jetik për të shmangur përshkallëzimin e mëtejshëm të situatës.

Përfundimisht, lufta hibride në Ballkan nuk duhet të trajtohet si një çështje e izoluar. Ajo është pjesë e një strategjie më të gjerë globale për të sfiduar perëndimin dhe për të krijuar një rend të ri ndërkombëtar multipolar. Prandaj përgjigjja ndaj këtyre sfidave duhet të jetë po aq strategjike dhe e gjithanshme, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve demokratike dhe të sigurisë në vendet e rrezikuara, si dhe adresimin e burimeve të ndikimit hibrid.

Referenca

1. Why people are worried about Trump's Montenegro comments. (2018, July 19). *CBS News*. <https://www.cbsnews.com/news/why-people-are-worried-about-trumps-montenegro-comments/>
2. Factbase Videos. (2018, July 18). *Interview: Tucker Carlson interviews Donald Trump in Helsinki – July 17, 2018* [Video]. YouTube. Retrieved December 11, 2024, from <https://www.youtube.com/watch?v=f56hrAmD8zs>
3. Kuçi, G. (2024). GEOPOLITICAL RISKS AND RECONFIGURATIONS: SERBIA AND THE CHALLENGE TO MONTENEGRO'S STABILITY. *Octopus.*, 2. <https://doi.org/10.69921/91pd1m30>
4. More favorable U.S. attitude toward Serbs and Srpska. (2024, November 11). *SRNA*. <https://www.srna.rs/en/novost/1251329/more-favorable-u.s.-attitude-toward-serbs-and-srpska>
5. Power to 1 million homes cut in Ukraine after latest 'massive' Russian aerial attack. (2024, November 28). *PBS News*. Retrieved December 11, 2024, from <https://www.pbs.org/newshour/world/power-to-1-million-homes-cut-in-ukraine-after-latest-massive-russian-aerial-attack>
6. R., B. (2024, October 14). DFC: By adopting the law on dual citizenship, Montenegro would fully become part of the "Serbian world." *vijesti.me*. <https://en.vijesti.me/news->

b/politika/728289/dfc%2C-by-adopting-the-law-on-dual-citizenship%2C-Montenegro-would-fully-become-part-of-the-Serbian-world

7. Roth, M. (2024, November 30). *X.com*. X (Formerly Twitter). Retrieved December 11, 2024, from

https://x.com/MiRo_SPD/status/1862796362112262393

8. Seibt, S. (2024, November 21). Hybrid warfare? China sabotaging Baltic Sea cables would be ‘super surprising’, experts say. *France24*. <https://www.france24.com/en/europe/20241121-hybrid-warfare-china-sabotaging-baltic-sea-cables-would-be-super-surprising-experts-say>

9. Uka, A. (2024, November 30). Policia për shpërthimin në Ibër-Lepenc: Sulm i qëllimshëm, akt kriminal terrorist. *Kallxo*. <https://kallxo.com/lajm/policia-per-shperthimin-ne-iber-lepenc-sulm-i-qellimshem-akt-kriminal-terrorist/>

Shënim: Dr. Gurakuç Kuçi është hulumtues i lartë në Institutin për Studime të Luftës Hibride “OCTOPUS” dhe bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë.

2.3 Dr. Skënder DEMALIAJ

Teza serbe për “Shqipërinë e Madhe” ka si qëllim krijimin e “Botës Serbe” dhe moslejimin e bashkimit të trojeve shqiptare etnike

Propaganda serbe flet vazhdimisht për rrezikun e krijimit të “Shqipërisë së Madhe”. Është një përpjekje, një strategji për të hedhur “mollën e sherrit” te kancelaritë më të mëdha të botës, me qëllim moslejimin e bashkimit të trojeve etnike shqiptare asnjëherë.

Historiani italian, Antonio Boldaci, përdor termat: “*E madhja Shqipëri*”, “*Shqipëria etnike*”, “*Shqipëria e plotë*”. Shqipëria e pastër gjeografike, domethënë e konsideruar si një individualitet në vetvete dhe brenda kufijve që i kemi vënë vetes, e mbyllur në një trapez të gjerë tokash, kulmet e së cilave prekin nyjën e Mokra Gorës, hyrjen e Karvasnarasit, Ulqinit dhe Kepit të Gjuhëzës ose Glosës ndodhet afërsisht midis 39 gradë dhe 43 gradë gjerësi gjeografike veriore dhe midis 19, 20 dhe 21 gradë gjatësi gjeografike lindore. Kjo përfshin në thelb të gjithë Vilajetin e Shkodrës, Janinës dhe një pjesë të atyre të Kosovës dhe Manastirit.[1]

Shqipëria e njohur sot është shumë e reduktuar nga Shqipëria Natyrore, që ëndërronin patriotët shqiptarë e mbështetësit e saj. Madje edhe më e vogël se ajo që u krijua nga pushtuesi italian. Në fund të shekullit XIX, sipërfaqja e Shqipërisë etnike ishte 80 mijë km², sipërfaqe ballkanike brenda kufirit të Perandorisë Osmane, një tokë “*sa dy Serbi*”, siç thotë Lumo Skëndo dhe kishte 2,5 milionë banorë.[2]

Më 12 gusht 1941 italianët bashkuan territoret e pushtuara në Shqipëri e Jugosllavi. Sipërfaqja ishte 42 469 km² dhe popullsia 1,750 000. Mitrovicën e mbajtën gjermanët, një pjesë të tokave shqiptare në Maqedoni i morën bullgarët. Nishi mbeti përsëri pjesë e Serbisë. Kjo “*Shqipëri e Madhe*” ishte pjesë përbërëse e Perandorisë Italiane me shtetësi të kufizuar. Italia fashiste dhe Gjermania naziste kur vendosën të krijonin “*Shqipërinë e Madhe*”, nuk patën si qëllim të korrigjonin

vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913, por të neutralizonin rezistencën antifashiste në territoret shqiptare dhe t'i mobilizonin shqiptarët në radhët e ushtrive të tyre. Gjatë pushtimit italian u shtuan 11780 km² dhe 820 mijë banorë. Pas kapitullimit të Bullgarisë kufijtë e “Shqipërisë së Madhe” u zgjeruan deri në afërsi të Shkupit dhe prej andej në vijën Kumanovë-Preshevë-Bujanovc. Pikërisht në këtë kohë u përdor për herë të parë termi “*Shqipëri e Madhe*”. Ishte një krijesë kalimtare.

Sipas Hermann Neubacher, përfaqësuesit të lartë të Rajhut në Ballkan: “*Shqipëria e pavarur brenda kufijve të saj etnikë*” nuk lejohej se “*ishte në dëm të Serbisë*”. [3] Gjermanët lejuan Mihajlloviçin e çetnikët të kryenin krime në Kosovë. Pashk Bibë Mirakaj, sekretar i FASH-së në Pejë, para se të sulmohej Vitomirica i kishte regjistruar emrat e shtëpive çetnike dhe i kishte njoftuar udhëheqësit e sulmit që të kishin kujdes, që të mos digjet asnjë shtëpi çetnike. [4]

Pra, ekzistonte bashkëpunimi i fashistëve italianë e gjermanë me çetnikët, bashkëpunimi i Muharrem Bajraktarit me Mihajl Drazhoviçin. Lëvizja çetnike ishte për pastrimin e territoreve të Kosovës nga shqiptarët, për vrasjen e shqiptarëve, kudo që gjendeshin dhe ndodheshin, ishte për Serbinë e Madhe. Natyrshëm lind pyetja: *A mund të bashkohen trojet shqiptare nga bashkëpunimi i fashistëve me çetnikët e kuislingët në Kosovë e në Shqipëri?*

Pohimi i profesor Fehmi Aganit, se “*kjo është demagogji, gënjeshtëri, mashtrim*” është i saktë. Pra, “*Shqipëria e Madhe*” është një tallje, një cinizëm i pashembullt. Shqiptarët nuk mund të pranojnë deklaratat e Mustafa Krujës, më 30 maj 1941, në Akademinë Mbretërore Italiane të Shkencave dhe të Arteve: “*Populli shqiptar nuk do të harrojë kurrë se sendërtimi i idealit të tij më të lartë kombëtar i detyrohet vlerës dhe sakrificës së ushtarit italian, gjeniut dhe vullnetit të Duçes, krijuesi i Shqipërisë së Re të Madhe e të Pavarur*”. [5]

Profesor Fehmi Agani shtron pyetjen: *Nga erdhi, ç'është e ç'mund të jetë kjo Shqipëria e Madhe?* Dhe përgjigjet: “*Në një përcaktim elementar, por në esencë të saktë, ky atribut i jepet një shteti që shtrihet përtej kufijve të zonës së tij të natyrshme etnike, zonës ku kombi përkatës përbën shumicën. Pra, Bullgaria e Madhe do të ishte shtrirja ose pretendimi i shtetit bullgar për t'u shtrirë jashtë zonës, ku bullgarët*

përbëjnë shumicën. Kështu do të mund të thuhej për Serbinë e Madhe, për Greqinë e Madhe etj.”.[6]

Duke analizuar sintagmën “*Shqipëria e Madhe*”, shtron pyetjen tjetër: *Po shprehja Shqipëri e Madhe, shprehje që e përdornin vetëm okupatorët dhe kuislingët, produkt manipulativ i tyre, si zuri rrënjë kaq të thella dhe si gjeti përdorim kaq të gjerë në Jugosllavi?*” Dhe ai përgjigjet kështu: *“Pikërisht për shkak të karakterit mjegullues dhe manipulativ të saj. Sepse mund të instrumentalizohej dhe keqpërdorej më lehtë, mund të formulohej si përqeshje dhe si akuzë”*.[7] Pra, përkundër seriozitetit të Shqipërisë Etnike, “*Shqipëria e Madhe*” është përdorur nga serbët me tone përqeshëse dhe ironizimi. Veç kësaj, forcat e hegjemonisë e të dominimit në Serbi e në Jugosllavi e kanë përdorur dhe po e përdorin edhe sot “*Shqipëria e Madhe*” kundër kërkesës së shqiptarëve për të qenë të pavarur e të barabartë me popujt e tjerë, si një kërcënim kundër guximit që të shikohet jashtë kufijve të 1913-ës. E vërteta është se jashtë kufijve është gjysma e popullit shqiptar. Prej serbëve shpresohet në mundësitë e instrumentalizimit negativ të saj, edhe pse kjo sot duket punë e kotë.

Profesor Agani pohon se sa shumë e kanë pësuar, se sa shumë janë dënuar, sa vite burg janë vuajtur për shkak të akuzës së “*Shqipërisë së Madhe*”. Ai arrin në përfundimin e rëndësishëm, që është edhe mesazhi dhe thirrja e tij: *“Është koha për bashkimin e natyrshëm të shqiptarëve në një shtet të përbashkët as të madh, as të vogël, por shtet të të gjithë shqiptarëve, kudo ku përbëjnë shumicën, për të jetuar vetë të bashkuar e në miqësi me të gjithë popujt e tjerë”*.[8] Kjo shprehje e serbëve është mjaft dominante dhe mund të arrijë bllokimin e plotë e ilegjitimitetin e çdo kërkesë të shqiptarëve. Kërkesat e shqiptarëve vlerësohen si të tilla, që synojnë “*realizimin e qëllimit të përbashkët - krijimin e “Shqipërisë së Madhe”*”. Kurse kërkesa: *“Të krijojnë Serbinë që të përfshijë të gjithë serbët, në dukje të parë sikur gëzojnë legjitimitet, por kjo fsheh se sa pjesëtarë të popujve të tjerë do të përfshihen në këtë shtet të të gjithë serbëve”*.[9] Është shumë vigjilent ndaj veprimeve dhe qëndrimeve të serbëve dhe parasheh rrezikshmërinë e tyre. Kjo kërkon që të sqarohet edhe opinionin ndërkombëtar. Për prof. Fehmi Aganin, sintagma “*Shqipëri e Madhe*” është e okupatorit dhe e kuislingëve. Ishte një demagogji, një

mashttrim, një shfajësim. “*Shqipëria e Madhe*” është një gënjeshtër, një provokacion dhe një instrument i instrumentalizuar, i papërdorshëm... Balli Kombëtar flet për “*Shqipërinë etnike*”, por nuk dinë a duan të thonë me këtë.[10]

Si u copëtuan trojet shqiptare?

Para vitit 1877 shqiptarët shtriheshin deri në Prokopolje, Leskovac e Vranjia, madje deri në liqenin e Masuricës, dega e Moravës, por me kalimin e kohës u dëbuan nga aty prej serbëve.

Në vitin 1876 shqiptarët u shpërngulën me dhunë nga trojet e tyre në Nish e në Sanxhak. Në prag të Luftës së Lindjes (1875-1878) Serbia është zgjeruar në jug, duke pushtuar rreth 12 mijë km² të territorit shqiptar. Në Nish ka marrë 248 katunde, në Pirrot 189 katunde, në Vranjë 189 katunde, në krahinën e Toplicës 372 katunde. Pra, gjithsej 998 katunde. [11] Ky është akti i parë i spastrimit etnik, duke i quajtur këto territore si “*Serbia e Re*”. Objektivi i kësaj strategjie ishte “*krijimi i një shteti nacional tërësisht homogjen*”. Ky objektiv është përfshirë edhe në vitin 2020 në strategjinë e fundit për politikë të jashtme që Beogradi aplikon sidomos në Kosovë.

Në luftën e fundit turko-ruse (1877) malazezëve iu dha Podgorica, duke përfshirë Triepshet. Në vitin 1882 Fuqitë e Mëdha ia dhanë Ulqinin dhe një pjesë të bregut të poshtëm të djathtë të Bunës. Pas Luftës së Parë Botërore, Shqipërisë iu shkëput nga trugu i saj Kosova dhe Çamëria. Me formimin e Jugosllavisë sipas statistikave qeveritare të vitit 1921, shqiptarët përbënin 3,7 % të popullsisë prej 11 619 750 banorësh, domethënë shqiptarët ishin 430 mijë banorë.

Serbët në Mesjetë pushtuan Ballkanin deri në Thesali, duke ndërtuar një pseudoperandori serbe jetëshkurtër, e cila zgjati pothuajse gjysmëshekulli. Këta i konsiderojnë shqiptarët si malësorë që zbritën nga malet në fusha për të plaçkitur. Argumenti i studiuesve serbë, se disa qendra të banuara shqiptare kanë emra sllavë e, për rrjedhojë, janë historikisht sllavë, hidhet poshtë, sepse atje ku janë më të shumtë këta emra sllavë, shumica dërmuese e popullsisë njihet veç gjuhën shqipe. Edhe vetë këta studiues e pranojnë se pjesa më e madhe e popullsisë që banon në Shqipëri është e përbërë nga shqiptarët që kanë karakter të veçantë:

me një lloj trupi të rregullt, absolutisht i dallueshëm nga trupi sllav. Shqiptari zotëron një gjuhë të individualizuar përsosmërisht, që s'ka pothuajse asgjë të përbashkët me gjuhët e tjera. Zakonet, doket, këngët, traditat, legjendat si individualitet antropologjik i krejt popullit shqiptar, përbëjnë një unitet absolut dhe lehtësisht të dallueshëm që askush nuk mund ta përçajë dot. Është ky një unitet etnografik, të cilin shekujt dhe gjaku e ruajtën të pastër. [12]

Për të kuptuar më mirë thelbin e trilltë të idesë së “Shqipërisë së Madhe” dhe për të parë se deri ku i ka rrënjët, është i nevojshëm një vështrim i shkurtër historik:

Shqiptarët nuk arritën gjatë shekullit XIX të krijojnë shtetin e tyre kombëtar, ndryshe nga vendet e tjera ballkanike që i rrethonin. Lidhja Shqiptare e Prizrenit shënoi institucionin e parë të organizuar të nacionalizmit shqiptar në vitet 1878-1881. Pati një program politik, që synonte të mbronte të gjitha territoret e populluara historikisht nga shqiptarët dhe bashkimin e vilajeteve në një shtet autonom nën Perandorinë Osmane. Lidhja Shqiptare e Prizrenit shërbeu si një ngjitje e fuqishme për pjekurinë dhe organizimin e mëtejshëm të nacionalizmit shqiptar.

Kuvendi i Vlorës, më 28 nëntor 1912 shpalli Shqipërinë e lirë e të pavarur. Edhe pse e përgjysmuar nga vendimet e Konferencës së Londrës, mbeti si shtet. Ishte e rrezikuar të fshihej nga harta politike e Europës. Woodrow Wilson hodhi poshtë përfundimisht planin franko-britanik për copëtimin e mëtejshëm të Shqipërisë në mars të vitit 1920.

Për prof. Paskal Milon çështja shqiptare në Ballkan nuk është “Shqipëria e Madhe”:

Së pari, është një realitet që kërkon një zgjidhje për ato komponentë problematikë të saj me prejardhje historike dhe aktuale.

Së dyti, është një fikcion me prejardhje politike për të penguar sadopak dhe për të ndaluar mbështetjen ndërkombëtare në emër të rrezikut që përfaqëson “Shqipëria e Madhe”. [13]

Kritikët e “Shqipërisë së Madhe” midis tezave të tjera thonë se synohet të krijohet si një armë për të luftuar nacionalizmin serb, për ta dobësuar atë si një faktor i rëndësishëm rajonal.

Udhëheqja dhe elita serbe akuzon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n si nxitëse për krijimin e “*Shqipërisë së Madhe*”. Me këtë synohet të krijohet “*një zemër myslimane në Ballkan*”, se “*ekspansioni shqiptar në Ballkan*” do të ishte shprehje e rifillimit të ofensivës së muhamedanëve në Europë. Kjo nuk është e vërtetë dhe është një tezë e rrezikshme. Shqiptarët nuk kanë asnjë lidhje me fundamentalizmin islamik. Teza e rrezikut nga “*Shqipëria e Madhe*” vjen nga një koncept gjeopolitik spekulativ me veshje fetare. Skema e krijimit të boshteve fetare në Ballkan dhe e përplasjes së tyre për synime gjeopolitike është e vjetër, por u gjallërua pas shpërthimit të konfliktit në Bosnjë-Hercegovinë nga qarqe të caktuara politike, ballkanike dhe europiane.

Slllobodan Millosheviçi ishte arkitekti modern i platformës dhe i veprimit për krijimin e “*Serbisë së Madhe*”. Më 16 mars 1991 në takimin me kryetarët e komunave të Serbisë deklaronte: “... *Të fortët gjithnjë i diktojnë kufijtë dhe asnjëherë të dobëtit. Ne thjesht mendojmë se është e drejtë legjitime dhe është interes i popullit serb të jetojë në një shtet. Nëse ka nevojë të rrihemi, të grushtohemi për Zotin, edhe do të grushtohemi*”. [14] Thirrja e tij për serbët ishte: *Serbia ose do të jetë e madhe, ose do të shuhet fare!*

Memorandumi i ASHS-së (1986) shërbeu si platforma ideologjike, ku u frymëzua dhe u inkurajua Slllobodan Millosheviçi dhe klani i tij për atë çfarë bënë disa vite më vonë me luftërat në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë. Edhe në vende të tjera nga partitë politike shprehen teza për bashkim tokash në një shtet të vetëm të madh:

- Për ribërjen e Rumanisë së Madhe lufton edhe partia e Rumanisë së Madhe.
- Në Greqi, Aleanca Nacionale, në programin e saj ka: “... *Autonomi e Epirit të Veriut, si fazë e parë, pastaj bashkimi me Greqinë*”.
- Platforma e Lëvizjes Kombëtare Bullgare është: “*Doktrina Kombëtare Bullgare, Bullgaria në shekujt XX dhe XXI, për realizimin e idealit kombëtar bashkëkohor bullgar*”

Në Ballkan ka edhe parti të tjera të mëdha e të vogla, përfaqësuese të nacionalizmit primitiv, programet e së cilave janë në drejtim të kundërt me tendencën e përgjithshme të zhvillimeve bashkëkohore. Nëse forcat e nacionalizmit primitiv apo segmente të veçanta ekstremiste të tij do të fitojnë terren mbi forcat demokratike dhe konstruktive, atëherë Ballkani rrezikohet të mbetet i sëmuri kronik i Europës. Në këtë rast skenari do të ishte riciklimi i dhunës dhe i konflikteve etnike, veçanërisht në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, por edhe më gjerë. Potencialet negative për ta mbajtur Ballkanin në një situatë shpërthyes kanë treguar se ekzistojnë dhe janë aktive.

Si kundërpeshë ndaj krijimit të “*Shqipërisë së Madhe*”, historianë, akademikë dhe politikanë serbë kanë propozuar ndarjen e Kosovës, ku gjysma e saj të bashkohet me Shqipërinë dhe gjysma tjetër me Serbinë. Për këtë Dobrica Qosiq i shkruan filozofit amerikan, Noam Chomsky: *“Jam i lumtur që jemi bashkëmendimtarë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Fatkeqësisht as udhëheqja zyrtare serbe, as udhëheqja separatiste shqiptare nuk e kishin pranuar propozimin tim. Sot rezistencën më të madhe idesë sime i bëjnë SHBA-ja dhe Britania. Në regji të Klintonit dhe Toni Blerit, siç e dini ju shumë mirë, u bë dhe u krye një luftë e vockël botërore kundër Serbisë, me një arsyetim hipokrit, se “po i shpëtojmë shqiptarët nga një katastrofë humanitare”, e nga ana tjetër, katastrofën e kishte prodhuar vetë Aleanca e NATO-s. Ajo sot po përfundon me pastrimin etnik të serbëve, romëve dhe goranëve nga Kosova. Me qëllimin amerikan për t’i dhënë Kosovës pavarësi, po kryhet edhe aneksimi i territorit kombëtar serb. Çomski përsërit: një zgjidhje e drejtë dhe e përhershme është kompromisi mes të drejtës historike dhe etnike mes shqiptarëve dhe serbëve”*. [15]

Sipas Tadiçit: *“Serbia si kundërvënie për njohjen e pavarësisë së Kosovës, do ta priste bashkimin e Republikës Sërpska me Serbinë.... le të përpiqemi të gjejmë zgjidhje praktike për problemet. “Shqipëria e Madhe” është shumë e rrezikshme, mirëpo nëse ajo është pjesë e një zgjidhjeje më të madhe, ne mund ta pranojmë këtë”*. [16]

Për Shaban Muratin: *“Shqipëria e Madhe” është një konstruksion i vjetër diplomatiko-propagandistik i Beogradit për të zhvlerësuar të drejtat e kombit shqiptar mbi territoret e tij, të grabitura nga Serbia dhe*

për të luajtur rolin e viktimës në sytë e opinionit ndërkombëtar... Është një dhuratë e helmatisur. Se vetë po përpiqen ta paraqesin, ta shesin si lëshim të madh faktin që Serbia po afron “Shqipërinë e Madhe”. Nuk është hera e parë me propozime të tilla. Millosheviçi i bëri ofertë Greqisë për ta ndarë Shqipërinë, jo Kosovën; ofertë Kroacisë për të ndarë Bosnjë-Hercegovinën. Karakteristikë është se kërkojnë të ndajnë territore dhe popuj që nuk i takojnë asaj”. [17] Ndryshe mendon ish-presidenti i Serbisë, Voislav Koshtunica: “Asnjë shtet demokratik në botë nuk do të pranonte që t’i shkëputen 15% të territorit të tij” dhe se “Nuk ka lindur ai serb, që do ta jepte Kosovën”. [18] Sipas tij, Kosova është pjesë e Serbisë dhe i takon asaj dhe vetëm asaj përjetësisht. Kjo është edhe në hyrje të kushtetutës së re serbe.

Për Beogradin ka vetëm një zgjidhje: “Kosova të jetë e Serbisë, të tjerat nuk kanë rëndësi se çfarë bëjnë shqiptarët kur të mos jenë pjesë e saj. Mihailo Markoviçi, nënkryetar i PSS-së në intervistën e dhënë “Europës së Lirë” deklaronte: “Serbia nuk do të lejojë ndarjen e Kosovës nga Serbia e po qe se kjo ndodh, atëherë nuk na intereson a do të bashkohet Kosova me Shqipërinë apo me kë të dojë”. [19] Edhe për zëvendëskryeministrin e Serbisë, Ivica Daçiç: “Ndarja e Kosovës mes Serbisë dhe Shqipërisë është i vetmi opsion realist”. [20] Elita politike e Serbisë e di se Kosovën e ka të humbur, prandaj përpiqet që të marrë çfarë të mundet prej saj, për të mos dalë duarbosh.

Në Kosovë, por edhe në diasporë ka pasur përpjekje e programe për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë: Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, e drejtuar nga Adem Demaçi, më 1961. Në programin e saj, më 1964, qëllimi i parë dhe i fundit u shpall çlirimi i krahinave shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia dhe bashkimi i tyre me Shqipërinë. Për këtë ai u dënua bashkë me 80 persona të tjerë. Po kështu u krijua edhe Fronti i Kuq Popullor me udhëheqës Isuf Gërvallën, me bindje marksiste-leniniste me qëllim: *Bashkimin e popullit shqiptar në një shtet të vetëm*. Edhe Isufi, edhe vëllai i tij, edhe Kadri Zeka, bashkëpunëtori i tij i ngushtë u vranë nga UDB-ja në Gjermani.

Beogradi i ka akuzuar të gjithë këta dhe në vitet ‘90 edhe Mahmut Bakallin, si ideologë të “Shqipërisë së Madhe”. Në përgjigjen e tij, Mahmut Bakalli shkruan: “Bashkimin kombëtar të popullit shqiptar nuk e

kuptoj si zgjerim të Shqipërisë, por vetëm si deklarin demokratik të popullit shqiptar nga të gjitha viset shqiptare, si etnitete të pavarura, të cilat tashmë janë të ndara mes tyre... Populli shqiptar kurrë nuk ka hequr dorë nga aspiratat e veta çlirimtare për bashkimin kombëtar dhe luftoi për to, jo për ndonjë “Shqipëri të Madhe”, por për tërësinë e tokave të veta etnike ku jeton”.[21] Nga kjo nxjerrim dy përfundime të rëndësishme:

- Pranon se tokat shqiptare janë copëtuar dhe për t’u ribashkuar ato, shqiptarët, kudo që ndodhen, të deklarohen për këtë bashkim, sepse janë të vendosur për lirinë e tyre, për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar.
- Është për Shqipërinë etnike, natyrore, jo për zgjerim kufijsh e për t’i marrë tokë kujt, kërkon vetëm tokat e saj.

Duke hedhur poshtë akuzat e Beogradit, bën dallimin midis “Serbisë së Madhe” dhe trillimit serb për rrezikun e krijimit të “Shqipërisë së Madhe”: *“Projekti për “Serbinë e Madhe” është një realitet në letër dhe në vetëdije. Nocioni “Shqipëri e Madhe” është një trillim serb për të arritur qëllimet e veta, qëllimet e “Serbisë së Madhe”...Për Serbinë çështja e pavarësimit të Kosovës ka të bëjë edhe me “sindromin” shqiptar në tërësi në Ballkan, me aspiratat e zgjerimit dhe të sundimit të vet ndaj Shqipërisë dhe në hapësirat ballkanike. Trillimet stereotipe të Serbisë mbi “Shqipërinë e Madhe”, synim ky, i cili nuk është paragjykim, por një projekt ekzistues politik serb, filluar nga ëndrra mbi Mbretërinë Serbe të Car Dushanit, nga “Naçartania” e Garashaninit, nga Memorandumi i AKSHS-së, nga Qosiqi e deri te projekti i Millosheviçit, i cili për arsye pragmatike e politike në këtë moment nuk e thekson atë projekt, por nga i cili as që ka hequr dorë”.* [22] Vitet 1998-1999 i dhanë të drejtë Mahmut Bakallit për vlerësimet dhe analizat e tij për situatën politike në Kosovë të parashikuar 3-4 vite më parë. Projekti i Millosheviçit u vu në zbatim në Kosovë dhe synonte shpërnguljen masive të shqiptarëve nga tokat e tyre mijëvjeçare.

Kundërshtarët e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë kanë akuzuar shqiptarët se po krijojnë “Shqipërinë e Madhe” me mbështetjen e SHBA-

së dhe të Perëndimit. Sipas tyre, Kosova do të përfundojë si pjesë e Shqipërisë, duke prishur kështu balancën delikate mes kufijve dhe minoriteteve etnike në Ballkan. Në platformën për zgjidhjen e çështjes shqiptare të ASHSH-së (1998) shkruhet: *“Akademia e Shkencave kërkon ndërhyrjen e përbashkët të forcave demokratike shqiptare dhe të faktorëve me peshë ndërkombëtare për ta njohur Republikën e Kosovës si element konstituitiv të Republikës Federale të Jugosllavisë, për t'i trajtuar shqiptarët e Maqedonisë si qytetarë të barabartë me maqedonasit, pra për t'i dhënë të drejtën e popullit shtetformues, për të ndihmuar shqiptarët e Malit të Zi të kenë krahinën e tyre autonome dhe për t'u siguruar shqiptarëve të Greqisë të drejtën të mësojnë në shkollat shtetërore dhe gjuhën e tyre amtare”*.

Unë nuk kam qenë dakord me këtë platformë, veçanërisht për Kosovën. Pas çlirimit të Kosovës është e tejkaluar dhe e kapërcyer. Akademisë sonë i ka munguar vizioni dhe atdhetarizmi lidhur me Kosovën. Formulimi për shqiptarët në Maqedoni e Mal të Zi është i pranueshëm pjesërisht, kurse për shqiptarët në Greqi të shtohet edhe kthimi i pronave. Nuk është i drejtë pohimi i kryetarit të Akademisë së Shkencave të Maqedonisë në atë vit, se platforma hidhte ide nacionaliste. As sulmi i gazetës franceze *“Le Monde”*, e cila e sulmonte atë si nxënëse të denjë të asaj që hartoi Akademia e Shkencave të Serbisë më 1986. Memorandumi i saj përgatiti shfarosjen masive të popujve jashtë Jugosllavisë.[23] ASHSH-ja me këtë platformë nuk ka kërkuar as ndryshim kufijsh, as *“Shqipërinë e Madhe”*, e cila është krijuar në mendjen e qarqeve politike dhe intelektuale serbe së bashku me shumë mite, të cilat ata i quajnë *“histori”*.

Në Planin e Ahtisarit dhënia e pavarësisë së Kosovës është e kushtëzuar me moslejimin e bashkimit të saj me Shqipërinë. Sipas Dritëro Agollit: *“Problemi i “Shqipërisë së Madhe” s'ishte dhe as nuk ka qenë kurrë i yni. Ne do të donim Shqipërinë siç ka qenë në historinë e saj të fillimit, Shqipërinë para padrejtësisë europiane, Shqipërinë Natyrore”*.[24] Duke iu kthyer përsëri kësaj teme, ai shkruan: *“Të punojmë njëherë arën tonë... Kur të kemi një xhakëtë, një këmishë të mirë, atëherë mund t'i rregullojmë me një kravatë. Nuk mund të kesh kravatë në kanotiere”*.[25]

Kërkesën e shqiptarëve të Kosovës për Republikë, për shtet të pavarur, pushteti serb e quan “irredentizëm, separatizëm, përpjekje për të krijuar “Shqipërinë e Madhe”. Shpikin e trillojnë për armiq të brendshëm e të jashtëm që duan ta copëtojnë Jugosllavinë Federative, ta shpërbëjnë atë. Protestat e shqiptarëve për të qenë të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë konsiderohen kundërrevolucion. Stane Dolanc, drejtues i lartë i Jugosllavisë, në intervistën e dhënë për të përditshmen “Danas” të Zagrebit thotë: *“Nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar i kemi gjykuar në të gjitha mënyrat e mundshme, mirëpo për nacionalizmat që po shfaqen prapa skenës, po flasim e po i gjykojmë më pak. Së shpejti duhet të flasim haptazi se kush po e nxit reaksionin në Jugosllavi... Na u desh një kohë e gjatë për t’i identifikuar më qartazi problemet tona, ngase jetonim në iluzione e, madje, edhe mbi dafina të revolucionit. Njëherë thoshim se revolucioni nuk ka marrë fund, po sillnin arsye sikur asgjë nuk i kërcënohet atij dhe asgjë nuk rrezikon vazhdimësinë e tij. Më duket se tash jemi liruar nga ky iluzion”*. [26] Pra, “Shqipëria e Madhe”, sipas tij, rrezikon jo vetëm Serbinë, Jugosllavinë, integritetin e saj, por edhe fitoret e revolucionit, bashkim-vëllazërimin e popujve të Jugosllavisë. Forcimi i shtetësisë (nënkupton i shqiptarëve) rrezikon edhe vetëqeverisjen.

Azem Vllasi, anëtar i kryesisë së KK-së të LK-së të Kosovës dhe kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Prishtinës nuk flet për rrezikun e nacionalizmit serb. Sipas tij: *“Nacionalizmi shqiptar, maqedonas, nuk niset vetëm nga teza e pazhvillueshmërisë, por që të dyja kultivojnë ëndrra për një “Shqipëri të Madhe” dhe “Maqedoni të Madhe”. Për t’i luftuar këta nacionalizma lipset të krijohet një vetëdije e re, por “është fshirë, sepse në të kaluarën ndërmjet popujve ka pasur konflikte të mëdha. Mbi bazën e këtyre konflikteve nacionalistët bëjnë përpjekje për t’i përvetësuar të rinjtë”*. [27] Sipas tij, kërkesat e të rinjve, të lëvizjes studentore në Kosovë, të cilët kërkonin “Kosovën Republikë!” janë lëvizje irredentiste dhe cenojnë integritetin e Jugosllavisë. Zvogëlimi i territorit të saj shkon në dobi të krijimit të “Shqipërisë së Madhe”. Këtij shërbëtori serb i dhimbset më shumë Jugosllavia se Shqipëria.

Sipas filozofëve, indoktrinimi nacional vjen nga një elitë, domethënë gjithnjë nga lart, ndërkohë që një etni, e cila shfaqet si një lëvizje sociale,

nuk është e strukturuar në mënyrë të tillë, që të lindë indoktrinime. Për Serbinë kjo është pjesërisht e vërtetë. Indoktrinimi i serbëve nuk vjen vetëm prej elitës politike, por edhe nga ASHS-ja, nga Kisha Ortodokse. Edhe vetë shoqëria serbe është e organizuar, e strukturuar dhe e përgatitur për indoktrimin nacional.

Dobrica Qosiq, babai shpirtëror i serbëve, ka mbrojtur me konsekuencë e në vazhdimësi ndarjen e Kosovës midis serbëve dhe shqiptarëve

Ky projekt është bërë publik që në vitin 1968. Për këtë shkak u përjashtua nga Lidhja e Komunistëve. Të njëjtin qëndrim mbajti derisa vdiq. Ai deklaroi: *“Dy shekuj ne kemi të njëjtin qëllim dhe ai është lufta për çlirim dhe për bashkimin e popullit serb. Kjo është lufta e shtatë, e cila zhvillohet për realizimin e këtij qëllimi”*. [28] Edhe në ditarin *“Kosova”*, botuar në tetor të vitit 2004, me një tirazh prej 30 mijë kopjesh, mbron këtë projekt. Kritikën e tij për mosrealizimin e këtij projekti janë për Kishën Serbe, për Millosheviçin, për Rusinë e Boris Jelcinit, për Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe. Ja disa fragmente nga *“Ditari i tij”*:

- 15 nëntor 1992 Lordi Ouen: *“Bashkësia Europiane nuk është e gatshme për kurrfarë ndarjeje të Kosovës. As Amerika. Ju propozojmë që së paku 5 vjet të heshtni për sa i përket ndarjes së Kosovës”*. [29]
- 6 qershor 1993: Me shqiptarët e Kosovës tash është e pashmangshme lufta ose dorëzimi i ngadalshëm kapitullues në duart e Shqipërisë”. [30]
- 10 maj 1998: Zoti Holbrooke është tip vulgar dhe kauboj primitiv, i cili urren inteligjencën dhe krenarinë kombëtare të serbëve, ndërsa kolegu i tij, Engel Gelbart, thotë: *“Çështja e Kosovës është shumë komplekse, sepse edhe serbët, edhe shqiptarët e përjetojnë emocionalisht Kosovën dhe sillen ndaj Kosovës sikur ndaj Jerusalemit të tyre”*. Ky injorant nuk ngurron të thotë se edhe për shqiptarët Kosova është Jerusalem. Jashtë shantazhbërës! (për amerikanët)... Millosheviçi nuk është Tito,

ndërsa 1998 nuk është 1948. Millosheviçi do të detyrohet të kapitullojë ose të abdikojë. Meqë përjashtohet mundësia e abdikimit të tij, ne të gjithë e presim kapitullimin e tij, kapitullimin tonë... Millosheviçi, i çmendur politik. [31]

- 25 shtator 1998: Rusët të paaftë për të mbrojtur serbët... Perëndimi arrogant e dyfytirësh, “*demokratik*” me Rusinë e kalbur nga korrupsioni është e gatshme që për herë të dytë në këtë dekadë të luftojë kundër popullit serb. Po del se serbët janë armiq të vetëm të “*Rendit të Ri Botëror dhe të demokracisë së saj*”. [32]

- 26 shtator 1998: Vetëm disfatë nacionale me një Kosovë të re. Ky do të jetë edhe fundi i pushtetit të Millosheviçit. Të mbështetur në mbajtjen e Kosovës dhe të përfunduar me disfatë në Kosovë dhe me humbjen e Kosovës. [33]

- 13 tetor 1998: Serbia *de facto* po ua dorëzon Kosovën shqiptarëve... Millosheviçi disa vjet rresht i refuzoi negociatat dhe kompromiset (pra, ndarjen e Kosovës). E qeverisi Kosovën me polici, i keqtrajtoi dhe i persekutoi shqiptarët, i korruptoi edhe ata pak serbë të dështuar dhe të mjerë, shpresoi se gjatë mandatit të tij mund t’i mbajë shqiptarët në magjen e vet e pastaj “*pas meje le të ndodhë kiameti*”. [34]

- 27 tetor 1998: Kemi pësuar disfatë deri në eshtra. [35]

- 13 nëntor 1998: Kisha Serbe nuk ka ideologë largpamës dhe inventiv, e cila me enklavat e manastireve do të shtronte praktikisht çështjen e ndarjes së Kosovës dhe të caktimit të ri të kufijve territorialë ndërmjet serbëve e shqiptarëve. [36]

- 16 janar 1999: I lutur nga Ambasada e Francës e pranova Kollesin, zëvendësin e William Walkerit, shef i OSBE-së në Kosovë. Ia paraqita konceptin tim të kompromisit historik dhe së drejtës etnike, që nënkupton kufijtë e rinj territorialë dhe mosnjohjen e kufijve të tanishëm të Kosovës, denacionalizimin e pronave të manastireve, formimin e enklavave serbe me të drejta sovraane ngjashëm me Andorën, San Marinon, Lihtenshtajnin, me Vatikanin, në të cilat do të mbroheshim përmendoret fetare, kulturore dhe të krishtera dhe do të mundësohej bashkimi i

popullit shqiptar, si edhe realizimi i qëllimit historik të këtij populli: krijimi i shtetit nacional.[37]

Dobrica Qosiq e konsideronte fat që shqiptarët kryengritës nuk donin zgjidhje të përkohshme, por të përhershme për Kosovën: Kosovën e pavarur dhe bashkimin e shqiptarëve. Sipas tij: “*Meqë mbledhjet e serbëve e të malazezëve janë revolucion, atëherë manifestimet e shqiptarëve duhet të jenë kundërrevolucion*”.[38] Nuk ekziston “*Shqipëria e Madhe*”, por kjo është shpifje dhe trillim i serbëve për të mbajtur Kosovën koloni të tyre, për të bërë represion ndaj shqiptarëve dhe për të penguar bashkimin e shqiptarëve të Kosovës me Shqipërinë. Ekziston Shqipëria Etnike, e bashkimit të trojeve shqiptare, e cila do të realizohet në të ardhmen.

Kuvendi gjithëserb, vendimet, mesazhi dhe rreziku që vjen prej tij

Më 8 qershor 2024 u mbajt Kuvendi Gjithëserb. Deklarata e miratuar nuk është asgjë tjetër përveç konkretizimit të “*Botës Serbe*” dhe bën thirrje për unitetin e serbëve në të gjithë rajonin. Vendimet e tij janë vazhdimësi e një politike që ekziston prej vitesh nga serbët.

Deklarata që u miratua është më e rrezikshme se Memorandumi i ASHS-së. Kjo deklaratë dhe mbledhja e Kuvendit është bërë për dy arsye themelore: për Rezolutën, për Srebrenicën dhe Kosovën. Është shprehur hapur dëshira dhe kërkesa për bashkimin e Serbisë me Republikën Sërpska të Banja Lukës. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, shprehu kënaqësinë për realizimin e këtij projekti në një të ardhme jo të largët: “*Na bën krenarë, kemi krijuar realitet të ri*”. Republika Sërpska është krijuar, më 9 janar 1992. Ka 2 milionë banorë. Kryeqyteti i saj është Banja Luka që nga viti 1998. Për 31-vjetorin e krijimit të saj, Aleksandër Vuçiq dërgoi djalën e tij, Danilin. Presidenti i Serbisë ka deklaruar se ndryshimi i kufirit është i mundur vetëm nën mandatin e Kombeve të Bashkuara ose të ndonjë institucioni tjetër.[39]

Vendimet e këtij Kuvendi janë një kërcënim për paqen në rajon e më gjerë. DASH ka paralajmëruar Serbinë dhe presidentin Dodik, duke u përcjellë mesazhin: “*Në Ballkan duam stabilitet*”.

Kuvendi i Serbisë më 31 korrik 2024 ka miratuar të ashtuquajturën *Deklaratë për Mbrojtjen e të Drejtave Kombëtare, Politike dhe të*

Ardhmërisë së Përbashkët të Popullit serb, me 139 vota pro, 9 kundër, asnjë abstenim dhe 6 deputetë nuk votuan. Në takimin e përbashkët të Qeverisë së Serbisë dhe Republikës Sërpska u miratua Rezoluta me 49 pika, ku më kryesoret janë:

- Populli serb “*përbën një entitet të vetëm*” dhe se, ndonëse “*përgjatë historisë*”, ai ka jetuar në shumë shtete me emra të ndryshëm, ka të drejtë të ruajë traditën e tij të pasur.
- Kosova emërtohet “*Kosova dhe Metohija*”.
- Pika 12: Kosova është pjesë e patjetërsueshme e Serbisë. Kuvendi Gjithëserb mbështet përpjekjet e Republikës së Serbisë për ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit, të garantuara me ligjin ndërkombëtar, Rezolutën 1244 dhe Rezolutat e tjera të KS të OKB-së.
- Të krijohet asociacioni i komunave me shumicë serbe.
- Serbia nuk njeh pavarësinë e Kosovës dhe angazhohet vazhdimisht në fushata lobuese kundër Kosovës (kjo në kundërshtim me Marrëveshjen e Ohrit).
- Nënshkruesit e deklaratës kanë dënuar edhe ato që i kanë konsideruar kushte të patolerueshme të jetesës së serbëve në Kosovë, të krijuara nga autoritetet e Prishtinës, por pa përmendur ndonjë fakt konkret.
- Serbët në Kosovë, si edhe të gjithë qytetarët e tjerë që janë besnikë të Serbisë, duhet të mbrojnë manastiret, kishat, pronat private, varrezat dhe objektet e tjera të rrezikuara. [40]
- Parlamenti Gjithëserb u shpreh kundër Rezolutës për gjenocidin në Srebrenicë, miratuar nga OKB-ja.
- Sipas kësaj deklarate, Marrëveshja e Paqes e Dejtonit është “*shkelur në mënyrë të përhershme dhe të konsiderueshme dhe të gjitha aktet ndërkombëtare që lidhen me të duhet të respektohen*”.
- 15 shkurti, Dita e Shtetësisë Serbe, do të jetë edhe Dita e Shtetësisë e Republikës Sërpska, të jenë një e të festohen së bashku.

- Parlamenti e konsideron “*të papërshtatshëm*” emërimin e një përfaqësuesi të lartë në Bosnjë-Hercegovinë, në kundërshtim me aneksin e marrëveshjes së Paqes së Dejtonit.[41]

Mesazhet e Kuvendit Gjithëserb janë gjithashtu paralajmërim për rajonin e më gjerë: Serbët janë më të fortët në rajon dhe askush nuk mund të bëjë shaka me ta.

Serbët gjithnjë e kanë quajtur veten si viktimë në vazhdimësinë e tyre, duke filluar me Betjën e Fushë-Kosovës, me pushtimin austro-hungarez dhe me pushtimin fashist, më 1916 dhe 1941; me dhënien e statusit të Krahinës Autonome Kosovës, me Kushtetutën e RFSJ-së, më 1974; me Marrëveshjen e Dejtonit, me bombardimet e NATO-s, më 1999 etj. Fajtor për këtë kanë bërë Perandorinë Osmane, Austro-Hungarinë, Italinë e Musolinit, regjimin e Titos dhe Perëndimin, me në krye SHBA-në. Qëllimi i tyre ka qenë të zmadhohen në kurriz të popujve të tjerë, duke ua marrë tokat atyre dhe veçanërisht shqiptarëve e të krijojnë kështu “*Serbinë e Madhe*”. Këtë e thotë troç edhe ish-kryetarja e Republikës Serbe të Bosnjë-Hercegovinës, Biljana Plavšić: “*Në obsesionin se kurrë më nuk do të lejojmë që të bëhemi viktimë, ne kemi lejuar që të bëhemi viktimizues të të tjerëve*”.[42] E kanë thënë më parë edhe politikanë, historianë e akademikë, si Pashiçi, Cvijiçi, Qosiqi etj. E thonë edhe sot Aleksandër Vuçiqi dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë.

Aleksandër Vulin, i zgjedhur në qeverinë e re të Serbisë zëvendëskryeministër, edhe pse *non grata* nga SHBA-ja, është fytyra e vërtetë e nacionalizmit serb dhe në njëfarë mënyre thotë të pathënat e Vuçiqit. Ky është mbrojtësi më i flaktë i shkëputjes së Republikës Sërpska nga Bosnjë-Hercegovina dhe mban lidhje të ngushta me Vladimir Putinin, me të cilin takohet herë pas here. Ai e ka quajtur “*histeri antiruse*” reagimin ndaj Rusisë, pasi kjo sulmoi ushtarakisht Ukrainën. Sipas tij: “*Nëse rruga jonë drejt BE-së të çon përmes poshtërimit para gënjeshtreve rreth Srebrenicës dhe heshtjes para së vërtetës për Jasenovac, atëherë është e drejtë që Serbia të ndjekë rrugën serbe*” [43], pra, të mos jetë pjesë e BE-së.

Udhëheqja e Republikës Sërpska dërgon rregullisht mesazhe për shkëputje nga Federata e Bosnjë-Hercegovinës dhe për bashkim me

Serbinë. Udhëheqja politike e Serbisë sa për sy e faqe e për të gënjyer Perëndimin dërgon gjoja mesazhe në mbështetje të sovranitetit të Bosnjë-Hercegovinës, por në të vërtetë, siç dëshmuar edhe vendimet e marra në qershor e korrik të vitit 2024, të cilat lidhen me “*Kuvendin Gjithëserb*”, është mbështetësja dhe sponsorizuesja e shkëputjes së Republikës Sërpska nga Bosnjë-Hercegovina.

Qeveria e Republikës Sërpska ka formuar një grup pune për hartimin e një marrëveshjeje për “*shkëputje paqësore*”. Autoritetet atje kanë miratuar një sërë ligjesh, me qëllim “*kthimin e juridiksionit*” nga shteti i Bosnjës në entitetin e Republikës Sërpska. Këto janë anuluar nga Gjykata Kushtetuese e Bosnjë-Hercegovinës dhe përfaqësuesi i lartë i Komunitetit Ndërkombëtar në këtë vend, prandaj duan ta largojnë prej atje dhe nuk e njohin autoritetin e tij. Procesi politik i shpërbërjes që ka përfshirë Bosnjë-Hercegovinën, ka të bëjë me ndikimin rus në Ballkan. Rreziku më i madh i konfliktit në rajon është në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Veri të Kosovës, ku realisht ekziston rreziku i një konflikti të mundshëm. Secesionizmi dhe politika shteruese e disa zyrtarëve në Bosnjë-Hercegovinë, të cilët janë satelitë të Beogradit dhe të Moskës kanë lidhje me vizitën e drejtorit të CIA-s, William Joseph Burns në Sarajevë, Beograd, Kosovë, më 20-21-22 gusht 2024. Vizita e tij është një mesazh për Serbinë dhe Republikën Sërpska, se SHBA-ja nuk do të tolerojë veprimet e tyre. Një ditë pas vizitës së tij në Bosnjë, Presidenti i Republikës Sërpska, Milorad Dodik, deklaroi: “*Republika Sërpska nuk e ka kundërshtuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës dhe shkëputja nuk ka qenë kurrë politika jonë*”. Më i kujdesshëm dhe më i matur në deklaratat e tij ishte edhe Aleksandër Vuçiq në takimin e Pragës. Në të vërtetë këto janë manovra diplomatike. Në tavolinën e punës si për Beogradin, ashtu edhe për Banja Lukën është krijimi i “*Hapësirës Serbe*”, bashkimi i serbëve kudo që janë.

Përfundime

Propaganda e Beogradit, me mbështetjen edhe të Rusisë, por edhe të Kosovës është në sulm të pandërprerë, të egër e të rafinuar për të defaktorizuar pavarësinë e Kosovës dhe për të penguar bashkimin e

shqiptarëve, duke paraqitur para ndërkombëtarëve gogolin e “*Shqipërisë së Madhe*”. Por cilat janë disa nga drejtimet kryesore të saj?

Së pari, e quajnë një kërcënim për paqen jo vetëm për Serbinë, por për tërë rajonin, Europën e të gjithë botën, çka nuk është e vërtetë. Zgjidhja e çështjes shqiptare, vënia në vend e padrejtësisë së saj stabilizon Ballkanin e më gjerë.

Së dyti, sipas Aleksandër Vuçiq: “*Njerëzit që thonë se “Shqipëria e Madhe” është makthi ynë kanë absolutisht të drejtë. Jo vetëm makthi ynë, por edhe i Europës, ankthi i gjithë njerëzimit*”. Kështu serbët kërkojnë të rritin ndjeshmërinë e opinionit ndërkombëtar për rrezikun që paraqet “*Shqipëria e Madhe*”, duke e lidhur me proceset psikologjike, të cilat sjellin pasoja dhe probleme edhe në gjendjen shëndetësore, veçanërisht për ata që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të dhe që i ndiejnë mbi kurriz pasojat e saj.

Së treti, duke folur për rritjen e mbështetjes nga shqiptarët për bashkimin kombëtar, paralajmërojnë për tensione në rajon. Sipas tyre, “*Shqipëria e Madhe*” nuk krijohet pa luftë me Serbinë.

Beogradi me retorikën për rrezikun e “*Shqipërisë së Madhe*” përpiqet ta normalizojë dhe ta ndërkombëtarizojë diskursin për “*Serbinë e Madhe*”. Hapi i parë në këtë drejtim është prishja e kufijve të Kosovës. Ndarja e Kosovës është bërë politikë shtetërore serbe. Aleksandër Vuçiq e drejtues të tjerë të lartë të Serbisë çdo ditë deklarojnë se nuk do ta njohin Kosovën si shtet të pavarur, se “*nuk ka asnjë mënyrë që ne ta njohim Kosovën, nuk kemi nevojë për atë njohje, kemi nevojë për kompromis*”. Kompromisi nënkupton të marrin Veriun e Kosovës.

Së katërti, heqja e kufijve midis shqiptarëve, kudo që jetojnë, është premisë për “*Shqipërinë e madhe*”. Sipas Aleksandër Vulinit: “*Beogradi duhet të mbledhë të gjithë serbët e rajonit brenda dhe rreth tij, prandaj presidenti i Serbisë imponohet si president i të gjithë serbëve apo popullit serb të shpërndarë në vendet fqinje të rajonit*”.[44]

Për ta penguar më tej bashkimin e shqiptarëve, Serbia bën presion mbi Perëndimin e ndërkombëtarët, duke deklaruar në media, në takime, në konferenca e mitingje, se “*Shqipëria e Madhe*” është formuar tashmë dhe çështja e vetme është se si shumë pjesë të shteteve të tjera do t’i tërheqë kjo. Të gjithë shqiptarët, me përjashtim të dy komunave në

Serbinë Qendrore, do të jetojnë në një siguri të vetme dhe hapësirë politike, në kuadër të NATO-s. Jeta e të gjithë shqiptarëve menaxhohet nga Tirana... *“Shqipëria e Madhe”* në aspektin gjeografik nuk ekziston, por politikisht është e pranishme. [45] Kjo është një tezë tendencioze, dashakeqëse, e rrezikshme me qëllime e objektiva të caktuar politikë, sepse shqiptarët në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi kanë qeveritë e tyre.

Sipas propagandës së Beogradit: *“Krijimi i “Botës Serbe” zgjidh çështjen kombëtare të serbëve, ndalon krijimin e “Shqipërisë së Madhe”, garanton serbët se gjenocidi ndaj tyre nuk do të ndodhë më kurrë dhe, mbi të gjitha, siguron paqen afatgjatë në Ballkan”*. Ndaj serbëve nuk ka pasur gjenocid. Gjenocid kanë ushtruar ata në Bosnjë-Hercegovinë (Maskara e Srebrenicës e njohur ndërkombëtarisht me Rezolutë të OKB-së) dhe në Kosovë. Serbët paskan të drejtë të zgjidhin çështjen e tyre kombëtare, duke ua marrë tokat të tjerëve, kurse shqiptarët nuk e paskan këtë të drejtë të bashkojnë tokat e tyre. Pyetja është se çfarë kërkon Serbia në të ardhmen? Kjo nënkupton aneksimin e territoreve të vendeve fqinje. Sipas gazetave serbe me doza të forta nacionalizmi: *“Aleksandër Vuçiqi është duke risjellë Perandorinë e Car Dushanit dhe kjo do të fusë në panik boshnjakët, kroatët dhe shqiptarët. Koncepti i “Botës Serbe”, i promovuar zyrtarisht nga qeveria e Serbisë, është koncept i njëjtë me “Botën Ruse” të Putinit”*. [46]

Presidenti Aleksandër Vuçiq thotë se *“me shqiptarët na duhet marrëveshje afatgjatë e paqes për 200 vitet e ardhshme dhe se të gjitha palët do të duhet të bëjnë disa kompromise”*. [47] Kompromisi është kryefjala e kësaj marrëveshjeje, që nënkupton marrjen e Veriut të Kosovës. Ai gjithashtu flet për 200 vjet, çka do të thotë se nuk ka hequr dorë nga Kosova përjetësisht. Kur të krijohen kushtet e favorshme, do ta marrë përsëri. Tani pret momentin...

“Serbia e Madhe” dhe *“Shqipëria e Madhe”* nuk kanë pasur e as nuk kanë kurrfarë pikash barazimi ose krahasimi. Serbia është e madhe, sepse ka në përbërjen e vet pjesën më të madhe të Sanxhakut, ku sot atje ka boshnjakë dhe shqiptarë; ka Vojvodinën, ku më parë banonin hungarezë, kroatë, gjermanë, vlleh; ka krahinën rumune të Timokut, tanimë të serbizuar; ka tri komunat e Kosovës Lindore dhe ka në preambulën e

Kushtetutës në përbërje të saj edhe Kosovën, pavarësisht se ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008 dhe është njohur ndërkombëtarisht nga mbi 100 shtete të botës.

Ndryshimi midis “*Serbisë së Madhe*” dhe “*Shqipërisë së Madhe*” janë një realitet faktik, historik, gjeografik. Serbia është zgjeruar duke ua marrë tokat të tjerëve; Shqipëria është copëtuar, duke ia marrë tokat të tjerët. Ne në shtetin shqiptar jemi në kufi me shqiptarë në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Greqi. Shqipëria pak më e madhe se sot ka qenë vetëm në vitet 1941-1944, por nën sundimin italian e gjerman, pasi këto dy shtete kishin prishur të gjithë kufijtë shtetërorë në vendet e Ballkanit dhe kishin vendosur kufij administrativë dhe qeveritë e tyre kuislinge në Serbi, Greqi, Bullgari, Shqipëri dhe Kroaci. Flamuri shqiptar kishte sëpatën e lektorit. Shqiptarët jo vetëm nuk ishin bashkuar, por të pushtuar dhe e kishin humbur lirinë e tyre edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri. Edhe politika gjermane për “*neutralitet*” në Shqipëri, se kishin ardhur përkohësisht e për qëllime strategjike është farsë. Të gjitha vendimet i merrnin gjermanët. Qeveria e Rexhep Mitrovicës dhe Këshilli i Regjencës ishin kukulla në duart e autoriteteve ushtarake gjermane. Pasuritë i grabisnin, veçanërisht kromin dhe naftën, ekspedita ndëshkuese kundër forcave partizane, që ndërmerrnin pa lejen e tyre. Thjesht ata iu bashkëngjiteshin dhe armatoseshin prej tyre. Merrnin vazhdimisht para nga Banka e Shqipërisë për të mbajtur Vermatin dhe për të financuar ndërtimet e rëndësishme strategjike. Edhe politikat monetare ishin në duart e tyre. Ata morën 120 milionë franga shqiptare, tri herë më shumë se të ardhurat e parashikuara në buxhet për vitin financiar 1943-1944. [48] Pra, kemi një plaçkitje dhe grabitje totale të pasurive dhe të ardhurave të shqiptarëve.

Akademiku Rexhep Qosja shkruan: “*Me pavarësinë e Kosovës shqiptarët i afrohen synimit historik për t’u bërë të barabartë me popujt e tjerë ballkanikë, por të barabartë nuk mund të quhen, derisa Kosovës të mos i lejohet të bashkohet me Shqipërinë*”. [49]

Referenca

1. Eugenio Barbarich, *Shqipëria etnike dhe gjeografike*, Tiranë: *Botimet M&B*, 2024, f. 27-28.
2. *Kalendari Kombëtar*, Sofje 1888, f. 47.
3. Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në luftë (1939-1944)*, Tiranë: *Globus R*, 2001, f. 261.
4. Syl Dreshaj, *Prefektura e Pejës, 1941-1944*, Pejë 1998, f. 174.
5. *Shqipëria e Madhe, karaktere natyrore dhe historike*, gazeta *Shekulli*, 6 prill 2009, f. 19.
6. Fehmi Agani, Studime sociologjike, Prishtinë ASHAK, 2008, f. 550
7. Fehmi Agani, Studime sociologjike, Prishtinë ASHAK, 2008, f. 552
8. Fehmi Agani, Studime sociologjike, Prishtinë ASHAK, 2008, f. 553
9. Fehmi Agani, *Studime sociologjike*, Prishtinë ASHAK, 2008, f. 550
10. Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: *Dukagjini*, 1994, f. 147
11. Dietmar Muller, Staatsbürger auf Widerruf. Juden und Muslime als Alteritätspartner im rumänischen und serbischen Nationscode. Ethnonationale Staatsbürgerschaftskonzepte 1878-1941, Berlin 2005, f. 122.
12. Antonio Boldaci, *Shqipëria e Madhe*, Tiranë: *Eugen*, 2006, f. 217-218.
13. Paskal Milo, “*Shqipëria e Madhe*” midis trillimit dhe realitetit, gazeta *Korrieri*, 17 maj 2001, f. 3
14. Revista NIN, 17 mars 1991; Beograd.
15. Enver Bytyçi, *E drejta e vetëvendosjes, rasti i Kosovës*, Tiranë: *Koha*, 2007, f. 306.
16. Intervistë për gazetën gjermane “*Frankfurter Allgemeine Zeitung*”, 2 qershor 2011
17. *Shqipëria e Madhe e Presidentit të Serbisë*, Gazeta *Shqiptare*, 6 qershor 2011, f. 21.

18. Enver Bytyçi, *E drejta e vetëvendosjes, rasti i Kosovës*, Tiranë: *Koha*, 2007, f. 95-96.
19. *Gazeta Kombi*, 24 mars 1995, f. 2.
20. Revista NIN, 2 qershor 2011; Beograd.
21. *Beogradi akuzon Mahmut Bakallin si ideolog të "Shqipërisë së Madhe"*, *gazeta Kombi*, 24 mars 1995, f. 2.
22. *Gazeta Kombi*, 24 mars 1995, f. 2.
23. *Shqipëria e Madhe*, revista "Klan", 27 shkurt 2000, f. 29.
24. *Demokracia dhe "Shqipëria e Madhe"*, *gazeta Shqip*, 16 korrik 2006, f. 19.
25. *"Shqipëria e Madhe"*, *Gazeta shqiptare*, 19 dhjetor 2012, f. 4.
26. Agjencia "Tanjug", 29 dhjetor 1985.
27. *Gazeta "Rilindja"*, 31.12.1985, f. 2.
28. Arsim Bajrami, *Gjenocidi i Serbisë në Kosovë, aspekte juridike*, Prishtinë: ASHAK, 2023, f. 267-268.
29. *Gazeta Tema*, 26-27 dhjetor 2004, f. 13.
30. *Gazeta Tema*, 28 dhjetor 2004, f. 12.
31. *Gazeta Tema*, 28 dhjetor 2004, f. 12-13.
32. *Gazeta Tema*, 29 dhjetor 2004, f. 12.
33. *Gazeta Tema*, 29 dhjetor 2004, f. 12.
34. *Gazeta Tema*, 29 dhjetor 2004, f. 13.
35. *Gazeta Tema*, 29 dhjetor 2004, f. 13.
36. *Gazeta Tema*, 30 dhjetor 2004, f. 12.
37. *Gazeta Tema*, 30 dhjetor 2004, f. 13.
38. Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: *Dukagjini*, 1994, f. 185.
39. *Bota Press*, 15 maj 2021.
40. *Euronews Albania*, 31 korrik 2024.
41. *Gazeta Express*, 1 gusht 2024.
42. *Gazeta Bota sot*, 18 dhjetor 2002, f. 13.
43. *Infoshqip.com*, 02.07. 2021
44. Sadri Ramabaja, *Rivaliteti Shekullor. Gjeopolitika postmoderne - Rikthimi te vetvetja*, Tiranë: Onufri & ISHGJ, 2024, f. 194.
45. *Vulin i tmerruar "Shqipëria e Madhe" është formuar*, *gazeta Metro*, 7 prill 2019

46. Enver Hoxhaj, *Përplasja e madhe*, Tiranë: UET Press, 2022, f. 139.
47. *Durrës Lajmi*, 13 tetor 2017 ose <https://durrëslajm.al/vucic-me-shqiptaret-na-duhet-nje-marreveshje-paqeje-per-200-vjet/>
48. Hubert Neurth, *Politika e Hitlerit ndaj Shqipërisë*, gazeta *Standard*, 12 janar 2013, f. 15.
49. *Gazeta shqiptare*, 19 shkurt 2009, f. 2.

2.4 Dr. Lavdim HAMITI

Roli korridoreve rrugore në përcaktimin e gjeopolitikës në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Hyrje

Ballkani Perëndimor zë një vend të rëndësishëm në gjeopolitikën europiane, për shkak të pozicionit të tij strategjik, duke shërbyer si një urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit. Ky rajon, që përfshin vende si Kosova dhe Shqipëria, ka një histori të pasur si pikë kyç për rrugët tregtare dhe kulturore që lidhin Europën me Azinë dhe Lindjen e Mesme. Diversiteti etnik dhe kulturor, së bashku me historinë e tij të trazuar, e kanë bërë Ballkanin një fushë të rëndësishme për ndikime gjeopolitike nga Fuqitë e Mëdha.

Një nga faktorët kryesorë që ndikon në gjeopolitikën e rajonit është infrastruktura rrugore, e cila jo vetëm që përmirëson lidhjet ekonomike dhe tregtare mes vendeve të rajonit dhe pjesës tjetër të Europës, por gjithashtu ndikon në politikën dhe stabilitetin e brendshëm. Korridoret rrugore kanë një ndikim të thellë në zhvillimin ekonomik dhe politik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke krijuar mundësi për zhvillim dhe bashkëpunim rajonal, por edhe sfida të reja në menaxhimin e varësive gjeopolitike. Për këtë arsye, investimet në infrastrukturën rrugore janë të lidhura ngushtë me interesat strategjikë të fuqive të mëdha si Bashkimi European, Kina dhe Rusia, të cilat synojnë të rritin ndikimin e tyre në rajon përmes rrjetit të transportit.

Ky punim trajton rëndësinë e korridoreve kryesore rrugore në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë në Kosovën dhe Shqipërinë, duke analizuar rolin e këtyre korridoreve në përcaktimin e strategjive gjeopolitike dhe zhvillimit ekonomik në rajon. Gjithashtu, shqyrtohen përpjekjet dhe prioritetet e politikave kombëtare të transportit, si dhe ndikimi i organizatave ndërkombëtare, si SEETO (Observatoriumi i Transportit në Europën Juglindore), në zhvillimin e infrastrukturës së rajonit.

Rëndësia strategjike e korridoreve rrugore

Korridoret rrugore kanë një rol thelbësor në epokën e sotme të globalizuar, duke ndikuar fuqimisht në zhvillimin ekonomik, stabilitetin politik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto rrugë nuk janë thjesht elemente fizike që lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe mallrave, por gjithashtu shërbejnë si infrastrukturë kritike, që ndikon në balancat e fuqisë dhe interesat strategjikë të vendeve dhe rajoneve.

Koncepti i korridoreve rrugore daton që nga Antikiteti, kur rrugët e para tregtare u krijuan për të lidhur qytetërimet e mëdha dhe për të mundësuar qarkullimin e mallrave dhe të kulturave. *Rruga e Mëndafshit*, e cila shtrihej nga Kina në Mesdhe, dhe rrugët e Romës që lidhën Europën me Lindjen e Afërt, janë shembuj të hershëm të korridoreve ndërkombëtare. Gjatë Mesjetës dhe periudhës së Rilindjes Europiane, rrugët u zhvilluan si arterie kryesore tregtare, duke mundësuar lidhje ekonomike dhe politike midis shteteve të ndryshme.

Me zhvillimin e shteteve kombëtare dhe rritjen e tregtisë ndërkombëtare, nevoja për rrugë të përmirësuara dhe të strukturuara u bë gjithnjë e më e rëndësishme. Në shekullin XX, koncepti i korridoreve rrugore mori një formë më të qartë në kontekstin e planifikimit urban dhe zhvillimit ekonomik. Pas Luftës së Dytë Botërore, zhvillimi i rrjeteve rrugore mori një rëndësi të veçantë në Europë dhe Shtetet e Bashkuara, ku autostradat dhe korridoret kryesore u ndërtuan për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike dhe për të forcuar integrimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Në kontekstin modern, korridoret janë rezultat i planeve të koordinuara ndërkombëtare për të krijuar rrjete transporti që lidhin rajone të ndryshme të botës, duke promovuar tregtinë dhe integrimin global. Një moment historik i rëndësishëm në zhvillimin e korridoreve moderne ishte Traktati i Mastrihtit në vitin 1992, ku Bashkimi European prezantoi konceptin e rrjeteve ndëreuropiane të transportit (TEN-T), të cilat synojnë të lehtësojnë lidhjet mes vendeve anëtare dhe të forcojnë kohezionin ekonomik (Union, 1992).

Përtej Europës, projekte të tilla, si Iniciativa e Brex-it dhe Rrugës e Kinës (*Belt and Road Initiative*-BRI) pasqyrojnë përpjekjet globale për të zhvilluar korridore të reja të transportit që lidhin Lindjen me Perëndimin

dhe rajonet e tjera të botës. *Belt and Road Initiative (BRI)* u lançua në vitin 2013, kur u propozua për herë të parë nga Presidenti i Kinës, Xi Jinping, me qëllim për të përmirësuar lidhjet infrastrukturore dhe bashkëpunimin ndërrajonal në shkallë globale (Initiative, 2013). Ky projekt ka qëndruar aktiv që nga ajo kohë, me shumë vende që kanë përfituar nga investimet kineze në rrjetet rrugore dhe hekurudhore.

Këto projekte ndërkombëtare kanë një ndikim të madh në gjeopolitikë, duke krijuar mundësi të reja për vendet në zhvillim dhe për Fuqitë e Mëdha që kërkojnë të rritin ndikimin e tyre politik dhe ekonomik.

Ndikimi dhe roli gjeopolitik i Fuqive të Mëdha

Sot korridoret rrugore janë mjete të rëndësishme për lidhjen e ekonomive dhe krijimin e stabilitetit politik. Ato mundësojnë jo vetëm lëvizjen e shpejtë të mallrave dhe njerëzve, por gjithashtu krijojnë varësi të ndërsjella midis vendeve dhe rajoneve. Përmes këtyre rrugëve, ekonomitë lokale lidhen me tregjet globale, duke përmirësuar konkurrueshmërinë e rajoneve dhe duke zvogëluar izolimin ekonomik. Me investimet në këto rrjete rrugore, shtetet mund të krijojnë mundësi të reja për zhvillim dhe të forcojnë pozicionet e tyre në skenën ndërkombëtare (Reka, 2023).

Korridoret rrugore janë gjithashtu të lidhura ngushtë me stabilitetin gjeopolitik. Fuqitë e Mëdha, si Bashkimi European, Kina dhe Rusia, shpesh përdorin investimet në infrastrukturë si një mjet për të rritur ndikimin e tyre politik dhe ekonomik në rajonet strategjike. Për vendet e Ballkanit Perëndimor, për shembull, korridoret rrugore shërbejnë si një mënyrë për të tërhequr investime të huaja dhe për të forcuar marrëdhëniet ndërkombëtare. Sot zhvillimi i korridoreve rrugore përbën një sfidë dhe një mundësi për rajone si Kosova dhe Shqipëria. Ndërsa këto vende përfitojnë nga zhvillimi ekonomik dhe bashkëpunimi rajonal, ato gjithashtu përballen me sfida të reja, përfshirë varësinë nga investimet e huaja dhe tensionet politike që mund të krijohen nga kontrolli i këtyre rrugëve strategjike. Prandaj menaxhimi i këtyre korridoreve kërkon një angazhim të kujdesshëm për të balancuar interesat kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Pra, korridoret rrugore janë të domosdoshme për

zhvillimin ekonomik dhe politik në botën moderne. Përmes rrjetit të tyre të gjerë dhe lidhjeve strategjike, ato kontribuojnë në stabilitetin gjeopolitik dhe krijimin e mundësive të reja për vendet dhe rajonet që i kontrollojnë. Njohja e etimologjisë së zhvillimit të tyre ndihmon në kuptimin e rëndësisë së tyre të vazhdueshme, si dhe sfidave që paraqesin në gjeopolitikën globale dhe rajonale.

Vendosja dhe kontrolli i korridoreve rrugore kanë pasoja të thella në gjeopolitikë, pasi Fuqitë e Mëdha shpesh investojnë në infrastrukturën rrugore për të përforcuar ndikimin e tyre politik dhe ekonomik në rajone të ndryshme. Në Ballkanin Perëndimor, investime të tilla nga aktorë, si Bashkimi European, Kina dhe Rusia, kanë një efekt të ndjeshëm mbi balancën e fuqisë, duke krijuar varësi ekonomike dhe politike. Për vendet si Kosova dhe Shqipëria, korridoret rrugore janë të rëndësishme jo vetëm për të siguruar zhvillim ekonomik, por edhe për të ndihmuar në krijimin e marrëdhënieve strategjike me këta aktorë globalë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA): SHBA-ja ka një ndikim të rëndësishëm gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor, përmes investimeve të drejtpërdrejta dhe mbështetjes politike për vendet e rajonit. Pas Luftës së Ftohtë, SHBA-ja ka ndihmuar në rindërtimin e rajonit, duke investuar në infrastrukturë dhe projekte zhvillimore. Përmes NATO-s dhe partneriteteve strategjike, SHBA-ja ka luajtur një rol kyç në krijimin e korridoreve rrugore dhe në përmirësimin e lidhjeve ndërmjet vendeve, si pjesë e politikave për stabilitetin e rajonit.

Rusia: Përmes interesave të saj energjetikë dhe lidhjeve të saj tradicionale me disa vende të Ballkanit Perëndimor, ka tentuar të ndikojë në politikën rajonale, duke investuar në infrastrukturën rrugore dhe energjetike. Investimet ruse synojnë të forcojnë ndikimin ekonomik dhe politik në rajon, veçanërisht në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, ku Rusia ka interesa strategjike (Observatory, 2016). Korridoret rrugore që lidhin rajonin me Europën dhe Azinë janë pjesë e strategjisë ruse për të zgjeruar aksesin në tregjet europiane dhe për të forcuar lidhjet transportuese.

Gjermania: Si fuqia kryesore ekonomike e Bashkimit European, Gjermania është një nga investorët më të mëdhenj në korridoret rrugore të Ballkanit Perëndimor. Projekti i korridoreve paneuropiane, siç është *Korridori X*, është pjesë e përpjekjeve të Gjermanisë për të përmirësuar

lidhjet ekonomike midis vendeve të Ballkanit dhe BE-së. Korridoret rrugore ndihmojnë në integrimin ekonomik dhe politik të rajonit në strukturat europiane, duke forcuar bashkëpunimin ndërkufitar dhe duke reduktuar tensionet politike.

Franca: Edhe pse më pak e pranishme ekonomikisht se Gjermania, Franca mbështet integrimin europian të Ballkanit Perëndimor dhe ka promovuar projekte infrastrukture, që rritin lidhjen midis rajonit dhe BE-së. Investimet franceze në infrastrukturën rrugore, përmes kompanive të mëdha të ndërtimit dhe përfshirjes në projekte financiare të BE-së, synojnë të forcojnë pozicionin strategjik të Francës në rajon dhe të sigurojnë që korridoret rrugore të jenë të harmonizuara me standardet europiane.

Italia: Italia ka një interes të veçantë strategjik në Ballkanin Perëndimor, për shkak të afërsisë gjeografike dhe marrëdhënieve tregtare. Përmes investimeve në korridore rrugore dhe porte detare, Italia synon të forcojë lidhjet tregtare me vendet e Ballkanit, veçanërisht me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Autostrada Durrës-Morinë, e njohur si “Ruga e Kombit”, është një projekt i rëndësishëm që lidh Shqipërinë me Kosovën dhe është pjesë e interesave strategjike të Italisë për të zgjeruar rrjetet tregtare në rajon.

Turqia: Turqia ka intensifikuar praninë e saj në Ballkanin Perëndimor përmes investimeve në infrastrukturën rrugore dhe energjetike, duke ndërtuar korridore që lidhin rajonin me Azinë. Turqia ka një interes të veçantë në zgjerimin e lidhjeve tregtare dhe kulturore me vendet myslimane të Ballkanit, si Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Shqipëria. Përmes ndihmës financiare dhe partneriteteve strategjike, Turqia synon të rrisë ndikimin e saj politik dhe ekonomik në rajon, duke përdorur korridoret rrugore si mjet për të arritur këta objektiva.

Pra, roli i fuqive të mëdha në krijimin dhe kontrollin e korridoreve rrugore në Ballkanin Perëndimor është shumë interesat për balancat gjeopolitike të rajonit. Investimet në këto korridore krijojnë varësi ekonomike dhe politike, që formësojnë marrëdhëniet ndërkombëtare të vendeve si Kosova dhe Shqipëria me fuqitë kryesore globale. Korridoret rrugore nuk janë vetëm arterie ekonomike, por edhe mjete për Fuqitë e

Mëdha për të zgjeruar ndikimin e tyre në rajon dhe për të promovuar interesat e tyre strategjike.

Gjeopolitika e shekullit XXI dhe korridoret rrugore

Në shekullin XXI, gjeopolitika e ka përqendruar vëmendjen e saj te kontrolli ekonomik dhe diplomacia infrastrukture, duke zhvendosur theksin nga fuqia ushtarake dhe dominimi territorial. Korridoret rrugore janë bërë arterie strategjike për këtë transformim, duke luajtur një rol vendimtar në lidhjen e rajoneve, zhvillimin ekonomik dhe balancën e fuqisë në botë. Korridoret rrugore sot janë shumë më tepër sesa vetëm rrugë transporti. Ato shërbejnë si mjete për Fuqitë e Mëdha për të forcuar ndikimin e tyre ekonomik dhe politik (K. Jean, 1998,). Projekti “Belt and Road Initiative” i Kinës është një shembull, ku korridoret rrugore përdoren për të lidhur Azinë me Europën dhe për të krijuar varësi të reja ekonomike, duke rritur ndikimin gjeopolitik të Kinës. Nga ana tjetër, Bashkimi Europian, përmes rrjetit TEN-T, kërkon të kundërbalancojë ndikimin e Kinës dhe të Rusisë në Ballkanin Perëndimor, duke promovuar integrimin ekonomik të rajonit me Europën Qendrore dhe Perëndimore.

Në këtë lojë gjeopolitike, Fuqitë e Mëdha, si SHBA-ja, Rusia, Gjermania, Franca, Italia dhe Turqia konkurrojnë për të kontrolluar rrjetet e transportit. SHBA-ja, përmes investimeve të drejtpërdrejta dhe partneriteteve strategjike në Ballkanin Perëndimor, kërkon të mbajë një ndikim të fortë në rajon, duke përmirësuar lidhjet infrastrukture dhe duke promovuar stabilitetin politik. Rusia, ndërkohë, përpiqet të forcojë marrëdhëniet tradicionale me disa vende të rajonit, si Serbia, duke investuar në projekte rrugore dhe energjetike për të ruajtur ndikimin e saj. Gjermania, si ekonomia kryesore e BE-së, investon në korridore, si *Korridori X*, për të përmirësuar lidhjet tregtare dhe për të forcuar integrimin e Ballkanit Perëndimor me Europën. Franca edhe pse më pak aktive, ka përfshirë kompanitë e saj në projekte ndërtimi dhe financimi të BE-së, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës rrugore. Italia, për shkak të afërsisë gjeografike, ka një interes të veçantë në zhvillimin e korridoreve që lidhin Ballkanin me portet italiane dhe tregjet e saj, veçanërisht përmes projekteve si autostrada Durrës-Morinë. Turqia, nga

ana tjetër, ka rritur investimet e saj në Ballkan, duke krijuar korridore të reja që lidhin rajonin me Azinë dhe përmes ndihmës financiare synon të zgjasë ndikimin e saj politik dhe kulturor në vendet me shumicë myslimane, si Kosova dhe Shqipëria.

Për vendet e vogla si Kosova dhe Shqipëria, korridoret rrugore ofrojnë një mundësi të madhe për të rritur qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe për të përmirësuar infrastrukturën e brendshme, por gjithashtu krijojnë një sfidë të re në balancimin e interesave kombëtarë me varësitë që sjellin investimet e fuqive të mëdha (Group, 2020). Këto vende duhet të lundrojnë në një peizazh gjeopolitik të ndërlikuar, ku çdo investim në infrastrukturë mund të sjellë përfitime ekonomike, por edhe varësi politike. Ndërkohë që korridoret rrugore formojnë arteriet e reja të tregtisë globale, ato gjithashtu krijojnë një hartë të re gjeopolitike, duke pozicionuar Ballkanin Perëndimor si një nyjë të rëndësishme strategjike, që tërheq interesat e fuqive globale.

Shekulli XXI ka sjellë një epokë të re gjeopolitike, ku dominimi nuk matet më me fuqinë ushtarake, por me kontrollin mbi korridoret rrugore dhe rrjetet e transportit. Përmes investimeve në këto rrjete, Fuqitë e Mëdha përpiqen të forcojnë kontrollin e tyre mbi tregjet dhe rajonet strategjike. Korridoret rrugore nuk janë më thjesht rrugë transporti, por janë bërë instrumente për të vendosur ndikimin politik dhe ekonomik në një rajon, që mbetet vendimtar për balancën globale të fuqisë. Për vendet e Ballkanit Perëndimor kjo përfaqëson një mundësi për zhvillim ekonomik, por gjithashtu kërkon një menaxhim të kujdesshëm për të ruajtur pavarësinë dhe për të mos rënë në varësi nga Fuqitë e Mëdha që financojnë këto projekte.

Kontroli dhe zhvillimi i korridoreve rrugore kanë një ndikim të thellë në stabilitetin politik dhe zhvillimin ekonomik të rajoneve që përfshijnë. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, për shembull, këto korridore janë vendimtare për të përmirësuar lidhjet tregtare me Europën dhe për të forcuar integrimin ekonomik të rajonit. Investimet e fuqive të huaja në infrastrukturë krijojnë mundësi të reja për zhvillimin ekonomik, duke rritur qasjen në tregje ndërkombëtare dhe duke nxitur rritjen e ekonomive lokale (Group, 2020). Këto investime gjithashtu ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm për banorët, duke përmirësuar

infrastrukturën dhe cilësinë e jetës në rajon. Korridoret, si *Korridori X* dhe ato që lidhin Adriatikun me Detin e Zi, ofrojnë një qasje më të shpejtë në tregjet e mëdha europiane, duke rritur konkurrencën ekonomike të rajonit dhe duke tërhequr investime të huaja.

Megjithatë, përtej përfitimeve ekonomike, ekzistojnë edhe rreziqe të rëndësishme që lidhen me varësinë e krijuar nga këto investime. Korridoret rrugore mund të bëhen mjete për kontroll politik, ku fuqitë që financojnë dhe ndërtojnë infrastrukturën përdorin varësinë ekonomike për të diktuar politikat e brendshme dhe të jashtme të vendeve të vogla. Për shembull, Rusia dhe Kina, përmes projekteve infrastrukturore në Ballkan, kanë tentuar të forcojnë ndikimin e tyre politik dhe ekonomik në rajon, shpesh duke krijuar një varësi të re nga këto investime. Fuqitë e Mëdha mund të përdorin investimet në korridoret rrugore si një mjet për të zgjeruar kontrollin e tyre politik dhe për të ndikuar në vendimet strategjike të qeverive lokale. Për vendet e vogla si Kosova dhe Shqipëria, kjo varësi mund të sjellë tensione të reja gjeopolitike, duke i bërë këto vende më të ndjeshme ndaj presioneve politike nga jashtë.

Tensionet mund të lindin jo vetëm për shkak të varësisë ekonomike, por edhe për shkak të konkurrencës ndërmjet fuqive të mëdha për kontrollin e korridoreve. Për shembull, Bashkimi Europian, SHBA, Kina dhe Rusia shpesh janë në një garë për të kontrolluar korridoret strategjike që lidhin Ballkanin me tregjet e mëdha ndërkombëtare. Kjo konkurrencë mund të krijojë një situatë të paqëndrueshme, ku vendet e vogla janë të detyruara të zgjedhin midis interesave të fuqive të ndryshme, gjë që mund të destabilizojë politikën e brendshme dhe marrëdhëniet e tyre me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, qeveritë lokale duhet të menaxhojnë me kujdes marrëdhëniet e tyre me investitorët ndërkombëtarë dhe të krijojnë një strategji të ekuilibruar, që shmang krijimin e varësive të dëmshme, duke ruajtur autonominë politike dhe ekonomike.

Për të përballuar këto sfida, qeveritë duhet të sigurojnë që investimet në korridore rrugore të jenë pjesë e një strategjie të qëndrueshme zhvillimi që përfiton nga këto korridore pa rënë në varësi të rrezikshme. Një qasje që përfshin diversifikimin e burimeve të investimeve dhe bashkëpunimin rajonal mund të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit dhe të

zhvillimit ekonomik afatgjatë. Prandaj, ndërsa kontrolli dhe zhvillimi i korridoreve rrugore ofron mundësi të mëdha për zhvillim, ai gjithashtu përfaqëson një sfidë të madhe për stabilitetin dhe autonominë e vendeve të vogla në Ballkanin Perëndimor dhe rajone të tjera strategjike.

Autori Radovan Vukadinoviq në librin e tij “Marrëdhëniet politike ndërkombëtare” trajton disa çështje të rëndësishme që lidhen me zhvillimet në politikën ndërkombëtare dhe ndikimet gjeopolitike të fuqive të mëdha (Vukadinoviq R., 2009). Në kontekstin e rendit të ri botëror, ai thekson rolin strategjik të korridoreve rrugore, si një pjesë thelbësore e infrastrukturës që formëson marrëdhëniet ndërkombëtare. Disa autorë nënvizojnë se në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, kontrolli mbi korridoret rrugore nuk është më vetëm një çështje ekonomike, por një element kyç për të formësuar fuqitë politike globale dhe rajonale. Rendi i ri botëror po formësohet nga globalizimi i infrastrukturës, ku korridoret rrugore dhe hekurudhore shërbejnë si instrumente për të lidhur ekonomi të ndryshme dhe për të krijuar marrëdhënie të ndërsjella varësie. Në këtë kuadër, Ballkani dhe rajonet e tjera me rëndësi strategjike përbëjnë një fushë konkurruese për Fuqitë e Mëdha, të cilat synojnë të ushtrojnë kontroll mbi këto arterie transporti.

Përmbledhje

Korridoret rrugore luajnë një rol strategjik në gjeopolitikën e Ballkanit Perëndimor, duke qenë një kyç që lidhin Lindjen me Perëndimin. Ky rajon është një vend strategjik për Fuqitë e Mëdha, të cilat përpiqen të rritin ndikimin e tyre përmes investimeve në infrastrukturën rrugore. Bashkimi Europian, Kina, Rusia dhe aktorë të tjerë globalë kanë interes të veçantë në zhvillimin dhe kontrollin e këtyre korridoreve, për shkak të ndikimeve ekonomike dhe politike që ato krijojnë. Për vendet e Ballkanit Perëndimor si Kosova dhe Shqipëria, korridoret rrugore ofrojnë mundësi për rritje ekonomike dhe përmirësim të lidhjeve me tregjet ndërkombëtare, duke i pozicionuar më mirë për integrim në strukturat globale ekonomike. Megjithatë, këto korridore gjithashtu krijojnë varësi ekonomike dhe politike, pasi Fuqitë e Mëdha përdorin investimet në infrastrukturë për të ndikuar në politikën e brendshme dhe marrëdhëniet rajonale.

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, këto korridore rrugore nuk janë thjesht rrugë transporti, por mjete për të rregulluar ekuilibrin e fuqisë dhe për të formësuar marrëdhëniet ndërkombëtare. Radovan Vukadinoviq, në librin e tij “Marrëdhëniet politike ndërkombëtare”, nënvizon rëndësinë e këtyre korridoreve në rendin e ri botëror, ku globalizimi i infrastrukturës është bërë një nga faktorët më të rëndësishëm, që ndikon në politikat globale dhe rajonale.

Në përfundim, korridoret rrugore në Ballkanin Perëndimor përbëjnë jo vetëm arterie ekonomike, por edhe mjete për Fuqitë e Mëdha për të ushtruar kontroll dhe për të avancuar interesat e tyre strategjikë.

Referenca

- Group, W. B. (2020). “Infrastructure and . Economic Growth in the Western Balkans”. Washington, D.C.: World Bank Group.
- Initiative., B. a. (2013). Beijing, China: Belt and Road Initiative. Council on Foreign Relations (CFR, <https://www.beltroad-initiative.com/belt-and-road/>.
- K. Jean. (1998,). “Gjeopolitika”, f. 127. Tiranë; Shtëpia Botuese e Ushtrisë.
- Observatory, S.-E. E. (2016). Annual Report . Belgrade, Serbia: SEETO.
- Reka, A. (2023). “Geopolitical turmoil in the Balkans and Eastern Mediterranean”. Cham, Switzerland: Palgrave Macmillan.
- Union, E. (1992). Treaty on European Union (Maastricht Treaty). Official Journal of the European Communities, C 191, 1–112. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A11992M%2FTXT>.
- Vukadinoviq R. (2009). “Marrëdhëniet politike ndërkombëtare”. Prishtinë: Kolegji “Victory”.

2.5 BARDHYL MAHMUTI, POLITOLOG

Luftërat Ballkanike dhe gjenocidi ndaj shqiptarëve

Golgota shqiptare

Në mesin e intelektualëve që ngritën zërin kundër planeve që synonin shkatërrimin e popullit shqiptar, një vend të veçantë zë publicisti hebre që jetonte në Vjenë, Leo Frojndlih (Leo Freundlich).

Duke u mbështetur në burime të ndryshme informimi për krimet e tmerrshme që forcat serbe dhe malazise kryenin kundër shqiptarëve, Leo Frojndlih ngriti zërin e revoltës për heshtjen e Europës ndaj masakrimit të dhjetëra mijëra persona pa mbrojtje, të përdhunimit të grave, të vrasjes së fëmijëve, të djegies së vendbanimeve shqiptare...

Të Dielën e Pashkës, më 23 mars 1913, ai u drejtoi një letër Fuqive të Mëdha, opinionit publik europian dhe, në veçanti, atij anglez dhe francez që të mos heshtnin, por të angazhoheshin “që të ndalej vala e shfarosjes së shqiptarëve dhe të formohej një komision hetimor ndërkombëtar, i cili do të hetonte akuzat që ishin bërë kundër qeverisë serbe”^[1].

Në apelin e lartpërmendur, Leo Frojndlih theksonte se *Konferenca e Ambasadorëve në Londër kishte propozuar që kufijtë e Shqipërisë të përcaktoheshin në bazë të statistikave të përkatësisë etnike dhe fetare që do të përpilonte nga terreni një komision i caktuar prej tyre. Serbët përshpejtuan t’ua përgatisnin statistikën me mitraloza, pushkë dhe bajoneta. Ata kanë kryer krime të tmerrshme (...)*^[2].

Për të ilustruar me shembuj konkretë përmbledhjen e rrëfimeve rrëqethëse, autori citon “Daily Chronicle” të datës 12 nëntor 1912. Në këtë shkrim pohohet vërtetësia e lajmit, se mijëra shqiptarë ishin masakruar nga serbët dhe saktësohej se “në Shkup numri i të masakruarve ishte 2000, ndërsa në Prizren 5000”^[3]. Ndërsa gazeta “Frankfurter Zeitung” “përmend rastin e 300 lumjanëve të ekzekutuar në Prizren, pa proces gjyqësor, dhe se që nga koha kur forcat serbe kaluan kufirin dhe pushtuan territoret shqiptare, masakrat nuk kishin të ndalur”^[4]. “Serbët janë duke bërë një luftë që ka për qëllim

shfarosjen e kombit shqiptar dhe nëse do të mundnin, ata do ta çrrënjosnin të tërin”[5].

Në vijim, Leo Frojndli mbështetet në gazetën “L’Humanité” të Parisit, e cila publikoi një procesverbal, që i ishte dorëzuar konsullatës franceze në Selanik, ku përshkruheshin aktivitetet e Serbisë në Shqipëri: plaçkitje, shkatërrime, masakra. Sipas të dhënave të këtij procesverbali, *“Serbia në mënyrë sistematike kishte shkatërruar tërësisht ose pjesërisht fshatrat shqiptare në rrethinën e Kumanovës, Shkupit, Shtipit, Krakovës, Koçanit, Zhujovës, Meshelit, Kavadarcit, Bogdancit, kurse në Drenovë u vranë të gjithë banorët. Madje në varrezat që u zbuluan ndërmjet fshatit Drenovë dhe Palikura kishte ndodhur varrosja për së gjalli e shqiptarëve”[6].*

Mizoritë e ushtrisë serbe kishin shkuar kaq larg, saqë edhe “Fritz Magnussen, korrespondenti i gazetës daneze “Riget”, i njohur për simpatinë e tij ndaj serbëve, në telegramin që kishte dërguar, theksonte se ushtria serbe bën një luftë të pashembullt krimesh, duke përmendur masakrimin e 3000 shqiptarëve në Kumanovë dhe Shkup dhe 5000 të tjerëve në Prishtinë, fshatra shqiptare të rrethuar dhe të djegura, shqiptarë të dëbuar dhe të vranë si minjtë”[7].

Në vazhdim Leo Frojndli sjell të dhënat e dosjes së publikuar nga “Reichspost”, ku theksohej se **“shqiptarët konsideroheshin si kafshë gjahu dhe nuk mbroheshin nga asnjë ligj dhe asnjë gjykatë”[8].** Si shembull për këtë pohim kjo agjenci përmend faktin se, *“edhe në rastet kur popullsia shqiptare nuk rezistonte, siç ishte me banorët e pesë fshatrave të rrethinës së Shkupit, u vranë pothuajse të gjithë banorët, ndërsa fshatrat u dogjën. Hendeku prapa kalasë së Shkupit ishte i mbushur me kufoma të mbi njëqind viktimave të kësaj fushate, ndërsa në Kisela Voda u gjetën trupat e tetëdhjetë viktimave shqiptare”[9].*

Përshkrimi i tmerreve vazhdon me krimet e kryera në rrethinën e Kumanovës, ku, sipas dëshmive të atyre që kishin marrë pjesë në këto krime, *“shumë fshatarë që nuk kishin mundur të iknin, ishin strehuar në tavane të shtëpive. Ne ua vumë zjarrin dhe kur shtëpitë i përfshiu flaka, ata dolën si urithët nga shtrofullat e tyre duke bërë titur, duke u lutur dhe*

duke kërkuar mëshirë. I vramë te dera. Vetëm ndaj fëmijëve kursyem plumbat dhe përdorëm bajonetat...”^[10].

E njëjta gjë ndodhi edhe me shqiptarët e Tetovës^[11]. *“Tetëdhjetë e pesë shqiptarë u masakruan në shtëpitë e tyre në Tetovë, pa asnjë rezistencë të armatosur, ndërsa vendi u plaçkit. Janë të papërshekrueshme aktet neveritëse të çnderimit të grave dhe vajzave, duke përfshi edhe fëmijë të moshës 12-vjeçare. Për të kurorëzuar të gjitha këto tmerre, baballarët dhe burrat e viktimave u detyruan, nën kërcënimin e revolverit, t’ua mbanin qirinjtë dhe të ishin dëshmitar të poshtërimit që u bëhej vajzave dhe grave të tyre, në shtëpitë e veta”*^[12].

Në përmbledhjen e sintetizuar të krimeve më të tmerrshme serbe, Leo Frojndliu përmend *“vrasjen e 1200 shqiptarë në Ferizaj dhe pothuajse të gjithë banorët shqiptarë të Gjilanit. Kësaj fushate shfarosëse i kishin shpëtuar vetëm një numër shumë i vogël i atyre që arritën të iknin”*^[13].

Barbaritë shkuan deri aty, sa grave shtatzëna ua shqyenin barkun me bajoneta dhe u nxirrnin fëmijët. Kështu, për shembull, autori përmend se pasi **“kishin shkatërruar tërësisht 27 fshatra të zonës së Lumës, u vranë të gjithë njerëzit, deri te fëmijët. Këtu i mbështollën ngratë dhe fëmijët me kashtë, si të ishin mullarë sane, dhe i dogjën për së gjalli përpara burrave dhe baballarëve të tyre, që ishin të lidhur. I plaçkitën gratë shtatzëna dhe, me bajoneta, ua nxorën foshnjat nga barku**

^[14]. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe në fshatin Gjylekar ^[15].

Vazhdojnë të dhënat për vrasjet: *“60 shqiptarë të masakruar në Tërstenik, 32 në Smirë, 20 në Vërban, 19 në Lubizhdë... Në Komogllavë, që numëronte 50 familje, u vranë të gjithë burrat pa përjashtim... Mbetën pak të mbijetuar në Preshevë”*^[16].

Nga të gjitha të dhënat që kishte grumbulluar, autori vjen te përfundimi, se *“Prishtina dhe Prizreni ishin shndërruar në ‘Mbretëri të vdekjes’, ku u vranë të gjithë, pa dallim moshe dhe gjinie”*^[17], ndërsa Gjakova e rrënuar dhe popullsia e masakruar.

Në këtë kontekst vlen të përmendet dëshmia e sekretarit të kryeministrit serb, Nikolla Pashiq: *“Zoti Tomiq kishte raportuar se gjatë udhëtimit të tij nga Prizreni në Pejë, në të dyja anët e rrugës nuk kishte*

parë asgjë tjetër, pos gërmadhavë të fshatrave të djegura që ishin bërë rrafsh me tokë. Në shtyllat e shumta përskej rrugëve, rrinin varur trupat e shqiptarëve. Rruga e Gjakovës ishte shndërruar në një 'Bulevard varjesh'".^[18]

Nga shembujt e shumtë të krimeve që përmenden në veprën e Leo Frojndlih kam përzgjedhur raportin e të dërguarit special të "Daily Telegraph", i cili kishte ardhur në konkluzionin e mëposhtëm:

*"Të gjitha tmerret e historisë janë tejkaluar me veprimet e tmerrshme të trupave të gjeneral Jankoviqit. Kanë vrarë jo vetëm shqiptarë të armatosur, por në egërsinë e tyre edhe njerëz të paarmatosur, persona të moshuar, gra, fëmijë, madje edhe foshnja në gjirin e nënave të tyre. **Oficerët serbë, në dehjen e tyre nga fitorja, gjetën zgjidhjen se mënyra më efektive për të qetësuar Shqipërinë ishte shfarosja e plotë e shqiptarëve.** Për të shuar etjen e tyre për gjak, ushtarët serbë zbuluan metoda të reja të kasaphanës: burrat vriteshin në sy të grave dhe fëmijëve të tyre, ndërsa gratë e gjora detyroheshin të shihnin se si ua copëtonin fëmijët.*^[19] *Për shkak të tokës së ngrirë, të vetmin telash që kishin ushtarët serbë ishte hapja e varreve. Prandaj i hidhnin në bunarë. Në rrethin e Shkupit një informator kishte numëruar 38 bunarë të mbushur me kufoma shqiptarësh"*^[20].

Nuk mund ta dimë saktësisht se deri në çfarë mase kanë ndikuar apelet e vazhdueshme, që Leo Frojndlih u drejtoi qeverive të Fuqive të Mëdha dhe opinionit publik të këtyre shteteve, por ajo që mund të themi pa fije rezerve ka të bëjë me faktin, se hapësira që iu dha në shtypin evropian dhe atë amerikan krimeve të kryera në Ballkan, ndikuan drejtpërdrejt që *Fondacioni Karnexhi për Paqe Ndërkombëtare* ^[21] të krijonte një komision ndërkombëtar të përbërë nga juristë dhe politikanë austriakë, francezë, gjermanë, britanikë, rusë dhe amerikanë, që të hetonte vërtetësinë e lajmeve për tmerret që kishin ndodhur gjatë luftërave ballkanike.

Vlen të përmendet këtu, se ithtarët e fondacionit *Karnexhi* ishin tepër kritikë për përmbajtjen e konventave që përcaktonin ligjet dhe zakonet e luftës dhe mënyrën se si e shihnin juristët e së drejtës ndërkombëtare çështjen e luftës. Për anëtarët e këtij fondacioni shumë më e rëndësishme

ishte “organizimi i arbitrazhit, ndërmjetësimi dhe vullneti i mirë që synon parandalimin e luftës, sesa përpjekjet për ta bërë të njerëzishme atë” [22]. Mirëpo duke parë “shkeljen e të gjitha klauzolave të së drejtës ndërkombëtare për luftën” [23] pikërisht nga “palët ndërluftuese që ishin nënshkruese të Konventës së vitit 1907” [24], ata u angazhuan të bënin këtë hetim.

Siç theksohet edhe në raportin e fondacionit Karnexhi, “në Ballkan luftën e bëjnë vetë kombet” dhe pushtimi i vendbanimeve shoqërohet “me dëshirën që të zëvendësohet popullsia vendase me pjesëtarët e kombit të vet. Kjo është arsyeja përse këto luftëra janë kaq të dhimbshme, përse ato prodhojnë humbje kaq të mëdha në njerëz, dhe përse ata kulmojnë në asgjësimin e popullsisë dhe shkatërrimin e rajoneve të tëra...” [25].

Pa u zgjeruar në shembujt e logjikës *Bellum omnium contra omnes* [26], që mbizotëron në Ballkan, do të ndalem vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me shqiptarët.

Në funksion të fshehjes së krimeve ndaj shqiptarëve, Qeveria e Serbisë nuk i lejoi këtij komisioni ndërkombëtar të bënte hulumtime në territoret që kontrolloheshin prej saj. Për këtë çështje në raport sqarohet me sa vijon:

“(…) Në kufirin shqiptar, ku keqtrajtimet po rifillonin, vizita e Komisionit u kundërshtua. Lidhur me këtë çështje, një gazetë serbe ngriti një pikëpyetje që duhet adresuar, pavarësisht motivit të saj. Pikërisht ditën e largimit me forcë të Komisionit (13/26 gusht), ‘Trgovinski Glasnik’ u përpoq të arsyetonte veprimin e qeverisë serbe, duke deklaruar se në Ballkan do të ndërmerrej një hetim ndërkombëtar që kërkonte kompetenca juridike, kompetenca të cilat, në një shtet të pavarur dhe sovran, ishin ekskluzivitet i qeverisë (vendase). Nisja e një hetimi të kësaj natyre, sipas gazetës, nënkuptonte kufizim të sovranitetit dhe ndërhyrje në të drejtat e shtetit. Për sa kohë shteti nuk binte dakord dhe nuk jepte leje të posaçme për kryerjen e hetimeve, vetë emërimi i një komisioni të tillë përbënte në vetvete ‘një akt të arbitrazhit ndërkombëtar’” [27].

Megjithatë, gjatë muajit gusht dhe shtator të vitit 1913, anëtarët e komisionit arritën të mbledhnin të dhëna të mjaftueshme, qoftë nëpërmjet

bisedave me të mbijetuar, fotografimin e vendbanimeve të djegura, grumbullimin dhe arkivimin e letrave, njoftimeve, vendimeve që u mundësuan të vinin deri te një pasqyrë e përafërt për atë që u munduan të fshihnin qeveritarët serbë.

Kapitulli IV i këtij raporti titullohet “Lufta dhe kombësitë” dhe i kushtohet *shfarosjes, emigrimit dhe asimilimit* [28]. Madje pika e parë e tij mban nëntitullin “*Shfarosja, emigrimi dhe asimilimi*”. Në bazë të hulumtimit që kishin bërë përpiluesit e raportit të fondacionit *Karnexhi*, ata kishin ardhur në përfundim se: “(...) qëllimi i këtyre konflikteve të armatosura, qofshin ato të hapura ose të fshehta, të konceptuara qartësisht ose të vështira për t’u perceptuar, është kudo dhe gjithnjë i njëjti: **shfarosja e plotë e një popullsie tjetër**. Në disa raste, ky qëllim është shprehur në formën e një ‘urdhri’ të prerë dhe të pakthyeshem për eliminimin e të gjithë meshkujve të popullsisë në rajonet e pushtuara” [29].

Duke u mbështetur te disa letra të ushtarëve grekë, vërtetësia e së cilave nuk vihet në dyshim, nxirret në pah urdhri që kishin marrë ushtarët: “*Ne duhet të djegim fshatrat, të masakrojmë të rinjtë, duke mos kursyer askënd përveç pleqve, fëmijëve dhe të miturve*”. Ajo që synohet është e qartë: **nuk duhet të shpëtojë askush, përveç atyre që nuk janë më në gjendje të vijojnë racën e vet dhe atyre që janë në një moshë aq të re, sa mund të humbin përkatësinë përmes edukimit grek**” [30].

Sa u përket ushtrive sllave, nuk mundën të siguronin urdhra të njëjtë. Përkundrazi. Në funksion të fshehjes së përgjegjësisë në zinxhirin komandues të krimeve, haset edhe në urdhra të kundërt. Mirëpo, duke u mbështetur “në bashkëbisedime private”, hulumtuesit konstatuan se “*karakteristika e lartpërmendur ndeshet vazhdimisht. Ajo që tregon se këto biseda nuk ishin thjesht një mënyrë e të shprehurit, është fakti se popullata turke u përndoq nga bullgarët, ashtu si ajo shqiptare nga serbët. Në rastin e bullgarëve, kjo dëshmohet nga djegia e të gjitha lagjeve turke në fshatra, të cilët u vizituan nga anëtari i Komisionit në Traki. Për sa u përket serbëve, ne disponojmë prova të pakundërshtueshme në formën e një letre nga një anëtar i ushtrisë serbe, botuar në gazetën socialiste serbe “Radničke Novine” të datës 9-22*

tetor. Përmbajtja e kësaj letre është shumë e ngjashme me letrat e ushtarëve grekë.

“Miku im i dashur, - shkruan ushtari. - Nuk kam kohë të të shkruaj gjatë, por mund të të them se këtu po ndodhin gjëra të tmerrshme. Jam i lebetitur prej tyre dhe vazhdimisht pyes veten se si njerëzit mund të jenë aq barbarë, sa të kryejnë të tilla mizori. Është e tmerrshme. Nuk guxoj (edhe sikur të kisha kohën që nuk e kam) të të shkruaj më tepër, por mund të të tregoj se Luma (rajon shqiptar përgjatë lumit me të njëjtin emër), nuk ekziston më. S’ka mbetur gjë, veç kufomave, pluhurit dhe hirit. Në fshatra me 100, 150 apo 200 shtëpi, nuk ka ngelur më asnjë njeri, asnjë për be. I grumbullojmë njerëzit në grupe nga dyzet a pesëdhjetë veta dhe më pas i therim me bajoneta një për një. Plaçkitjet vijnë. Oficerët u thanë ushtarëve të shkonin në Prizren dhe të shisnin çfarë kishin vjedhur”.

Gazeta që botoi këtë letër shton: *“Personi në fjalë na tregoi edhe ngjarje më të tmerrshme se këto (!), por ato janë kaq të dhimbshme dhe tronditëse, sa që vendosëm të mos i botojmë”* [31].

Përveç dëshmisë së ushtarit serb, në raport përmendet një letër e dërguar nga Elbasani dhe një raportim përmbledhës për gjendjen në territoret shqiptare të okupuara nga forcat serbe dhe malaziasë, të publikuara në gazetën bullgare *“L’Écho de Bulgarie”* [32]. Përkundër asaj se komisioni nuk arriti të vërtetojë saktësinë e pohimeve të këtyre shkrimeve, në raport thuhet në mënyrë të qartë: *“Nuk ka asnjë arsye për të dyshuar në vërtetësinë e tyre, kur kemi parasysh atë që është parë dhe dëgjuar: Më 20 shtatorin e kaluar (kalendari i ri) [33], ushtria serbe kishte shtënë në dorë të gjithë bagëtitë e Malësisë së Dibrës. Barinjtë kishin qenë të detyruar të mbroheshin dhe kishin luftuar, por të gjithë u vranë. Serbët kishin vranë edhe dy krerët e fisit Luma, Mehmed Ademin dhe Xhafer Elezin dhe, më pas, kishin plaçkitur e djegur të gjitha vendbanimet që u kishin dalë përpara: Peshkopi, Pjeçë dhe Dohoshisht në Dibrën e Poshtme; Aliaj, Beg, Maç, Para, Obok, Kloboçishtë dhe Sollokiç, në Dibrën e Sipërme. Në të gjitha këto vendbanime, serbët kryen masakra të frikshme, si dhe dhunuan gra, fëmijë e pleq. Autoritetet e qytetit të Dibrës dhanë urdhrin që pazari i së dielës të mos hapej dhe që atë ditë, banorët të mos dilnin nga shtëpitë. Dyzet e tetë persona të*

shquar (të zonës) u arrestuan. Kur serbët vunë re se banorët e fshatrave të plaçkitur, lista me emrat e të cilëve është publikuar më lart, kishin ardhur për të rimarrë bagëtitë e veta dhe po rrethonin qytetin, morën të burgosurit në fjalë dhe i vranë në mënyrën më të turpshme të mundur. Që atëherë, në mesin e shqiptarëve në Dibër e rrethina ka sunduar terrori dhe dëshpërimi, çfarë i detyroi ata të ngrinin krye. I sulmuan serbët me armë, sëpata, gurë e shkopinj. Vranë një numër serbësh, ndërsa pjesën tjetër e dëbuan nga qyteti. Thuajse të gjithë të vrarët ishin eprorë serbë; ushtarët e mbetur gjallë kaluan në anën tjetër të lumit Radika” [34].

Në vijim të raportit, përpara se të citohet një pjesë e shkrimit të publikuar në të njëjtën gazetë të datës 3 dhe 16 tetor, raportuesit e fondacionit *Karnexhi* kërkojnë nga lexuesit që “të shohin ‘Reichspost’ të 29 shtatorit, ku gjendet dhe lista e masakrave të kryera në dy javët e para të shtatorit të 1913-ës, të pasqyruara në peticionin e mbledhjes së përfaqësuesve shqiptarë në Shkodër më 21 shtator”[35] dhe vazhdon: “Fshatrat e përmendura më poshtë, me popullsi të përzier, shqiptare e bullgare, u plaçkitën dhe u dogjën: Loçnan, Lisiçan, Gitoçe, Dibricë, Harliçë, Desovë, Kradeshnicë, Pçelopez. Shumë familje myslimane nga këto fshatra, përfshirë gra dhe fëmijë, u masakruan pa mëshirë. Me të hyrë në fshatin Porçasijë, ushtria e rregullt serbe i dërgoi të gjithë burrat jashtë fshatit. Më pas solli atje gratë, ku u kërkuar para, njëfarë haraçi, në shkëmbim të lirisë së burrave të tyre. Gjithsesi, pas pagesës së haraçit, burrat e mjerë u kyçën në xhami, e cila, më pas, u hodh në erë me katër predha. Në fshatin Sulp, shtatëdhjetë e tre shqiptarë pësuan një vdekje të tmerrshme dhe dyzet e shtatë të tjerë nga fshati Pçelopez u bënë pre e një atentati të ulët. A nuk ishte prefekti i Krushevës ai që, kur ushtria serbe po kthehej nga kufiri shqiptar, haptazi i bëri thirrje që të digjte të gjitha fshatrat që ndodheshin midis Krushevës dhe Ohrit?”[36].

Duke u mbështetur në dëshmi të tilla, në raport vihet të përfundimi: “Delegacioni shqiptar, i cili më 21 shtator iu drejtua Fuqive të Mëdha në emër të popullatës së Gjakovës, Pejës, Plavës, Gucisë dhe ish-vilajetit të Kosovës, nuk e teproi aspak kur në lidhje me inskenimin e kryengritjes deklaroi: ‘Që nga dita e parë që pushtuan territorin shqiptar, trupat e rregullta serbe e malaziasë ndërmorën dhe bënë

gjithçka mundën ose për të detyruar banorët të humbnin kombësinë e tyre, ose për të shtypur brutalisht racën shqiptare. Mjetet që ushtria serbo-malaziasë ka përdorur dhe vazhdon të përdorë, me qëllim transformimin e plotë të karakterit etnik të rajoneve të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët, janë shtëpi dhe fshatra të tëra të bëra pluhur e hi, popullata të paarmatosura e të pafajshme të masakruara në masë, akte të pabesueshme dhune, plaçkitje, brutalitet të çdo lloji e të tjera” [37]

Referenca

[1] Leo Freundlich, *Albaniens Golgatha: Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes (Golgota shqiptare: Dosjet e akuzës kundër shfarosësve të popullit shqiptar)*, Wien 1913. Verlag der Buch-und Kunstdruckerei Josef Roller & Co. III., Seldlgassa, f. 4-6.

[2] Po aty, f. 6.

[3] Po aty, f. 8.

[4] Po aty, f. 7.

[5] Po aty, f. 8.

[6] Po aty, f. 8-9.

[7] Po aty, f. 9.

[8] Po aty, f. 11.

[9] Po aty, f. 10.

[10] Po aty, f. 11.

[11] Në shkrim përdoret emri turqisht i Tetovës, *Kalkandele*.

[12] Po aty, f. 12.

[13] Po aty, f. 12

[14] Po aty, f. 15.

[15] Po aty, f. 17.

[16] Po aty, f. 16.

[17] Po aty, f. 13.

[18] Po aty, f. 19.

[19] Po aty, f. 18.

[20] Po aty, f. 11.

[21] Fondacioni *Karnexhi* për Paqe Ndërkombëtare (Carnegie Endowment for International Peace) u themelua në Uashington, në vitin 1910, nga filantropi Andrew Carnegie.

[22] Carnegie Endowment for International Peace, Division of intercourse and education, Publication No.4, Report of the International Commission, To Inquire in to the Causes and Conduct of the Balkan wars, Published by the endowment, Washington, D.C, 1914, f. 14. Teksti i plotë i raportit është publikuar edhe në faqen e internetit dhe të interesuarit mund ta gjejë në:
<http://www.pollitecon.com/html/ebooks/Carnegie-Report-on-the-Balkan-Wars.pdf>

[23] Po aty, f. 14.

[24] Po aty, f. 233. Bëhet fjalë për konventën lidhur me ligjet dhe zakonet e luftës në tokë (Convention concernant les lois et coutumes de la guerre sur terre), të miratuar më 18 tetor 1907, në Hagë. Nënshkruese të kësaj konvente ishin edhe Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria. Për nënshkruesit dhe përmbajtjen e kësaj konvente shih: https://www.fedlex.admin.ch/eli/cc/26/429_338_411/fr

[25] Po aty, f. 148.

[26] *Lufta e të gjithëve kundër të gjithëve*. Shprehje latine që u bë e njohur falë veprës “Leviathan” të Thomas Hobbes.

[27] Raporti i lartpërmendur i fondacionit *Karnexhi*, f. 233.

[28] Chapter IV, *The War and the Nationalities*, f. 148-207.

[29] Po aty, f. 148.

[30] Po aty, f. 148.

[31] Po aty.

[32] *Jehona e Bullgarisë*.

[33] I referohet kalendarit gregorian (shënim i përkthyesit).

[34] Raporti i lartpërmendur i fondacionit *Karnexhi*, f. 149.

[35] Po aty, f. 150.

[36] Po aty, f. 151.

[37] Po aty, f. 150 -151.

2. 6 Gzim RUSHITI, PhD

Diplomacia e Turqisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Hyrje

Shumë komentues e shohin diplomacinë si mjet për aleatët për të bashkëpunuar dhe për kundërshtarët për të zgjidhur konfliktet pa forcë.

Prej vitit 2003, kohë në të cilën në pushtet në Turqi erdhi Partia për Drejtësi dhe Zhvillim, diplomacia turke ka lëvizur nga doktrina konservatore ose realpolitika në politikën e jashtme, e cila bazohet në sovranitetin dhe sigurinë si përparësi; nga doktrina e bilancit të pushtetit, përdorimi i forcës ushtarake në një politikë më liberale, e cila mbështetet te tregtia, përfshirë mallrat kulturore, si dhe u jep përparësi negociatave me të gjithë fqinjët për të përmbushur objektivat e “politikës së zero problemeve me fqinjët tanë”, si dhe në përdorimin e afërsisë kulturore dhe fetare me vende të caktuara për të rritur tregtinë dhe ndikimin.

Turqia paraqet një rast interesant, sepse doktrina e realpolitikës në Turqi u zbatua për dekada nga politikanët dhe diplomatët që merren me diplomacinë, politikën e jashtme dhe me marrëdhëniet ndërkombëtare të Turqisë.

Për një periudhë të gjatë kohore, e cila shkon thellë në histori, Turqia ka qenë dhe mbetet një nga lojtarët më të rëndësishme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Fillimisht prania e Turqisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor haset si pushtuese, pastaj si ndërmjetëse e stabilizimit rajonal gjatë luftës së fundit, dhe kohët e fundit si fuqi ekonomike dhe investitore në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

1. Ballkani Perëndimor në politikën e jashtme të Turqisë

Për ta kuptuar peshën dhe rëndësinë e diplomacisë turke për rajonin e Ballkanit duhet që, paraprakisht, të kemi disa njohuri themelore. Turqia është vendi më i madh në Ballkan, me një popullsi me rreth 82,5 milionë banorë, ndërsa sipas parashikimeve pritet që deri në vitin 2040 të kalojë shifrën mbi 100 milionë banorë. Republika e Turqisë është anëtar i G20-ës, pra është brenda njëzet ekonomive më të fuqishme botërore. Gjithashtu, Turqia është ekonomia më e madhe dhe më moderne në gjithë

botën myslimane nga Azia në Afrikë e deri në Ballkan. Në aspektin ushtarak, sipas revistës “Ceo world”, botim i vitit 2018, ushtria turke u llogarit si e teta nën botë. Pozita e volitshme gjeografike, si hapësirë ndërmjet Europës, Lindjes së Mesme dhe Rusisë, ia shton asaj rëndësinë strategjike akoma më shumë. [1]

Në doktrinën e re turke që rrjedh nga AKP-ja, përveç interesave të mëdha në Azinë Qendrore, Kaukaz apo Afrikë, edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor shfaqet gjithashtu si një territor me rëndësi parimore. Duke pasur parasysh që ky territor ka qenë për pesë shekuj me radhë pjesë e Perandorisë Osmane, trashëguese e drejtpërdrejtë e së cilës është Turqia, autoritetet turke kanë shtuar në masë të madhe përpjekjet që të rritin përsëri ndikimin e tyre. Lidhjet kulturore, fetare, por edhe historike shërbejnë aktualisht si një pikënisje në dobi të thellimit dhe nxitjes së bashkëpunimit në shumë drejtime. Pra, shtetet si Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria zënë tashmë një vend me rëndësi të veçantë strategjike në politikën e jashtme turke, e cila këmbëngul të zhvillojë marrëdhënie të mira kryesisht në fushën e diplomacisë, kulturës, fesë, tregtisë dhe ekonomisë.

Përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor shteti turk zbaton një politikë, e cila synon të tejkalojë problemet etnike, në mënyrë që të arrihet një paqe dhe mirëbesim afatgjatë mes këtyre të fundit.[2]

Nëse përpiqemi të shohim pozitën gjeografike të Ballkanit, do të vërejmë se pozicioni rajonal dhe global ku kalojnë rrugët tokësore dhe detare, shpeshherë është kthyer në arenë lufte nga ana e fuqive botërore dhe europiane, për të kontrolluar këtë bosht strategjik global, dhe si pikë ku mund të vëzhgohet dhe dominohet një pjesë e mirë e Lindjes së Afërt. Deti Adriatik, deti Jon, ngushtica e Bosforit, e Dardaneleve, lumenjtë lundruar Sava, Danubi dhe Morava, kanë bërë që rajoni historikisht të fitojë rëndësi strategjike dhe të bëhet tërheqës për gjatë shekujve për perandoritë dhe fuqitë e mëdha.

Kështu, duke e parë rajonin dhe sistemin ndërkombëtar nga këto të dhëna historike dhe gjeografike, dyshoj se shtetet e brishta të botës postkomuniste do të mund aq lehtë t'i keqësojnë marrëdhëniet me Ankaranë dhe të rishikojnë zgjidhje të tjera strategjike. Zgjerimi turk drejt veriperëndimit është duke u bërë njësoj si shekuj më parë, kur

osmanët pushtuan zonën. Aktualisht, me këtë politikë zgjeruese që ka nisur Ankaraja, ka të ngërthyer në vete elemente të “diplomacisë së butë” apo të politikës së quajtur “zero probleme me fqinjët”. Pra, nuk kemi të bëjmë me vërshim klasik të këmbësorisë turke drejt Ballkanit. Në Ballkan, edhe përkundër problemeve me të cilat ballafaqohen këto shtete të dobëta, Turqia tani e ka më lehtë të veprojë në vakuumin e ri gjeopolitik. Sipas ekspertëve, Turqia që nga viti 1992 është duke zbatuar politikë të jashtme selektive me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Nga pikëpamja e rolit turk në organizatat ndërkombëtare që janë marrë me krizën ballkanike, është parë se Ankaraja i ka përkrahur të gjitha planet ndërkombëtare për paqe dhe stabilitet dhe ka qenë shumë e vështirë për Turqinë t’i refuzojë apo kundërshtojë nismat amerikane. Turqia në mënyrë sistematike ka bërë që diplomacia e saj të veprojë në bazë të parimeve dhe rregullave të ligjit ndërkombëtar. Në vitin 1994, Turqia përkrahu planin e NATO-s për ish-Jugosllavinë vetëm nga pikëpamja logjistike dhe refuzoi që të merrte pjesë në ndonjë sulm ushtarak të asaj kohe. Pas vitit 2002, me ardhjen në pushtet të forcave politike që kishin për qëllim reformimin e sistemit politik turk, është parë një strategji tjetër se si të arrihet deri tek avancimi i interesave të Ankarasë në gadishull. Në këtë kontekst, disa analistë thonë se AKP-ja e Erdoganit dhe e Gjylit mund ta çojë shoqërinë turke drejt radikalizimit dhe të marrë përmasa të habitshme rajonale. Por kur është çështja e politikës së jashtme turke të fillimshekullit XXI, këtu vërehet një diplomaci më aktive drejt Ballkanit, me zgjidhje të përcaktuara qartë. Kështu, me Serbinë dhe Maqedoninë ka një politikë të ngjashme, ndërsa i ka futur në një bllok Shqipërinë, Kosovën dhe Bosnjën. [3]

Diplomacia turke për rajonin e Ballkanit bart elemente të rëndësishme historike, gjeografike dhe demografike. Ajo që fuqizon edhe më shumë këtë argument është e kaluara kulturore, trashëgimore dhe historike, që ndihet ende në shumë vende ballkanike, e ruajtur nga periudha e administrimit osman. Viti 2023 shënon 100-vjetorin e rënies së Perandorisë Osmane nga Ballkani deri në Turqinë e sotme, kur edhe themelohet Republika moderne e Turqisë.

Njëqindvjetori i kësaj rënieje për shumë perandori është një rikujtim i zakonshëm historik, ndërsa për Ballkanin dhe diplomacinë turke, ky

është një fillim i së drejtës juridike ndërkombëtare mbi të ardhmen e Ballkanit, veçanërisht asaj kulturore dhe komunitetit mysliman në rajon. Përbushja objektive e një rivlerësimi historik, juridik dhe diplomatik mbi pozicionin e ardhshëm turk në Ballkan, gjithsesi varet nga vullneti politik i partnerëve strategjikë, siç janë SHBA-ja dhe BE-ja. Kjo e drejtë e Turqisë mbi riinterpretimin e mundshëm juridik të “Traktatit të Lozanës” bazohet edhe në pjesën V, Seksioni II i Traktatit dhe Seksioni III i Dispozitave të Përgjithshme.[4]

Si një fuqi rajonale në zhvillim, fuqia e butë dhe diplomacia publike e Turqisë po tërheqin vëmendjen e akademisë vitet e fundit. Një nga elementet kryesore të fuqisë së butë turke dhe diplomacisë publike janë diplomacia fetare e drejtuar nga *Diyanet*, sot një nga institucionet më të forta fetare në botën sunite; diplomacia e shkëmbimit të studentëve e drejtuar nga *Turkiye Burslari* dhe një diplomaci shumë e gjallë e qytetit, e drejtuar nga bashki të ndryshme dhe sindikata komunale, ndër të cilat më e shquara është Unioni i Komunave të Botës Turke. Për shekuj Gadishulli Ballkanik ishte një zonë me interes për Perandorinë Osmane dhe më vonë për Turqinë. Rajoni i shërben Turqisë si e vetmja portë për në Europë. Pas një pushimi gjatë Luftës së Ftohtë, angazhimi aktiv i Turqisë në rajon është rikthyer. Sot mund të thuhet se Turqia është kthyer në rajon. Është fuqia e butë, që ka qenë mjeti kryesor i ndikimit të Ankarasë në rajon dhe diplomacia publike qëndron në thelbin e kësaj fuqie të butë. Institucionet e diplomacisë publike po shërbejnë si fytyra e dukshme e politikave, ambicieve, synimeve dhe vizionit të Turqisë në rajon. Për këtë arsye, analiza e diplomacisë publike turke ofron një pasqyrë të qartë se cilat janë synimet dhe potencialet e Turqisë në Ballkan. [5]

2. Marrëdhëniet e Turqisë me Bosnjë-Hercegovinën

Qeveria turke e njohu Bosnjë-Hercegovinën më 6 shkurt 1992 si shtet të pavarur, edhe para se Bosnja të mbante referendumin e saj të pavarësisë më 29 shkurt 1992. Turqia ishte e para që kuptoi luftën e mundshme midis serbëve dhe boshnjakëve në vend. Brenda pak javësh, Turqia mbajti një takim me Organizatën e Konferencës Islamike tani, anëtare e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik më 17-18 qershor 1992 në Stamboll, ku i kërkoi OKB-së të ndërhynte në Bosnjë.[6]

Nën qeverinë e AKP-së, politika e jashtme e Turqisë ndaj Ballkanit Perëndimor, dhe veçanërisht ndaj Bosnjë-Hercegovinës, ka bërë që shumë analistë të dyshojnë se ajo zotëron objektiva neoperandorake ose të ashtuquajtura neo-otomane. Këto dyshime janë shtuar nga deklaratat e përsëritura të ish-kryeministrit Davutoglu dhe presidentit aktual, Erdogan, se historia dhe identiteti fetar i përbashkët i turqve dhe i myslimanëve të Ballkanit Perëndimor përbën bazën e marrëdhënieve turko-ballkanike dhe të një të ardhmeje të përbashkët.

Ekzaminimi kritik i qëndrimeve të Ankarasë zyrtare ndaj Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, dhe veçanërisht ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës, identifikon katër faza të dallueshme, në të cilat apelet kulturore, historike dhe fetare u shndërruan në grupin e politikave të jashtme dalluese. Këto politika janë formuar gjithashtu nga ndjekjet pragmatike të ndikimit rajonal, efektet e transformimeve të brendshme (turke) dhe, së fundmi, nga politikat *ad hoc* të presidentit Erdogan.[7]

Historikisht, marrëdhëniet e Turqisë me Bosnjë-Hercegovinën kanë mbetur shumë të përzemërta dhe miqësore. Politika e jashtme e Turqisë nën presidentin Erdogan ka marrë një rrugë të re të re, pasi vendi ka pohuar në mënyrë progresive ndikimin e tij në rajonin e Ballkanit, duke përfutur nga marrëdhëniet e përbashkëta historike dhe kulturore. Investimi në zhvillimet e infrastrukturës dhe sektorët arsimorë të rajonit të Ballkanit nën diplomacinë kulturore e ka ndihmuar Turqinë të ndërtojë imazhin e saj të butë. Kompanitë turke po investojnë në mënyrë aktive në sektorë dhe industri të ndryshme të Bosnjë-Hercegovinës, duke përfshirë telekomunikacionin, energjinë, transportin, shëndetin, turizmin, ndërtimin dhe bankat etj.

Historia e përbashkët, afërsia gjeografike dhe rëndësia ekonomike në zgjerim të Turqisë, të gjithë këta faktorë kanë rezultuar me rritjen e investimeve turke në Bosnjë-Hercegovinë. Turqia po përpiqet gjithashtu të promovojë bashkëpunimin tregtar rajonal, përveç marrëveshjeve dypalëshe tregtare, si krijimi i një mekanizmi të diskutimit ekonomik trepalësh midis Turqisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë. [8]

Marrëdhëniet midis Turqisë dhe Bosnjë-Hercegovinës shfaqin një prani të fortë në fushën politike, sociale dhe kulturore. Vendi ynë përfaqëson Organizatën e Bashkëpunimit Islamik në Bordin Drejtues të

Këshillit për Zbatimin e Paqes, i krijuar me qëllim që të mobilizojë mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar për rendin politik të Bosnjë-Hercegovinës, të përcaktuar nga Marrëveshja e Paqes e Dejtonit. Përveç mbështetjes për sovranitetin, integritetin territorial dhe strukturën multietnike të Bosnjë-Hercegovinës, Turqia përpiket për përmirësimin e zhvillimit ekonomik të BiH, ndjek nga afër procesin e reformave në BiH, kontribuon në hapat e ndërmarrë përpara dhe i jep mbështetje të fortë Bosnjë-Hercegovinës në përpjekjet e saj për të përfunduar integrimin me institucionet europiane dhe euroatlantike (BE dhe NATO) sa më shpejt që të jetë e mundur. Në kuadër të pjesëmarrjes në operacionet ndërkombëtare të paqes, vendi ynë i ofron mbështetje ushtarake edhe operacionit EUFOR-ALTHEA, që është një forcë paqeruajtëse e BE-së në BeH dhe që zhvillon aktivitete të përbashkëta me NATO-n. Kështu, misioni turk përbën grupin e dytë më të madh në kuadër të operacionit në fjalë. Marrëdhëniet e shkëlqyera midis Turqisë dhe BiH janë përforcuar me vizita intensive të ndërsjella të nivelit të lartë. Për më tepër, mekanizmat trepalësh Turqi – Bosnjë-Hercegovinë – Serbi dhe Turqi – Bosnjë-Hercegovinë – Kroaci përbëjnë elemente të rëndësishme të bashkëpunimit tonë.

E vetëdijshme se zhvillimi dhe stabiliteti në Ballkan duhet të ecin paralelisht me zhvillimin ekonomik, Turqia i kushton rëndësi të madhe përmirësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ekonomike dhe tregtare me Bosnjë-Hercegovinën. Ekziston një vullnet për të çuar përpara marrëdhëniet e përmendura në forcimin e kuadrit ligjor dhe kontakteve të përfaqësuesve të sektorit real të të dy vendeve. Përveç kësaj, Turqia mbështet Bosnjë-Hercegovinën në përpjekjet e saj për të përdorur burimet e veta dhe për të ndërmarrë hapa për të krijuar vende pune. [9]

3. Marrëdhëniet e Turqisë me Serbinë

Pas fitores së vitit 1389 kundër koalicionit të ushtrive ballkanike në Kosovë, të cilit i printe cari serb L Lazar Hrebelanoviqi, në Ballkan filloi dominimi i osmanëve dhe me pushtimin e Beogradit në vitin 1521 nga Sulejmani i Madhërishtëm, u forcua sundimi i osmanëve, i cili vazhdoi deri në shekullin XIX. Midis fundit të Perandorisë Osmane në vitet 1923

dhe 1980, kishte vetëm marrëdhënie formale midis Turqisë dhe Jugosllavisë. Në vitin 1953, Turqia, Greqia dhe Jugosllavia madje nënshkruan një “Marrëveshje miqësie dhe bashkëpunimi”, të quajtur më vonë Pakti Ballkanik. Që nga fillimi i trazirave jugosllave në fund të viteve 1980, Fuqitë e Mëdha, si SHBA-ja, Rusia, Europa dhe disa vende myslimane, si Turqia, Arabia Saudite, Malajzia janë përfshirë në ngjarjet në terren. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, *Partia për Drejtësi dhe Zhvillim* i kushtoi vëmendje përmirësimit të marrëdhënieve me Serbinë, pasi partitë demokratike fituan pushtetin në tetor 2000 në Serbi. Me korrelacionin e përpjekjeve për të zgjeruar lidhjet e Turqisë në zonat ku Turqia kishte lidhje të forta historike dhe kulturore si rezultat i politikës së re të jashtme aktive të saj, e cila i jep përparësi fuqisë së butë, Serbia është bërë një nga vendet më të rëndësishme për sa i përket pozicionit dhe potencialit të saj të rëndësishëm gjeopolitik në Ballkan. Prandaj, Turqia ka filluar të investojë në fuqinë e butë, duke përdorur diplomacinë e saj publike në Serbi për të përmirësuar marrëdhëniet turko-serbe. [10]

Marrëdhëniet midis Turqisë dhe Serbisë janë ndikuar shumë ngushtë në 20 vitet e fundit nga zhvillimet negative në rajonin e ish-Jugosllavisë. Në të kaluarën, megjithëse Turqia zhvilloi një politikë të kujdesshme, bëri përpjekje në çështjet në lidhje me Serbinë dhe shfaqti dëshirë për të ruajtur marrëdhëniet e saj me Beogradin, konfliktet në Bosnjë midis viteve 1992 dhe 1995 dhe në Kosovë në vitin 1999 kanë ndikuar negativisht në marrëdhëniet Ankara-Beograd. Serbët besojnë se gjatë viteve 1990 Turqia qëndroi në anën e kundërshtarëve të Serbisë.

Megjithatë, lidhjet dypalëshe midis Turqisë dhe Serbisë filluan të përmirësoheshin, kur forcat demokratike u zgjodhën në qeveri në Serbi në tetor 2000. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, marrëdhëniet Turqi-Serbi u përkeqësuan përsëri, pasi Turqia u bë një nga vendet e para që njohu Pavarësinë e Kosovës. Sipas ish-ambasadores së Turqisë në Beograd, Suha Umar, Kosova nuk ishte e vetmja arsye pse marrëdhëniet u ndërlikuan përsëri. Marrëdhëniet dypalëshe u përkeqësuan sërish, për shkak të mungesës së bazës së përbashkët, paragjytimeve ndaj Turqisë dhe manipulimeve të jashtme.

Që nga viti 2009, Ankaraja dhe Beogradi kanë ndërmarrë hapa të vendosur për të përmirësuar lidhjet dypalëshe. Zyrtarët turq përdorin çdo

rast për të nënvizuar, se Turqinë dhe Serbinë i shohin si fqinje, pavarësisht mungesës së një kufiri të përbashkët. Ankara ja e sheh Serbinë, vendndodhja e së cilës i siguron Turqisë rrugën më të shpejtë për të arritur në Europë, si vendin kyç për paqen dhe stabilitetin në Ballkan. Nga këndvështrimi i Serbisë, Turqia është qendra për zhvillimin e disa projekteve të infrastrukturës. [11]

Marrëdhëniet midis Turqisë dhe Serbisë kanë marrë vrull vitet e fundit, me objektiv kryesor partneritetin strategjik mes dy vendeve. Së fundmi, qëllimet kryesore në marrëdhëniet dypalëshe përfshinë Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë, Marrëveshjen për Bashkëpunim Infrastrukturor, si dhe heqjen e ndërsjellë të vizave, të cilat janë finalizuar me sukses. Kuadri ligjor për marrëdhëniet ekonomike dypalëshe përbëhet nga një sërë marrëveshjesh midis Turqisë dhe Serbisë, duke përfshirë Marrëveshjen për Bashkëpunimin Ekonomik (2009), Marrëveshjen Dypalëshe për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve (2001), Trajtimi për Parandalimin e Taksimit të Dyfishtë (2005) dhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë (2009). Në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ekonomik, me qëllim të vlerësimit dhe lehtësimit të zhvillimit në marrëdhëniet dypalëshe ekonomike, takimet e Komisionit të Përbashkët Ekonomik Turko-Serb zhvillohen në mënyrë alternative në Ankara dhe Beograd, ku marrin pjesë institucionet publike si nga Turqia, ashtu edhe nga Serbia. [12]

4. Marrëdhëniet e Turqisë me Malin e Zi

Zhvillimi i dy dekadave të fundit në Turqi përfaqësoi një ndryshim thelbësor në zhvillimin e saj social dhe ekonomik. Turqia shihej si një urë lidhëse midis Europës dhe Azisë, si dhe botës së krishterë dhe myslimane për Perëndimin. Ballkani Perëndimor shihet sot si një urë lidhëse mes Turqisë dhe Bashkimit Europian. Në politikën e jashtme të Turqisë së Re, bazuar në Vizionin Strategjik të Turqisë 2023, ka mbetur në fuqi një lundrim kyç dhe synimi për anëtarësimin e Turqisë në Bashkimin Europian, por këtë herë në bashkëpunim me hapësirën e sapokrijuar gjeopolitike të Ballkanit Perëndimor.

Turqia dhe Mali i Zi kanë një orientim të përbashkët të politikës së jashtme në lidhje me zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit më

të mirë fqinjësor, i cili është shumë i rëndësishëm për stabilitetin rajonal. Stabiliteti në Ballkan, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, është i domosdoshëm i lidhur me integrimet e rajonit në BE dhe në NATO. Duke pasur parasysh lidhjet historike, kulturore dhe gjeografike të pjesës tjetër të rajoneve me Turqinë, është shumë e rëndësishme që marrëdhëniet midis Turqisë dhe shteteve të Ballkanit të ndodhin përmes mekanizmave të krijuar tashmë të bashkëpunimit në kuadër të integritit europian dhe euroatlantik. Pa stabilitetin e Turqisë, nuk ka stabilitet në Europë dhe as në rajonin e Ballkanit. [13]

4.1 Marrëdhëniet diplomatike të Turqisë me Malin e Zi

Mali i Zi dhe Republika e Turqisë ruajnë marrëdhënie tradicionalisht miqësore, me gatishmëri të shprehur reciprokisht për zhvillimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit të përgjithshëm dypalësh.

Republika e Turqisë njohu pavarësinë e Malit të Zi më 12 qershor 2006. Mali i Zi dhe Republika e Turqisë vendosën marrëdhënie diplomatike më 3 korrik 2006. Më 21 mars 2019, qeveria e Malit të Zi miratoi vendimin për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme në Stamboll, e cila zyrtarisht filloi të funksionojë në fund të vitit 2019. [14]

4.2 Bashkëpunimi ekonomik midis Turqisë dhe Malit të Zi

Marrëdhëniet mes Malit të Zi dhe Republikës së Turqisë, në një histori të gjatë, të pasur dhe kuptimplotë, janë të jashtëzakonshme sot dhe kanë arritur kulmin e tyre historik. Por ka hapësirë të gjerë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, tregtisë, turizmit, infrastrukturës dhe shkëmbimeve ndërparlamentare, si dhe paralajmëruan intensifikimin e aktiviteteve që do t'i japin shtysë shtesë këtyre proceseve. [15] Në vitin 2022, shkëmbimi tregtar midis Malit të Zi dhe Turqisë arriti në 186,1 milionë euro, importi ishte 170,3 milionë euro, ndërsa eksporti 15,8 milionë euro, që është 10,5% më shumë krahasuar me vitin 2021. Në pesë vitet e fundit, duke përfunduar në dhjetor 2022, investimet e huaja direkte nga Turqia arritën në 173,71 milionë euro.

Sipas të dhënave zyrtare, shumica e kompanive të huaja në Mal të Zi janë në pronësi të shtetasve turq: 3772 kompani turke, 25,7% e numrit të përgjithshëm të subjekteve afariste me pronësi të huaj. Turqia u rendit e

dyta për sa i përket numrit të kompanive me pronë të huaj, të themeluara në Mal të Zi në vitin 2022.

Në vitin 2022 Malin e Zi e kanë vizituar 43 536 turistë nga Turqia, 66% më shumë krahasuar me vitin 2021 dhe 8,8% më shumë krahasuar me vitin rekord 2019. Ata kanë arritur 193,391 për një natë, pra 71,41% më shumë krahasuar me vitin 2021, dhe 201% më shumë krahasuar me vitin 2021. Mesatarisht turistët kanë qëndruar 4,4 ditë dhe në totalin e fjetjeve jashtë vendit kanë realizuar 1,62%.[16]

5. Marrëdhëniet e Turqisë me Kosovën

Një politikë e rëndësishme turke në Ballkan, nën udhëheqjen e AKP-së, ishte njohja diplomatike e Kosovës vetëm një ditë pas Shpalljes së Pavarësisë së saj nga autoritetet kosovare. Para së gjithash, duhet theksuar se njohja turke e Kosovës nuk përfaqësonte një ndryshim rrënjësor në politikën e jashtme turke, por një vazhdimësi. Pritja e Turgut Özalit për Ibrahim Rugovën, liderin e shqiptarëve të Kosovës, në vitin 1992, si dhe debatet parlamentare në vitet 1990, tregojnë se Turqia e kishte simpatizuar kauzën e shqiptarëve të Kosovës që në fillim. Së dyti, Turqia ishte e vetëdijshme për faktin, se procesi i Pavarësisë së Kosovës ishte i pakthyeshëm dhe se nuk kishte asnjë perspektivë për kthimin e Kosovës në sovranitetin serb. Një ndryshim stilistik është se Ministria e Jashtme turke pushoi së theksuari integritetin territorial jugosllav në vitet 2000. Turqia madje ndërmori hapa për të promovuar pranimin e Planit të Ahtisarit, që favorizon Pavarësinë e Kosovës nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së në vitin 2007. [17]

Pas pavarësimit të Republikës së Kosovës, marrëdhëniet e saj me Republikën e Turqisë kanë shënuar një zhvillim të konsiderueshëm. Këto marrëdhënie kanë qenë gjithëpërfshirëse, duke u shtrirë në dimensione politike, ekonomike, ushtarake, shëndetësore, arsimore, kulturore etj.

Marrëdhëniet politike mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë ndikohen nga faktorë të shumtë të natyrës gjeopolitike, ekonomike dhe socio-historike. [18]

Ka vite që po rritet ndikimi i Turqisë në Ballkan dhe në veçanti në Kosovë. Presidenti turk duket se ka nostalgji nga koha e Perandorisë Osmane dhe në shumë raste flet hapur për dëshirën e tij, që të jetë i

pranishëm në këtë pjesë të Ballkanit sa më tepër të mundet. Doktrina turke për ndikim në Ballkanin Perëndimor ka për qëllim faktorizimin e saj, duke përdorur lidhjet dhe trashëgiminë nga Perandoria Osmane.

Diplomacia e jashtme turke në Kosovë ndikimin e saj është përpjekur që ta shtrijë nëpërmjet ndërmjetësimit të konflikteve, në rastin konkret duke u munduar që t'i përafrojë qëndrimet si një lloj ndërlidhësi ndërmjet presidentit të Kosovës dhe atij të Serbisë.

Dimension tjetër i diplomacisë turke është edhe shtrirja e ndikimit në disa sfera të rëndësishme, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë, arsimin, religjionin, kulturën dhe ekonominë. Turqia e ka shtrirë ndikimin e vet në pesë sfera kryesore, në të cilat ka një kontroll mjaft të gjerë.

Së fundmi i gjithë ky aktivitet diplomatik, i cili është rritur në mënyrë graduale nëpërmjet diplomacisë turke, është shpërndarë dhe është mbështetur vazhdimisht nëpërmjet medieve qoftë radio apo televizionit.

[19]

Kosova aktualisht është një partner i rëndësishëm tregtar për Turqinë midis vendeve të Europës Juglindore. Për të plotësuar kuadrin ligjor të marrëdhënieve dypalëshe tregtare dhe ekonomike, Turqia dhe Kosova kanë nënshkruar Marrëveshje për Tregti të Lirë (2013), Marrëveshje për Eliminimin e Tatimeve të Dyfishta (2010), Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ekonomik (2009) dhe Marrëveshjen bilaterale për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve (2006).

Në fushën e bashkëpunimit arsimor janë nënshkruar Protokolli i Bashkëpunimit në fushën e arsimit (2010) dhe Protokolli i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Kërkimit Shkencor dhe Teknologjik të Republikës së Turqisë, TÜBITAK (2014).

[20]

6. Marrëdhëniet e Turqisë me Shqipërinë

Marrëdhëniet dypalëshe midis Turqisë dhe Shqipërisë kanë nisur kryesisht me fillimin e bashkëpunimit në çështjet ekonomike dhe ushtarake. Zyrtarë të nivelit të lartë bënë disa vizita reciproke gjatë vitet '90. Gjatë kësaj vizite shkëmbimi i mendimeve dhe marrëveshjet për disa

çështje specifike forcuan marrëdhëniet e këtyre dy shteteve. Presidenti Demirel bëri një vizitë zyrtare në Shqipëri dhe Maqedoni në vitin 1999, për të diskutuar veçanërisht për çështjen e Kosovës, stabilitetin në Shqipëri dhe situatën e refugjatëve. Një vit më pas Demireli vizitoi sërish Tiranën për të biseduar për çështjen e Kosovës dhe disa çështje të tjera rajonale dhe ndërkombëtare lidhur me interesat e Turqisë dhe Shqipërisë.

Në vitin 2000, kryeministri shqiptar, Ilir Meta, vizitoi Ankaranë për të kërkuar avancimin e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve. Lidhur me bashkëpunimin në fushën ushtarake, në vitin 2000 Shqipëria dhe Turqia, së bashku me Azerbajxhanin, Bullgarinë, Gjeorgjinë, Ukrainën dhe Kazakistanin realizuan një operacion taktik ushtarak me emrin *Peaceful Star 2000* në Shtabin e Akademisë Ushtarake. Nga frekuenca e vizitave të zyrtarëve të nivelit të lartë, është evidente se marrëdhëniet dypalëshe të Turqisë dhe Shqipërisë u zhvilluan fuqishëm gjatë viteve 1990.[21]

Karakteristika e përgjithshme e marrëdhënieve dypalëshe midis Turqisë dhe Shqipërisë është miqësia, besimi dhe solidariteti i ndërsjellë. Ndërmjet dy vendeve kryhen vizita periodike dhe kontakte të suksesshme të nivelit të lartë dhe teknik.

Numri i konsiderueshëm i shtetasve turq me origjinë shqiptare që jetojnë në Turqi dhe i shqiptarëve që zgjedhën të qëndrojnë në Turqi, për shkak të arsimit, shëndetit dhe punësimit ose martesës dhe përmasat në rritje të komunitetit turk që vendosen në Shqipëri, qoftë si punëdhënës apo profesionistë, forcojnë potencialin e bashkëpunimit të të dy vendeve. Turqia e konsideron Shqipërinë si një vend të rëndësishëm strategjik për vendosjen e paqes dhe të stabilitetit të qëndrueshëm në Ballkan dhe mbështet integrimin e saj në institucionet europiane dhe euroatlantike. Në vitin 2013, Turqia u shpall “partner strategjik” nga Shqipëria. Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes përbën një dimension të fortë të marrëdhënieve dypalëshe turko-shqiptare. Ekipet e caktuara nga Forcat e Armatosura Turke kanë trajnuar Forcat e Armatosura Shqiptare dhe i kanë mbështetur ato në aspektin logjistik dhe modernizues.

Turqia është një nga partnerët më të mëdhenj tregtarë të Shqipërisë. Marrëveshja Dypalëshe e Tregtisë së Lirë (në fuqi më 2008), ofron një mjedis të përshtatshëm për të çuar më tej tregtinë dypalëshe.

Për zgjerimin e fushëveprimit të kësaj marrëveshjeje është ende duke u punuar. Disa nga investimet kryesore turke në Shqipëri janë si më poshtë:

- Ndërtimi: ndërtimi i *Limak Aydıner* (ndërtimi i digës)
- Energjia: *Aydiner/Ayen Energy, Kürüm Holding*
- Telekomunikacioni: *Çalık Holding (Albtelecom)*
- Banka: *Çalık Holding (BKT)*
- Industria e hekurit dhe e çelikut: *Kürüm Holding*
- Shëndeti: spitali “Medivia”
- Administrata portuale: *Kürüm Holding*
- Minierat: *Kürüm Holding, Beralb*
- Prodhimi: *TurTekstil*
- Edukimi: *kolegje turke*
- Transporti: *Çağatay Logistics*
- Makineri: *FMT Group*

Midis Turqisë dhe Shqipërisë janë 12 qytete simotra. [22]

7. Marrëdhëniet e Turqisë me Republikën e Maqedonisë së Veriut

Ballkani, veçanërisht Republika e Maqedonisë, si për nga perspektiva historike dhe kushtet gjeopolitike bashkëkohore, është një nga zonat për të cilat Republika e Turqisë shfaq interes të veçantë. Turqia po udhëheq politikën e “rimarrjes” të territoreve, që ishin nën pushtimin e ish-Perandorisë Osmane.

Në planin ekonomik veçohen më shumë investime kapitale të Turqisë në Maqedoni, duke përfshirë ndërtimin e aeroportit “Aleksandri i Madh” në Shkup, rrokaqiejt “Dzhevahir Holding” në Shkup, deri dhe ndërtimi i konviktit të zakonshëm studentor në Shtip, për akomodimin e studentëve turq.

Në planin kulturor, pasqyrimi i plotë i serialeve turke të filmave, prania e “Agjencisë Turke të Bashkëpunimit dhe Koordinimit” (TIKA) po operojnë në më shumë se 100 vende në tri kontinente, aktivitete të organizuara të më shumë se 30 OJQ-ve turke në Republikën e Maqedonisë, të organizuara bashkërisht nën ombrellën e “Bashkimit të OJQ-ve turke në Maqedoni (MATÜSİTEB)”, dhe veprojnë në shumë sfera të jetës shoqërore: përmes arsimit dhe sportit deri te feja, duke arritur qëllime të ndryshme, që janë në interes të shtetit dhe kombit turk.

Në plan politik, përmes partive turke në Republikën e Maqedonisë, target-grup është popullsia turke, e cila numëron rreth 3,9% të popullsisë së përgjithshme. [23]

Më 6 shkurt 1992, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ende nuk kishte miratuar as flamurin kombëtar dhe as himnin kombëtar, Republika e Maqedonisë u njoh si shtet i pavarur nga Republika e Turqisë, e cila në të njëjtën kohë njohu edhe ish-Republikat Jugosllave: Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën.

Marrëdhëniet diplomatike ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë u vendosën në gusht të vitit 1992. Protokolli për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike u nënshkrua më 26 gusht 1992 në Londër nga ministrat e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë dhe të Republikës së Turqisë, dr. Denko Maleski dhe Hikmet Çetin.

Më 20 tetor 1992, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi vendimin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Maqedonisë dhe Turqisë në nivel ambasdash. Pas këtij vendimi, më 6 maj 1993, Turqia hapi ambasadën e parë në Shkup. Më 7 maj 1993, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Kiro Gligorov, pranoi letrat kredenciale nga ambasadorja turke, Suha Nojan, e cila në fakt është ambasadorja e parë e huaj e akredituar në Republikën e Maqedonisë. [24]

Maqedonia është një vend tërheqës për investitorët e huaj. Numri i kompanive turke që operojnë në Maqedoni është rreth 100. Shuma totale e investimit është 1,2 miliardë dollarë. Produktet kryesore të eksportit të Turqisë janë: agrume, tekstile, pajisje shtëpiake, mobilie, produkte metalike dhe farmaceutike. Produkte të importuara nga Maqedonia janë hekuri dhe çeliku, materiali sintetik, endje, tulla, produkte metalike, hekur i papërpunuar dhe skrap.

Vëllimi tregtar midis Turqisë dhe Maqedonisë po rritet, por ngadalë. Arsyeja për këtë është për shkak të luhatjeve në koniunkturën botërore. Ndër institucionet që shërbejnë në Maqedoni janë *Turkish Airlines*, *Halk Bank* në sektorin bankar *Cevahir Holding*, në fushën e ndërtimit TAV, që rindërtoi aeroportin në Maqedoni. Ekziston edhe qendra kulturore *Yunus Emre*, e cila shërben si zonë kulturore. Qëllimi i qendrës kulturore *Yunus Emre* është t'u mësojë turqisht atyre që duan të mësojnë turqisht. Përveç

kësaj, TIKA është një nga organizatat më të rëndësishme turke, që ka restauruar monumentet osmane. [25]

Objektivat strategjikë të Republikës së Turqisë në Republikën e Maqedonia janë turqit etnikë, boshnjakët, myslimanët maqedonas, popullata rome në Maqedoninë Lindore dhe qytetarë të tjerë të fesë islame, si shqiptarë etj., dhe pjesa tjetër e popullit përmes imponimit dhe promovimit indirekt të kulturës dhe vlerave turke. [26]

Përfundime

Në doktrinën e re turke që rrjedh nga AKP-ja, përveç interesave të mëdha në Azinë Qendrore, Kaukaz apo Afrikë, edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor shfaqet gjithashtu si një territor me rëndësi parimore. Duke pasur parasysh që ky territor ka qenë për pesë shekuj me radhë pjesë e Perandorisë Osmane, trashëguese e drejtpërdrejtë e së cilës është Turqia, autoritetet turke kanë shtuar në masë të madhe përpjekjet që të rritin përsëri ndikimin e tyre. Lidhjet kulturore, fetare, por edhe historike shërbejnë aktualisht si një pikënisje në dobi të thellimit dhe nxitjes së bashkëpunimit në shumë drejtime.

Përballë vendeve të Ballkanit Perëndimor shteti turk zbaton një politikë, e cila synon të tejkalojë problemet etnike, në mënyrë që të arrihet një paqe dhe mirëbesim afatgjatë mes këtyre të fundit.

Diplomacia turke për rajonin e Ballkanit bart elemente të rëndësishme historike, gjeografike dhe demografike. Ajo që fuqizon edhe më shumë këtë argument është e kaluara kulturore, trashëgimore dhe historike, që ndihet akoma në shumë vende ballkanike, e ruajtur nga periudha e administrimit osman. Rajoni i shërben Turqisë si e vetmja portë për në Europë. Pas një pushimi gjatë Luftës së Ftohtë, angazhimi aktiv i Turqisë në rajon është rikthyer. Sot mund të thuhet se Turqia është kthyer në rajon. Është fuqia e butë, ajo që ka qenë mjeti kryesor i ndikimit të Ankarasë në rajon dhe diplomacia publike qëndron në thelbin e kësaj fuqie të butë. Institucionet e diplomacisë publike po shërbejnë si fytyra e dukshme e politikave, ambicieve, synimeve dhe vizionit të Turqisë në rajon. Për këtë arsye, analiza e diplomacisë publike turke ofron një pasqyrë të qartë, se cilat janë synimet dhe potencialet e Turqisë në Ballkan.

Referenca

1. Ivan Ristov, Kostadina Klechkaroska, Ivona Shushak, Turkish strategic in the Balkans: the Republic of Macedonia - a case study, International Scientific Conference Macedonia and the Balkans, a hundred years after the world war I - security and euroatlantic integrations, Skopje, 2014, f. 304.
2. Fidan Mustafa, *Gjeopolitika e Ballkanit - e ardhmja e shqiptarëve në rajon*, Tiranë 2022, f. 231.
3. Liridon Lika, *Strategjia e Turqisë përballë shteteve të Ballkanit Perëndimor*, revista *Diskutime*, numër 8, 2013, f. 65.
4. Selim Ibraimi, *Zgjerimi i ri turk në Ballkan*, Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim-Maqedoni (CSSD), Tetovë, 2017, f. 3.
5. Fidan Mustafa, *Gjeopolitika e Ballkanit - e ardhmja e shqiptarëve në rajon*, Tiranë 2022, f. 235.
6. Muhasilović Jahja, Turkey's soft power and public diplomacy in Bosnia-Herzegovina and Sandžak (2002-2017), Bogazici University. Atatürk Institute for Modern Turkish History, 2020. Turkey, f. 5.
7. Ubeydullah Sakin, Turkey's soft power strategy the case of Bosnia and Herzegovina, Istanbul Şehir University, Turkey, 2017, f. 35.
8. Eşref Kenan Rašidagić & Zora Hesova, Development of Turkish Foreign Policy Towards the Western Balkans with Focus on Bosnia and Herzegovina, Croatian International Relations Review, Zagreb, 2020, f. 96.
9. Farrukh Nawaz Kayani, Turkey's bolstering economic and political relations with Bosnia and Herzegovina, Eurasian Journal of Social Sciences, 2021, Turkey, f. 198. <https://sarajevo-emb.mfa.gov.tr/Mission/ShowInfoNote/340627>
10. Talha Yavuz1, Şirin Duygulu Elcim, Turkey's Soft Power and Public Diplomacy: The Case of Serbia Between 2002-2019, Nitel Sosyal Bilimler-Qualitative Social Sciences, Vol:2 Issue:1, Turkey, 2020, f. 77.

11. Erhan Türbedar, Turkey's New Activism in the Western Balkans: Ambitions and Obstacles, *Insight Turkey*, Vol. 13 / No. 3 / 2011, Turkey, f. 145.
12. Davut Han Aslan, Hasan Eren, Economic relations of Turkey with Balkans: Greece, Bulgaria, Serbia and Romania, *Akademia Finansów i Biznesu Vistula – Warszawa*, Warszawa, 2018, f. 113.
13. Mehmedin Tahirovic, Relations between Turkey and the Balkan Countries as in a Function of Improving the Regional Peace and Stability, *Adam Academy Journal of Social Sciences*, Turkey, 2014, f. 59. <https://www.gov.me/en/diplomatic-missions/embassies-and-consulates-of-montenegro/turkey>; <http://tvteuta.com/beciq-shentop-mali-i-zi-dhe-turqia-po-shenojne-faqet-me-te-bukura-ne-historine-e-marredhenieve-dypleshe>; <https://www.gov.me/en/diplomatic-missions/embassies-and-consulates-of-montenegro/turkey>
14. Birgül Demirtaş, Turkey's recognition of Kosovo independence and its relations with Serbia, Kosovo: sui generis or precedent in international relations, *Institute of International Politics and Economics*, Belgrade, Belgrade, 2018, f. 189; <https://ambasadat.net/turqi/>
15. Izet Berisha, *Heshtja ndaj influencës turke në Kosovë*, opinione, *Bota Sot*, 2018; <https://ambasadat.net/turqi/>
16. Mehmed Sülkü, Political relations between Turkey and Albania in the post cold war period, *Middle East Technical University*, 2010, f. 66; <https://tirana-emb.mfa.gov.tr/Mission/ShowInfoNote/255500>
17. Ivan Ristov, Kostadina Klechkaroska, Ivona Shushak, Turkish strategic in the Balkans: the Republic of Macedonia - a case study, *International Scientific Conference Macedonia and the Balkans, a hundred years after the world war I – security and euroatlantic integrations*; Skopje 2014, f. 303
18. Ivan Ristov, *Pushteti i Turqisë në Ballkan dhe implikimet e sigurisë - rasti i Maqedonisë Veriore*, Universiteti “Shën.

Klimenti i Ohrit”, Manastir, Fakulteti i Sigurisë në Shkup; Shkup 2020, f. 175.

19. Ali Yılmaz Gündüz, From Ottoman Period To Present Socio-Economic View Of Macedonia-Turkey Relations, X. InternaΘonal Balkan and Near Eastern Social Sciences Congress Series – Ohrid / Macedonia, University “St. Kliment Ohridski” Faculty of Economics/Macedonia University of Agribusiness and Rural Development/Bulgaria; Macedonia 2018, f. 403.

2.7 Xhelal NEZIRI

Bota po ndryshon - shqiptarët gjithashtu

Çfarëdo që të ndodhë në skenën globale, shqiptarët etnikë në Ballkan për herë të parë janë më të përgatitur, më syçelë, më të ditur, më proaktivë dhe me një instinkt edhe më të fuqishëm mbijetese. Kjo nuk ishte realitet në katër fazat e mëhershme, kur bota pësoi transformime rrënjësore.

Rikthimi i Donald Trump-it në Shtëpinë e Bardhë në Uashington hapi shumë dilema dhe shkaktoi shumë paqartësi. Çfarë rendi botëror dëshiron: atë aktual të bazuar në rregulla, apo një rend të bazuar në fuqi? I pari është vendosur që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore (me rregullat e mosndryshimit të kufijve dhe respektimit të sovranitetit të të gjitha shteteve), kurse i dyti ka kohë që kërkohet nga Rusia dhe Kina (me rregullin e vetëm, që shteti i fuqishëm bën atë që duhet bërë, i dobëti vuan atë që duhet vuajtur). Rendi aktual shkon më shumë në favor të shteteve ose popujve të vegjël, kurse rendi që ofrohet është dëshirë e shteteve ose popujve të mëdhenj.

Përshtatja si instinkt mbijetese

Shqiptarët, si popull i shtrirë në pesë shtete në Ballkan, sërish bien në kategorinë e popujve të vegjël. Historikisht kanë arritur të mbijetojnë falë përshtatshmërisë së rrethanave të krijuara nga perandoritë nga ajo romake e deri tek ajo osmane. Në ato sisteme shqiptarët nuk kanë qenë rebelët, kryengritësit ose shkatërrimtarët, por, përkundrazi, pjesë e zgjerimit dhe e drejtimit të perandorive. Në një situatë përafërsisht të njëjtë kanë qenë edhe në Luftën e Dytë Botërore, kur Italia fashiste, gati pa rezistencë, pushtoi trojet ku jetonin shqiptarët etnikë edhe pas asaj lufte, në Shqipërinë ose ish-Jugosllavinë komuniste. Pas valës së demokratizimit të shkaktuar nga rënia e komunizmit në vitet '90 të shekullit të kaluar dhe

krijimit të një bote unipolare me në krye me SHBA-në, shqiptarët u rreshtuan fuqishëm me perandorinë e re.

Shqiptarët kanë mbijetuar falë instinktit të fuqishëm të njohjes së fuqisë së tyre dhe fuqisë së tjetrit. Duke i njohur këto rrethana, ata janë përshtatur, në vend që të luftojnë deri në zhdukje. Në rrethanat e reja ata e kanë riqartësuar vizionin e tyre, i kanë ripërcaktuar interesat dhe kanë rivendosur vlerat.

Në këtë tërmet të gjeopolitikës botërore, të shkaktuar pas aneksimit të Krimesë nga Federata Ruse në vitin 2014 dhe pas pushtimit të pjesës lindore të Ukrainës në vitin 2022, është legjitime të hapen temat se si do të veprojnë shqiptarët. Po ashtu është legjitime të hapen dilemat për vizionin e Trump-it si president i shtetit më të fuqishëm në botë dhe për vlerat, parimet dhe interesat që SHBA-ja do të promovojë në periudhën që vjen. Është i pritshëm edhe ankthi nga epilogu i luftës në Ukrainë, i cili pa dyshim se do të reflektohet edhe në kontestet e tjera në botë, por edhe në Ballkan.

A po lind rendi i ri botëror?

Përherë pas një lufte botërore lind një botë e re. Sot mbase pa ia vënë emrin, ne po kalojmë nëpër Luftën e Tretë Botërore. Lufta në Afganistan në vitin 2001, në Irak në vitin 2005, Pranvera Arabe e vitit 2011, lufta e përgjakshme në Siri dhe Irak, lufta brutale në Ukrainë, në Izrael dhe në Gazë mbase shënojnë ndonjë fazë të kësaj lufte botërore, që si duket po zgjat më shumë sesa dy luftërat e para, të cilat përfunduan për katër vjet. Ajo që nuk e dimë, është se në cilën fazë të Luftës së Tretë Botërore jemi, ndërkohë që po shpresojmë se jemi në fundin e saj. E tani, a do të prodhojë një botë të re me rend krejtësisht të ri riafrimi i Trump-it me presidentin rus, Vlladimir Putin, pas një ngrirjeje të tërësishme të marrëdhënieve që nga viti 2022?

Personalisht nuk besoj se Trump-i do të ndryshojë një rend botëror, nga i cili përfituesja më e madhe ka qenë SHBA-ja. Çdokush e ka të qartë se Putini e kërkon një rend të ri botëror, pasi rendi aktual i bazuar në rregulla u dëshmuar se nuk është në favor të tij. Rusia sot është shteti me gjeografi më të madhe në botë, për shkak të mendësisë perandorake, të rrënjësuar në psikologjinë kolektive të rusëve ndër shekuj. Ndaj edhe

doktrina ruse “Zgjerim territori në të gjitha anët, në çdo kohë”, mbetet e pandryshuar, pa marrë parasysh ndryshimet e brendshme të sistemeve dhe udhëheqësve. Ajo që dëshiron Trump-i është që të rivendosë një qasje krejtësisht realiste në marrëdhëniet ndërkombëtare, por pa ndryshuar rregullat. Kjo qasje realiste ndryshon nga ajo liberaliste e ish-presidentit Joe Biden, me atë se në radhë të parë vë interesin shtetëror. Pra, për Trump-in “Amerika e para” është doktrinë e një realizmi pragmatik, që nuk mban aq shumë llogari për vlerat dhe parimet, sesa për interesat amerikanë. Ky vizion nënkupton një qasje edhe nga shtetet e tjera të fuqishme, të cilat po ashtu do të vënë si prioritet interesat e tyre shtetërore dhe në këtë zinxhir marrëdhëniesh të gjendet një hallkë, që do të lidhë interesat e përbashkët të shteteve. Kjo shkollë vë në pah rolin e shteteve dhe e dobëson atë të organizatave ndërkombëtare dhe unioneve. Në sytë e Trump-it realist, OKB-ja nuk është vend ku mund të zgjidhet ndonjë luftë në botë, OSH-ja është shpenzim kot i parave, kurse NATO-ja është një koalicion shtetesh, ku çdo anëtar duhet të paguajë nëse dëshiron të mbrohet. Ai nuk e sheh Bashkimin Europian (BE) si partner, por si një union në konsolidim, që mund të jetë konkurrent i SHBA-së në gjeopolitikën e botës. Takimi i Trump-it me Putinin mund t’i ridefinojë zonat e ndikimit, të cilat u përcaktuan në Jaltë të Krimesë pas Luftës së Dytë Botërore dhe u rishikuan pas tranzicionit demokratik të vendeve të Europës Lindore. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për zonat e ndikimit amerikan dhe rus, por edhe të shteteve të tjera, si Kina, Turqia, Mbretëria e Bashkuar ose edhe Bashkimi Europian (BE). A do të arrihet ndonjë marrëveshje dhe sa do të prodhojë ajo një paqe të qëndrueshme, kjo është një çështje e parashikueshme.

Shqiptarët në botën e re

Raporti i SHBA-së me shqiptarët nuk do të ndryshojë në thelb, por do të bëhet më realist dhe më pragmatik. Njësoj siç pretendon Trump-i pronësinë mbi Kanalin e Panamasë (i ndërtuar nga SHBA në vitin 1904), ai e sheh Kosovën si krijesë amerikane. Ringjallja e Marrëveshjes së Uashingtonit, e cila u arrit në shtator të vitit 2020 midis Aleksandër Vuçiqit të Serbisë dhe Avdullah Hotit të Kosovës, disa muaj para se Trump-i ta humbë garën për mandatin e dytë, pritet që të bëhet realitet

sapo Kosova të ndërtojë institucionet e reja pas zgjedhjeve të shkurtit. Idetë kreative për zgjidhjen e problemit Prishtinë-Beograd po ashtu do të rikthehen në tavolinë. Paralelisht me këtë, në Shqipëri do të ketë tentime të forcimit të së djathtës, me qëllim të instalimit të aleatëve të Trump-it, në një vend që shquhej për një qeveri të afërt me familjen e George Soros-it, të cilin Trump-i e sheh si rrezikun më të madh për doktrinën e tij. Edhe nëse nuk arrin ta kthejë të djathtën në pushtet, kjo nuk do të thotë se në Shqipëri do të nxiten revolucione.

Kryeministri Edi Rama e ka atë instinkt kolektiv të mbijetesës, i cili e njeh mirë fuqinë e tij dhe fuqinë e Trump-it dhe, në këtë raport, i përshtatet realitetit të ri. Shembull është rasti me Italinë, ku Rama ndërtoi marrëdhënie të shkëlqyera me kryeministren Giorgia Meloni, e cila erdhi në këtë post si përfaqësuese e një partie që llogaritet e ekstremit të djathtë, që aktualisht është e afërt me Trump-in.

Zgjidhja e kontestit midis Kosovës dhe Serbisë mund të ndikohet nga epilogu i luftës në Ukrainë. Ngrirja e konfliktit në Ukrainë për një kohë të pacaktuar, me qëllim të rikthimit të normalitetit në zonat e luftës e që më pas të kërkohet një zgjidhje racionale, është epilogu më i mundshëm i luftës atje. Por nuk përjashtohet edhe opsioni i shkëmbimit të territorit midis Ukrainës dhe Rusisë. Në rastin e parë, pra të ngrirjes së konfliktit, palët do t'u rikthehen obligimeve të Marrëveshjes së Minskut të vitit 2015, e cila parasheh formimin e njësive vetëqeverisëse për rusët etnikë në Krime, Donbas dhe Donjetsk dhe një ndarje të pushtetit në baza etnike në nivel të shtetit ukrainas. Në rastin e dytë, atë të shkëmbimit të territorit, do të aplikohet formula e zgjidhjes së luftës midis Finlandës dhe Rusisë në vitin 1944, e cila njihet si “territor për paqe”. Finlanda i dha Rusisë 20 për qind të territorit të saj, përfshirë një qytet të banuar me afër gjysmë milioni banorësh. Edhe në rastin e Kosovës, dy opsione do të sillen në tavolinë: vazhdimin e konfliktit të ngrirë me Marrëveshjen e Brukselit (Asociacionin e Komunave Serbe) apo shkëmbim territoresh për paqe (korrigjimi i kufirit).

Çdo zgjidhje në Kosovë, ndërkohë, do të ndikojë te shqiptarët etnikë në Maqedoninë e Veriut. Sidomos nëse Shkupi do të ngelet jashtë procesit të negociatave për integrim në BE, një union që e projekton veten si një faktor gjeopolitik dhe që mendon për formimin e forcave të

përbashkëta ushtarake. Nëse Maqedonia e Veriut nuk i bashkohet Shqipërisë në trenin drejt BE-së dhe mbetet në një stacion me Kosovën dhe Bosnjë- Hercegovinën, kjo situatë do ta ekspozojë ndaj çdo epilogu të mundshëm në Ballkan. Aq më tepër kur Serbia dhe Bullgaria pretendojnë në legjitimitet historik mbi Maqedoninë e Veriut, shkaku i Traktatit të Shën Stefanit (1878) apo Traktatit të Bukureshtit (1913), kurse Greqia nuk është aq e lumtur për emrin që mbart fqinji i saj verior. Sidoqoftë, shqiptarët etnikë në Maqedoninë e Veriut e kanë projektuar të ardhmen e tyre në një shtet të drejtë, të përbashkët me maqedonasit dhe të tjerët, të integruar në NATO dhe BE. Kjo nuk do të thotë shkëputje nga trangu etnik shqiptar ose tjetërsim etnokulturor, por veprim në përputhje me konceptet moderne të shtetit.

Çfarëdo që të ndodhë në skenën globale, shqiptarët etnikë në Ballkan për herë të parë janë më të përgatitur, më syçelë, më të ditur, më proaktivë dhe me një instinkt edhe më të fuqishëm mbijetese. Kjo nuk ishte realitet në katër fazat e mëhershme, kur bota pësoi transformime rrënjësore. Lufta e Parë Botërore i gjeti pa shtet e ushtri, pa ekonomi të konsoliduar dhe me mbi 90 për qind analfabetizëm. S'kishte se si të ishte më ndryshe koha e errët që pasoi. Pas Luftës së Dytë Botërore i gjeti gati në të njëjtën gjendje, por tashmë me një identitet të konsoliduar etnik dhe kombëtar. Periudha që pasoi sërisht nuk ishte e ndritur. Pas rënies së komunizmit, shqiptarët etnikë në Ballkan sot jetojnë në dy shtete, Shqipëri dhe Kosovë, kurse në dy shtete të tjera janë bisedarë, Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi., me praninë dhe anëtarë të NATO-s, në proces të integrimit në BE, me shkollim të hovshëm dhe të gjithmbarshëm dhe me konkurrueshmëri në nivele globale.

III. BOTA

3.1 DR. ENVER BYTYÇI

Pozita gjeopolitike e Shqipërisë dhe e Kosovës në zhvillimet e sotme të vendosjes së rendit të ri botëror

Shihni si është katandisur në dekadën e fundit edhe marrëdhënia midis Kosovës dhe Shqipërisë. Edhe sikur hasmi të donte ta bënte më të shëmtuar këtë marrëdhënie, nuk do të kishte arritur ta bënte kaq të egër.

Që prej 24 shkurtit 2022, kur Rusia sulmoi ushtarakisht Ukrainën, Kontinenti European ka filluar ndryshimin e madh. Për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore në kontinentin tonë ndodhi një sulm i papritur kundër sovranitetit të një vendi tjetër, ndonëse Karta e OKB-së ndalon kategorikisht ngjarje të tilla. Rusia nisi pushtimin ushtarak të Ukrainës. Pyetja që u shtrua ishte kjo: *Çfarë do të ndodhë në botën e sotme, nëse të fuqishmit, atomikët, ato vende që kanë potenciale ushtarake të papërbalueshme, do të nisin pushtimin e vendeve të tjera?!*

Më e pakta nuk do të kishte dhe nuk do të ketë më rregulla që përcaktojnë sjelljen e shteteve midis tyre. Sulmi ushtarak në Ukrainë ishte fillimi i një rendi të ri botëror, gjithashtu me rregulla të reja. Cilat do të jenë ato rregulla? Ne ende nuk e dimë. Por e dimë se në gjeopolitikën e botës do të kemi rregulla dhe ekuilibra të tjerë nga ata që pati përcaktuar Konferenca e Jaltës në shkurtin e vitit 1945. Po, Jaltës, pikërisht të atij qyteti që ndodhet në gadishullin e Krimesë, e cila zyrtarisht është në territorin e Ukrainës, por që në mars 2014 u aneksua prej Rusisë. A do të jenë edhe kësaj radhe tre vendimmarrës? Atëherë ishin Rusveti, Çerçilli dhe Stalini. A do jenë kësaj radhe Donald Trump, Vladimir Vladimiroviç Putin dhe Xi Jinping? Të shohim! Por Europën mund ta shohim në rolin e Francës së De Golit të asaj kohe.

Ukraina u përsërit në Lindjen e Mesme, në Gaza. Më 7 tetor 2023 ndodhi akti terrorist i Hamasit. U morën peng qindra izraelitë dhe u vranë

rreth 1200 të tjerë. Tel Avivi u hakmor. Nisi sulmin mbi Gazën dhe e shkatërroi atë. Deri tani ka vrarë mbi 60 mijë të pafajshëm, prej të cilëve mbi 22 mijë fëmijë. Edhe këtu u rrënuar rendi ndërkombëtar. Ishte dhe mbetet një luftë pa rregulla, pa limite. Të sulmosh brenda territorit të Izraelit, siç veproi Hamasi palestinez, e të shkaktosh viktima të shumta, ishte e paprecedentë.

Ndërkaq, reagimi joproporcional dhe masakrat mbi njerëzit e pafajshëm, përfshirë fëmijët e pambrojtur, edhe kjo përbën shkelje të çdo rregulli dhe norme ndërkombëtare. Dhe të dyja këto konflikte e luftëra duket se kanë diktuar dhe po shkohet madje drejt vendosjes së një rendi të ri. Qëllimi është që aktorët e këtij rendi të fuqizohen. Por është ende herët të mësojmë nëse po shkohet ose jo drejt një lufte të re botërore pas këtyre ngjarjeve. Në Europë mësohet gjithnjë e më shumë se Lufta e Tretë është në nisje të saj. Popujt e këtyre vendeve po përgatiten madje për të përballuar një tragjedi të tillë, deri tek udhëzimet që edhe në shkolla të flitet me nxënësit për këtë.

Kësisoj, situata gjeopolitike e sotme është një shqetësim në rritje për botën e sidomos për kontinentin dhe Bashkimin Europian. Kësaj radhe shqiptarët janë më në avantazh sesa në çdo rast tjetër të vendosjes ose rivendosjes së rendit botëror, sidomos në shekullin XX. Por për mirë apo për keq, ky shqetësim nuk ndihet sa në vendet e tjera të Europës. Ndoshta se jemi mësuar me të keqen dhe duhet kohë të na dalë ajo. Ndoshta se valët e rrezikut vijnë te ne me vonesë, siç ka ndodhur thuajse në të gjitha kohët historike të mëparshme. Ne u çliruam të fundit nga Perandoria Osmane dhe, po ashtu, të fundit në rajon krijuam shtetin e parë shqiptar. Ne u pushtuam në Luftën e Parë Botërore nga pushtues të shumtë sa asnjë komb tjetër, por reaguam të fundit. Fillimisht erdhën serbët, pastaj grekët, më vonë austro-hungarezët, por edhe italianët e francezët. Dhe ne si popull aso kohe nuk reaguam si një organizëm me organizim e me hierarki. Prej italianëve u çliruam të fundit, në qershorin e vitit 1920, gati dy vite pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Në Luftën e Dytë Botërore u pushtuam po ashtu të parët dhe pritëm të çliroheshim kur pushtuesit të thyheshin nga Fuqitë e Mëdha. Në historinë tonë kemi bërë luftëra, por thuajse asnjëherë me një organizim mbarëkombëtar, përveçse në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Kur

Çerçiz Topulli luftoi kundër osmanëve më 1908, vetëm Gjirokastra ishte pjesë e kësaj lufte. Kur Dedë Gjon Luli luftoi në Malësi në kryengritjet e vitit 1910-1911, mungoi solidariteti i pjesës tjetër të shqiptarëve. Kur në pranverën e verën e vitit 1912 ndodhi kryengritja e armatosur kundër osmanëve në Kosovë e që nisi me Kuvendin e Junikut, zonat tjera të Shqipërisë heshtën dhe nuk u solidarizuan me atë që ndodhi në Kosovë. Për pasojë Serbia e pushtoi atë vit Shqipërinë deri në Shkumbin, përfshirë edhe Durrësin. Ajo masakroi sipas Aleksandër Leo Freundlich ose sipas Trock-it së paku 25 mijë shqiptarë, kryesisht në Kosovë, Shkup, Kumanovë e Shqipërinë Verilindore.

Të fundit ishim ne që shembëm diktaturën komuniste, ndonëse ofertën e morëm të parët përmes ish-kryeministrit bavarez, Josef Strauss. I vetmi rast kur kemi qenë unikë, qe lufta e fundit në Kosovë. Dhe kjo falë mençurisë, urtësisë dhe vizionit të Ibrahim Rugovës. Për pasojë jemi i vetmi popull dhe i vetmi komb, që nuk po orientohe mi si duhet edhe në kohët e sotme. Na mungon jo vetëm koherenca, por edhe bashkëpunimi e harmonia për të qenë koshientë për atë që ndodh pranë e rreth nesh. Ne vend të vlerësojmë rreziqet që vijnë nga agresioni rus në Ukrainë; ne vazhdojmë dhe presim që “të mirat e kombit tonë të vijnë nga Amerika ose nga Europa”! Ne nuk kemi një qasje të balancuar dhe të unifikuar të politikës e, madje, as të të dy shteteve shqiptare, Shqipërisë dhe Kosovës, për shumë çështje thelbësore, strategjike dhe politike të përbashkëta. Ne vazhdojmë të jemi të përçarë, njësoj si në dekadën e parë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në këto pozicione na gjejnë edhe zhvillimet e sotme gjeopolitike.

Gjeopolitika është shkencë që bazohet në dy komponentë: *në gjeografinë*, pra në teatrin e zhvillimeve praktike dhe *në politikën* që ndiqet për të përballuar sfidat e këtyre zhvillimeve. Teatri i zhvillimeve politike është kryesisht në Kontinentin Europian. Agresioni rus në Ukrainë synon pikërisht dobësimin e Europës dhe forcimin e Rusisë në raport me pjesën tjetër të kontinentit. Territoret dhe popullsia shqiptare janë pjesë e këtij teatri gjeografik të zhvillimeve politike dhe strategjike. Nëse Rusia e fiton luftën në Ukrainë, ka shumë mundësi që ajo të bëjë agresion kundër vendeve të tjera të Europës Lindore. Polonia përgatitet për luftë. Po ashtu vendet baltike e deri te Bullgaria, Serbia, Greqia e

Turqia. Por Serbia është në anën e Rusisë. Ndërsa ne soditim dhe presim që fatin tonë ta përcaktojnë zhvillimet dhe konfliktet midis të tjerëve. Ne vazhdojmë të jemi hipokritë me veten tonë. Ne vazhdojmë të ushqejmë kapriçiot, unin, egon tonë me kërkesën për prestigj fasadë. Ne mburremi me një anije të falur nga Italia, ndonëse ajo anije është ndërtuar para një shekulli. Ne luajmë me fasadën, mashtrimin dhe intrigën edhe në kushtet e emergjencës kombëtare për t'u mbrojtur nga agresioni rus ose serb kundër nesh. Ne vazhdojmë të shkujdesur në situatat e tmerrshme që po zhvillohen rreth nesh. Në vend që të përgatisim njerëzit për të përballuar rreziqet që na kërcënojnë, ne vazhdojmë të flasim e t'i gënjejmë shqiptarët me përrallat e "integritimeve"! Ne jetojmë në një botë tjetër, sepse duket se e kemi në gjen atë që thoshte Maks Veberi: etjen për pushtet dhe për prestigj.

Prandaj dhe ne nuk e lexojmë ose nuk duam ta lexojmë mirë gjeopolitikën. Nuk bëjmë llogari sa më të sakta për interesat, fuqinë, aleancat dhe mundësitë që krijohen në rrethana të caktuara gjeopolitike. Vitet e fundit Kosova e ka bërë këtë më mirë sesa Shqipëria. Shqipëria ka qenë e aftë të realizojë spektakle të show-bizit gjeopolitik me samite, konferenca, fjalime pompoze, betime e stërbetime për të qëndruar besnike në aleancat euroatlantike. Kosova ndoshta nuk e ka bërë këtë aq mirë sa Shqipëria. Por Kosova ka ndërtuar një ushtri funksionale e profesionale. Ndërsa te ne ende politika grindet për pronat e ushtrisë, në Kosovë ushtria, Forcat e Sigurisë, policia kanë ndryshuar imazhin e vendit të tyre me vepra konkrete. Ato po ndërtohen edhe në lokacione, që askujt nuk ia merrte mendja para pak vitesh. Prej gati katër vjetësh te ne flitet për ndërtimin e dy fabrikave të municionit ushtarak. Ndërsa në Kosovë një fabrikë përfundon këto ditë dhe tjetra nga fundi i këtij viti. Secila më moderne se tjetra. Ndërsa Kosova shpenzon 250 milionë euro në vit për sigurinë dhe mbrojtjen, Shqipëria shpenzon më pak se gjysmën e kësaj shume.

Kuptimi i gjeopolitikës, sidomos për vendet e vogla si Shqipëria e Kosova, do të thotë të përgatitesh për sakrificë më të mëdha se vendet e fuqishme të globit. Sakrificë më e vogël do të ishte "më pak hajni e më shumë investim për sigurinë dhe mbrojtjen"! Pikërisht ky element i rëndësishëm ne na mungon. Ndërkohë që retorikën politike e kemi të

përsosur, harrojmë se kjo retorikë po shërben për të mos vënë re defektet në jetën praktike të qeverisjes. Më duket se investimi për sigurinë dhe mbrojtjen shihet si detyrë e NATO-s ose BE-së.

Gjeopolitika është e lidhur me rolin që ka vendi në një situatë të caktuar të konflikteve rajonale, kontinentale ose globale. Shqipëria dhe Kosova janë në pikën kyç të zhvillimeve gjeopolitike në rajonin e Ballkanit. Shqipëria luan rolin e portës së Adriatikut, ndërsa Kosova është territor, nga ku kontrollohet i gjithë Ballkani. Këtë e pohon gjithashtu ish-akademiku serb, Vasa Çubrilloviç, në memorandumën e tij “Shpërngulja e shqiptarëve” të 7 marsit 1937!

Po sa e si e shfrytëzojmë në këtë pozitë favorizuese për të forcuar pozicionin tonë gjeopolitik? Mendoj se jo aq sa janë mundësitë për këtë. Kosova bën më shumë se Shqipëria edhe në këtë drejtim. Eliminimi ose paralizimi i grupit terrorist serb të Banjskës më 24 shtator 2023 ishte mesazhi kuptimplotë për mbrojtjen e territorit të Kosovës. Unë e kam krahasuar atë ngjarje, e cila u përballua me aq sukses nga policia e Kosovës, të ngjashme me Luftën e Vlorës në verën e vitit 1920. Duhet ditur se Lufta e Vlorës dhe hedhja e forcave ushtarake italiane në det, bashkë me Kongresin e Lushnjës, krijuan kushtet që në Konferencën e Parisit të hiqej nga rendi i ditës ricopëtimi i territoreve të Shqipërisë në favor të Greqisë. Suksesi i Banjskës ishte akt i ngjashëm, me të cilin Kosova mbrojtë pikën më strategjike të Ballkanit në Veri të saj. Në vitin 1920 nuk bënë punë tri delegacione që shkuan të ndara në Konferencën e Parisit, aq sa bëri punë Lufta e Vlorës dhe Kongresi i Lushnjës. Në Kosovë e për Kosovën i përkeqësoi punët procesi i dialogu më shumë se dhjetëvjeçar, por kthesën e shënoi qëndresa, profesionalizmi dhe suksesi i policisë dhe i qeverisë së Kosovës në përballimin e situatës në Banjskë shkaktuar nga grupet terroriste të Serbisë.

Përmenda këta dy shembuj për të ilustruar faktin se veprimi në terren, përgatitja dhe parapërgatitja për të përballuar rrethanat e gjeopolitikës janë vendimtare dhe përcaktuese. Pra, nuk është retorika dhe fotografitë e samiteve “të mëdha”, ato që e çojnë një vend në fitore në një moment kritik të konfliktit të interesave të më të mëdhenjve, kur pjesë e këtyre interesave bëhet edhe vendi ose vendet tona.

Ne shqiptarët luftojmë më shumë për protagonizëm, sesa për suksese praktike. Ne i shërbejmë më shumë egos dhe përpjekjeve tona për lavdi, prestigj e pasuri përmes pushtetit, sesa krijojmë harmoni e ekuilibër në marrëdhëniet tona mes nesh. Përçarja na ka lënë në bisht të situatave në çdo kohë të kthesave historike e gjeopolitike. Ne nuk jemi bashkë as për çështjet më thelbësore që kanë të bëjnë me interesat më jetikë të atdheut, kombit e popullit tonë. Ne luftojmë në çdo rast e për çdo gjë kundër njëri-tjetrit. Ne përçamë dhe përçahemi shumë lehtë.

Te ne ideologjitë janë shkatërrimtare dhe jo udhërrëfyese motivuese për përparim e prosperitet.

Shihni se si është katandisur në dekadën e fundit edhe marrëdhënia midis Kosovës dhe Shqipërisë. Edhe sikur hasmi të donte ta bënte më të shëmtuar këtë marrëdhënie, nuk do të kishte arritur ta bënte kaq të egër. Së paku kishim një lloj tabuje sa u përket marrëdhënieve midis të dy shteteve tona. Ajo tabu njihte limite e kufij në kritikën, sharjet dhe kundërvëniet midis dy shteteve ose dy pjesëve të të njëjtit komb. Kjo tabu u thye dhjetë vitet e fundit. Tirana dhe Prishtina janë më larg njëra-tjetrës, sesa ishin edhe në kohën e diktaturës. Dhe, fatkeqësisht, kjo konsiderohet nga globalistët si “emancipim”!

Po ashtu të përçarë jemi brenda kontureve politike të të dy vendeve. Lufta kundër njëri-tjetrit bëhet pa zgjedhur as mjetet. Është luftë e ashpër, sikur luftojmë kundër një legjioni armiqësor. Sëmundja jonë quhet përçarje. Ndaj dhe askush nuk merret me çështjet themelore të gjeopolitikës së sotme. Ndaj dhe të huajt nuk na marrin seriozisht e zor se na besojnë, pavarësisht fjalëve diplomatike me etikë që ata artikulojnë.

Si përfundim, mund të themi se gjeopolitikën, zhvillimet e saj i përcaktojnë Fuqitë e Mëdha. Ngjarjet gjeopolitike zhvillohen përmes konflikteve dhe zgjidhen në tavolinën e bisedimeve. Vendimmarrja është po ashtu në dorën e aktorëve të fuqishëm ndërkombëtarë. Në rastin e sotëm në dorë të SHBA-së, Kinës, Rusisë dhe Fuqive Europiane. Kombet, shtetet dhe popujt e vegjël kanë në dorë vetëm të veprojnë me shkathtësi e me zgjuarsë, të përgatiten për ta mbrojtur vendin e tyre dhe të luftojnë për këtë.

Nëse ndodhin konfliktet e të mëdhenjve, në një situatë si kjo jona, ata krijojnë aleanca me më të vegjlit. Në rajonin tonë është sërish Serbia, ajo

që mbështetet në aleancën e saj me Rusinë. Por popujt dhe kombet e tjera, falë zgjimit të madh në luftën e fundit gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë e kanë nxjerrë mësimin përfundimtar. Ata duhet të bashkohen kundër Serbisë, nëse kjo do të kërcënojë sovranitetin e fqinjëve të saj. Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova janë më të rrezikuara. Por kjo nuk do të thotë që boshnjakët dhe kosovarët duhet të jenë vetëm në një përballje të mundshme nga agresioni serb. Aleanca ushtarake e lidhur javët e shkuara midis Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë është modeli i rezistencës. Me shumë gjasa kësaj aleance do t'i bashkohet edhe Bullgaria.

Por kjo nuk mjafton. Ka shumë nevojë të flitet me opinionin publik për t'u përgatitur për më të keqen. Mbi të gjitha, të lëmë mënjatë inatet, sherret, luftën e brendshme dhe urrejtjen kundër njëri-tjetrit. Ne nuk mund të kemi komoditetin e sharjeve dhe sherreve politike ekstreme për pushtet. Neve na duhet harmoni dhe ekuilibër në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Na duhet ajo që në teorinë e politikës quhet *pagja sociale*. Kosova ka një përvojë të mrekullueshme dhe unike nga fundi i viteve 1980 e fillimi i viteve 1990 me pajtimin e gjaqeve dhe homogjenizimin e saj, duke u bërë një me lidhshpirtin e Ibrahim Rugovës. Shqipëria do të duhet të iniciojë sa më shpejt një lëvizje si ajo e Kosovës para 35 vitesh.

3.2 Dr. Samet DALIPI [Profesor, kolegji “Universum”, Kosovë]

Revolucioni “Trump”-ian i politikës së jashtme të SHBA-së dhe ndikimi i saj në Ukrainë e Kosovë

Abstrakt

Shmangia nga rendi liberal në botë po vendoset nga vetë shteti, i cili ishte prijës i këtij rendi për një periudhë prej disa dekadash. Konservatorizmi dhe përqaftimi i realpolitikës nga ana e SHBA-së ndaj botës po zhgënjën përkrahësit e idesë liberale duke hedhur kështu dyshime mbi përkushtimin e Amerikës ndaj sigurisë dhe vlerave perëndimore. Pse ky revolucion i politikës së jashtme të vendit, i cili identifikohet si promovues i demokracisë, dhe cila politikë e bëri atë shtet aq të fuqishëm, të admirueshëm dhe i cili ishte në përkrahje të

humanizmit e drejtësisë ndërkombëtare? A do të dëmtojë apo përforcojë imazhin e shtetit një politikë e këtillë, e cila, me gjasë përkohësisht, po rreshtohet krah vendeve autoritariste? Trump-i me qëllim të arritjes së paqes në Ukrainë po tregohet pragmatik me Rusinë, duke u ofruar me të si me armikun më të madh ideologjik që pas Luftës së Dytë Botërore. Në çështjen e Kosovës nuk pritet të ketë ndryshime nga kursi amerikan i paracaktuar që nga shpallja e Pavarësisë së saj.

Fjalë kyç: SHBA, Ukraina, konservatorizmi, realpolitika, “America First”.

Hyrje

Ndryshimet në shoqëri ndodhin evolucionarisht apo revolucionarisht, me hope. Shoqëritë stabile ndryshojnë gradualisht, me kalimin e kohës dhe si rezultat i përvojave në politikat e brendshme e konkurrenca, të cilat ndikohen edhe nga ambienti rrethues. Në të kundërt, në shoqëritë e pakonsoliduara politikisht e ekonomikisht, ndryshimet mund të bëhen në formë revolucionare ose transformuese, përnjëhershëm të thella dhe duke e transformuar shoqërinë me norma të reja të të jetuarit, të besuarit, të vepruarit e të rindërtimit dhe të krijimit të aleancave të reja.

Ardhja e Donald Trump-it në krye të shtetit ka karakteristikat e ndryshimit të përzier, evolucionar e revolucionar. Evolucionar, sepse është vazhdimësi e demokracisë përfaqësuese, ndjekëse e zhvillimit ekonomik, përpjekje për të qenë hegjemoni... revolucionare, sepse ka një prapakthim në disa nga të drejtat e njeriut, ndryshim të aleancave, kalim nga një liberalizëm demokratik drejt një konservatorizmi shoqëror e politik, mbyllje ndaj organizatave ndërkombëtare, tërheqje nga përkrahja humanitare, përveç rasteve të rënda ekzistenciale...

Që pas Luftës së Parë Botërore, përhapja e demokracisë ishte qëllimi i SHBA-së e sidomos pas 14 pikave të Woodrow Wilson-it. Diplomacia tradicionale do të shndërrohet në një gjysmë të hapur e paqja shpresohet të jetë më thjeshtë e arritshme. Kultivimi i paqes konsiderohet si një virtut që duhet zhvilluar drejt përsosmërisë gjatë brezave, si garancia më e mirë e një bote paqësore. Mirëpo ajo degeneroi si rezultat edhe i mospërfshirjes së SHBA-së në Ligën e Kombeve dhe apetiteve të

autokratëve të kohës. Autokratë të tillë jetojnë dhe veprojnë edhe sot, si Putini e satelitët rreth tij, si Vuçiqi, Orbani, Kim Jon dhe të tjerë si këta prishës të paqes. Udhëheqës të tillë shkatërrojnë paqen jo vetëm të të huajve, por edhe të qytetarëve të vet. Zbatimi i drejtësisë ndaj shkatërruesve të paqes do të jetë një model i rëndësishëm për parandalimin e konflikteve të mundshme. Mosndëshkimi i drejtuesve përgjegjës do t'u japë dritë jeshile autokratëve për aventura të tjera të luftës.

Ndërtimi i institucioneve ndërkombëtare të besueshme me ndikim vendimtar në vendimmarrjen globale për luftën dhe paqen do të rriste sigurinë dhe reduktimin e kërcënimeve dhe luftërave. Bota demokratike, pavarësisht nga qëllimet e mira të Trump-it, mbeti e shokuar me rreshtimin e SHBA-së përkrah Rusisë, Bjellorusisë, Koresë së Veriut... siç ndodhi në votimin e fundit të 24 shkurtit 2025 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara lidhur me integritetin territorial të Ukrainës, edhe pse dihej se, që në Konventën e Republikanëve, ishte vendosur që Ukraina dhe Rusia duhet të lëshojnë pe edhe në aspektin territorial.¹

Politika e jashtme e Amerikës ka pasur mbyllje-hapjet e saj. Baballarët e kombit kishin porositur pasuesit që të kishin kujdes në përzierjen në punët e Europës, pasi, sipas tyre, ajo gjithmonë ka qenë e përfshirë në luftëra, ndaj mund të zhyten lehtë në vorbullën europiane. Në fillet e saj shtetndëruese ajo ndoqi politikën e hapjes ndaj botës, për t'u mbyllur kur pa që ajo po shndërrohej në një vend të rikonolizuar nga europianët. Mbyllja e saj nxiti zhvillimin e hovshëm të kapaciteteve prodhuese, e kur këto kapacitete tejkaluan nevojat vendore, vendi i shtyrë nga kapitalistët u detyrua të hapej nëpërmjet krijimit të rrugëve të reja tregtare me botën, duke dalë nga izolacionizmi. Dalja nga izolacionizmi përfshin sidomos kyçjen e saj në fundin e Luftës së Dytë Botërore nga W. Wilson, e cila vendosi një rend të ri botëror.

Mosratifikimi dhe mospërfshirja e SHBA-së në Ligën e Kombeve, rikthimi në izolacionizëm, ishte një nga faktorët e dështimit të Ligës dhe shkuarjes së botës në Luftën e Dytë Botërore. Përfshirja e vendit në luftë, pas sulmit në Perl Harbër, do ta përshpejtojë humbjen e boshtit narcist. Nga kjo kohë politika e jashtme amerikane do të jetë përfshirëse dhe

aktive, sidomos në përpjekjet për të luftuar ideologjinë komuniste dhe për të përhapur liberalizmin në botë, duke e ndryshuar rendin dypolar në njëpolar, në krye të së cilës do të qëndroj vetë Amerika. Me këtë raport forcash nuk u pajtuan Federata e Ruisë, e cila synonte kthimin e “Botës Ruse” dhe Kina, nëpërmjet ndikimit ekonomik në botë, e të dyja së bashku duke qenë nismëtare të grupimit të shteteve në aleancën politiko-ekonomike mes shteteve Brazil, Rusi, Indi, Kinë, Afrikë e Jugut, “BRICS”, pjesëtarë të së cilës janë edhe disa shtete.

Ikja e Amerikës nga neoliberalizmi drejt realpolitikës e konservatorizmit klasik

Ngjarjet dinamike në politikën botërore nuk i japin komoditetin një analisti të predikojë mbi të ardhmen e kësaj fushe, e sidomos të veprimeve të Presidentit të SHBA-së, Donald Trump. Sipas “Nye”, *ka vënë në dyshim të ardhmen e rendit ndërkombëtar të pasluftës*.² Paralajmërimet për tërheqje nga Organizata Botërore e Tregtisë, e moslejimit të përzjerjes në politikat e SHBA-së nga ana e OKB-së, i mosrespektimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, rishikimi i rolit të saj në NATO, dalja nga Marrëveshja e Parisit etj., janë dëshmi e tërheqjes nga rendi ekzistues botëror.

Takimi i fundit i Trump-it me Zelenskin në Shtëpinë e Bardhë në Uashington treguan paparashikueshmërinë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky joprediktabilitet tregon edhe jopritshmëritë në rrugën e paqes, për të cilën Trump kishte paralajmëruar se me ardhjen e tij në funksion të presidentit do ta përfundonte shumë shpejt luftën në Ukrainë. Tani ai po përballlet me kërkesat e papajtueshme të palëve, sidomos të Ruisë.

Donald Trump, nëpërmjet doktrinës “Amerika e para”, po tregon largim të rëndësishëm nga diplomacia tradicionale e SHBA-së me fokus në “sovrانيتin kombëtar, proteksionizmin ekonomik dhe shkëputjen strategjike nga aleancat dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.³ Trump-i i ka vendosur administratës së tij një agjendë të ndërthurur të qasjeve konservatore ndaj taksave, duke zvogëluar ato për të pasurit dhe duke vendosur ato për prodhimet e importuara, një prirje më populiste për tregtinë, tkurrje të të drejtave civile, si për emigrantët, ndalimin e

abortimit, mospërkrahje të komunitetit LGBTQ, për tërheqjen e fondeve federale “për çdo shkollë apo program që shtyn teorinë kritike të racës, shpërbërjen e Departamentit të Arsimit, ideologjinë gjinore ose përmbajtje të tjera të papërshtatshme racore, seksuale ose politike për fëmijët”⁴, zgjerim të kompetencave të tij, duke ndikuar në degën e ekzekutivit, qëndrim të ashpër ndaj ambientalistëve dhe një qasje pragmatike në rolin ndërkombëtar të Amerikës në botë. Dhe kjo e fundit do të konsiderohet në artikullin tonë.

Trump-i dhe politika e jashtme e SHBA-së

Riardhja e presidentit Trump në krye të Amerikës me motot populiste të fushës ekonomike, “Amerika së pari” (America first) dhe “Ta bëjmë Amerikën sërish të fortë” (Make America great again), po zhvendos politikën amerikane drejt një shpërndarjeje të balancuar të kontributeve të vendeve në mekanizmat institucionalë vendorë e ndërkombëtarë, duke porositur botën se, “nëse doni paqe, investoni në sigurinë tuaj; nëse doni shëndetësi, sërish investoni për shëndetin tuaj”, në kuptim të asaj se “Amerika nuk i bën më këto për ju”, e kjo është pragmatike, reale dhe e drejtë. Retorika dhe qasja e politikës së Trump-it në çështjet botërore është narracion izolues diplomatik, jondërhyrëse ushtarakisht dhe proteksioniste ekonomikisht krahasuar me atë të SHBA-së pas Luftës së Dytë Botërore.⁵

Politika ekonomike e kësaj administrate, sipas *American First Trade Policy*, bazohet në adresimin e pabarazisë tregtare dhe në mbrojtjen e industritë amerikane përmes tarifave reciproke dhe nismave të tregtisë së drejtë.⁶ Kjo doktrinë u jep përparësi interesave të SHBA-së në marrëdhëniet globale, duke e vënë theksin në reduktimin e deficiteve tregtare, kthimin e vendeve të punës në SHBA, duke siguruar se qytetarët amerikanë do të ishin përfituesit kryesorë në angazhimet e saj jashtë SHBA-së.

Buxheti i SHBA-së për ndihmat e jashtme është dyfishuar gjatë 25 viteve të fundit, megjithatë është ende një pjesë e vogël e BPV-së; mbi gjysma e projekteve të SHBA-së zbatohen nga organizata ndërkombëtare

dhe OJQ. Ky trend ishte në rritje edhe me administratën e parë të Trump-it.

Ndërsa administrata e J. Biden popullin ukrainas gjatë luftës trevjeçare me Rusinë e ka përkrahur me rreth 174 miliardë dollarë,⁷ duke i ofruar përkrahje sa të jetë e nevojshme, e sipas *Interagency Oversight Group* rreth 183 miliardë dollarë⁸, dhe gjithsej 240 miliardë dollarë për 180 vendet e tjera⁹, tani Trump-i ka ndryshuar radikalisht në këtë fushë duke kritikuar edhe USAID-in për shpenzime joadekuate dhe të cilën dëshiron ta pushojë së vepruari, duke e vendosur nën përkujdesjen fillimisht të Sekretarit të Shtetit, Marco Rubio. “*Mendoni për këtë, - thotë Trump-i, - një komedian modest i suksesshëm, Volodymyr Zelenskyy, i nxiti Shtetet e Bashkuara të Amerikës të shpenzonin 350 miliardë dollarë, për të shkuar në një luftë që nuk mund të fitohet, që nuk duhet të fillonte kurrë, por një luftë që ai, pa SHBA-në dhe ‘Trump’-in, nuk do të mund ta zgjidhte kurrë*”. Ky tregues e kthen vendin në një nikoqir të kujdesshëm të shpenzimit të parasë publike dhe josolidar me vendet e varfra! Bazuar në GDP-në e vendeve perëndimore ato e ndihmuan pak Ukrainën: Gjermania, SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar vetëm me 0,2% të GDP-së së tyre e tjerat edhe më pak, p.sh., Franca, Italia e Spanja vetëm 0,1%, e Ukraina, përveç shkatërrimeve njerëzore e infrastrukturore, mbulon 55% të luftës, 20% SHBA dhe 20% vendet e tjera,¹⁰ edhe kjo ndihmë kushtëzohet me mospërdorim të armatimit për të sulmuara agresorin në territorin e tij.

Ofrimi i presidentit Trump me presidentin e Federatës Ruse, V. Putin, dhe paralajmërimi i vizitës së Presidentit të Kinës, Xi Jinping në SHBA, vlerësimi i kryeministrit hungarez, V. Orban, e qëndrimi kritik ndaj liderëve të shteteve europiane, përfshirë edhe ata brenda NATO-s, janë shenja të kthimit të politikës amerikane në kahin e kundërt të politikës së udhëhequr deri tani nga administratat e kaluara amerikane, duke hedhur dyshime serioze për të ardhmen e rendit ndërkombëtar të pasluftës.

Rezoluta e propozuar nga Ukraina dhe e përkrahur nga partnerët europianë, “*Advancing a comprehensive, just and lasting peace in Ukraine*”,¹¹ e cila thërret për përkushtimin e sovranitetit territorial të Ukrainës, përmbante fjalinë: “*Pushtimi i plotë i Ukrainës nga Federata*

Ruse ka vazhduar për tre vjet dhe vazhdon të ketë pasoja shkatërruese dhe afatgjata jo vetëm për Ukrainën, por edhe për rajone të tjera dhe stabilitetin global”, që nuk u përkrah nga SHBA-ja. Rezoluta e dytë u votua brenda ditës, e propozuar nga SHBA-ja, por e ndryshuar me vërejtjet, kryesisht të europeanëve, e si rezultat pati abstenimin e propozuesit, SHBA-së.¹²

Dy rezolutat e AP-së dhe njëra në KS të OKB-së, e cila u përkrah edhe nga Rusia, fuqishëm ftonin për arritjen e paqes, por ato dallonin, po ashtu fuqishëm, në mënyrën se si duhej të arrihet paqja. Në Rezolutën e SHBA-së, *A Path to Peace*, nuk figuronte shprehja *agresion rus* e as *integriteti territorial për Ukrainën*, e cila u plotësua me amendamentin e europeanëve, i cili kishte të bënte me këtë çështje e që shënon zhvendosje të politikës amerikane pranë politikës së Federatës Ruse për kthim të imperializmit të së kaluarës. SHBA-ja kishte sponsorizuar një rezolutë në vitin 2023 dhe kishte dënuar agresionin rus në Ukrainë. Kulmi në këtë pikë do të vijë në takimin e dy presidentëve në Shtëpinë e Bardhë, më 28 shkurt 2025, kur Trump-i dhe zëvendësi i tij, Wance, e mbështetën për muri Zelenskin për të nënshkruar marrëveshjen për mineralet e rralla, pa i ofruar garanci sigurie për Ukrainën, duke e quajtur jomirënjohës, se po e shtynte botën drejt Luftës së Tretë Botërore, “se pa ne nuk i ke letrat e paqes në dorë” etj. Më vonë do të kuptohet se kjo sjellje ndaj një kërkuesi për ndihmë nga SHBA-ja ishte një skenar agresiv paralajmërues, i cili do të mund të replikohet edhe në situata të tjera ndaj atyre, të cilët dëshirojnë shërbimet amerikane apo për të ulur pritshmëritë e Ukrainës nga procesi i paqes e duke joshur Putinin për t’u ulur në tavolinën e bisedimeve, me tendencën e blerjes së kohës nga SHBA-ja, pasi Rusia nuk po heq dorë nga kërkesat e saj.

Kriticizmi ndaj politikës së qëndresës së Ukrainës karshi agresionit rus dhe politikës së administratës së J. Biden e vendeve të BE-së, kur e tërë hemisfera perëndimore kishte përkrahur dhe ndihmuar luftën e Ukrainës, si dhe votimi në AP të OKB-së mbi ruajtjen e integritetit territorial të Ukrainës, tregon për qasje të kundërt me politikat amerikane të deritashme,¹³ dhe është shenjë e dallimeve strategjike e të rigrupimeve të reja të aleancave me mundësi dëmtimi të aleancës transatlantike, një shpërndarje e re e forcave në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Pse ky kthim radikal në politikën e jashtme amerikane, sidomos për çështjen e mospërkrahjes së sovranitetit të Ukrainës dhe ofrimit të sigurisë së saj nga NATO-ja, të hezitimit për ta pasur në tavolinë të parin e Ukrainës, V. Zelenski, deri te klasifikimi si fajtor i nisjes së luftës, jolegjitim e diktator, trajtimin të aleatëve të deridjeshëm në kuptimin negativ se ata nuk janë liderë të vërtetë e të paafte për të zgjidhur problemet; vlerësimi pozitiv për AfD-në gjermane dhe partitë e orientimit të ekstremit të djathtë në Europë dhe zbutja ndaj kundërshtarëve si Rusia e Kina? A do të thotë kjo se Amerika po ofron dhe anon nga ish-kundërshtarët ideologjik, si Rusia e Kina, si dhe satelitët e tyre si Irani, Koreja e Veriut, Serbia?

Në fushën e ekonomisë dhe të tregtisë ndërkombëtare SHBA-ja ka miratuar një përzjerje të strategjive tregtare tradicionale dhe progresive, e nëpërmjet strategjisë “America First” thekson mbrojtjen e industrive vendase, përpiqet për të promovuar praktikën e tregtisë së drejtë dhe për të forcuar marrëdhëniet tregtare me aleatët. SHBA-ja po punon drejt krijimit të një mjedisi, ku konkurrenca mund të çojë në rezultate paqësore duke u angazhuar në marrëveshje tregtare shumëpalëshe dhe duke avokuar për praktikën e drejtë tregtare brenda OBT-së.¹⁴

Bashkëkryesuesi i Qendrës për Sigurinë Amerikane, gjenerali me tri yje, Keith Kellogg, tani këshilltar dhe i deleguar special i D. Trump për Ukrainën dhe Rusinë, në prill të vitit të kaluar shkroi se “*përfundimi i luftës Rusi-Ukrainë do të kërkojë një udhëheqje të fortë, “America First” për të arritur një marrëveshje paqeje dhe për t’u dhënë fund armiqësive midis dy palëve ndërluftuese*”. Lëshimi pe dhe kapitullimi para Putinit duke u pajtuar me kërkesat e këtij të fundit, sidomos për territoret ukrainase dhe mosanëtarësimin në NATO të saj, a e bën të fortë udhëheqjen e SHBA-së? Përkundrazi, kompromiset e Trump-it në disa nga objektivat e nisur lidhur me taksat për mallrat nga jashtë, me kërkesat për tokat e rralla në Ukrainë nuk premtjnë dhe nuk tregojnë për qëndrueshmërinë e tij në objektivat e politikave të paraqitura publikisht.

Cili mund të jetë interesi amerikan në vendosjen e kësaj politike konfrontuese me partnerët euroatlantikë e ofrimi me ata autoritarë në botë?

Ne mund të spekulojmë lidhur me objektivat e Trump-it dhe me sjelljen e tij në politikën globale. Por tashmë janë dhënë shkëndijat e para mbi tendencat e tij në kuptim të përvetësimit të infrastrukturës tregtare botërore, si Kanali i Panamasë, të territoreve jashtë SHBA-së për ofrimin e sigurisë së vendit, siç është rasti me Grënlandën, të marrjes eventuale të Gazës, bërjen e Kanadasë si shtetin e 51-të të SHBA-së etj., duke përkeqësuar marrëdhëniet me aleatët tradicionalë të Amerikës. Në arritjen e të gjitha këtyre synimeve nuk mund të përjashtohet edhe përdorimi i forcës. Të gjitha këto japin mundësinë për heqjen e paraleleve me veprimet e Rusisë në Ukrainë, e cila ka pushtuar territore të saj në emër të sigurisë së Federatës Ruse me interesat e sigurisë dhe ata ekonomikë të SHBA-së. Fatin e Ukrainës, anëtare e OKB-së sipas kësaj logjike, mund ta pësojnë në të ardhmen e afërt edhe shtetet pa vend në OKB, si Tajvani, Kosova e Palestina, të cilat mund të bien pre e këtyre politikave të pretenduesve potencialë kinezë, serbë apo hebraikë.

Administrata “Trump” dhe Kosova

Çështja e Kosovës dhe vazhdimi i dialogut me Serbinë ende nuk është shtuar në tavolinën e interesimit të administratës amerikane, por bazuar në letrën e Trump-it dërguar institucioneve të Kosovës, ai konsideron që lidhjet midis popujve të të dyja vendeve janë të forta dhe se pret zgjerimin e tyre, përfshirë rritjen e mundësive për investime, për të sjellë mirëqenie më të madhe për të dy vendet.¹⁵ Duke e konsideruar se konteksti politik Kosovë-Serbi është çështje e BE-së, dy administratat, e SHBA-së dhe e BE-së, janë në pritje të ndërtimit të qeverisë së re të Kosovës, për të vazhduar me procesin negociator. Nuk pritet që të ketë zhvendosje nga ky proces e aq më pak ndonjë kthesë dramatike dhe kontesti kryesor do të jetë ai i cilësisë së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, si një nga elementet për arritjen e marrëveshjes Kosovë-Serbi. Edhe pse kontesti u është bartur europianëve për ta zgjidhur, administrata amerikane do ta shtyjë procesin, që ta përfundojë gjatë mandatit “Trump 2”, për të treguar se Kosova është ndërmarrje suksesi i Amerikës. Dy pretendimet serbe “nën tepih”, për ndarjen e Bosnjës dhe të Kosovës, nuk do të përkrahen, sepse ky efekt do t’u hapte rrugë nismave të ngjashme të popujve në Gadishullin Ilirik, Ballkan.

Përfundime

Së paku sa të qëndrojë në krye të SHBA-së, Presidenti Trump do të riformësojë marrëdhëniet globale me bazë realizmin, duke sfiduar idenë bazë të liberalizmit, multilateralizmin, duke vendosur prioritet interesin ekonomik të SHBA-së, transaksionizmin.

Veprimet e presidentit Trump vijnë si reagim ndaj:

- kërcënimeve kineze në garën për primat, fillimisht ekonomik e politik ndërkombëtar;
- pjesëmarrjes jo të balancuar financiare të vendeve të tjera të NATO-s në veprimet e aleancës e në dëm të SHBA-së;
- i pabarazive në transaksionet ekonomike mes aleatëve dhe joaleatëve;

Si reagim ndaj politikës së jashtme të Amerikës do të krijohen grupime, aleanca shtetesh regjionale, duke rishpërndarë fuqinë ndërmjet tyre, megjithatë Amerika:

- do të mbetet substancialisht lidere ekonomike e ushtarake, por edhe e aleancave;
- nëpërmjet politikës së karotës për Rusinë dhe narracionit të balancuar mes palëve në luftë po synon ta ofroj atë afër tavolinës negociuese;
- potencialisht, do të përsëritet marrëveshja e Munihut, do të shpërblehet agresori dhe do t'u hapet rrugë zgjerimeve të reja për agresorin, në këtë rast Rusisë.

Dobësimi i NATO-s, nëpërmjet mosobligueshmërisë së SHBA-ve për të vepruar sipas nenit 5 të marrëveshjes, mospërkrahja e Ukrainës, lëndimi i aleatëve tradicionalë, është fitore e Putinit. Fajësimi i Ukrainës për konfliktin me Rusinë, i tipit *“të fortin mos e bëj me të dobëtit, mos e bëj me zë”*, e inkurajon Rusinë për veprime të ngjashme ndaj fqinjëve të saj.

Paqja në Ukrainë:

- nuk funksionon pa Ukrainën.

- nuk arrihet pa unitetin SHBA-Europë;
- nuk arrihet pa plotësimin e disa nga synimet e Rusisë, siç janë respektimi i të drejtave të rusfolësve në vend, nëpërmjet një lloj autonomie të lirisë fetare, mosanëtarësimi në NATO për një kohë etj.
- Krimeja do të ndahet mes Ukrainës dhe Rusisë, sidomos portet detare në gadishull, si një element i paqes mes tyre;
- pa ofrimin e sigurisë ndërkombëtare, sidomos të NATO-s.

Paqja e padrejtë nuk mund të zëvendësojë paqen e qëndrueshme. Fitorja eventuale e Ukrainës do të thotë vazhdimësi e mënyrës perëndimore e të jetuarit, e Trump-i do të rreshtohet në anën e drejtë të historisë ose e kundërta.

Vendimi i kthimit të përkrahjes ushtarake për Ukrainën nga SHBA-ja në momentet e fundit pas përparimit negociator të Xhedas, jep shpresë për paqe më të drejtë mes palëve.

Kosova do të vazhdojë të jetë problem evropian, por me ndërhyrje amerikane për të përmbyllur atë brenda periudhës qeverisëse të administratës “Trump”.

Referenca

1. Bill Barrow, AP, Donald Trump has sweeping plans for a second administration. Here's what he's proposed, 19 January 2025, <https://apnews.com/article/trump-second-term-policies-immigration-economy-tariffs-f9d55c34a95054cd224a0b295d88fbde>
2. Congressional Research Service, U.S. Direct Financial Support for Ukraine, January 15 2025, shih në:chromeextension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://crsreports.congress.gov/product/pdf/IF/IF12305#:~:text=As%20of%20January%202025%2C%20Congress,to%20Russia's%20war%20against%20Ukraine.
3. Dawood Mamoon, How would the second term of President Trump define a New World Order? f. 53.
4. Donald Trump's foreign policy: A comprehensive analysis, NTCFPA, 11 November 2024, <https://nycfpa.org/11/11/donald-trumps-foreign-policy-a-comprehensive-analysis/>
5. Eerik Kross, Greg Mills, History is repeating itself as the U.S. risks abandoning Ukraine like it did in Vietnam and Afghanistan. March 06, 2025, <https://kyivindependent.com/us-set-to-abandon-partners-again-as-history-repeats-in-ukraine/>
6. Joseph S Nye, Jr. The future of world order, march 04, 2025. Observer, <https://www.omanobserver.om/article/1167186/opinion/the-future-of-world-order>
- Julia Moon, Inside USAID: How America has spent billions in development aid, 21 February, 2025. <https://www.nzz.ch/english/a-closer-look-at-usaid-how-the-us-spent-its-development-aid-ld.1871424>
7. Marco Rubio, Seanca e Konfirmimit të Senatit, 15 janar 2025, CFR/FP 11/24. Aty, mes të tjerash, thuhet se Ukraina është në luftë shkatërruese, vdekjet duhet të ndalen... të dyja palët do të duhet të bëjnë lëshime nga pozicionet e tyre. Presidenti Trump e uron Presidenten Osmani për 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës,

<https://president-ksgov.net/presidenti-trump-e-uron-presidenten-osmani-per-17-vjetorin-e-pavaresise-se-kosoves>

8. President Trump's America First Priorities, January 20, 2025: <https://www.whitehouse.gov/briefings-statements/2025/01/president-trumps-america-first-priorities/>

9. Ukraine Oweright, <https://www.ukraineoversight.gov/Funding/>

10. UN, https://docs.un.org/en/A/ES-11/L.10?_gl=1*19yki9d*_ga*MTA4MTIxNDQ4MC4xNzQwNDg0MTk2*_ga_TK9BQL5X7Z*MTc0MDQ4NDE5Ni4xLjEuMTc0MDQ4NDIzOS4wLjAuMA..*_ga_S5EKZKSB78*MTc0MDQ4NDIzOS4xLjEuMTc0MDQ4NDY1NC42MC4wLjA.

11. UN News, 24 February 2025, https://news.un.org/en/story/2025/02/1160456?_gl=1*1snyimn*_ga*MTA4MTIxNDQ4MC4xNzQwNDg0MTk2*_ga_TK9BQL5X7Z*MTc0MDQ4NDE5Ni4xLjEuMTc0MDQ4NDIwMi4wLjAuMA.

The Guardian, Trump says he 'had very good talks with Putin and again criticizes Ukraine - as it happened, https://www.theguardian.com/us-news/live/2025/feb/21/trump-administration-federal-government-politics-updates?utm_source=chatgpt.com

12. 1 Marco Rubio, Seanca e Konfirmimit të Senatit, 15 janar 2025, CFR/FP 11/24. Aty, mes të tjerash thuhet se Ukraina është në luftë shkatërruese, vdekjet duhet të ndalen...të dyja palët do të duhet të bëjnë lëshime nga pozicionet e tyre.

13. 2 Joseph S Nye, Jr. The future of world order, march 04, 2025. Observer, <https://www.omanobserver.om/article/1167186/opinion/the-future-of-world-order>

14. 3 Donald Trump's foreign policy: A comprehensive analysis, NTCFPA, 11 November 2024, <https://nycfpa.org/11/11/donald-trumps-foreign-policy-a-comprehensive-analysis/>

4 Bill Barrow, AP, Donald Trump has sweeping plans for a second administration. Here's what he's proposed, 19 January 2025, <https://apnews.com/article/trump-second-term-policies-immigration-economy-tariffs-f9d55c34a95054cd224a0b295d88fbde>

15. 5 Bill Barrow, po aty.
16. 6 President Trump's America First Priorities, January 20, 2025. <https://www.whitehouse.gov/briefings-statements/2025/01/president-trumps-america-first-priorities/>
17. 7 Kongresi ka ndarë afro 174,2 miliardë dollarë nga viti 2022 deri në vitin 2024 në ndarjet shtesë në përgjigje të luftës së Rusisë kundër Ukrainës, prej tyre 37,8 miliardë dollarë për Fondin e Mbështetjes Ekonomike dhe Asistencës për Europën, Euroazinë dhe Azinë Qendrore, duke urdhëruar që një pjesë e kësaj ndihme të vihet në dispozicion për mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për buxhetin qendror të Qeverisë së Ukrainës (GOU). Deri më sot, Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ka obliguar më shumë se 30 miliardë dollarë për një mbështetje të tillë nëpërmjet tre mekanizmave të Bankës Botërore.
18. Congressional Research Service, U.S. Direct Financial Support for Ukraine, January 15 2025, shih në <chromeextension://efaidnbmnnnibpcajpcggleclcfndmkaj/https://crsreports.congress.gov/product/pdf/IF/IF12305#:~:text=As%20of%20January%202025%2C%20Congress,to%20Russia's%20war%20against%20Ukraine.>
19. 8 Ukraine Oversight, <https://www.ukraineoversight.gov/Funding/>
- 9 Julia Moon, Inside USAID: How America has spent billions in development aid, 21 February, 2025. <https://www.nzz.ch/english/a-closer-look-at-usaid-how-the-us-spent-its-development-aid-ld.1871424>
20. 10 Eerik Kross, Greg Mills, History is repeating itself as the U.S. risks abandoning Ukraine like it did in Vietnam and Afghanistan. March 06, 2025, <https://kyivindependent.com/us-set-to-abandon-partners-again-as-history-repeats-in-ukraine/>
21. 11 UN, [https://docs.un.org/en/A/ES1/L.10?_gl=1*19yki9d*_ga*MTA4MTIxNDQ4MC4xNzQwNDg0MTk2*_ga_TK9BQL5X7Z*MTc0MDQ4NDE5Ni4xLjEuMTc0MDQ4NDIzOS4wLjAuMA..*_ga_S5EKZKSB78*MTc0MDQ4NDIzOS4wLjEuMTc0MDQ4NDY1NC42MC4wLjAu.](https://docs.un.org/en/A/ES1/L.10?_gl=1*19yki9d*_ga*MTA4MTIxNDQ4MC4xNzQwNDg0MTk2*_ga_TK9BQL5X7Z*MTc0MDQ4NDE5Ni4xLjEuMTc0MDQ4NDIzOS4wLjAuMA..*_ga_S5EKZKSB78*MTc0MDQ4NDIzOS4wLjEuMTc0MDQ4NDY1NC42MC4wLjAu)

22. 12 UN News, 24 February 2025,
https://news.un.org/en/story/2025/02/1160456?_gl=1*1snyimn*_ga*MTA4MTIxNDQ4MC4xNzQwNDg0MTk2*_ga_TK9BQL5X7Z*M Tc0MDQ4NDE5Ni4xLjEuMTc0MDQ4NDIwMi4wLjAuMA..

13 The Guardian, Trump says he ‘had very good talks with Putin’ and again criticizes Ukraine – as it happened,
https://www.theguardian.com/us-news/live/2025/feb/21/trump-administration-federal-government-politics-updates?utm_source=chatgpt.com

23. 14 Dawood Mamoon, How would the second term of President Trump define a New World Order? f. 53.

15 Presidenti Trump e uron Presidenten Osmani për 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës,
<https://president-ksgov.net/presidenti-trump-e-uron-presidenten-osmani-per-17-vjetorin-e-pavaresise-se-kosoves>

Shënim: Kumtesë e lexuar në konferencën shkencore “Roli i shqiptarëve në rajon dhe qasja e administratës Trump - Një perspektivë e re”, mbajtur në Shkodër, më 13.03.2025, organizuar nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë [Prishtinë] në bashkëpunim me Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

3.3 ZORAN METER

[GEOPOLITIKA NEWS, ZAGREB]

Kryqi i Trump-it mbi globalizimin liberal! Një botë e re lindi

Ndërsa globalizimi si fenomen tregtar ka kontribuar në zhvillimin e paimagjinueshëm të Perëndimit për dekada të tëra, në radhë të parë të Shteteve të Bashkuara, të cilat në thelb ishin prapa tij dhe qëndruan me institucionet e saj të fuqishme financiare dhe ndikimin kyç në ato ndërkombëtare, si Banka Botërore, FMN ose OBT (kjo e fundit mund ta gjente veten në telashe serioze që nga java e kaluar), me pozicionin dominues të dollarit si monedhë rezervë botërore dhe fuqinë po aq të padiskutueshme politike dhe ushtarake amerikane si një mjet shtesë për të siguruar atë proces, gjithçka ishte në rregull.

Megjithatë, kur globalizimi filloi të sjellë përfitime të paimagjinuara zhvillimore për vendet e tjera jashtë të të ashtuquajturave miliarda të arta, kryesisht për Kinën, por jo vetëm për atë, Shtetet e Bashkuara filluan gjithnjë e më shumë të mendojnë se si të ndalojnë një kthesë kaq të papritur dhe të padëshiruar të rezultateve të globalizimit, e cila gjithnjë e më shumë po shkonte përtej fushëveprimit të trendit dhe po kthehej në një proces të pandalshëm.

Në këtë kontekst, në lidhje me Kinën, të dyja partitë politike dominuese amerikane e perceptonin tashmë këtë vend si rivalin kryesor të tregtisë dhe teknologjisë së lartë amerikane në shekullin XXI më shumë se dhjetë vite më parë. Kështu, në mesin e dekadës së fundit, ata arritën një konsensus përfundimtar për marrjen e masave të nevojshme për të ngadalësuar rritjen ekonomike dhe tregtare të Kinës.

Si filloi gjithçka?

Kjo u pa menjëherë pas fitores së Donald Trump-it në zgjedhjet e vitit 2016, kur kreu i ri “jokonvencional” i Shtëpisë së Bardhë filloi të prezantojë masat e para të ashpra tregtare ndaj Kinës (ato u mirëpritën edhe nga demokratët), si ato që lidhen me vendosjen e parë të tarifave për importin e produkteve kineze dhe kufizimet (sanksionet) ndaj disa

kompanive kineze të teknologjisë së lartë dhe atyre *fast-grosta*. SHBA-ja edhe në këtë mënyrë i shtyn ato nga tregu amerikan si konkurrentë të pakëndshëm.

Paralelisht me këtë (tarifat shërbyen si mjet presioni), Trump-i nisi gjithashtu procesin e negociatave tregtare midis SHBA-së dhe Kinës dhe e para nga dy fazat e planifikuara të Marrëveshjes Tregtare midis dy mega-ekonomive u nënshkrua në fund të vitit 2019 dhe, në fakt, përfaqësonte Marrëveshjen e Pekinit për koncesione të shumta të kërkuara nga pala amerikane në reduktimin e tregtisë, me një reduktim të madh tregtar. Megjithatë, gjithçka u ndal shpejt nga pandemia e papritur *Covid-19*, e cila në fund, përveç shkatërrimit të vetë marrëveshjes, i kushtoi Trump-it më shumë: humbjen në luftën për një mandat të dytë presidencial kundër demokratit Joe Biden.

Diplomacia e lavdëruar “pingpong” u shndërrua në një fatkeqësi

Nëse dikush priste që Bideni, tradicionalisht miqësor ndaj Kinës dhe Partia Demokratike në përgjithësi, do të ndryshonin drejtimin e ashpër kundër Kinës të marrë nga Trump-i në mandatin e tij të parë, ata gabuan rëndë. Biden jo vetëm që dështoi në shfuqizimin e tarifave dhe kufizimeve të tjera tregtare të Trump-it kundër Pekinit, por vazhdoi në të njëjtin drejtim, duke i sjellë marrëdhëniet midis dy vendeve në gjendjen e tyre më të keqe që nga themelimi i tyre në 1972 pas diplomacisë “pingpong” të Nixon-it dhe Kissinger-it. I njëjti, i cili, për t’i bërë gjërat më tragjike për Shtetet e Bashkuara të sotme, në vend që të ishte plotësisht i varur nga Amerika dhe, siç priste Uashingtoni, një Kinë e demokratizuar në të ardhmen, e cila më pas futi parimet e tregut të biznesit (pavarësisht nga sistemi formalisht komunist shtetëror njëpartiak), krijoi një fenomen zhvillimi historikisht të paprecedentë.

Nga një vend i varfër, i pazhvilluar, agrar, Kina është rritur me një shpejtësi kozmike në vetëm 30 vjet, në një vend modern, bashkëkohor dhe një lider global në shumë teknologji, në një vend me potencial të madh ekonomik, por edhe fuqi ushtarake. Ajo është bërë “fabrika globale” e famshme, pa të cilën bota nuk mund të funksionojë më. Por jo më vetëm i produkteve të lira me cilësi të dyshimtë, sepse shumë shpejt u bë një gjigant teknologjik, produktet tashmë cilësore më se të

mjaftueshme të të cilit mbushin raftet e supermarketeve perëndimore, shitësve të makinave, dyqaneve industriale, produkteve mjekësore dhe pajisjeve të tjera me çmime, që janë ende shumë më të pranueshme se ato të prodhuesve perëndimorë.

Për më tepër, shumë marka krenare të industrisë perëndimore e kanë zhvendosur masivisht prodhimin e tyre në Kinë, ku përveç fuqisë punëtore më të lirë (për t'u siguruar që nuk ka konfuzion, që nuk është më aq e lirë, sepse standardi kinez gjithashtu është rritur ndjeshëm ndërkohë, megjithëse është ende më i lirë se në Perëndim), ata gjithashtu fituan akses të drejtpërdrejtë në tregun e madh kinez. Ky është tani elementi kyç i klasës së mesme të punës për qytetarët perëndimorë, jo për qytetarët me standard perëndimor, ndërkohë ai ka arritur shifrën prej rreth 300 milionë banorësh (për krahasim, popullsia e përgjithshme e Bashkimit European është rreth 440 milionë, dhe në të prej vitesh shtresa e mesme e qytetarëve po tkurret me shpejtësi dhe po kthehet në të varfër, të cilët mbijetojnë nga muaji në muaj).

Megjithëse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi European do të kishin qenë prej kohësh të lumtur të hiqnin dorë nga produktet kineze në favor të atyre vendase, problemi se përse kjo nuk ndodhi është shumë i thjeshtë dhe është thjesht problem ekonomik ose i natyrës së tregut: produktet kineze janë të cilësisë së mjaftueshme dhe të lira, dhe prodhimi vendas është i pamjaftueshëm dhe më i shtrenjtë. Kthimi i investimeve nga Kina në Europë, e cila tanimë është e ngarkuar me probleme ekonomike, energjetike dhe sigurie (luftë në Lindje, çështje emigrantësh, probleme demografike), thjesht nuk është fitimprurëse për kompanitë e mëdha europiane. Fitimi është ai që drejton biznesin privat, kështu ka qenë dhe do të jetë gjithmonë.

Edhe pse shumë kompani amerikane janë larguar nga tregu kinez pas intensifikimit të konfliktit politik midis Uashingtonit dhe Pekinit vitet e fundit (në asnjë mënyrë të gjitha, duke përfshirë “Teslën” e bashkëpunëtorit të ngushtë të Trump-it, Elon Musk), duke u përpjekur të kompensojnë duke nisur nga prodhimi në Indi, Vietnam ose Filipine, nuk është sekret që shumë prej tyre do të preferonin të vazhdonin të operonin në Kinë, ku ka një treg shumë më të mirë të punës për një infrastrukturë më të mirë edukative. Kjo përkundër faktit se puna në vendet e

sipërpërmendura aziatike fqinje me Kinën është shumë më e lirë se te vetë Kina. Ata do ta bënin këtë, sapo Pekini të hiqte kufizimet administrative që kishte vendosur në përgjigje të atyre të vendosura nga SHBA-ja ndaj kompanive kineze atje, gjë që sigurisht nuk do të ndodhë, të paktën jo për një kohë të afërme.

Trump-i qëllon rreptësisht: “goditja bërthamore” ndaj neoliberalizmit dhe globalizmit

Edhe shumë kohë përpara zgjedhjeve amerikane në nëntor 2024, Donald Trump-i e bëri të ditur hapur se ishte një merkantilist. Merkantilistët (prirje kjo në teorinë ekonomike, që filloi në mesin e shekullit XVIII në Francë dhe u përhap shpejt te fuqitë e tjera koloniale) mbrojnë rritjen e ofertës së parasë në vend dhe parandalimin e daljes së pasurisë kombëtare përtej kufijve të vendit. Ata veçanërisht janë në favor të tregtisë, por ekskluzivisht për eksport. Ajo rrit pasurinë kombëtare, ndërsa merkantilistët përçmojnë importet, përveç rasteve kur është e nevojshme. I lidhur ngushtë me konceptin e merkantilizmit është *koncepti i proteksionizmit*, të cilin Trump-i e promovon hapur me veprimet e tij në kundërshtim me liberalizmin globalist.

Ndaj, lëvizjet e javës së kaluar të Trump-it nga 2 prilli, të cilën ai e quajti “Dita e çlirimit” të SHBA-së dhe që i referohet vendosjes së tarifave amerikane pothuajse në të gjitha vendet e botës (në shuma të ndryshme nominale), nuk duhet të kishin qenë të papritura, ndonëse ato perceptohen si të tilla po të shohim reagimet e pothuajse të gjithë shtetarëve botërorë që pasuan së shpejti. Ata, padyshim, ushqenin ende shpresën, se Trump-i mund të mos guxonte të kryente një “goditje bërthamore” ndaj neoliberalizmit dhe globalizimit, ose se ai, të paktën, do t’i minimizonte këto sulme, për shkak të përpjekjeve të emisarëve të shumtë nga e gjithë bota që mbërritën në Uashington javët e fundit, me qëllimin për ta bindur atë të përpiqet të gjejë një marrëveshje. Një tërmet ky, që nuk do të çonte në një tërmet tektonik në tregtinë globale.

Por ata gabuan rëndë! Trump-i nuk dëshiron asnjë marrëveshje: ai beson se Amerika “është grabitur” dhe “shfrytëzuar” nga vende të tjera për dekada të tëra, “është përdhunuar” nga tarifatat e tyre ndaj produkteve

amerikane, duke përfshirë, mbi të gjitha, ato miqësore me SHBA-në, si BE-ja apo Koreja e Jugut dhe Japonia.

Sido që të jetë, tarifat e reja amerikane tashmë shkaktuan bujë në tregjet botërore ditën e dytë pasi u shpallën, nga vetë SHBA-ja dhe Bashkimi European, përmes Kinës dhe Japonisë, në Australi. Tregjet e aksioneve po përfundonin plotësisht në të kuqe dhe brenda 15 minutash, aksionet humbën qindra miliona dollarë - nga industritë tek ato që lidhen me financat dhe shërbimet. Në të njëjtën kohë, ari në bursën e Çikagos, siç raportohet nga “Forbes”, arriti një nivel historik deri në 3200 dollarë për ons!

Stoqet europiane ranë ndjeshëm gjatë tregtimit të 3 prillit, me eksportuesin më të madh të mallrave, Gjermaninë, e goditur rëndë. Bursat europiane janë thujse tërësisht “të kuqe”, edhe pse Bashkimi European preket nga tarifatat e SHBA-së prej “vetëm” 20 për qindësh, që është sa gjysma e Kinës, ku arrijnë në 39 për qind dhe, në total, duke përfshirë edhe ato të prezantuara së fundmi, arrijnë në 54 për qind ndaj Kinës, ndaj Pekini po shpall kundërmasa të ashpra.

Nuk ka asgjë për t’u habitur, duke pasur parasysh se eksportet përbëjnë 20 për qind të të gjithë ekonomisë kineze dhe tregtia me Amerikën përbën rreth 15 për qind, që do të thotë se ndikimi i tarifave të Trump-it në Kinë do të jetë i madh dhe i gjerë. Ekspertët tashmë po parashikojnë se humbjet e vendeve të punës mund të jenë në miliona; kompanitë e vogla që përbëjnë zinxhirët kompleksë të furnizimit të Kinës mund të shemben dhe ka një probabilitet të lartë, që objektivi i rritjes së Kinës prej rreth 5 për qindësh të jetë i paarritshëm (*Geopolitika news*, 3 prill). Me fjalë të tjera, fillon lufta tregtare! Neoliberalizmi dhe globalizmi kanë vdekur dhe Trump-i u ka vënë kryq përgjithmonë që nga 2 prilli 2025.

Kush do të fitojë? Një takim i papritur në Seul

Se kush do ta fitojë këtë luftë, kjo është plotësisht e panjohur. Kina padyshim po përgatitej për të, edhe para se Trump-i të zgjidhej president i SHBA-së vjeshtën e kaluar. Disa analistë thonë se Pekini mund të bëjë atë që Trump-i i frikësohet gjithmonë më shumë: të zhvlerësojë monedhën e saj, juanin, dhe në këtë mënyrë të anulojë të gjitha tarifatat e

vendosura rishtazi. Sigurisht, jo gjithçka është kaq e thjeshtë: Kina gjithashtu tregton me vende të tjera dhe juani nuk i ka humbur ambiciet e tij për t'u bërë monedha e dytë rezervë globale, kështu që në këtë kuptim, zhvlerësimi i tij nuk është i dëshirueshëm. Në çdo rast, Pekini do të vendosë vetë se çfarë të bëjë.

Një nga ato vendime, krejtësisht të papritura dhe veçanërisht të dhimbshme për Shtetet e Bashkuara, ishte sigurisht ai për takimin e përbashkët të javës së kaluar në Seul të ministrave të tregtisë të Koresë së Jugut (e prekur gjithashtu shumë nga tarifat amerikane, duke pasur parasysh eksportin e madh të makinave të saj në tregun amerikan), Japonisë dhe Kinës, pra, rivalë të mprehtë gjeopolitikë rajonalë. Seuli dhe Tokioja janë partnerët kryesorë politikë dhe ushtarakë të Uashingtonit, por tani nuk u pëlqejnë lëvizjet e këtij të fundit, të cilat mund të ndikojnë seriozisht në pozicionin e tyre tashmë gjithnjë e më të vështirë ekonomik (kjo është veçanërisht e vërtetë për Japoninë) edhe pa tarifa të reja amerikane.

Kjo është arsyeja pse partneriteti me Pekinin përmes një “trekëndëshi tregtar” të ndërsjellë është shumë interesant për ta në situatën e re. Aq më tepër që këto vende, veçanërisht Koreja e Jugut, deri pak vite më parë dhe përpara presionit politik të SHBA-së për t'u larguar gradualisht nga Kina, kishin marrëdhëniet tregtare më të zhvilluara me këtë të fundit, ashtu si të gjithë të tjerët në Azi (përfshirë Australinë) dhe natyrisht, jo vetëm atje, por edhe në mbarë botën.

Trump-i mund të fitojë dhe të humbasë

Është shumë herët të thuhet se çfarë do të vijë nga e gjithë kjo. Nuk përjashtohet që Trump-i të arrijë përfundimisht atë që dëshiron, kryesisht me këto tarifa globale: të nënshkruajë marrëveshje të favorshme tregtare dypalëshe për SHBA-në me të gjitha vendet që i duan, pas së cilës tarifat e javës së kaluar ose do të hiqen, ose do të rregullohen, në varësi të shkallës së kënaqësisë amerikane me dokumentet e nënshkruara.

Deri atëherë, SHBA-ja, pas “ditës së çlirimit”, do të përballen me ditë, muaj e ndoshta vite të vështira lufte. Një numër i madh analistësh besojnë se recensionin në SHBA, pas kësaj lëvizjeje me tarifa globale, në vitin 2025 është i pandalshëm, pa përmendur rritjen e inflacionit.

Papunësia do të rritet gjithashtu, dhe sektorët financiarë dhe të shërbimeve mund të preken veçanërisht, ndërsa prodhimi industrial duhet të rritet (ai filloi të rritet edhe para masave të Shtëpisë së Bardhë të përmendura javën e kaluar).

Këto ditë është vënë re se si në SHBA, ashtu edhe në mbarë botën në përgjithësi, shitjet e makinave po rriten ndjeshëm, përpara se çmimet e tyre të rriten për shkak të tarifave të reja të Trump-it, si dhe tarifave prej 25 për qindësh, që ai vendosi së fundmi për importet e makinave të huaja. Këto shitje patjetër do të ngadalësohen së shpejti, kur të hyjnë në fuqi tarifat.

Prodhuesit amerikanë do të përballen gjithashtu me problemin e fuqisë punëtore shumë të shtrenjtë në SHBA, por ata do të jenë ende shumë të varur nga komponentët e importuar, kryesisht nga Kina, dhe çmimet e së cilave tani do të rriten në mënyrë drastike.

Ekipi i Trump-it, nga ana tjetër, nuk po llogarit në një efekt të shpejtë të masave të futura, por në një kohë afatgjatë padyshim që do të ndodhë. Megjithatë, problemi për Trump-in është se si t'i bindë qytetarët amerikanë, të cilët ai i siguroi para zgjedhjeve, se do ta “rriste përsëri Amerikën” menjëherë pas ardhjes në pushtet, për domosdoshmërinë e durimit për “një ose dy vjet” në emër të luftës së Amerikës për dominim me Kinën. Sepse amerikanët, tradicionalisht, janë shumë më të interesuar për gjendjen e kuletave të tyre, sesa për interesat e politikës së jashtme amerikane dhe luftën për dominim botëror.

E gjithë bota është në listën doganore, përveç Rusisë, Bjellorusisë dhe Koresë së Veriut!

Pra, që nga e mërkura e kaluar, e gjithë bota është mbuluar me tarifa të reja amerikane, përveç (interesant kjo), Rusisë, Bjellorusisë dhe Koresë së Veriut. Kur u pyet nga gazetarët se përse u vendosën tarifa të reja ndaj Ukrainës (10 për qind), por jo ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë, Sekretari i Thesarit i SHBA-së, Scott Bessent, deklaroi para kamerave televizive më 2 prill, se “Amerika nuk bën tregti me ta gjithësi”.

Edhe pse një përgjigje mjaft e përshtatshme për një pyetje të pakëndshme, unë do të thosha se gjërat janë pak më ndryshe, përveç faktit që SHBA-ja dhe Perëndimi në tërësi kanë vendosur tashmë çdo

sanksion të mundshëm të imagjinueshëm kundër Ruisë dhe kanë ndaluar tregtinë në një shkallë të madhe në krahasim me kohët e paraluftës, por Shtetet e Bashkuara nuk duan të shkatërrojnë atë që është strategjikisht thelbësore për ekonominë e tyre në krizën dhe pasigurinë aktuale. Kështu, ***uraniu i pasuruar rus vazhdon të mbërrijë në Amerikë, pavarësisht se lufta në Ukrainë vazhdon prej më shumë se tre vjetësh.*** Uashingtoni sigurisht që nuk dëshiron të vendosë tarifa ndaj uranimit rus, sepse nuk dëshiron të “shtjejë në këmbën e vet”, siç ka bërë tashmë BE-ja në lidhje me importin e produkteve ruse të energjisë.

Kjo, pra, nuk është një shprehje e “dashurisë” së Trump-it për Rusinë dhe Vladimir Putinin personalisht, por një tregues i qartë se si SHBA-ja po largohet nga problemet e saj ekonomike ashtu siç di të bëjë më mirë: duke grabitur të gjithë botën, ose më mirë vendet që mundet, dhe ku nuk mundet nuk e bën dot, sepse do të dëmtonte seriozisht interesat e saj strategjikë, ose e bën këtë në mënyrë të tepruar për të marrë një kundërpërgjigje.

Mjafton të kujtojmë se dhjetë ditë më parë, në një intervistë për NBC-në, Trump-i kërcënoi Moskën me tarifa të reja amerikane për naftën ruse prej 25 për qindësh, edhe për vendet që vazhdojnë ta blejnë atë, nëse nuk janë bashkëpunuese për arritjen e armëpushimit në Ukrainë. Që nga e mërkura e kaluar, Trump-i me sa duket i ka harruar këto tarifa ndaj Moskës.

Për më tepër, më 3 prill, i dërguari special i Putinit për investimet e huaja ruse, Kirill Dmitriev, mbërriti në Uashington për një vizitë. Ai është zyrtari i parë i lartë rus që viziton zyrtarisht SHBA-në që nga viti 2022, dhe rëndësia e vizitës së tij dëshmohet nga fakti, se Dimitriev u bë përjashtim dhe iu hoq ndalimi për dhënien e vizës për të hyrë në SHBA. Në momentin e shkrimit të kësaj analize, ai duhet të takohet me të dërguarin special të Trump-it për Lindjen e Mesme, Steve Witkoff, por me sa duket edhe për komunikim me Putinin, i cili vetë së fundmi u takua me liderin rus në Moskë.

Ftohja e “kokave të nxehta”

Krahas “harrimit” për momentin të sanksioneve të reja ndaj naftës ruse, Trumpi mund të harrojë shumë lehtë edhe vetë Ukrainën dhe të

fokusohehet tërësisht në “lodrën” e tij të re, tarifat kudo dhe ndaj të gjithëve. Kjo mund të jetë shumë e keqe për Kievin, pasi tema e tarifave do të mbizotërojë politikën botërore nga java e kaluar, por edhe për një kohë të gjatë. Për më tepër, ajo mund të ftojë shumë mirë të gjitha përpjekjet e “kokave të nxehta” nga Bashkimi European, për të vazhduar shpërndarjen e burimeve të mëdha financiare për të ndihmuar Ukrainën.

BE-ja tashmë i ka premtuar Kievit 20 miliardë dollarë këtë vit dhe ministrja e saj e Jashtme, Kaja Kallas, së fundmi u përpoq pa sukses të shtyjë një paketë të re prej 40 miliardë dollarësh për Kievin në vitin 2025, të cilën ajo as nuk u përpoq ta akordonte me ministrat e Jashtëm të vendeve kyç europiane, për çka ata ishin të zemëruar.

Me sa duket, për shkak të “solimit” në lëvizjet e saj drejt Moskës, ajo tashmë ka shkuar në favor të vetë Ursula von der Leyen, Presidentes së Komisionit European. Sepse me siguri “disa politikane të së ardhmes” nga Estonia nuk do t’i imponojnë rregullat e saj të lojës në të gjithë Bashkimin European dhe metropolet e tij kryesore. Kjo do të ishte shumë ambicioze edhe për ministrat nga vende shumë më të mëdha dhe më me ndikim të BE-së se Estonia. Kaja Kallas u emërua në këtë detyrë të rëndësishme në radhë të parë për të realizuar me bindje atë që kërkojnë prej saj personat kyç në zinxhirin vendimmarrës. Duhet të jetë ende shumë më e lehtë të kërkojë bindje nga “zyrtarët” nga shtetet e vogla anëtare, sesa nëse do të ishte, për shembull, për një drejtues të diplomacisë europiane, i cili, në këto kohë të trazuara do të vinte nga Franca, Gjermania apo Italia, vende që ende shqetësohen kryesisht për interesat e tyre kombëtarë në lidhje me politikën e përbashkëta.

Pra, supozoj se pas tarifave të fundit të Trump-it, dhe aq më tepër pas një reagimi të mundshëm të ashpër european që, nëse ndodh, do të shkaktonte patjetër një luftë tregtare midis dy anëve të Atlantikut, vështirë se do të ketë ndonjë interes shtesë nga anëtarët e BE-së për të hedhur paratë e tyre në një vend, fati i të cilit është ende plotësisht i pasigurt. Sidomos nëse Trump-i heq dorë fare nga Ukraina, pjesërisht për shkak të politikës europiane që këmbëngul për ndihmën ushtarake për vendin pothuajse deri në fitoren e tij (edhe pse ky term tani përdoret shumë rrallë), gjë që i bën negociatat e tij me Moskën më të vështira.

Europa në një pikë kthese vendimtare

Sipas “Bild”-it gjerman, më 3 prill tarifatat e reja amerikane “do t’i grabitin” Gjermanisë deri në 200 miliardë euro. Ursula von der Leyen, menjëherë pas lajmeve nga Uashingtoni, tha se tarifatat e Trump-it ishin një goditje e rëndë për tregtinë globale dhe kërcënuan një përgjigje të ashpër europiane dhe marrëveshje të mundshme tregtare me të gjitha vendet në botë, si përgjigje nëse nuk arrihej një marrëveshje me Uashingtonin.

Presidenti francez, Emmanuel Macron, më 3 prill u bëri thirrje të gjitha kompanive franceze që “të pezullojnë të gjitha investimet e tyre në SHBA, derisa situata të sqarohet”.

Ministri gjerman i Ekonomisë në largim, i cili nuk vendos më asgjë, Robert Habeck, bëri thirrje për unitet europian dhe një përgjigje të përbashkët, të ashpër ndaj SHBA-së etj., etj.

Të gjithë ata ende shpresojnë se ndoshta mund të ndodhë diçka, që do të parandalonte skenarin e pashmangshëm të proteksionizmit amerikan, i cili, përveç vendeve të vogla dhe të dobëta të botës, mund të mbyste seriozisht ekonominë europiane, e cila është pothuajse gjysma e madhësisë së asaj amerikane.

Në një përplasje tregtare mes SHBA-së dhe BE-së, kjo e fundit nuk ka asnjë shans dhe të gjithë e dinë shumë mirë këtë, prandaj emisarët e shumtë europianë që kanë bërë pelegrinazhe te Trump-i javët e fundit dhe dukshëm e kanë dashuruar, disa madje i ofrojnë atij një ulje të tarifave aktuale për produktet amerikane, siç është rasti me kryeministrin britanik, Keir Starmer, popullariteti i të cilit në Mbretërinë e Bashkuar tashmë po zbehet dhe po bie.

Popullariteti i Emmanuel Macron-it të lartpërmendur në Francë nuk është më i mirë dhe nuk ka gjasa të jetë më i mirë pas vendimit të javës së kaluar nga gjykata kompetente franceze kundër lideres së opozitës nga Tubimi Kombëtar i krahut të djathtë (RN), Marine Le Pen, politikanja më e njohur franceze dhe pretendentja më serioze për presidentin e ri në zgjedhjet e vendit më 2027. Le Pen u dënua të hënën në një gjyq të shkallës së parë për rastin e përvetësimit të parave europiane për të mirën

e partisë së saj, me një ndalim prej pesë vjetësh për të mbajtur postin, gjë që, siç janë punët tani (para një apeli të mundshëm), e pengon atë të kandidojë për presidente të Francës! Koha vështirë se mund të jetë në favor të Macron-it dhe liberalëve të tij nga “gjqësori i pavarur”, siç e quajti vetë Macron-i menjëherë pas vendimit. Por kjo është ende larg nga një zgjidhje ideale për liberalët francezë dhe europianë, të cilët e kanë gjithnjë e më të vështirë.

Për gjithçka, në fund të fundit, faji do t'i bie Trump-it

E vetmja gjë e mirë e gjithë kësaj për elitat liberale në pushtet në BE, është se ata do të jenë në gjendje të transferojnë fajin për të gjitha problemet ekonomike dhe sociale nga vetja dhe politikat e tyre të Trump-it, si dhe politikat e tij tarifore dhe proteksioniste. Disi e ngjashme me atë që ata kanë bërë për një kohë të gjatë, kur bëhet fjalë për Rusinë dhe pushtimin e saj në Ukrainë.

Në kushtet e rritjes së justifikueshme të frikës mes qytetarëve europianë për atë që do të sjellë e nesërmja, pak prej tyre do të përpiqen të gjejnë fajtorët brenda strukturave të kockëzuara europiane dhe elitave politike në Bruksel. Të njëjtët që, përveç ideologjisë, agjendës së gjelbër dhe ndërtimit të vazhdimit të luftës në Ukrainë, me shpresën se në fund do të tërheqin SHBA-në në të dhe, më pas, do të bashkojnë forcat për një fitore të re (siç ishte në Luftën e Dytë Botërore), paraqiten gjithmonë në publik si të aftë, por vetëm për të pozuar para aparateve fotografike dhe kamerave televizive.

Deri më tani ata e kanë çuar Europën vetëm nga një krizë në tjetrën, pa ditur të mendojnë strategjikisht dhe me pikëpamje largpamëse. Ata nuk ishin në gjendje të parandalonin ose trajtonin problemet e mëdha që kanë qenë dhe janë ende, duke e shtyrë Kontinentin e Vjetër në vitet e fundit nga migrimi i paligjshëm, te pandemia *Covid*, te pushtimi rus dhe kthimi i Trump-it në pushtet në SHBA.

Në vend të kësaj, ata ofruan rregullisht receta të gabuara për sëmundje të ndryshme, kështu që është e vështirë të besohet se kësaj radhe, në luftën kundër Amerikës së Trump-it do të jetë ndryshe. Ata mund të shpëtohen vetëm nga dështimi i Trump-it në skenën e brendshme

dhe kthimi eventual në pushtet i rrymave të mposhtura liberale dhe globaliste, gjë që nuk mund të përjashtohet.

Por të shpresosh gjithmonë për dikë dhe diçka, duke pretenduar se jeni politikanë të vendosur dhe të aftë, po bëhet jashtëzakonisht irrituese për qytetarët europianë që duan gjithnjë e më shumë gjak të freskët dhe politika të freskëta në strukturat qeveritare si në nivel kombëtar, ashtu edhe në selinë qendrore në Bruksel.

Megjithatë, pasi gjërat kanë nisur, vështirë se do të mirëpritën, gjë që vetëm sa do të thellojë zhgënjimet e tyre në rritje. [Përktheu: ISHGJ]

IV. GJEOEKONOMI

4.1 AKADEMIK ANASTAS ANGJELI

A mund të flitet për trampizëm në fushën ekonomike?

Në fushatën e tij elektorale, ish-presidenti Donald Trump e vendosi ekonominë amerikane në qendër të platformës së tij politike, duke synuar rritjen ekonomike përmes reformave të mëdha fiskale dhe strukturore. Kështu, me fitoren e zgjedhjeve të 5 nëntorit, Trump-i rikthehet në Shtëpinë e Bardhë si President i 47-të i SHBA-së, për të vazhduar realizimin e motos së tij: “Ta bëjmë Amerikën përsëri të madhe”. Programi ekonomik i Trump-it u fokusua kryesisht në uljen e taksave, çuarjen përpara të reformave rregullatore përmes lehtësimit të rregulloreve mbi bizneset dhe mbështetjen për industrinë amerikane, rritjen e tarifave për produktet kineze dhe europiane, në përpjekje për të nxitur investimet dhe krijimin e vendeve të punës brenda vendit. Ky program, edhe pse u prit me shumë debat, duke marrë mbështetje për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe kritika për rritjen e pabarazisë dhe ndikimin në deficitin kombëtar, ia doli. Të nesërmen e fitores, tregjet financiare reaguan pozitivisht. Më poshtë jepen argumentet e këtij reagimi pozitiv.

Bursat amerikane në rritje pas fitores së Trump-it

Janë disa faktorë të ndërlidhur, që kontribuan në rritjen e tregjeve të bursave amerikane pas zgjedhjes së Trump-it, të cilët nxitën besimin e investorëve dhe optimizmin për të ardhmen ekonomike të vendit. Disa nga këta faktorë përfshijnë:

- Nga një vështrim disi historikisht, një nga shtyllat kryesore të politikës ekonomike të Trump-it në 4-vjeçarin e parë të tij ishte Akti i Uljes së Taksave dhe Punësimit, i miratuar në fund të vitit 2017. Ky ligj uli taksën federale për korporatat nga 35% në 21% (ndërsa tashmë premton ta ulë nga 21% në 15%), duke shtuar fitimet e kompanive dhe kapitalin për investime të reja, çka u dha hov çmimeve të aksioneve. Kjo u përsërit edhe në fushatën e re

elektorale si një politikë e suksesshme, që ktheu në memorien e investitorëve periudhën e pasviteve 2017. Psikologjikisht, kjo shtyu investimet në tregjet e kapitaleve amerikane dhe në rritjen brenda një ditë me 6% *Bitcoin*-it.

- Reformat rregullatore përmes Liberalizimit të Rregulloreve mbi Bizneset ishte përsëri një element që u provua gjatë mandatit të parë dhe u përsërit si masë e vlefshme edhe për këtë mandat. Administrata “Trump” reduktoi ndjeshëm rregulloret mbi industri të ndryshme, sidomos në energji, financa dhe shëndetësi. Kjo u mundësoi kompanive më shumë fleksibilitet për të zgjeruar operacionet e tyre dhe për të rritur fitimet, duke çuar në rritje të vlerës së aksioneve të tyre. Të njëjtën gjë premtoi edhe në këtë fushatë dhe argumentoi që pasojat do të jenë të njëjta.

- Politika të Qëndrueshme të Normës së Ulët të Interesit ishte një premtim tjetër elektoral, që ishte karakteristikë për mandatin e parë të ish-presidentit dhe presidentit të ardhshëm. Rezerva Federale, megjithëse institucion i pavarur, vazhdoi politikën e normave të ulëta të interesit për të nxitur rritjen ekonomike. Kjo e bëri më të lirë dhe më të lehtë për kompanitë dhe konsumatorët marrjen e kredive, duke nxitur kështu investimet dhe shpenzimet. Në më pak se një javë nga fitorja e Trump-it, Banka Qendrore Amerikane uli përsëri normat e interesit me 0,25 pikë dhe pavarësisht se ishte diçka e pritshme, fakti që u bë pas zgjedhjeve favorizoi Presidentin Trump. Nëse reagimi i bursave ishte vetëm një sinjal për programin politik të Presidentit Trump, programi i tij ekonomik ishte më i gjerë dhe prekte të gjithë sektorët e ekonomisë si në aspektin makroekonomik, ashtu edhe në atë mikroekonomik.

Trampizimi në ekonomi dhe ndikimet në zhvillimet europiane

Një nga pikat më të forta të programit ekonomik të Presidentit Trump ishin investimet në infrastrukturë dhe mbështetja për industrinë vendëse. Premtimet për investime të mëdha në infrastrukturë dhe mbrojtja e industrive vendëse përmes tarifave mbi importet nga vende të ndryshme, veçanërisht Kina, i dhanë shpresa të reja industrisë amerikane dhe kompanive prodhuese, duke forcuar më tej optimizmin për zhvillimin

ekonomik. Ai premtoi një përmirësim të ekonomisë globale dhe se do të ndihmonte kompanitë amerikane që operonin ndërkombëtarisht pas vendosjes e paqes në botë, që të rrisnin dominimin e tyre. Kështu, kërkesa globale për mallra dhe shërbime do të rritet dhe kjo do të ndikonte pozitivisht në fitimet e korporatave dhe në vlerën e aksioneve të tyre.

Sipas Presidentit Trump, luftërat në proces dhe përfshirja e SHBA-së në konflikte të ndryshme ndikuan në mënyrë negative në ekonominë globale, kryesisht duke krijuar pasiguri dhe luhatje në tregjet financiare ndërkombëtare. Kjo politikë e paraardhësit të tij si me Ukrainën, ashtu edhe me Izraelin krijoi pasiguri politike dhe ekonomike, që ndikoi negativisht në tregjet globale, të cilat reagueshan ndjeshëm ndaj tensioneve gjeopolitike. Pasiguria bënte që investitorët të kalonin në asete më të sigurt, si ari apo bonot e thesarit, duke ndikuar në luhatje të tregjeve.

Një element tjetër i rëndësishëm, pasojë e luftërave, ishin kriza e çmimeve, inflacioni, çmimet e naftës dhe tregu i energjisë. Politikën dhe deklaratat e Trump-it mbi konfliktet, veçanërisht ato në Lindjen e Mesme, kishin ndikim të drejtpërdrejtë mbi çmimet e naftës. Ndryshimet në çmimet e energjisë ndikojnë ekonominë globale, pasi çmimet e larta të naftës përkthehen në kosto më të larta për transport dhe prodhim, duke rritur inflacionin.

Gjithashtu, deklaratat e Trump-it për një rishikim të marrëdhënieve dhe aleancave ndërkombëtare, veçanërisht me NATO-n dhe vendet e tjera të aleatëve, krijuan paqartësi në aspektin e stabilitetit ndërkombëtar. Këto deklarata nxitën shqetësime mes vendeve të tjera mbi qëndrueshmërinë e mbështetjes amerikane në rajone të ndjeshme, si Europa Lindore dhe Azia. Paqartësia në mbrojtjen e këtyre rajoneve krijoi tensione, që mund të ndikonin në tregti dhe investime ndërkombëtare. Në fakt, siç ai shpjegoi në intervistat pas fitores, politika amerikane ndërkombëtare do të jetë funksionale, por me financime më të barabarta të të gjithë partnerëve në funksion të sigurisë që NATO-ja ofron për të gjithë anëtarët e saj. Partnerët europianë duhet të kontribuojnë më shumë në buxhetin e NATO-s. Deklaratat dhe veprimet e Trump-it gjatë fushatës shpesh përqendroheshin në parimin “Amerika e para”, duke mbështetur nacionalizmin ekonomik dhe duke larguar vëmendjen nga angazhimet

ndërkombëtare. Kjo qasje nënkuptonte një përqendrim më të madh në prodhimin dhe punësimin amerikan, duke krijuar tensione tregtare me vende të tjera dhe duke kufizuar tregtinë ndërkombëtare në disa sektorë.

Politikat ekonomike të ish-Presidentit Trump, sidomos ato që u përqendruan tek “Amerika e para” dhe tarifat tregtare, patën perceptime penalizuese për ekonominë europiane. Ja disa elemente se si Europa mund të ndikohet nga këto politika:

- Trump-i shpesh kërkoi në të kaluarën, por ka evidentuar si taksative në programin e tij aktual ekonomik, faktin që vendet e NATO-s, kryesisht ato europiane, të rrisnin ndjeshëm shpenzimet e tyre për mbrojtjen. Kjo u bë një çështje shumë e diskutueshme për nivelin e rritjes së shpenzimeve dhe europianët kanë frikë se kjo do të çonte në rritje të shpenzimeve ushtarake nga ana e Europës, duke shkurtuar burimet e disponueshme për sektorët e tjerë të ekonomisë. Në programet europiane ka një rritje të ndjeshme për buxhetet e mbrojtjes, por një rritje e mëtejshme do të ndikonte si në inflacionin, ashtu dhe në pakësimin e fondeve të politikave të zhvillimit ekonomik të vendeve anëtare, si *Next Generation EU* etj.

- Trump-i vendosi gjatë mandatit të parë tarifa mbi një sërë produktesh të importuara nga Europa, përfshirë çelikun dhe aluminin, me qëllim mbrojtjen e industrive amerikane. Këto tarifa ndikuan te prodhuesit europianë, duke e bërë më të kushtueshëm eksportin e mallrave në SHBA dhe duke rritur kostot për konsumatorët amerikanë që blinin produkte nga Europa. Për më tepër, vendet europiane u detyruan të vendosnin tarifa reciproke mbi mallrat amerikane, gjë që ndikoi negativisht në tregtinë ndëratlantike. Në programin ekonomik të këtij mandati, administrata “Trump” parashikon të vendosë tarifa doganore për industrinë ushqimore, produktet e modës dhe industrinë e makinave të prodhuara nga vendet europiane, që të ruajë prodhuesit vendas. Vendet që mund të kenë pasojë në këtë drejtim janë kryesisht Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Gjermania. “Do të ketë pasoja për Europën!” - thotë analisti Garret Martin nga Universiteti Amerikan në Uashington.

- Politikat proteksioniste dhe lëkundja e përkrahjes për organizata ndërkombëtare si OBT, nga Trump-i krijuan pasiguri në marrëdhëniet ekonomike mes SHBA-së dhe shumë vendeve të tjera dhe Europës. Kjo bëri që shumë kompani europiane të ngrinin investimet e tyre ose të rivlerësonin strategjitë e tyre për tregun amerikan. Shumë janë në pritje për t'i parë konkretisht këto masa dhe zbatimin e tyre.

- Trump-i synon të nxisë më tej eksportet amerikane të gazit natyror të lëngshëm (LNG) në Europë, si një alternativë për të reduktuar varësinë nga gazi rus. Megjithëse kjo shtoi diversifikimin e burimeve të energjisë për Europën, gazi amerikan shpesh rezultoi më i shtrenjtë se ai rus. Për më tepër, presioni për të pranuar më shumë LNG nga SHBA-ja krijoi tensione mes disa vendeve europiane, që tradicionalisht kishin marrëveshje afatgjata me Rusinë dhe që gjetën zgjidhje në disa vende afrikane dhe të Lindjes së Mesme.

Raportet e administratës “Trump” me Kinën dhe Azinë Jugore

Një vend të veçantë në politikën ekonomike të presidencës së re zë lufta tregtare me Kinën dhe ndikimi në zinxhirët e furnizimit në ekonominë globale. Tarifat dhe kufizimet mbi mallrat kineze parashikohet të ndikojnë te kostot e prodhimit për kompanitë, duke i bërë produktet e tyre më të shtrenjta dhe më pak konkurruese në tregjet ndërkombëtare.

Gjatë fushatës zgjedhore, Trump-i premtoi tarifa 60% për mallrat e konsumit kinez. Nëse do ta realizojë premtimin elektoral e tij, Kina, me rreth 500 miliardë dollarë eksporte në Shtetet e Bashkuara (15% e totalit), do ta gjente veten përballë një sfide komplekse dhe shumë të ndërlikuar për ta zgjidhur. Për të kuptuar sa të vështirë e ka Kina një takës të tillë doganore, mjafton të bëjmë një krahasim me atë që ndodhi në vitet 2018-2019, kur agjenda proteksioniste e liderit republikan mori formën e tarifave, që varionin nga 7,5% në 25% për 370 miliardë dollarë mallra të prodhuara në Kinë.

Këtë herë, përveçse shumës, që është më e madhe dhe tarifave, që janë dyfishi i të kaluarave, duhet marrë në konsideratë që edhe ekonomia

kineze nuk është më si ajo e vitit 2018. Në atë kohë, një e katërta e PBB-së së Kinës bazohej rreth sektorit të pasurive të paluajtshme. Sot, pronat e paluajtshme në Kinë janë në një krizë të thellë dhe nuk do të jenë në gjendje të ndihmojnë atë vend të absorbojë ndikimin e një lufte të regtare. Jo vetëm kaq. Kriza e pasurive të paluajtshme ka ngarkuar administratat vendore me borxhe të destinuara për të reduktuar në masë të madhe arsenalin fiskal që mund të përdoret për të zbutur goditjet e jashtme. Shkurtimisht, kërkesa e brendshme që mbetet e dobët, me konsum familjar nën 40% të PBB-së, rreth 20 pikë më pak se mesatarja botërore, e rrezikojnë shumë Kinën nga tarifat për mallrat e eksportuara në SHBA. Në këto kushte edhe levat ekonomike të institucioneve kineze për të stimuluar kërkesën e brendshme apo për të zhvlerësuar juanin me rreth 18%, që sipas disa vlerësimeve do të bënte të mundur kompensimin e 60% të detyrimeve doganore të shoqërive që eksportojnë në Shtetet e Bashkuara, mbeten utopike.

“Kina, - shpjegon Alicia Garcia Herrero, kryekonomistja e Azisë së Paqësorit në “Natixis Bank”, - në fakt nuk mund t’u përgjigjet tarifave doganore të këtyre përmasave. Ajo që mund të bëjë është të shpallë stimuj të rinj në ekonomi, në mënyrë që tregjet të mos e penalizojnë”. Nga ana tjetër, duhet të marrë masa kundërvepruese për shoqëritë amerikane në Kinë. Për shembull, duke vendosur tarifa në sektorin agro-ushqimor (në sajë të marrëdhënieve solide tregtare me Brazilin), ajo do të synojë të penalizojë kompanitë amerikane me interesa të fortë kinezë dhe duke vendosur kufizime në eksportin e lëndëve të para thelbësore. Kjo ndodhi vitin e kaluar me galiumin dhe germaniumin, dy metale të përdorura në sektorët e mbrojtjes, komunikimit dhe gjysmëpërçuesve.

Donald Trump-i nuk është vetëm autori i “Artit të rikthimit”, por edhe i “Artit të marrëveshjes”, por gjithashtu ekziston mundësia që kërcënimet ndaj Pekinit të shërbejnë për të hapur një negociatë, konturet e të cilit janë ende të paqarta dhe të përcaktuara. Sigurisht që këto do të rifusin në lojë edhe problemet gjeopolitike të interesave amerikanë në Tajvan, Filipine, Vietnam etj. Në këtë drejtim, emri i parë që të vjen ndër mend është Tajvani (një vend që “duhet të na paguajë për t’u mbrojtur”, -tha Trump-i verën e kaluar), por jo vetëm kaq. Japonia, Vietnami dhe Filipinet gjithashtu e gjejnë veten në “pozitën e sikletshme” për të pasur

mosmarrëveshje territoriale me Kinën. Nuk duhet të harrojmë se gjatë Presidencës së parë, Trump-i krijoi për herë të parë raporte zyrtare me diktatorin koreano-verior, Kim Jongun, elementi kryesor i destabilitetit në rajon. Është shumë vështirë të parashikohen hapat konkretë të tij në këtë rajon.

Në Azinë Jugore, kthimi i Trump-it duhet të jetë më shumë lajm i mirë për Indinë sesa për Pakistanin. Nju Delhi ka qenë kundërpesha kryesore politike dhe ushtarake ndaj Pekinit për vite me radhë dhe në të kaluarën midis Presidentit të ardhshëm të SHBA-së dhe kryeministrit indian, Narendra Modi, ka pasur ulje-ngritje të karakterit koniunktural ekonomik. Fakti është që gjithmonë kanë gjetur një kompromis interesant midis tyre.

Cili është vlerësimi i specialistëve ekonomikë të Presidentit Trump?

Specialistët dhe analistët ekonomikë kanë mendime të ndryshme rreth politikave ekonomike të Trump-it, veçanërisht në lidhje me qasjen proteksioniste dhe përqendrimin te parimi “Amerika e para”.

Disa ekonomistë e shohin uljen e taksave si një hap pozitiv, që ndihmoi kompanitë amerikane të rrisin fitimet dhe të krijojnë vende pune. Këto politika, sipas tyre, do të përmirësojnë konkurrueshmërinë e kompanive amerikane dhe do të inkurajojnë investimet vendase. Por kritikët theksojnë se përfitimet e këtyre politikave do të ndihen kryesisht nga korporatat dhe më pak nga shtresat e mesme dhe të ulëta të popullsisë.

Shumë specialistë shprehen të shqetësuar për rritjen e borxhit federal, që do të pasojë uljet e mëdha të taksave dhe rritjen e shpenzimeve. Sipas disa ekonomistëve, kjo qasje mund të ketë ndikime afatgjata negative, duke kufizuar aftësinë e SHBA-së për të përballuar kriza të ardhshme ekonomike.

Shumica e ekspertëve që kritikuan tarifat tregtare dhe luftën tregtare me Kinën në mandatin e parë, janë të mendimit se proteksionizmi pengon tregtinë e lirë dhe rrit çmimet për konsumatorët. Lufta tregtare në mandatin e parë jo vetëm që preku ekonomitë e tjera, si ato europiane dhe aziatike, por ndikoi edhe te konsumatorët amerikanë, duke rritur çmimet për mallrat e importuara. Specialistët theksojnë se tarifa dhe

kufizime të tilla ndikuan negativisht edhe në zinxhirët globalë të furnizimit, duke krijuar një ambient të pasigurt për bizneset ndërkombëtare. Politikat e Trump-it, sipas disa analistëve, do të përforcojnë pabarazinë ekonomike në SHBA. Nga uljet e taksave për korporatat dhe individët me të ardhura të larta do të përfitonin kryesisht shtresat e pasura, duke rritur diferencat ekonomike mes shtresave të ndryshme të shoqërisë. Kjo situatë, sipas tyre, krijon një problem social dhe ekonomik afatgjatë, pasi rritja e pabarazisë mund të dobësojë konsumin dhe të ndikojë negativisht rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Disa specialistë janë të mendimit se politikat ekonomike të Trump-it do të sjellin përfitime afatshkurtra për disa sektorë të ekonomisë amerikane, por gjithashtu mund të krijojnë pasiguri dhe tensione në ekonominë globale. Parashikimet për ciklet ekonomike gjatë këtij mandati të Donald Trump-it do të varen nga faktorë të ndryshëm, përfshirë politikën e brendshme, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe situatën ekonomike globale.

Në përfundim, politikat ekonomike të Presidentit Donald Trump mbeten një temë komplekse dhe shpesh e debatueshme, me ndikime të thella si në ekonominë amerikane, ashtu edhe në atë globale. Mendohet se mandati i dytë i Trump-it do të sjellë mundësi për rritje ekonomike, duke e bërë të domosdoshme një balancë të kujdesshme, për të siguruar një ekonomi të qëndrueshme dhe bashkëpunim ndërkombëtar të fortë. Për Europën dhe pjesën tjetër të botës, politikat e tij do të vazhdojnë të ndikojnë në tregjet globale dhe do të kërkojnë një përgjigje strategjike për të mbrojtur interesat ekonomikë dhe stabilitetin afatgjatë, në radhë të parë të Amerikës.

4.2 DR. DRITA SHAQIRI

Ndikimi i luftës hibride në sentimentet ekonomike - investitorët në Kosovë

Hyrje

Lufta hibride është një formë e konfliktit modern që kombinon mjete ushtarake, politike, ekonomike dhe propagandistike për të ndikuar dhe destabilizuar shtete dhe rajone. Ajo shpesh shfrytëzon pasigurinë, dezinformimin, sulmet kibernetike dhe presionin ekonomik për të arritur objektiva strategjike pa përdorimin e drejtpërdrejtë të forcës ushtarake. Në një mjedis ku stabiliteti politik dhe ekonomik është thelbësor për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm, ndikimi i luftës hibride mbi perceptimet ekonomike dhe investimet bëhet një çështje kritike.

Në rastin e Kosovës, si një ekonomi në zhvillim, sentimentet ekonomike të investitorëve ndikohen ndjeshëm nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Investitorët si vendas, ashtu edhe të huaj, marrin vendime të bazuara jo vetëm në indikatorët tradicionalë ekonomikë, si normat e interesit, inflacioni apo infrastruktura ligjore, por edhe në perceptimin e sigurisë dhe stabilitetit të një vendi. Përhapja e dezinformimit, tensionet politike rajonale, ndërhyrjet kibernetike dhe presionet ekonomike mund të krijojnë pasiguri të lartë, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi vendimmarrjen e investitorëve.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e luftës hibride në perceptimet ekonomike dhe në vendimet e investitorëve në Kosovë. Përmes një qasjeje teorike dhe empirike, do të shqyrtohet se si dezinformimi, presionet politike dhe faktorët e tjerë të luftës hibride ndikojnë në mjedisin e investimeve. Pyetjet kryesore kërkimore, të cilat do të trajtohen në këtë studim janë:

- Si ndikon lufta hibride në perceptimin ekonomik të Kosovës?
- Cilat janë pasojat kryesore mbi vendimet e investitorëve?
- Çfarë strategjish mund të përdoren për të ulur efektet negative të luftës hibride në ekonomi?

Nëpërmjet analizës së hollësishme të literaturës ekzistuese dhe të dhënave empirike, ky studim synon të ndriçojë mënyrat se si strategjitë hibride të përdorura në Ballkan, mund të ndikojnë në stabilitetin ekonomik të Kosovës dhe çfarë masash mund të merren për të ruajtur një klimë të favorshme investimi.

Lufta hibride dhe ndikimi i saj ekonomik

Lufta hibride është koncept që përshkruan përdorimin e mjeteve të shumta jokonvencionale për të ndikuar dhe destabilizuar një shtet ose rajon, duke përfshirë dezinformimin, presionin ekonomik, sulmet kibernetike dhe manipulimin e tregjeve financiare (NATO, 2021)¹. Kjo formë e luftës është veçanërisht e rrezikshme për shtetet me institucione të brishta dhe ekonomi të vogla si Kosova, ku stabiliteti ekonomik mund të ndikohet ndjeshëm nga pasiguria politike dhe propagandat e jashtme.

Strategjitë më të përdorura të luftës hibride në raport me Kosovën janë shpërndarja e dezinformatave dhe krijimi i perceptimit të një lufte të afërt me Serbinë. Në periudha të caktuara, sidomos në momente të tensionuara politike, në mediet rajonale dhe ndërkombëtare qarkullojnë lajme të rreme, që paralajmërojnë një konflikt të mundshëm midis Kosovës dhe Serbisë, duke krijuar frikë dhe pasiguri te qytetarët dhe investorët (EU vs Disinfo, 2022)². Këto dezinformata përfshijnë pretendime për lëvizje ushtarake, rritje të tensioneve ndëretnike dhe ndërhyrje të fuqive të huaja, duke ndikuar drejtpërdrejt në tregjet financiare dhe në vendimet e investorëve. Për shembull, në disa periudha krize, si gjatë vendosjes së reciprocitetit për targarat e makinave apo tensioneve në Veriun e Kosovës, është vërejtur një rënie e drejtpërdrejtë e investimeve dhe një tërheqje e kapitalit të huaj nga vendi. Në gusht 2022, pas një vale dezinformatash, që parashikonin "fillimin e një konflikti të armatosur", pati një ndikim të drejtpërdrejtë në tregun e këmbimit valutor dhe në transaksionet financiare, duke shkaktuar panik te bizneset dhe investorët (World Bank, 2023)³.

Sulmet kibernetike dhe lufta ekonomike janë gjithashtu elemente kyç të luftës hibride, që ndikojnë ekonominë e një vendi. Në vitet e fundit, Kosova është përballur me sulme kibernetike të sponsorizuara nga shtete të huaja, të cilat kanë synuar institucionet financiare, platformat tregtare

dhe sistemet e pagesave online (*Kosovo Cybersecurity Report*, 2023)⁴. Këto sulme jo vetëm që kanë krijuar humbje financiare, por kanë dëmtuar edhe besimin e investitorëve në sigurinë e tregut të Kosovës. Një ekonomi e ekspozuar ndaj sulmeve kibernetike dhe pa strategji mbrojtëse të mjaftueshme, mund të shihet si e paqëndrueshme për investitorët, duke reduktuar interesin për investime afatgjata në vend.

Presioni ekonomik dhe ndërhyrjet politike në tregjet financiare përbëjnë një tjetër dimension të rëndësishëm të luftës hibride. Një shtet mund të përballet me bllokada tregtare të imponuara nga aktorë të jashtëm, kufizime të financimit ndërkombëtar ose masa sanksionesh të fshehta, që ndikojnë në aftësinë për të tërhequr investime. Për shembull, tensionet politike në rajon shpesh kanë çuar në vendosjen e barrierave tregtare të njëanshme, duke ndikuar drejtpërdrejt në sektorët e prodhimit dhe eksportit (IMF, 2021)⁵. Këto ndërhyrje ndikojnë sidomos te vendet me ekonomi të vogla, si Kosova, ku qasja në tregjet ndërkombëtare dhe besimi i investitorëve janë vendimtare për rritjen ekonomike.

Përmbledhtazi, lufta hibride nuk është vetëm një fenomen ushtarak apo politik, por ka pasoja të drejtpërdrejta në stabilitetin ekonomik të një vendi. Përmes dezinformimit, sulmeve kibernetike dhe presionit ekonomik, aktorët e huaj mund të krijojnë një klimë pasigurie, që ndikon negativisht në sjelljen e investitorëve dhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo e bën të domosdoshme hartimin e politikave mbrojtëse dhe forcimin e institucioneve për të ruajtur një mjedis të qëndrueshëm për investimet dhe zhvillimin ekonomik.

Sentimentet ekonomike dhe vendimet e investitorëve

Sentimentet ekonomike përfaqësojnë perceptimet dhe pritshmëritë e aktorëve të tregut mbi situatën ekonomike të një vendi, duke ndikuar drejtpërdrejt në vendimet e konsumatorëve, bizneseve dhe investitorëve. Në mjedise të pasigurta, si ato të ndikuara nga lufta hibride, sentimentet ekonomike janë shpesh më të luhatshme, duke reflektuar frikën për stabilitetin ekonomik dhe politik. Matja e këtyre perceptimeve realizohet përmes disa indikatorëve, si Indeksi i Besimit të Konsumatorit, Indeksi i Besimit të Biznesit, luhatjet në tregjet financiare dhe raportet mbi klimën e investimeve. Në Kosovë, sentimentet ekonomike janë veçanërisht të

ndjeshme ndaj zhvillimeve politike dhe ndikimeve të jashtme, duke përfshirë raportet me Serbinë, stabilitetin e qeverisë dhe politikat e investimeve të huaja. Çdo lajm për tensione politike ose rrezik të destabilizimit ndikon drejtpërdrejt në pritshmëritë e tregut dhe në flukset e investimeve.

Investitorët, qofshin ata të huaj apo vendas, janë të ndikuar nga një sërë faktorësh kur vlerësojnë stabilitetin ekonomik dhe potencialin e fitimit në një vend të caktuar. Në mjedise të pasigurta, stabiliteti politik dhe siguria ligjore luajnë një rol vendimtar në vendimmarrjen e investitorëve, pasi një qeverisje e qëndrueshme dhe një kornizë e qartë ligjore krijojnë ambient më të besueshëm për investime. Ndërkohë, rreziku i konflikteve dhe i tensioneve politike është faktor tjetër, që ndikon në perceptimin e investitorëve mbi Kosovën, ku zhvillimet rajonale dhe raportet me Serbinë janë elemente kyç në analizën e rrezikut. Lufta hibride ndikon gjithashtu përmes shpërndarjes së dezinformatave ekonomike, të cilat krijojnë panik dhe pasiguri në treg, duke ndikuar në sjelljen e investitorëve dhe në vendimet e tyre mbi zgjerimin apo tërheqjen e kapitalit. Përhapja e lajmeve të rreme mbi një krizë të mundshme financiare, një konflikt të afërt apo ndryshime të befasishme në politikën fiskale, është mjet i fuqishëm i luftës hibride, që shpesh shfrytëzohet për të ndikuar në tregjet financiare dhe në stabilitetin ekonomik. Investitorët i ndjekin nga afër këto zhvillime dhe shpeshherë reagojnë duke pezulluar investimet, duke tërhequr kapitalin ose duke ndryshuar strategjitë e tyre të biznesit. Përveç dezinformimit, investitorët ndikohen edhe nga faktorë, si infrastruktura dhe klima e biznesit, ku përmirësimet në sektorët strategjikë mund të krijojnë një ambient më të favorshëm për investime. Ndërkohë, politikat e Bashkimit Europian dhe të Shteteve të Bashkuara për Kosovën luajnë rol të rëndësishëm në orientimin e tregut dhe në ndërtimin e një ambienti të sigurt për investime afatgjata. Lufta hibride krijon një ambient të paqëndrueshëm, që ndikon drejtpërdrejt në sjelljen e investitorëve, duke ulur investimet afatgjata, duke shkaktuar tërheqjen e investitorëve ekzistues dhe duke rritur kostot e huamarrjes dhe të sigurimeve. Pasiguria politike dhe rreziku i luftës hibride shpesh çojnë në rritjen e normave të interesit për kreditë, pasi bankat dhe institucionet financiare i perceptojnë investimet

në një mjedis të pasigurt si më të rrezikshme. Ndikimi i këtyre faktorëve është i dukshëm në Kosovë, ku përhapja e lajmeve të rreme për një konflikt të afërt me Serbinë, sulmet kibernetike ndaj infrastrukturës shtetërore dhe pasiguria mbi të ardhmen e marrëdhënieve me Bashkimin Europian ndikojnë në perceptimin e stabilitetit të vendit. Për të mbrojtur interesin e investitorëve dhe për të rritur besimin në treg, nevojiten politika të qarta të menaxhimit të krizave, përmirësim i sigurisë kibernetike dhe transparencë më e madhe në komunikimin qeveritar mbi situatën ekonomike.

Rasti i Kosovës: analizë empirike

Lufta hibride dhe pasiguria politike kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në perceptimet e bizneseve dhe investitorëve në Kosovë, duke krijuar ambient të luhatshëm për zhvillimin ekonomik. Një analizë e opinionit të bizneseve tregon se një pjesë e madhe e operatorëve ekonomikë e konsiderojnë pasigurinë politike si faktorë kryesorë që ndikon në zgjerimin e investimeve dhe në stabilitetin e tyre financiar. Bizneset që operojnë në sektorët strategjikë, si industria e prodhimit dhe sektori i ndërtimit, shpesh raportojnë vonesa në projektet e tyre, për shkak të pasigurive të krijuara nga tensionet politike dhe presioni i jashtëm ekonomik. Në një mjedis, ku narrativat e luftës përdoren si mjet për të destabilizuar perceptimet ekonomike, dezinformimi luan rol kritik në vendimmarrjen e investitorëve. Raportet tregojnë se në periudha kur diskursi i luftës është më i lartë, ka pasur rënie të drejtpërdrejtë të interesit për më tepër investime; presioni politik nga aktorët e jashtëm ka ndikuar në perceptimin e stabilitetit të Kosovës, duke krijuar pasiguri mbi të ardhmen e saj ekonomike. Këto sfida bëjnë që investitorët të aplikojnë strategji të ndryshme për të përballuar rreziqet e luftës hibride, ku disa prej tyre zgjedhin të diversifikojnë investimet në rajone më të qëndrueshme, ndërsa të tjerë përdorin masa mbrojtëse, si sigurimet financiare, për të mbuluar rreziqet e mundshme.

Rekomandime

Analiza e zhvilluar tregon se pasiguria politike dhe ekonomike, e nxitur nga dezinformimi dhe presioni politik, ka ndikuar në ngadalësimin

e investimeve dhe në pasigurinë e tregut. Për të përmirësuar këtë situatë, nevojiten masa të qarta, që synojnë rritjen e besimit të investitorëve dhe forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Këto masa përfshijnë përmirësimin e transparencës institucionale, luftimin e dezinformimit nëpërmjet politikave të forta të komunikimit publik dhe sigurimin e një ambienti ligjor, që mbrojnë investitorët nga rreziqet e paqëndrueshmërisë. Për politikëbërësit dhe institucionet ekonomike rekomandohet hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse, që synon forcimin e infrastrukturës së sigurisë kibernetike, promovimin e një klime të qëndrueshme investimi dhe rritjen e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar mbështetje në fushën e stabilitetit ekonomik. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa konkretë për të krijuar mekanizma të mbikëqyrjes së lajmeve të rreme dhe për të luftuar narrativat destabilizuese, të cilat ndikojnë në perceptimet ekonomike dhe në vendimmarrjen e investitorëve.

Referenca

1. NATO (2021). *Hybrid Warfare: A Growing Threat to Global Security*. Retrieved from <https://www.nato.int>
2. EU vs Disinfo. (2022). *The Impact of Economic Disinformation on European Markets*. Retrieved from <https://www.euvdisinfo.eu>
3. World Bank. (2023). *Economic Impact of Political Instability in the Western Balkans*. Retrieved from <https://www.worldbank.org>.
4. Kosovo Cybersecurity Report. (2023). *State of Cybersecurity in Kosovo: Threats and Challenges*. Retrieved from <https://www.kosovocybersecurity.org>.
5. International Monetary Fund (IMF) (2021). *Trade Barriers and Economic Stability in Small States*. Retrieved from <https://www.imf.org>.
6. OECD (2022). *Economic Confidence Index Report*. <https://www.oecd.org>
7. World Bank. (2021). *Global Investment Trends and Economic Stability*. <https://www.worldbank.org>.

8. *European Bank for Reconstruction and Development* (2023). Investment Climate in Kosovo. <https://www.ebrd.com>.
9. International Monetary Fund (IMF). (2022). Political Risk and Economic Stability in Small Countries. <https://www.imf.org>.
10. *EU External Action* (2023). Kosovo and Regional Stability: Economic Perspectives. <https://www.europa.eu>.
11. EU DisinfoLab (2022). The Role of Disinformation in Economic Destabilization. <https://www.disinfo.eu>.
12. *World Economic Forum* (2021). The Impact of Political Uncertainty on Business Investments. <https://www.weforum.org>
13. *European Commission* (2023). Western Balkans Economic Development Report. <https://www.ec.europa.eu>.

V. HISTORI

5.1 AKADEMIK PËLLUMB XHUFI

Shqipëria e nëntorit 1912

Ngjarjet që kulmuan me shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, u zhvilluan në kushtet kur në gjirin e shoqërisë shqiptare kishin ndodhur zhvendosje të mëdha dhe kur në vend të parisë së vjetër feudale e turkoshake, të komprometuar rëndë me regjimin osman, një shtresë e re, e përfaqësuar nga intelektualë me ide liberale e socialdemokrate, kishte dalë në skenën e historisë me ambicien për të udhëhequr popullin shqiptar në luftërat për liri e për shtet kombëtar.

Të frymëzuar nga idetë e Iluminizmit francez e të *Risorgimentos* italiane, ideologë e veprimtarë të lëvizjes kombëtare shqiptare e shihnin ndarjen nga “regjimi i vjetër” si një domosdoshmëri historike, që nëpërmjet një revolucioni kombëtar e social, bashkë me sundimin osman, do të flakte tej edhe gjithëpushtetin e “oxhaqeve” shqiptare, klasat e vjetra të bejlerëve, pashallarëve, krerëve fisnorë e klerikëve të lartë, bashkëpunëtorë dhe bashkësundues të sunduesit të huaj.

Një analizë të grupeve shoqërore dhe të sjelljes së tyre kundrejt çështjes kombëtare në Shqipërinë në prag të pavarësisë, e bën në mënyrë mjeshtërore në raportin e tij të 5 shkurtit 1912 konsulli austro-hungarez në Janinë, Belinski. Në njërën anë Belinski rreshton përfaqësuesit e aristokracisë së bejlerëve, të pashallarëve dhe të bajraktarëve, të cilët sipas tij ishin njësuar me klasën sunduese osmane. Këtu Belinski përfshin personazhe, si Ferid pashë Vlorën, Myfid bej Libohovën, Esat pashë Toptanin e të tjerë. Në krahun tjetër, sipas tij, qëndronin patriotët e vërtetë shqiptarë, të cilët, sipas Belinskit, i përkisnin shtresës së mesme të mësuesve të shkollave shqipe, botuesve të gazetave, sekretarëve të klubeve, nëpunësve dhe oficerëve shqiptarë.

Ishin këta që kishin bërë Rilindjen Kombëtare, që kishin përhapur arsimin në gjuhën shqipe, që kishin forcuar ndërgjegjen kombëtare, që kishin ndërgjegjësuar qarqet europiane për ekzistencën e kombit e të çështjes kombëtare shqiptare dhe që kishin përgatitur e drejtuar betejat e

armatosura për liri e pavarësi të çetave të armatosura patriotike. Në analizën e tij të shoqërisë shqiptare në prag të Pavarësisë, Belinski nuk harron të dallojë edhe një grupim të parisë feudale, që e parandjeu se me rënien e Perandorisë do të humbte pushtetin, prestigjin dhe privilegjet e vjetra, ndaj dhe iu bashkua, në çastin e fundit, lëvizjes kombëtare.

Këta nuk shihnin mundësi tjetër, veç asaj të përfshirjes në lëvizjen për pavarësi, për të mundur të luanin edhe më tej një rol udhëheqës në jetën politike të vendit. “Megjithatë, - e mbyll analizën e tij konsulli Belinski, - lëvizja e çetave toske vitin e kaluar u organizua krejtësisht prej shtresës së mesme të intelektualëve patriotë. Bejlerët nuk morën pjesë fare në këtë aksion...”.

Ndonjëri prej këtyre bejlerëve, si Mehmet Ali Pasha i Delvinës, deputeti Mufid bej Libohova e ndonjë tjetër, u detyruan në ndonjë rast t’u jepnin çetave ndihma në të holla, por këtë e bënë nën presionin e elementëve radikalë të lëvizjes së armatosur, të cilët kërcënonin se do të ndërmerrnin akte terroriste kundër tyre, në rast se nuk bashkëpunonin. Siç treguan faktet, në përgjithësi, shtresa e vjetër e bejlerëve, e pashallarëve, e krerëve dhe bajraktarëve, i qëndroi deri në fund besnike Perandorisë Osmane dhe, akoma më keq, filloi të flirtojë me monarkitë fqinje, pikërisht me ato që rrezikonin më së shumti integritetin territorial të Shqipërisë.

Aubrey Herbert, anëtar i Parlamentit britanik e mik i madh i shqiptarëve, rrëfen se Mehmet Konica dhe Filip Noga i kishin thënë në 1913 në Londër, se në Shqipëri *“populli nuk mund t’i durojë më bejlerët dhe pashallarët dhe se një lëvizje e madhe demokratike pritej të shpërthente aty”*. I bindur për rolin antikombëtar të bejlerëve turkoshakë shqiptarë ishte, si shumë aktivistë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare, edhe Dervish Hima. Në 12 shtator 1901, në faqet e gazetës “Albania” i akuzonte ata se kishin tradhtuar çështjen shqiptare “për medaljet prej teneqeje që ua var në gjoks Sulltani”. Dhe u kujtonte kërcënueshëm, se *“në Europë mbretërit, princat e fisnikët kishin kaluar në shpatën e drejtësisë së popullit”*, dhe se *“ata që ju keni keqtrajtuar e poshtëruar, nesër do nderohen”*. Figura më emblematike e parisë së vjetër shqiptare në periudhën e kapërcimit nga shthurja e Perandorisë në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, është padyshim Esat pashë Toptani. Të shumta janë

vlerësimet që i janë bërë atij nga njerëz që e kanë njohur, por që të gjitha janë ekstremisht negative: *“Esati ishte njeriu që nuk dinte asnjë gjuhë të huaj, por që ua dinte vlerën të gjitha monedhave të Europës”*, shkruan historiania Margaret McMillan. Ishte njeriu, i cili *“ishte gati të shiste të gjithë vendin, që të mund të sundonte qoftë edhe në një katund të vetëm të tij”*, deklaronte Obrei (Aubrey) Herbert. U kthye me turp nga fronti i mbrojtjes së Shkodrës, dhe ndonëse u ftua të bënte pjesë në kabinetin e Ismail Qemalit, bëri gjithçka për të sabotuar bashkimin e të gjitha trevave shqiptare përreth Qeverisë Kombëtare të Vlorës. Ai tentoi të krijonte shtetin e tij në Shqipërinë e Mesme, herën e parë më 1913, me mbështetjen e feudalëve turkoshakë e të Francës dhe, herën e dytë më 1915, me ndihmën e Serbisë.

Marrëveshjet e tij të fshehta me E. Venizellosin e Greqisë, me “kryeministrin” e qeverisë së “Epirit autonom”, Zografos, dhe me N. Pashiçin e Serbinë, në gusht-shtator 1914 e bënë atë prototipin e politikanit shqiptar, që për të ruajtur pushtetin, nuk ngurron të nxjerrë në ankand interesat dhe territoret e atdheut të tij.

* * *

Në krahun tjetër, përfaqësuesi më i lartë i grupimit të veprimtarëve patriotë ishte Ismail Qemali. Ai ishte një personalitet, që përmblihte në shkallën sipërore të gjitha tiparet e një lideri të urtë e vizionar. U nda shpejt nga klasa e tij e bejlerëve. Në vitin 1900, konsulli austro-hungarez, Petroviç, e përshkruante Ismail Qemalin si një person të ditur e inteligjent, por pa pasuri. Ashtu si vëllezërit Frashëri, Faik Konica, Said Toptani, Fehmi Zavalani e Shahin Kolonja, ai jetoi me forcën e mendjes, dhe jo me rentë feudale, si pinjollët e tjerë të familjes Vlora.

Ndryshe edhe nga Faiku, asnjëherë nuk nënshkruante si “Bej”, edhe pse të tjerët i drejtoheshin me këtë titull për respekt. Iu kushtua edukimit e nëpunësisë. Ishte formuar nën frymën e “Deklaratës së të Drejtave të Njeriut” të shpallur nga Revolucioni Francez, prandaj edhe nuk ngurroi të denonconte pikërisht Francën, vendin e lirive, e cila shtypte egërsisht lirinë dhe popullsitë e kolonive të veta. Si intelektual me ide liberale, u përfshi në procesin reformues të Perandorisë Osmane, i bindur se kështu,

në atë *Commonwealth* popujsh, shqiptarët do të gjenin hapësirën për të afirmuar kombësinë e tyre të mohuar.

Kur e pa se pushteti despotik i sulltanëve nuk u la asnjë shans reformave decentralizuese, ndërpreu çdo marrëdhënie me Portën e Lartë, u arratis dhe vendosi t'i përkushtohej kryekëput çështjes shqiptare. Në thirrjen që Ismail Qemali u drejtoi shqiptarëve më 15 tetor 1900, thoshte: *“Kuptova se nuk ishte punë të vazhdoja të përpiqesha të shpëtoja Perandorinë Turke...E ndjeva, se në rrokullimën e përgjithshëm që do të përfshinte Perandorinë, Shqipëria do të copëtohej e para”*.

Ndërkohë i kishte përjetuar të gjitha emocionet kulturore të Rilindjes Kombëtare: ishte përfshirë në debatet për alfabetin e Stambollit dhe kishte mbrojtur me ngulm germat latine; kishte ndërhyrë fort për të mundësuar botimin e fjalorit të Kristoforidhit; kishte tentuar të shpjegonte me gjuhën shqipe mbishkrimet e zbuluara në Kretë nga arkeologu Artur Evans dhe kishte zbuluar, ai vetë, orakullin e Dodonës, tempullin e pellazgëve, të cilët ai, si shumë rilindës të tjerë, i konsideronte paraardhësit e shqiptarëve. I bindur për kolapsin e shpejtë të Perandorisë dhe për rrezikun eminent të pansllavizmit, Ismail Qemali punoi për të ndërtuar aleanca parimore me vendet fqinje.

Në këtë vështrim u mundua të ndërtojë një aleancë të qëndrueshme me grekët, popull po aq i vjetër e me interesa të ngjashëm me shqiptarët. Në këtë kuadër, si qytetar i thjeshtë, pa ofiqe e pa kompetenca, takoi kryeministrin helen, Theotokis, më 1907. Pas vdekjes së tij, propaganda greke, e mbështetur edhe nga zëra brenda Shqipërisë, pretendoi se në atë takim me Theotokin, Ismail Qemali nënshkroi një deklaratë, në të cilën pranonte që Shqipëria e Jugut t'i jepej Greqisë.

Këtë deklaratë të pretenduar, përfaqësuesit grekë e kanë cituar në Konferencat e Paqes, Venizelloso në Versajë më 1919 e Caldaris në Paris më 1946, për të mbështetur pretendimet territoriale të Greqisë. Por një deklaratë e tillë thjesht nuk ekziston. Asnjë organ shtypi, asnjë libër historik nuk boton një deklaratë të tillë, as edhe libri i fundit i Vasil Kondisit mbi “Vorio-Epirin”, i shoqëruar me plot 4 vëllime me dokumente.

Përkundrazi, qëndrimin e vet mbi kufijtë greko-shqiptarë, të cilët me siguri ia ka parashtruar edhe Theotokit, Ismail Qemali i parashtron në

protokollin që nënshkroi po ato ditë të qëndrimit të tij në Athinë me kryetarin e shoqërisë “Helenizmos”, Neokles Kazazi. Neni 2 i këtij protokollit thotë: *“Dy popujt, ai grek e shqiptar, do t’i përmbledhnin ambiciet territoriale brenda kufijve të tyre historikë e gjeografikë, duke marrë për bazën gjuhën që flet shumica e banorëve të zonave të kontestuara”*.

Jemi në vitin 1907, kur edhe në administratën e shtetit grek jo vetëm Çamëria, por i gjithë Epiri quhej “Shqipëri e Poshtme” (*Kato Allvania*). Pavarësisht dëshirës për të lidhur një aleancë me Greqinë për kundër otomanizmit e pansllavizmit, Ismail Qemali nuk bëri asnjë kompromis në kurriz të interesit kombëtar. Në vitin 1911 refuzoi kërkesën e Athinës për të hequr dorë nga organizimi i lëvizjeve kryengritëse në Shqipërinë e Jugut. Kur në vitin 1912 Greqia i shpalosi hapur pretendimet mbi territoret shqiptare, duke invaduar, djegur e përzhitur jugun e Shqipërisë, ai iu vu punës për ndërtimin e një aleance me Turqinë, dhe pas shpërthimit të Luftës II Ballkanike, edhe me Bullgarinë.

Këto dy vende, me mprehtësinë e një politikani të regjur, Ismail Qemali i vlerësoi si aleatë të natyrshëm të shqiptarëve, nga momenti që për interesat e veta, ata i kthyen armët kundër grekëve.

* * *

Plaku i Vlorës dhe patriotët e tjerë rreth tij nuk u besonin “oxhaqeve” të mëdha shqiptare, të cilët i qëndruan besnikë Perandorisë Osmane deri në ditët e fundit të saj. Bejlerët nuk iu përgjigjën thirrjes së tij për t’u përfshirë në kryengritjen e vitit 1911. Nuk iu përgjigjën as kur më 10 shkurt 1913, Ismail Qemali i bëri thirrje “parisë” së jugut të mobilizonte njerëz për t’i shkuar në ndihmë Janinës së rrethuar nga ushtritë greke.

Edhe kësaj radhe pashallarët dhe bejlerët e jugut u kujdesën për ruajtjen e pronave e të privilegjeve të tyre, qoftë edhe duke rënë në ujdi pikërisht me qarqet greke. Kishte shpresuar që, në atë moment dramatik, kur qeveria e tij ishte pa mjete, pa ushtri e me një atdhe të copëtuar nga të katërta anët, bejlerët e pashallarët do të vinin në shërbim të atdheut

taborët e tyre të armatosur, që deri atëherë i kishin vënë në dispozicion të Padishahut.

Për këtë qëllim, në kabinetin e tij të përbërë nga intelektualë të shquar, përfshiu edhe Mufit bej Libohovën, si ministër të Brendshëm, dhe Mehmet pashë Dërrallën si ministër të Mbrojtjes. Por këta nuk i justifikuan shpresat e tij. I pari u mundua të minojë nga brenda qeverinë, duke bërë zëdhënës të informatorin e përfaqësuesve italianë e francezë në Komisionin Ndërkombëtar, kurse i dyti nuk la ndonjë shenjë në organizimin e mbrojtjes së trojeve të kafshuara nga ushtritë greke e serbe.

Në atë situatë, që është pak ta quash kaotike, Ismail Qemali e quajti me rëndësi jetike bashkimin e Shkodrës me qeverinë kombëtare, dhe për këtë qëllim e ftoi disa herë parinë e atij qyteti e, madje, dërgoi Luigj Gurakuqin për ta bindur atë të kryente këtë gjest kombëtar. Por paria e Shkodrës u përgjigj se ndihej mirë nën qeverisjen e Komisionit Ndërkombëtar. Edhe në Vlorë Ismail Qemali ishte i rrethuar nga kundërshtarë, intrigantë e skeptikë, që pavarësinë dhe shtetin shqiptar mund ta konceptonin vetëm si një krijesë të ujdive të paskrupullta me të huajt. Të tillë ishin njerëzit e tij të afërt, Ferit Pasha, Syrja Beu dhe djali i tij, Eqerrem bej Vlora. Këta ishin të parët që e denoncuan si “bukëshkalë” e “tradhtar”, kur Ismail Qemali u arratis nga Bejruti, duke deklaruar se tani e tutje do t’i kushtojë me mish e me shpirt çështjes shqiptare. Kur në 16 prill 1911 Ismail Qemali deklaronte se populli i Vlorës ishte gati të rrokte armët e t’u bashkohej kryengritësve të veriut, Syrja bej Vlora, Xhemil bej Vlora, myftiu dhe përfaqësues të tjerë të parisë së qytetit nxituan ta qetësonin e ta siguronin Portën, se në Vlorë e në të gjithë jugun e Shqipërisë “mbretëronte paqja e qetësia”, e në fakt punuan për të sabotuar lëvizjet popullore aty.

Ishin kushërinjtë, të cilët e kallëzuan Ismail Qemalin te Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit për kinse implikimin e tij në çështjen “Beqir Gebreneja”, që solli edhe rrëzimin e qeverisë kombëtare të Vlorës.

Pavarësisht këtyre goditjeve prapa krahëve, pavarësisht zhgënjimeve që i dhuruan deri edhe bashkëpunëtorë e miq të tij, të cilët me të dëgjuar për ardhjen e afërt të Princ Vidit, e braktisën qeverinë e tij kombëtare dhe vrapuan drejt Durrësit për të marrë ndonjë post në qeverinë feudale të

princit gjerman, por Ismail Qemali nuk e humbi shpresën dhe besimin e tij në të ardhmen e atdheut.

“Lipset të fitojmë me ça do mënyre Kosovën, Manastirin, Janinën e gjithë Çamërinë, - shkruante ai nga emigracioni i detyruar, - por për këtë unë shpresën nuk e kam te bejlerët dhe arkondët që vështrojnë të fitojnë tituj e të bëhen princër... Shpresa ime është te pronarët e vegjël e opingarët që janë zotët e vërtetë të Shqipërisë”.

* * *

Mbi Ismail Qemalin ka ekzistuar perceptimi i një “plaku të urtë”, “mjeshtri të lojërave politike e diplomatike” apo i një “negociatori sallonesh”. Sigurisht, Ismail Qemali ishte edhe i tillë. Por ishte po aq edhe organizator i kryengritjeve antiosmane në periudhën e viteve 1900-1912, siç e përshkruajnë edhe konsujt e huaj apo funksionarët e agjentët xhonturq. Kur e takoi për herë të parë në Itali, më 1903, Dervish Hima u befasua teksa zbuloi tek Ismail Qemali një ithtar të “revolucionit”. *“Ismail Qemali, - shkruante ai, -mendon se revolucioni është një lloj vorbulle gjithëpërfshirëse, që do të mundësonte kapjen e kohës së humbur. Në kushtet e prapambetjes së thellë, populli shqiptar duhej futur në udhë me forcë”.*

Nga një funksionar i regjur i Perandorisë Osmane nuk do të ishte pritur një koncept kaq “revolucionar” lidhur me përshpejtimin e proceseve historike nëpërmjet gjithëpërfshirjes. Në funksion të kryengritjeve të armatosura, Ismail Qemali mori përsipër detyrën e vështirë të furnizimit të tyre me armë. Më 5 maj 1909, valiu i Janinës raportonte se Ismail Qemali ndodhej në Korfuz, nga ku po mundohej të fuste në Shqipëri 50 mijë pushkë. Gjatë kryengritjes së vitit 1911 shkoi vetë në Malësinë e Mbishkodrës, ku përpunoi edhe të quajturin *Memorandum i Greçës*, që duhej të siguronte autonominë e Shqipërisë.

Periudha e viteve 1911-1914 është ndër momentet më dramatike, kur si asnjëherë faktorët e huaj u përzien në çështjen shqiptare. Kundrejt tyre, Ismail Qemali mbrojti interesat kombëtarë me dinjitet të rrallë nga pozita sovrane. Nuk e njohu servilizmin dhe kompleksin e inferioritetit, që vijon të jetë edhe sot vesi endemik i klasës politike shqiptare. E çmonte rolin e

pazëvendësueshëm që Austro-Hungaria luante në avancimin e interesave kombëtarë shqiptarë. Por iu kundërvu politikës së saj të *status quo*-së.

Nuk ia fali Austro-Hungarisë ndërhyrjen e saj për ta shuar kryengritjen e Mbishkodrës, duke përdorur për këtë qëllim edhe klerin katolik. Në prononcimin e tij të hidhur në gazetën vjeneze “Die Zeit”, të datës 31 korrik 1911, Ismail Qemali shprehej: *“Gabimet politike janë të pafalshme, por një qëndrim politik që kushton jetën e një populli të tërë është në kundërshtim me çdo moral politik”*. Me një intuitë e largpamësi të pashembullt, Ismail Qemali e kundërshtoi projektin austro-hungarez të hekurudhës së Sanxhakut, që Vjena vendosi ta ndërtojë pas aneksimit të Bosnjë-Hercegovinës më 1908, hekurudhë e cila do të zgjatej deri në Mitrovicë të Kosovës e prej andej në Durrës.

Sipas konsullit Kraus, që e takoi dhe bisedoi me Ismail Qemalin për këtë çështje, udhëheqësi shqiptar e kundërshtonte realizimin e këtij projekti, pasi, sipas tij, kjo hekurudhë në të ardhmen do të mund të bëhej bartëse e ekspansionit sllav në trevat shqiptare. Jo më kot, Ismail Qemali e quante atë hekurudhë “hekurudhë sllave”. Njeriu, i cili e kishte parashikuar me kohë kolapsin e Perandorisë Osmane, e dinte mirë se një ditë do të shpërbëhej edhe Perandoria Austro-Hungareze. Si për të vërtetuar dyshimet e tij, 6 vjet më vonë, në 14 shtator 1914, përfaqësuesit e qeverisë serbe nënshkruan në Nish një marrëveshje me një pasha shqiptar, pika 11 e së cilës parashikonte ndërtimin e “Hekurudhës Adriatike”, e cila do të dilte në Durrës.

Në fund të vitit 1915 e njëjta marrëveshje u ripërtëri, duke sanksionuar, veç ndërtimit të hekurudhës, edhe një bashkim të vërtetë mes Serbisë e Shqipërisë, me unifikimin e ushtrisë, doganave, diplomacisë, financave e tregtisë. Nga pala shqiptare, nënshkruesi i dy marrëveshjeve ishte i njëjti person: Esat pashë Toptani³³

Në janar 1914, në bazë të një denoncimi tinëzar të figurave të diskredituara, Myfit bej Libohova e Syrja bej Vlora, denoncim i ujdur në bashkëpunim me anëtarët rusë e francezë të Komisionit Ndërkombëtar

³³ Cedomir Antić, “Un port et une voie de chemin de fer: histoire d’une province maritime comme étude du colonialisme dans les Balkans”, Paris, éd. Pierre Belon, 2011, f. 85, 86.

të Kontrollit, Kryetari i Qeverisë së Përkohshme u detyrua të japë dorëheqjen e të lërë vendin.

Me gjithë tradhtitë e kundërshtarëve politikë, me gjithë zhgënjimet që kishte pësuar edhe nga ndonjë bashkëpunëtor i afërt i tij, Ismail Qemalin nuk e la nervi prej shtetari patriot. Vetëm pak muaj më vonë, në gusht 1914, ai u njoftua se forcat kryengritëse të Haxhi Qamilit kishin mbërritur në hyrje të Vlorës. Prej aty, rebelët i kishin dërguar një listë me kërkesa ultimative bashkisë: të dorëzonte qytetin, të shpërndante administratën e xhandarmërinë, të lejonte vendosjen në qytet të një mijë trupave rebele dhe, mbi të gjitha, të ulte flamurin kombëtar e të ngrinte në vend të tij flamurin osman.

Kërkesës së bashkatdhetarëve e bashkëpatriotëve të tij, se ç'përgjigje këshillonte ai t'u jepej rebelëve haxhiqamilitë, Ismail Qemali iu përgjigj me qetësinë e vendosmërinë që e karakterizonte. Në kushtet ekstreme në të cilat ndodhej vendi e posaçërisht Vlora, nuk kishte rrugë tjetër, veç të bisedohej me rebelët për të gjitha kërkesat e tyre, me përjashtim të njërës: kërkesës për heqjen e flamurit shqiptar. “Ne, - u shkruante ai bashkëqytetarëve të tij, - duhet ta mbajmë me çdo kusht flamurin me ngjyrat kombëtare, pa të cilin vendi do të humbte simbolin e vetëm të pavarësisë së vet dhe do të shndërrohej *ipso facto* në një prè të fqinjëve”.

Një përgjigje e denjë për burrin, i cili sot e gjithë ditën identifikohet me atë flamur.

5.2 NGA DR. MARK PALNIKAJ

Kultprotektorati për katolikët e Shqipërisë

Protektorati i Kultit ose kultprotektorati mbi popullsinë katolike të Shqipërisë, sidomos mbi popullsinë e trevave veriore, ka filluar qysh në shekullin XVI dhe ka pasur ndikim shumë të madh për vetë mbijetesën e kombit shqiptar dhe krijimin e shtetit të tij në kufijtë ndërkombëtarë që janë sot.

Shumë studiues që janë marrë me historikun e krijimit të shtetit shqiptar pas pushtimit katërshekullor nga Perandoria Osmane, janë të mendimit se një faktor përcaktues për formimin e këtij shteti ka luajtur prania e popullsisë katolike, kryesisht në Shqipërinë Veriore. Midis shumë studiuesve që janë marrë me çështjen e mbijetesës së katolicizmit në Shqipëri dhe me mbrojtësit e kësaj popullsie janë edhe Zef Prella, i cili ka shkruar një artikull në revistën *Studime historike*, nr. 3, viti 1965, dhe studiuesi Kurt Gostentschnigg, i cili ka shkruar një artikull me temë “*Protektorati i Kultit austro-hungarez mbi popullsinë katolike të Shqipërisë së Veriut*” në revistën “Phoenix 15-16” (2000/1-2).

Për mbrojtjen e katolikëve të Shqipërisë nga Perandoria Austro-Hungareze është shkruar edhe në një numër shumë të madh punimesh, ku qëllimi ka qenë nxjerrja në pah e kontributit të këtij shteti. Nga analiza që i kam bërë kësaj çështjeje gjatë një studimi mbi dioqezën e Pultit, për mbijetesën e popullsisë së kësaj dioqeze si të krishterë katolikë, më rezulton se mbrojtja e të krishterëve në trevat ballkanike nuk ka qenë problem vetëm i Perandorisë Austro-Hungareze, por edhe i Francës, Italisë, Rusisë, Prusisë etj.

Disa nga pikat kulmore të shfaqjes së kësaj mbrojtjeje ose protektorati, quajeni si të doni, kanë filluar të shfaqen menjëherë pas pushtimit turk të Ballkanit në shek. XV.

- 1448 – Turqit pushtuan Kosovën.
- 1453 – Shteti turk pranon zyrtarisht Patriarkanën e Stambollit si subjekt fetar në Perandori. [1] Këtë veprim nuk e bëri për Kishën Katolike të Romës. Kjo e vështirësonte funksionimin normal të veprimtarisë fetare për katolikët e ritit romak.

- 1462 – Më datë 8 nëntor, kryepeshkvi i Durrësit dhe këshilltari i Skënderbeut, Pal Engjëlli, në një sinod me pjesëmarrjen e disa meshtarëve nga e gjithë Shqipëria, shkroi një qarkore, që kishte fuqinë e një kushtetute (*constitute*) baritore, që u drejtohej meshtarëve të fshehur nëpër male dhe shpella të malësive, mbi aktivitetin baritor që nevojitej të ndërmerrenin, dhe mbi doktrinën e krishterë të sakramenteve bazë. [2]
- 1479 – Turqit pushtuan Shkodrën.
- 1480 – 5 tetor, gjenerali turk, Ahmet Gjedik Pasha, me ushtarët e tij masakroi 800 shqiptarë brenda një dite. [3]
- 1485 – Pushtuesi turk i Shqipërisë bëri regjistrimin e parë të banorëve, si dhe inventarizimin e pasurisë së zonave të pushtuara. Fshatarët e lirë, që i paguanin pushtuesit turk 50 akçe të argjendta në vit, ishin edhe fiset shqiptare të Piprit, Hotit, Palabardhit, tokat e Pjetër Spanit (Petrispanili) dhe disa fshatra të Shestanit. [4]
- 1535 – Në emër të *kultprotektoratit* në vitin 1535, kur Franca sundohej nga Fransua I (Francois I^{er}), ky shtet fitoi “*të drejtën e mbrojtjes së kultit dhe të kishës së krishterë në vendet e Perandorisë Osmane*” [5] dhe i ka përkitur vetëm Francës.
- 1615 – Ndikimi politik dhe ekonomik i Austro-Hungarisë mbi popullin shqiptar u vu në veprim me anë të Protektoratit të Kultit, të cilin monarkia e arriti me Paqen e Sitvatorokut më 1615 dhe parashihte fillimisht mbrojtjen e klerit katolik në Perandorinë Osmane.
- 1698 – Në Paqen e Karlovacit bisedimet filluan në dhjetor 1698 dhe zgjatën 70 ditë. Marrëveshja u nënshkrua më 26 janar 1699. Sipas kësaj marrëveshjeje, Sulltani u detyrua të ripohonte të drejtën për lirinë e kultit të nënshtetasve të tij katolikë. Vjena do të ndërhynte në favor të tyre nëse u shkeleshin të drejtat.
- 1718 – Në korrik të vitit 1718 u nënshkruar marrëveshja e Pasaroviçit (Pozharevac). Austriakët sipas kësaj marrëveshjeje do të dërgonin konsuj në Perandorinë Osmane, të cilët përveç punëve të tjera, do të mbrojnë të drejtat e kultit të popullsisë së krishterë.

- 1739 – Marrëveshja e Beogradit u nënshkrua më 18 shtator të vitit 1739. Sipas kësaj marrëveshjeje, këto të drejta fituan me të vërtetë një zbatim, në të cilin habsburgëve iu dha një leje e posaçme e trashëguar më parë prej Venedikut, e që kishte të bënte me mbrojtjen e të gjithë katolikëve të Europës nën pushtimin turk.
- 1774 – Më 21 korrik 1774 u nënshkrua Marrëveshja e Kyçyk-Kajnarxhasë, që ndodhej në një fshat të “Çezmës së vogël”, pranë Silistrës, në Bullgarinë e sotme. Kjo marrëveshje parashikonte mbrojtjen nga ana e Rusisë të të krishterëve të Perandorisë Osmane.
- 1791 – Paqja e Sistovit u nënshkrua në gusht të vitit 1791, në këtë qytet që ndodhet në breg të Danubit në Bullgari. Kjo marrëveshje i lejonte Austro-Hungarisë të hapte një konsullatë në Shkodër dhe një nënkonsullatë në Durrës, duke i rikonfirmuar marrëveshjet e mëparshme në mbrojtje të popullsisë katolike në Perandorinë Osmane.
- 1815 – Në Kongresin e Vjenës më 1815, Monarkisë Austriake iu dha e drejta të kishte nënkonsullata të tjera, si në Vlorë, Janinë dhe Prevezë. Konsulli ishte përfaqësuesi i drejtpërdrejtë i politikës së Protektoratit të Kultit. Ndër detyrat e tij bënin pjesë veprimtaritë humaniste, ngritja e nivelit të formimit, mbështetja e zhvillimit kombëtar dhe ndarja e parave. Vetëm me diplomatë të tillë, si August Král, Theodor Anton Ippen dhe Alfred Rappaport, të cilët e njihnin mirë Shqipërinë dhe ishin njëkohësisht miq të popullit shqiptar, u arrit të kryhej një punë e mirë fillestare në vendosjen e bazave të marrëdhënieve të mira mes Monarkisë Danubiane dhe shqiptarëve.
- 1837 – Më 1837 edhe Selia e Shenjtë njohu, më në fund, të drejtat e Monarkisë Dualiste mbi katolikët shqiptarë.
- 1855 – Një etapë e rëndësishme në zhvillimin e Protektoratit të Kultit shënohet në vitin 1855, kur u arrit Konkordati mes Vatikanit dhe Austrisë, i cili parashihte mbështetjen e një “Programi Veprimi” të Ballplatz-it nga ana e Vatikanit dhe posaçërisht veprimtarinë e Propagandës Fide.
- 1878 – Në Kongresin e Berlinit më 1878, gjithnjë në kuadrin e Kultprotektoratit, Austro-Hungaria ka zgjeruar të drejtat e

saj në mbrojtje të katolikëve të Shqipërisë. Edhe pas vitit 1878, angazhimi i Austro-Hungarisë për mbrojtjen e të drejtave të popullsisë katolike të veriut shqiptar ka vazhduar.

Analistët e sotëm, mbështetur mbi një numër shumë të madh dokumentesh arkivore të shkruar nga konsujt e ndryshëm që kanë shërbyer në qytetet e ndryshme të Shqipërisë, kuptojnë se protektorati i kultit nuk është kufizuar vetëm në të drejtën për ushtrimin e lirë të fesë si të krishterë katolikë, por edhe për *zhvillimin e kulturës dhe të vetëdijes kombëtare me qëllimin final: shkëputjen nga Turqia dhe krijimin e shteteve kombëtare të disa shteteve të Ballkanit*.

Ndikimi politik dhe ekonomik i Austro-Hungarisë mbi popullin shqiptar gjatë pushtimit turk ka qenë i madh. Pas Paqes së Karlovacit, më 1699 u arrit zgjerimi i protektoratit mbi të gjithë të krishterët nën sundimin turk. Pas Marrëveshjes së Beogradit të vitit 1739, këto të drejta, tashmë të konfirmuara realisht edhe nga Sulltani, fituan të zbatoheshin me njëfarë realizmi, të paktën sa për sy e faqe. Pas paqes së Sistovit të vitit 1791, ndikimi i Perandorisë Danubiane u rrit ndjeshëm. Shteti Austro-Hungarez u lejua të hapte konsullatë në Shkodër dhe një nënkonsullatë në Durrës. Më vonë, në Kongresin e Vjenës, Monarkisë Austriake iu dha e drejta të kishte nënkonsullata edhe në Vlorë, Janinë dhe Prevezë.

Nga 240 institucione katolike të Protektoratit të Kultit që ishin në Perandorinë Osmane, 220 prej tyre ndodheshin në Shqipëri. Ndikimi i Austro-Hungarisë në kuadër të protektoratit të kultit shtrihej në shtatë dioqezat katolike: Shkodër, Lezhë, Durrës, Prizren, Sapë, Pulti dhe Mirdita. Konsulli ishte përfaqësuesi i drejtpërdrejtë i politikës së Protektoratit të Kultit. Në vitin 1914, konsujt u morën me normalizimin e tensioneve mes popullsisë me besim fetar të ndryshëm, si dhe me mobilizimin e fiseve të Veriut kundra Serbisë dhe Malit të Zi. Baroni Nopça, me katolikët e Mirditës, Lezhës, Pukës, Nikaj Mërturit, Shalës, Shoshit, Kelmendit, por edhe me popullsitë e Gashit, Krasniqes, Hotit dhe Grudës ka zhvilluar veprimtari direkte në pajtimin dhe koordinimin e veprimeve për konsolidimin e shtetit të sapokrijuar shqiptar. Ai ka bërë marrëveshje, ka organizuar takime krerësh dhe ka krijuar besëlidhje dhe aleanca midis fiseve, ka shpërndarë para dhe armë, me qëllim ruajtjen e

identitetit të një shteti shqiptar. Në katër vite, nga viti 1914 deri në vitin 1918, me ndihmën financiare dhe organizative të austriakëve, në zonën nga lumi Shkumbin deri në Kosovë janë hapur 432 shkolla shqipe.

Françeskanët ishin mbështetja më e fuqishme e Protektoratit të Kultit. Vrasja e françeskanit Luigj Palaj në rrethinat e Gjakovës nga forcat serbo-malaziasë shkaktoi një revoltë shumë të madhe të katolikët shqiptarë dhe një reagim shumë të ashpër të qeverisë së Austrisë.

Trupi i klerikut u zhvarros, iu krye ekspertiza mjeko-ligjore dhe u vërtetua me fakte vrasja në mënyrë makabre e tij për motive dhe interesa në shërbim të pushtuesve. Detyra zyrtare e Protektoratit të Kultit qëndronte në ndërtimin dhe mbajtjen e kishave, në shkollimin e klerit dhe në mbrojtjen e kongregatave në Shqipëri. Mjafton të përmendim faktin e dhënë nga arqipeshkvi i Durrësit, D'Ambrosio, i cili thotë se dioqeza e tij deri nga mesi i shekullit XIX kishte vetëm 13 kisha dhe 10 kapela, të cilat ishin drejt shkatërrimit të plotë. Ndërsa në fund të po këtij shekulli, me ndihmën materiale të Vjenës u ndërtuan tashmë 22 kisha, 2 oratorë dhe 23 kapela.

Në mënyrë jozyrtare, kjo ndihmë u shfrytëzua nga Ministria e Jashtme e Austrisë për të ndikuar mbi popullsinë katolike të Shqipërisë së Veriut. Nga dokumentet arkivore të shtetit të Austrisë, merret vesh se politika e subvencionit, në pjesën më të madhe i shërbeu protektoratit të Kultit për përmbushjen e detyrave “zyrtare” dhe “jozyrtare”. Dhe në detyrat “jozyrtare” janë përfshirë ndikimi i Perandorisë së Austro-Hungarisë për krijimin e shtetit shqiptar. Në pjesën jozyrtare të veprimtarisë përfshihet veprimtaria e Johann Georg von Hahn-in, i cili ishte studiues i albanologjisë austro-hungareze dhe i albanologjisë gjermane. Po ashtu, veprimtaria studimore e studiuesve Franz Miklosich, slloven i Austrisë; Gustav Meyer-it, shtetas Austriak me kombësi gjermane; Wilhelm Meyer Lübkes, Maximilian Lambertzit, Ludwig von Thallóczyt, Josef Konstantin Jirečekut, Franz Baron Nopcsas, Milan von Šufflajt etj.

Këta studiues dhanë një kontribut madhor për nxjerrjen në dritë të historisë dhe kulturës së popullsisë shqiptare, tashmë të harruar në pushtimin pesëshekullor turk dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar. Përveç një pune të madhe studimore për historinë, fiset,

zakonet, veshjet, ata shërbyen si nxitje, që edhe shumë persona që kishin studiuar në shkollat e kësaj perandorie, të kryejnë punime brilante për historinë dhe kulturën shqiptare.

Të kësaj periudhe janë botimi i romanit të parë nga Dom Ndoc Nikaj, botimi i një historie të Shqipërisë nga po ky autor, punimet e Fishtës, Mjedës, Gjeçovit, Abat Doçit dhe shumë figura të tjera të ndritura.

Përfaqësuesit e Rilindjes Kombëtare Shqiptare që gjendeshin jashtë Shqipërisë u mbështetën financiarisht nga Vjena. Revista “Albania” në Bruksel, e botuar nga Faik Konica, u subvencionua për 11 vjet nga Austro-Hungaria.

Politika zyrtare e Vjenës angazhohej të kishte në mbështetje të saj njerëz besnikë nga radhët e parisë së fiseve të veriut. Nopça ishte veprimtari kryesor në lidhjet me prijësit dhe me bajraktarët e veriut katolik, por edhe të popullsisë muhamedane. Ai ia arriti në përgjithësi, me pak përjashtime, që të mobilizojë parinë dhe popullsinë e kësaj zone në luftë kundra pushtuesve serbo-malazezë, që pas largimit të pushtuesve turq ishin armiq të më të betuar kundër krijimit të një shteti shqiptar në Ballkan. Nuk u lanë jashtë vëmendjes edhe udhëheqësit shpirtërorë, si priftërinjtë, ipeshkvijtë, veçanërisht prelatët, të cilët në pjesën dërmuese ishin prej Dalmacisë, Istrias dhe Tirolit të Jugut.

Fretërit françeskanë u dalluan si organizatorë dhe udhëheqës të masave popullore kundra pushtuesve serbo-malazezë, duke kundërshtuar dhe denoncuar masakrat e tmerrshme që ata kryen mbi popullsinë e pafajshme të këtyre zonave. Në pjesën më të madhe, këta fretër shkollat i kishin kryer në qytetet e shtetit të Austrisë, si Vjenë, Graz, Linz, Innsbruck, Villach etj.

Vjena krijoi edhe fonde financiare dhe mundësi materiale, me qëllim që të gjithë klerikët që i kishin përfunduar studimet dhe noviciaten e tyre në Shkodër, të mundeshin të studionin në Austri për teologji dhe filozofi. Shumica e këtyre klerikëve nuk studioi vetëm teologji dhe filozofi, por ata studiuin edhe histori, arkeologji, matematikë, fizikë, kimi, farmaci dhe muzikë në universitetet perandorake. Në sajë të këtij programi të Monarkisë Danubiane, në atë kohë u formuan personalitetet më në zë nga kisha, politika, shoqëria dhe arsimi, të cilët do të luanin më pas një rol të rëndësishëm në historinë e kombit shqiptar. Mbarimi i Luftës së Parë

Botërore shënon edhe fundin e një bashkëpunimi treqindvjeçar midis Perandorisë Danubiane dhe popullsive katolike të veriut shqiptar. Me shkatërrimin e Monarkisë së Danubit dhe krijimin e shtetit të Austrisë merr zyrtarisht fund Protektorati i Kultit ndaj popullsive të krishtera.

Referenca

1. Gaspër Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, f. 141.
2. Letra e Pal Engjëllit, Arkivi i QSA-së, Tiranë.
3. Zef Mirdita, *Krishtenizimi ndër shqiptarë, Drita*, Prizren-Zagreb 1998, f. 174.
4. Selami Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Tiranë 1974, f. 24.
5. Pellissie du Rausas, G., *Le regime des capitulations dans l'Empire Ottoman*, Vol. I. Paris 1910, f. 6.

5.3 DR. QAZIM NAMANI

GJURMË TË MBISHKRIMEVE NË GURË NË TERRITORIN E DARDANISË QENDRORE

Mbretëria e Dardanisë padyshim që kishte arritur një shkallë të lartë zhvillimi ekonomik e kulturor gjatë shekullit IV e deri në shekullin I para erës sonë. Burimet e deritanishme na bëjnë të ditur, se gjatë kësaj periudhe në Dardani ishte e zhvilluar xehetaria dhe përpunimi i metaleve. Dardanët ishin të njohur për përpunimin e arit, ndaj nuk qëndronin prapa me zhvillimin ekonomik dhe kulturor me popujt fqinjë. Gjatë kësaj periudhe Mbretëria e Dardanisë kishte dalë në skenë dhe si fuqi e rëndësishme ushtarake në rajon.

Duke pasur parasysh këto burime për zhvillimin e Dardanisë, duhet të besojmë se edhe në territorin e saj ishte i zhvilluar shkrimi, në material të ndryshme sikurse te popujt fqinjë rreth saj. Për ta kuptuar sadopak realitetin e asaj periudhe lidhur me alfabetin dhe shkrimin e lashtë te fiset ilire, ne po japim disa të dhëna nga studimet e deritashme.

Shqiptarët flasin dhe shkruajnë një gjuhë që është shumë e veçantë nga gjuhët e tjera dhe konsiderohet ndër më të vjetrat në Ballkan dhe Europë. Lidhur me lashtësinë e gjuhës shqipe dhe lidhjen e saj me gjuhët e tjera, të dëshmuara edhe përmes shkrimeve epigrafike, po japim disa nga mendimet e studiuesve më eminentë në këtë fushë.

Petro Janura në librin e tij “Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe” shkruan se gjuha shqipe është gjuhë e stërlashtë, por shkrimi i saj i dokumentuar është mjaft i ri. Enzo Gatti në librin e tij “Ilirët” citon profesorin e Universitetit të Tubingenit, De Simeone, i cili deklaron: “Me njohuritë që kemi deri më sot, nuk është e mundur të rindërtojmë qoftë edhe pjesërisht një gjuhë ilire, pasi që nuk ekziston deri më sot asnjë mbishkrim tipik ilir”.

Enzo Gatti na ofron të dhëna, se në luginën e lumit Drava janë zbuluar dy shkrime të lashta (Dali, viti 3200 para Krishti). Këto janë

ndoshta shkrimet e para alfabetike të botës. Në këto shkrime vërehen dy sisteme të ndryshme shkrimi. Njëri ka germa solemne (të mëdha shtypi) dhe tjetri ka germa të vogla kursive (të vogla me lajlelule). Njëri prej tyre është i pari i të gjitha shkrimeve të tipit lapidar romak, ndërsa tjetri i atyre të tipit arab fenik. Nga këta prototipa lindën dy degët e mëdha të shkrimeve alfabetike botërore, perëndimi dhe lindja, gerrat e mëdha dhe të vogla. Pra, alfabeti i parë ka lindur në zemrën e Ballkanit, dhe burimi gjuhësor i shkrimeve të vjetra duhet kërkuar në një gjuhë ballkanike.

Robert D'Angely shkruan se gjuha shqipe ka qenë e shkruar në Antikitët, dhe kjo provohet nga mbishkrimet etruske ose shqipe dhe, nga ato po ashtu shqipe ose likiase e të tjera, që janë zbuluar në Azinë e Vogël, në Lemnos, në Kretë dhe në Itali.

Petro Janura shkruan se supozohet që stërgjyshërit e shqiptarëve, ilirët, e përdorën alfabetin etrusk dhe atë grek të latinizuar derisa u themelua alfabeti latin i shekullit III para erës sonë.

Niko Stylo në librin e tij “Historia e shenjtë e arvanitëve” jep të dhëna për një shkrim në gjuhën etrurë të zbuluar në një fasho të një mumieje. Mumia u dhurua nga trashëgimtarët e kroatit Michael Bariç në Muzeun Kombëtar të Zagrebit, në korrik të vitit 1862. Ky shkrim ishte i panjohur në fund të shekullit XIX për profesor Henrich Karl Brugsch. Pasi fasha e shkruar u dërgua në Universitetin e Vjenës, specialistët vunë në dukje se bëhej fjalë për gjuhën etrurë. Analizat e karbonit datimin e shkrimit e përcaktuan me shënimet historike të Plutarkut për trupin e balsamosur të Alkmenës (për grekët, nëna e Herkulit). Sipas Plutarkut, varrimi dhe rivarrimi i Almenës ndodhi në kohën e faraonit egjiptian Nektanavit I, sundimi i të cilit nisi më 378 para erës së re.

Nermin Vlora Falaski citon Herodotin: “*Etruskët flisnin gjuhën e një populli të lashtë, që jetonte në krahinat e Mesdheut para ardhjes së grekëve*”. Pellazgët nga Homeri u quajtën *popull hyjnor*. Herodoti shënoi se Greqia para ardhjes së helenëve quhej Pellazgji dhe se pellazgët u mësuan atyre përpunimin e metaleve, ndërtimin e mureve e, madje, edhe alfabetin.

Mbishkrimet etruske interpretohen me anë të ilirishtes, prandaj kjo ka kuptim që romakët i quajnë etruskët TOSCHI (TUSCI), duke e ditur se ata flisnin të njëjtën gjuhë toske të Ilirisë Jugore.

Shkencëtari italian, abati Emidia Luzi, në veprën e tij “Epoca Eroica”, të botuar më 1847 shkruan: *“Pellazgët kanë qenë banorët më të vjetër të Italisë sonë... Në të vërtetë, vendasit Ombiuenët, Osonët, Oskët, Britët, Rutualët dhe Enotrienët janë emrat e parë të italianëve, që shënonin një popull të vetëm të së njëjtës origjinë... me pellazgët që quheshin popull hyjnor nga Homeri”*.

Plini, Plaku, në shekullin e parë shpjegon se germat e alfabetit fonetik në Itali i prunë pellazgët. Sipas Diodorit të Sicilisë, *“pellazgët qenë të parët, që e prunë në Europë alfabetin, duke ia përshtatur gjuhës së vendit sistemin e shkronjave me disa ndryshime e përmirësime”*. Diodori shkruan se këtë alfabet të njohur me emrin *“alfabeti pellazg”* e përdorën të gjithë poetët para Homerit. Në vitin 1875, dy arkeologë francezë zbuluan në ishullin pellazg të Lemnosit (Egje) gjurmë të një shkrimi parahelen.

Studiuesi L. Benlow në veprën e tij “Greqia para ardhjes së grekëve”, të botuar në vitin 1877 në Paris, shkruan: *“Shumë emra të vendeve, të maleve, të lumenjve, të personazheve legjendare nuk mund të shpjegohen me etimologjinë greke. Vetëm një gjuhë ka qenë në gjendje të hedhë dritë mbi emrat e këtyre vendeve, e kjo është gjuha shqipe”*.

Mbishkrimet e zbuluara në Shqipëri janë të shumta, por po veçojmë fjalën XAIPE = HAIRE, e cila haset shpesh në portat e qyteteve, për të thënë “Qoftë me hair” ardhja e mysafirëve.

Nermin Vlora Falaski shkruan se ilirët dhe etruskët shkruanin zakonisht pa ndërprerje, prandaj çdo shkrim kërkon analizë të posaçme, për të bërë vendin e saktë të ndarjes, në mënyrë që fraza të ketë kuptim logjik. Meqë gjuha etruske rezulton se mund të interpretohet me anë të gjuhës shqipe, provohet se kjo gjuhë e fundit është vazhdim i ilirishtes.

Lloji i shkrimeve epigrafike është gati identik në një hapësirë të gjerë gjeografike që nga Deti Egje (një shembull është dhënë nga stelat e Lemnosit), në Iliri (mbishkrimet nga Durrësi, Kosova e vende të tjera), te venetët, te mesapët dhe natyrisht tek etruskët.

Lidhjen linguistike ndërmjet etruskishtes dhe gjuhës shqipe e ka shqyrtuar gjerësisht prof. Zacharie Mayani, ligjërues në Universitetin e Sorbonës. Prof. Guiseppe Catapano në studimin tij “Lashtësia e gjuhës

shqipe” vërteton gjurmët e pellazgëve në territoret e banuara nga egjiptianët e lashtë, nga fenikasin, nga kartagjenasin dhe nga babilonasit.

Lidhja kulturore ndërmjet etruskëve dhe ilirëve vërtetohet edhe me anë të kulturës materiale, siç janë varrezat monumentale dykatëshe të zbuluara në Shqipëri, që përngjajnë në mënyrë të çuditshme me varrezat etruske të njëkohshme, duke paraqitur të njëjtat veçori. Studiues të shumtë kanë konstatuar se gjuha shqipe ka elemente të përbashkëta me trakishten.

Në territorin e Rumanisë është vërtetuar se ekzistojnë mbishkrime pellazge, që janë të kuptueshme me anë të gjuhës shqipe, sepse trakët, banorët e lashtë të atij territori, ishin një nga fiset më të mëdha pellazge.

Akademiku rumun, Grigore Brankush, shkruan se midis të gjitha gjuhëve ballkanike që kanë trajta të përbashkëta me gjuhën shqipe, vendin e parë e zë padysim gjuha rumune. Shqipja dhe rumanishtja kanë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, morfologjisë, leksikut, formimit të fjalëve, sintaksës, frazeologjisë, fjalëve të urta dhe lokucioneve proverbiale.

Elementet e përbashkëta paralatine, që bashkojnë shqipen me rumanishten, nxjerrin në dritë lidhjen gjenetike të tyre përmes shumë fjalëve të përbashkëta.

Janë disa fjalë nga fondi i përbashkët rumuno-shqiptar pararomak, që përfundojnë me germën S (Sh), të cilat janë shumë të vjetra dhe kanë ardhur nga të dyja gjuhët, si: *gushë* (*gusa*), *mosh* (*mos*), *mushk* (*musc*), *shapi* (*shaparla*), *shtirë* (*shtira*) etj., shkruan Brankush. Ky studiues në librin e tij jep të dhëna për shumë emra vendesh, që kanë për bazë fjalën “gushë” në Rumani dhe Shqipëri. Në Kosovë po veçojmë fshatin Gushtericë, që bazuar në studimet e akademikut rumun Brankush, nëse këtij toponimi ia heqim prapashtesën *-icë*, atëherë emri i këtij fshati na del në gjuhën shqipe *Gushter* (*Gusha e terur-tharë*). Grigore Brankush në studimet e tij konstaton se shqipja popullore dhe rumanishtja e vjetër kanë shumë trajta të përbashkëta.

Eqrem Çabej në studimet e tij ka ofruar të dhëna dhe supozime rreth origjinës së gjuhës shqipe. Sipas tij dhe shumë studiuesve të tjerë, shqiptarët rrjedhin nga ilirët dhe gjuha shqipe është vetë ilirishtja, por

duke mos e mohuar edhe mundësinë që gjuha shqipe të rrjedhë nga një përzierje iliro-trakishte.

Vlladimir Georgiev, me rastin e gërmimeve arkeologjike në kodrinën e Bashovës, në fshatin Duvanli të Plovdivit në Bullgari, njofton se janë zbuluar disa mbishkrime në enë dhe në një unazë, të cilat datojnë kah fundi i shekullit V ose kah fillimi i shekullit IV para erës së re. Në një enë argjendi është gjetur mbishkrimi *DADALEME*, mirëpo një emër i tillë trakas ishte i panjohur. Teksti përmban tri fjalë, që mund të përkthehen fjalë për fjalë në gjuhën shqipe. Në këtë lokalitet u zbulua edhe një unazë ari me figurë kalorësi, me tekst *EYSE...DELE MEZHNAI*.

Aleksandër Stipqeviqi në librin e tij "*Historia, jeta dhe simbolet e kultit*" jep të dhëna për shumë monedha "barbare", siç i njihnin në shekullin e dytë para erës së re, të zbuluara në pellgun e Danubit dhe në fshatin Ribnjaça, ku me shkronja të alfabetit të etruskëve shkruhej emri i sundimtarit lokal, Sosthenes.

Duje Rendiç-Mioçeviq për një shkrim nga Grebeshtica te Shibeniku mendoi se ishte një variant vendor i shkrimit latin. Në një shkrim të gjetur në Braç është shkruar emri prej dy pjesësh: *Veselia Felicitas*. Pjesa e parë *Veselia* është fjalë ilire, ndërsa pjesa e dytë, *Felicitas*, është fjalë latine, që do të thotë *fat*, shkruan Aleksandër Stipqeviqi.

Eqrem Çabej në veprën "*Studime gjuhësore V*" njofton se në nekropolin e kalasë së Dalmacës pranë Komonit, dihet se, që në fillim të shekullit XX, midis objekteve të tjera është gjetur një unazë prej bronzi të hollë, e cila e mban mbishkrimin (*ANA OHOH ICER(ICEB)*). Me këtë mbishkrim u morën studiuesit Degrand, Traeger, Ippen, Nopça etj. Ippen ishte i pari që e shprehu mendimin, se ka gjasa që kemi të bëjmë me një mbishkrim në gjuhën ilire. Mendimin e tij e përforcoi më vonë edhe Hans Krahe, që sipas tij, kemi të bëjmë me një mbishkrim të ilirishtes ballkanike.

Domethënia e disa emrave të lashtë ilirë ka qenë e mundur që të dihen nëpërmjet gjuhës shqipe, të vetmes gjuhë bashkëkohore në Ballkan, që mund të konsiderohet trashëguese e drejtpërdrejtë e ilirishtes.

Këto të dhëna, edhe pse të pakta, janë dëshmi se ilirët, krahas popujve fqinjë, kishin alfabetin e tyre. Përveç alfabetit, është e pamundur që ilirët të mos kishin edhe bibliotekat e tyre, krahas bibliotekave të zhvilluara të

kohës në Mesdhe. Në këtë periudhë kohore ekzistonin biblioteka të famshme, si në Aleksandri, Athinë, Romë etj., që i bashkonin njerëzit më të ditur të kohës në Mesdhe. Mbretëritë ilire duke jetuar në fqinjësi me këta popuj, në mungesë të burimeve të shkruara, supozojmë se kishin edhe bibliotekat e tyre. Këtë e dëshmon edhe Aleksandër Stipqeviqi, që lë hapësirë për të menduar se në Iliri kishte biblioteka, kur shkruan: *“Oktavian Augusti pas nënshtrimit të ilirëve, duke u kthyer në Romë, nga plaçka që solli prej Ilirisë, urdhëroi që të ndërtohet një bibliotekë e madhe publike, të cilën për nder të motrës së tij, Oktavisë, e quajti Oktaviana”*.

Në periodhat e mëvonshme, me të drejtë duhet theksuar se ilirët (shqiptarët) në shkrimin e tyre përdorën alfabetin latin, kur Roma ndikoi mbi ilirët në pikëpamje kulturore. Gjatë sundimit të Perandorisë Romake në Iliri, përmes misionarëve të krishterë filloi që të përhapej krishterimi. Me legalizimin e krishterimit, sipas burimeve të shkruara, mund të flitet për një etapë të shkollimit fetar edhe në gjuhën ilire.

Budimir Milani në librin e tij *“O etnickom odnosu Dardanca prema Ilirima”*, ndër të tjera shkruan: *“Kalimi i fisit dardan Galabri-Kalabri në Itali, përveç pasurisë dardane, që e morën me vete në Romë, ata e sollën edhe bibliotekën”*.

Kjo e dhënë haset edhe në librin *“Izraelska veza”*, ku shkruhet se në Sicili u shpërngulën galabrët-kalabrët, fis dardan. Pasurinë dardane dhe bibliotekën e ka sjellë nga Lindja në Romë fitimtari Perse.

Fanula Papazoglu duke iu referuar autorëve antikë, jep të dhëna për lidhjen e emrit të Kalabrisë me galabrët e Dardanisë, si dhe dardët në Itali me dardanët. Këto të dhëna historike dëshmojnë se në Mbretërinë e Dardanisë ekzistonin shkrime dhe biblioteka të pasura me të dhëna të rëndësishme për kohën. Nga burimet historike mësojmë se në Dardaninë Qendrore dhe atë Lindore jetonte fisi i njohur dardan, Galabroi, për të cilin kemi të dhëna edhe nga autorët antikë, për zhvillimin ekonomik dhe migrimin e disa prej tyre në Kalabri të Italisë.

Gjurmët arkeologjike, të zbuluara deri më tani në Dardani, dëshmojnë për një qytetërim të zhvilluar. Autorët antikë kanë shkruar, edhe për ekzistimin e qyteteve në Dardani, para pushtimit romak. Deri tani janë zbuluar rrënojat e qytetit dardan në Kërshevicë afër Vrajës. Shumë

studiues e mbështesin mendimin, se edhe qytetet Aria dhe Damastioni duhen kërkuar në Dardaninë Qendrore, si zona më e zhvilluar për eksplantimin dhe përpunimin e metaleve.

Straboni, një nga autorët antikë, shkruan se ata janë një fis i madh i dardanëve, në vendin e të cilit është një qytet i lashtë. Sipas Strabonit, galabrët ishin një nënfis i fuqishëm, në kuadër të fisit ilir të dardanëve. Në lindje të fisit Galabroi jetonte edhe fisi tjetër i njohur dardan i Thunatëve.

Ata zotëronin një rajon të gjerë në Kosovën e sotme Lindore, Serbinë e sotme Jugore dhe shumë territore në Maqedoninë e sotme Veriore. Në territorin që zotëronin galabrët përfshiheshin shumë vendbanime të rëndësishme, të cilat u zhvilluan edhe gjatë periudhës romake, si qytetet Nish (Naisusi), Vendenis (Gllamniku), Ad Fines (Hamenium-Kursumlija), Herkulium (Prokupla), Viminacium (Kostolac), Vicinianum (afër Ulpianës), midis Vendenisit dhe Therandës, Tranupara, midis Astibus (Shtip) dhe Skupi (Shkupit). Shkupi u bë kryeqyteti i Dardanisë në shekullin e dytë para Krishtit, që shtrihej deri te Bylazora (Velesi i sotshëm).

Nga kjo kuptojmë se për nga zhvillimi ekonomik dhe ushtarak, Dardania dhe qytetet e saj nuk qëndronin mbrapa qytetërimit të asaj kohe, dhe se Mbretëria e Dardanisë ishte ndër mbretëritë më të fuqishme në Mesdhe.

Mbishkrimet në gurë, që po i ofrojnë të fotografuara më poshtë, janë hasur në muret e një shtëpie banimi në fshatin Dumnicë të Epërme, në lagjen e Tihovcëve, komuna e Besianës. Territori i këtij fshati shtrihet në brezin kufitar të sotëm midis Kosovës dhe Serbisë. Si territor mes qytetit të Besianës dhe Kushumlisë, dhe pranë rrugës së njohur antike Nish-Lezhë, mund të supozojmë se këta gurë janë marrë nga gërmadhat e ndonjë lokaliteti arkeologjik, për t'u murosur në murin e kësaj shtëpie. Këtë e vërteton fakti, se në muret e këtij objekti janë murosur edhe shumë gurë të tjerë me plastikë gurore, që simbolizojnë simbole astrale e mitike.

Shtëpia ku janë murosur gurët me mbishkrim dhe plastikë gurore është dy kate, dhe është ndërtuar gjatë shekullit XX.



Mbishkrime në gurë, në themelet e shtëpisë në fshatin Dumnicë e Epërme, komuna e Besianës.

Ndërsa njëri nga gurët me mbishkrim është murosur, në themelin e objektit, guri tjetër është murosur në katin e dytë, rreth 1 m nën çatinë e objektit. Pozita e murosjes së këtyre gurëve në këtë objekt banimi, dëshmon qartë se gurët janë bartur nga rrënjat e një objekti shumë më të vjetër.



Pozicioni i gurëve me mbishkrim të murosur në këtë objekt banimi.

Përveç gurëve me mbishkrim, që gjenden në fshatin Dumnicë të Epërme në komunën e Besianës, edhe dy gurë të tjerë me mbishkrime u zbuluan në vitin 2005, në fshatin Gërmovë, komuna e Vitisë. Gurët e zbuluar në themelet e hajatit të xhamisë së vjetër në fshatin Gërmovë të komunës së Vitisë, dëshmojnë për kulturën e lashtë të shkrimit edhe në vendin tonë. Mendoj se kemi të bëjmë me një shkrim shumë të vjetër, pasi së bashku me këta dy gurë është gjetur edhe një altar i papërpunuar. Germat në këto mbishkrime janë mjaftë të dëmtuara. Vërehet se është përdorur stili i shkrimit pa ndërprerje, ndaj është me interes shkencor, që ky mbishkrim të studiohet nga ekspertë të kësaj fushe. Këta gurë qëndrojnë në një kënd të oborrit të xhamisë dhe janë në rrezik që të zhduken nga pakujdesia, pasi institucionet kompetente nuk ndërmorën asnjë masë për t'i marrë në përkujdesje.



Mbishkrime në gurë, të zbuluuar në fshatin Gërmovë të komunës së Vitisë.



Mbishkrime në gurë, të zbuluara në fshatin Gërmovë të komunës së Vitisë.

Mendoj se këta gurë kanë vlera të mëdha për trashëgiminë kulturore, dhe është me interes që të barten në institucionet që merren me ruajtjen e monumenteve.

VI. INTERVISTA

6.1 DR. MARTIN BERISHAJ

Paqëndrueshmëria në Ballkan mund të ketë pasoja të rënda për sigurinë dhe prosperitetin e rajonit dhe më gjerë

Intervistoi: Ina Stašević [Glas Slavonije]

“Si diplomat, qëllimi im do të ishte që Kosova të njihet jo vetëm si një destinacion ekonomikisht në rritje, por edhe si një parajsë turistike me natyrë të bukur, duke i fisnikëruar kulturën dhe duke ruajtur traditën në çdo aspekt të zhvillimit të saj.”

1. Cilat janë lidhjet kulturore dhe historike mes kroatëve dhe shqiptarëve?

Marrëdhëniet kulturore dhe tregtare midis Dubrovnikut dhe shqiptarëve u vendosën që në shekullin XIII, kur Dubrovniku lidhi një marrëveshje tregtare me fisnikun shqiptar, Dimitrin, birin e Progonit. Këto lidhje mbetën të forta gjatë shekujve, gjë që vërtetohet nga statuti i Dubrovnikut i vitit 1272, ku përmenden qytetet shqiptare, si Durrësi, Vlora dhe Kruja.

Është interesant fakti, se gjuha shqipe është përmendur për herë të parë në burimet e Dubrovnikut që në vitin 1285 dhe në mes të viteve 1382 dhe 1399 doli emri aktual kombëtar i shqiptarëve: shqiptar. Gjatë shekujve XIV dhe XV, Dubrovniku ishte shtëpia e priftërinjve dhe e murgjve të shumtë shqiptarë nga Tivari, Ulqini, Shasi, Shkodra dhe rajone të tjera, dhe ardhja e tyre ishte pasojë e persekutimit të katolikëve nën dinastinë serbe të Nemanjiqëve.

Ndër të ardhurit e rëndësishëm nga Shqipëria, më të njohurit ishin: Nikolla Arbanas, mësues në Ston (1345); Ivani, piktor nga Durrësi (1388-1389); Gjorge Span, mjek nga Shkodra (1439); Marul Tarkanjot nga Arta, poet latin (1453); Marin Beçikemi nga Shkodra, humanist dhe drejtor i shkollës së Dubrovnikut (1492-1496); Andrija nga Durrësi, doktor i Librit të Shenjtë provincial dhe inkuizitor (1438), më vonë peshkop në

Senj (1443-1456). I njëjti ka qenë dëshmitar edhe në promovimin e Gjinn Gazullit në Padovë.

Dy kryepeshkopë të Dubrovnikut ishin shqiptarë: Benedikti, dikur peshkop i Shasit në Shqipëri (1317-1317) dhe Andrija i Durrësit (1388-1393), i cili themeloi Vëllazërinë e Priftërinjve, portreti imagjinar i të cilit nga shekulli XVIII ruhet në seminarin e Dioqezës së Dubrovnikut. Sot varri i tij ndodhet në të djathtë të derës hyrëse të kishës dominikane nga klostri me një pllakë guri gri me një mbishkrim në gotik. Poshtë panelit është një statujë relief e kryepeshkopit në një pozicion të shtrirë me shkopin pastoral në duar të kryqëzuara mbi kraharor. Don Paulus Albanesis (1363-1368) përmendet ndër kancelarët shtetërorë të parë në Ston. Ne hasim testamente të ndryshme të shqiptarëve, e ndër to janë interesante ato në të cilat dhurohen libra. Kështu, për shembull, prifti nga Piloti u largua në 1428: një përmbledhje, një fjalor, një psalter, një homoliar dhe letra e apostullit Shën Pali, një libër për Shën Gjergjin, i cili ishte në purgator, dhe statutet e ordinancat e kishës.

Pak më herët, deri në vitin 1401, disa shqiptarë renditën librat e tyre në testamentet e tyre, por edhe informacione të vlefshme historike, siç mësojmë në testamentin e Fr. Jacom Greco, se turqit e shkatërruan Drishtin në vitin 1399: *“Li se Turchi devastasse Drivasto 1399”*. Më tej, Lagari Albanensis lë: psalteri, saltiero francescano, ndërsa don Alexi de Georgio, prift i kishës së Shën Palit në Pulat, lë: një meshar, një libër për gramatikën dhe Rregulloren e Shën Donatës, përmbledhje dhe libër fillestar.

Në mesin e shqiptarëve të Dubrovnikut spikat Gjinn Gazulli dhe vëllezërit e tij. Ky personalitet i veçantë i periudhës humaniste lindi rreth vitit 1400 dhe vdiq më 19 shkurt 1465 në Dubrovnik. Babai i tij ishte shqiptar nga Zadrima. Vëllai i tij, Pali, përmendet si rektor i shkollës në Dubrovnik (1442-1444) dhe ishte përfaqësues i Heroit Kombëtar shqiptar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeut (1453).

Kohët e fundit është shkruar shumë, sidomos për shqiptarët që kanë jetuar dhe kanë punuar në bregdetin kroat gjatë Rilindjes, në veçanti skulptori dhe ndërtuesi i famshëm Andrija Aleši, lindur në Durrës, por që krijoi veprën e tij artistike në Split, Trogir, Zadar dhe Rab. Më 8 mars 1332, në një seancë të Këshillit të Madh të Dubrovnikut, u mor vendim

për emërimin e një konsulli në Prizren, një nga qytetet autonome më të njohura të Europës Juglindore (Quod eius mansio sit në Prizren). Kjo datë shënon fillimin e jetës diplomatiko-konsullore të Kosovës, 676 vjet para shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës (2008)! (dokument të cilin e ka zbuluar profesor Jahja Drançolli).

Lidhja e kulturës shqiptare me atë kroate ndihej edhe nëpërmjet letërsisë. Gjergj Fishta, poet i madh shqiptar, si dhe Shtjefën Gjeçovi u frymëzuan nga veprat e Ivan Mažuranić, Fr. Grga Martiq dhe Silvio Strahimir Kranjčević, të cilëve Gjergj Fishta u kushtoi edhe një poezi në italisht. Këto të dhëna historike dëshmojnë për lidhjet e thella mes kroatëve dhe shqiptarëve, të cilat u krijuan përmes tregtisë, fesë, artit dhe letërsisë dhe lanë gjurmë të qëndrueshme në trashëgiminë kulturore të dy kombeve.

Si litoglif në atë mozaik të aleancës historike shqiptaro-kroate shquhet historiani kroat, dr. Milan Šufflay, themeluesi i albanologjisë, i vrarë në Zagreb në shkurt të vitit 1931. Me vrasjen e tij, studimet mesjetare shqiptare mbetën pa vepra vendimtare, që do të dëshmonin për një histori të ndryshme shqiptare nga ajo që, për fat të keq, njohim sot!

2. Republika e Kosovës është një vend i vogël me vetëm dy milionë banorë. Pasi një krahinë përbërëse hyri në Kushtetutën e RSFJ-së, e më pas në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, më në fund u bë e pavarur në vitin 2008. A jeni optimist për zhvillimin ekonomik të vendit tuaj?

Republika e Kosovës mund të jetë një vend i vogël me dy milionë banorë, por potenciali i saj është shumë më i madh se përmasat e saj. Që nga pavarësia në vitin 2008, Kosova ka hedhur themelet e një ekonomie moderne dhe dinamike, dhe sot me krenari mund të themi, se po shënojmë rritje të vazhdueshme ekonomike dhe rritje të njohjes në skenën ndërkombëtare. Si ambasador, detyra ime është të forcoj urat ekonomike, të tërheq investime dhe ta promovoj Kosovën si një partner të besueshëm. Pikat tona të forta qëndrojnë te popullsia e re, e arsimuar dhe novatore, që i jep frymë sektorit të teknologjisë së informacionit në zhvillim të shpejtë, projektet strategjike të infrastrukturës dhe burimet natyrore. E gjithë kjo e bën Kosovën tërheqëse për investitorët dhe një

lojtar kyç në rajon. Edhe pse ka sfida, ne i përjetojmë ato si mundësi. Kosova është e përkushtuar ndaj reformave, digjitalizimit dhe forcimit të marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare. Qëllimi ynë nuk është vetëm rritja ekonomike, por qëndrueshmëria dhe konkurrenca afatgjatë. Në këtë frymë, optimizmi nuk është vetëm i domosdoshëm; ai bazohet në një vizion të qartë dhe lëvizje strategjike, që e çojnë Kosovën drejt një të ardhmeje edhe më të fortë dhe më të begatë.

3. Kosova është ende e lidhur me tensione me Serbinë. Çfarë imazhi dëshironi t'i ofroni botës si shtet?

Kosova nuk është vetëm një histori për sfidat e kaluara, por edhe për një të ardhme të mbushur me inovacion, zhvillim dinamik dhe partneritete strategjike. Qëllimi ynë është ta paraqesim Kosovën para botës si një vend i paqes, stabilitetit dhe mundësive ekonomike, një vend modern, i orientuar drejt Europës, që kontribuon në sigurinë rajonale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ne duam të ndërtojmë identitetin tonë mbi tri shtylla kryesore: inovacionin, vlerat demokratike dhe rritjen ekonomike. Kosova është shtëpia e njerëzve të rinj dhe të talentuar, me një shpirt jashtëzakonisht sipërmarrës, të cilët tashmë po arrijnë sukses në industritë globale, nga sektori i TI-së në industritë kreative. Ne duam të jemi të njohur si një vend me institucione të forta, një mjedis biznesi transparent dhe partneritete të forta ndërkombëtare.

Tensionet që përmenden shpesh, fatkeqësisht, nuk janë ende pjesë e së kaluarës, për shkak të regjimit autokratik të Aleksandër Vuçiqit, mirëpo vizioni dhe puna jonë janë të përqendruara ekskluzivisht në të ardhmen. Çdo ditë forcojmë praninë tonë në organizatat ndërkombëtare, punojmë për të forcuar stabilitetin rajonal, zhvillojmë diplomacinë e bazuar në bashkëpunim dhe respekt të ndërsjellë. Sot, Kosova është sinonim i vendosmërisë, inovacionit dhe perspektivës europiane dhe ky është imazhi që duam të ndajmë me botën.

4. Cilat janë marrëdhëniet me fqinjët tuaj, me vendet e tjera të Ballkanit, veçanërisht me Serbinë, e cila për fakte historike nga e

kaluara e afërt pretendon territorin tuaj dhe nuk e njeh shtetësinë e Kosovës?

Kosova mban marrëdhënie shumë të mira me të gjithë fqinjët e saj, përfshirë Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Shqipërinë, të cilët janë partnerët tanë të ngushtë dhe të rëndësishëm në shumë fusha. Megjithatë, ekziston vetëm një faktor në rajonin tonë, që paraqet kërcënim për të gjithë fqinjët, dhe ai është Serbia. Serbia ka marrëdhënie të tensionuara pothuajse me të gjitha vendet fqinje, sepse ndërhyr vazhdimisht në punët e tyre të brendshme dhe përpiqet të destabilizojë rajonin përmes formave të ndryshme të luftës hibride dhe ndërhyrjes direkte, e cila kërcënon sigurinë dhe sovranitetin e vendeve fqinje. Në këtë kontekst, është thelbësore që Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'u qasen seriozisht çështjeve që lidhen me Serbinë. Është e qartë që besnikëria ndaj vlerave dhe parimeve europiane nuk është diçka që mund të blihet me para, investime apo marrëveshje tregtare. Besnikëria nuk realizohet nëpërmjet transaksioneve financiare, si blerja e litiumit, por nëpërmjet ndryshimeve të mirëfillta politike, që nënkuptojnë demokratizimin e vendit. Fatkeqësisht, nuk pres që ministrat që kanë qenë pjesë e regjimit të Slobodan Millosheviqit, si Vuçiq dhe Daçiq, as njerëz që janë në listat e zeza të Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar, si Aleksandër Vulin, të mund të bëjnë reformat e nevojshme për demokratizimin e Serbisë. Ky proces kërkon angazhim të madh nga të gjithë ne, sepse Serbia mbetet në qendër të problemeve politike dhe të sigurisë në të gjithë rajonin. Nga ana tjetër, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë janë jashtëzakonisht të mira në të gjitha aspektet. Së fundmi kemi pasur dy forume ekonomike, ku është dëshmuar interesimi i madh i kompanive kroate për të investuar në Kosovë. Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të jashtëzakonshme në katër vitet e fundit, ndërsa lufta kundër korrupsionit dhe forcimi i sundimit të ligjit kanë tërhequr shumë investitorë të huaj. Ky bashkëpunim në shumë fusha, duke përfshirë ekonominë, sigurinë, bashkëpunimin ushtarak, kulturën dhe arsimin, e bën Kroacinë një partner kryesor strategjik të Kosovës. Më vjen mirë që vazhdon tradita e mirë e bashkëpunimit të viteve '80-'90, kur ishim gjithmonë në të njëjtin krah. Gjithashtu, nuk duhet harruar se të rinjtë shqiptarë nga Kosova luftuan krah për krah me

ushtinë kroate në luftën kundër agresionit serb. Oficerët nga Kosova nuk kishin asnjë shqetësim se në cilën anë ishin në luftën ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë.

Mbështetja e palëkundur e Kroacisë për Pavarësinë e Kosovës, si dhe angazhimi i saj i vazhdueshëm brenda Bashkimit Europian dhe NATO-s për të mbështetur aspiratat legjitime të Kosovës, po ashtu konfirmojnë se Kroacia është një partner i sigurtë dhe i fortë strategjik i Kosovës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përparimin e rajonit tonë. Kosova vazhdimisht qëndron për marrëdhënie të mira fqinjësore, stabilitet rajonal dhe vlera europiane, sepse besojmë se, vetëm përmes bashkëpunimit, mund të sigurojmë paqe të qëndrueshme dhe përparim për të gjithë Ballkanin. Ne kemi marrëdhënie të shkëlqyera me shumicën e vendeve fqinje, të bazuara në respektin reciprok të interesave të përbashkët, qoftë bashkëpunimi ekonomik, çështjet e sigurisë apo integritet euroatlantike. Fatkeqësisht, Serbia vazhdon të ndjekë një politikë të mohimit të shtetësisë sonë dhe në mënyrë aktive po përpiqet të minojë pozicionin e saj ndërkombëtar. Në vend që të përballet me të kaluarën dhe të kthehet nga e ardhmja, Beogradi vazhdon me provokime dhe aktivitete destabilizuese. Megjithatë, Kosova mbetet e fokusuar në dialog, si e vetmja mënyrë për të zgjidhur çështjet e hapura, por në dialog që bazohet në barazi dhe njohje reciproke, dhe jo në përpjekje për të rishikuar historinë apo për të sfiduar të drejtat tona sovranë. Fokusi ynë nuk është në konfrontim, por në forcimin e pozicionit tonë si një anëtar i përgjegjshëm dhe i përkushtuar i komunitetit ndërkombëtar. Perspektiva europiane e rajonit mbetet prioritet dhe ne besojmë se përmes integritit të BE-së dhe NATO-s marrëdhëniet mes të gjitha vendeve të Ballkanit, përfshirë Serbinë, do të jenë më të qëndrueshme dhe më konstruktive në të ardhmen. Në këtë proces Kosova do të mbetet një avokate e vendosur e paqes, demokracisë dhe respektit të ndërsjellë.

5. A mundet që inkursionet e grupeve terroriste dhe nxitja sistematike e trazirave të shkaktojnë destabilizimin serioz të qeverisë dhe të kërcënojnë pavarësinë?

Në shtator të vitit 2023, në Banjë [Banjska], Serbia nisi një sulm të hapur ndaj Kosovës, duke ndjekur taktikat që Putini përdori në Ukrainë.

Ata dërguan një grup luftëtarësh paraushtarakë, të armatosur me armë [nga fabrikat ruse dhe serbe], me qëllim që të pushtonin një pjesë të territorit tonë. Gjatë konfliktit ka mbetur i vrarë hero i ynë, rreshter Afrim Bunjaku. Forcat paramilitare u tërhoqën në manastirin e shekullit XIV në Banjë [Banjskë], ku u mundën, u vranë ose u dëbuan nga forcat tona, pa viktima civile apo dëmtime të manastirit. Më vonë, në nëntor të të njëjtit vit, Serbia kreu një sulm në një infrastrukturë të rëndësishme civile, konkretisht në kanalin Ibër-Lepenc. Ky sulm ndodhi vetëm dy ditë pas një sulmi të ngjashëm të Putinit në Ukrainë, gjë që tregon se shumë nga lëvizjet e Aleksandër Vuçiqit drejt Kosovës janë kopje e taktikave të Putinit. Sulmi, i cili përfshinte rreth 15 kilogramë eksploziv, kishte për qëllim të shkaktonte ndërprerje të mëdha në furnizimin me ujë, energji elektrike, lojëra në internet në Kosovë, duke u përpjekur të shkaktonte panik. Megjithatë, inxhinierët tanë dhe shërbimet e sigurisë e riparuan shpejt dëmin, fillimisht përkohësisht, e më pas përgjithmonë, duke siguruar kështu stabilitetin e furnizimit me energji elektrike. Ne jemi të vetëdijshëm për kërcënime të tilla dhe jemi të gatshëm të përballemi me to, sepse e dimë që Vuçiqi shpesh e përdor Kosovën si një mënyrë për të shpërndarë vëmendjen nga problemet e brendshme, duke mobilizuar nacionalistët në vendin e tij. Ne dhe partnerët tanë duhet të jemi vazhdimisht vigjilentë dhe të përgatitur mirë, sepse me një fqinj të tillë si Serbia autokratike, nën udhëheqjen e Aleksandër Vuçiqit, siguria dhe paqja në rajon janë gjithmonë në rrezik.

6. Së fundmi keni nënshkruar një deklaratë të përbashkët për bashkëpunimin në mbrojtje mes vendit tonë dhe Shqipërisë. Çfarë dëshironi të arrini me të?

Pa dyshim që është një çështje bashkëpunimi, që lind natyrshëm mes tri vendeve që ndajnë një histori të përbashkët dhe që prej shumë vitesh kultivojnë marrëdhënie jashtëzakonisht të mira. Kjo lidhje forcon më tej deklaratën, qëllimi kryesor i së cilës është përmirësimi i ndërveprimit strategjik dhe operacional me forcat tona ushtarake. Kjo marrëveshje mbulon katër fusha kryesore. *Së pari*, vihet theksi në zhvillimin dhe forcimin e industrisë së mbrojtjes përmes bashkëpunimit të tri vendeve. *Aspekti i dytë* u referohet stërvitjeve të përbashkëta, stërvitjeve ushtarake

dhe aktiviteteve të tjera përgatitore, që do të forcojnë më tej njësitë tona përmes koordinimit të ndërsjellë. *Dimensioni i tretë* përfshin forcimin e kapaciteteve të forcave të armatosura të të tria vendeve. *Elementi i katërt* ka të bëjë me gatishmërinë e ndërsjellë për t'u përballur me kërcënimet hibride, duke përfshirë dezinformimin dhe veprimet e aktorëve, me qëllime destabilizuese, veçanërisht atyre me qëllime autokratike dhe hegjemoniste.

Sa i përket NATO-s, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës komunikojnë rregullisht me përfaqësuesit e Aleancës përmes një ekipi të përhershëm ndërlidhës. Të gjitha angazhimet ndërkombëtare janë të koordinuara me NATO-n dhe misionet diplomatike, përfshirë edhe këtë marrëveshje, e cila nuk është e drejtuar kundër askujt, por ekskluzivisht në thellimin e bashkëpunimit rajonal. Marrëveshje të tilla dërgojnë gjithashtu një mesazh të qartë për të gjithë ata me interesa konfliktuale, se vendet tona janë të vendosura të mbrojnë vlerat dhe interesat e tyre të përbashkët. Kur bëhet fjalë për pretendimet e Serbisë, se kjo marrëveshje shkel dispozitat e marrëveshjes së vitit 1996 për kontrollin e armëve, është e qartë se akuza të tilla nuk kanë bazë. Ky dokument nuk kufizon format dypalëshe apo shumëpalëshe të bashkëpunimit ndërmjet shteteve, duke përfshirë bashkëpunimin në mbrojtje. Arsyeja e reagimeve të tilla qëndron në faktin se Serbia e percepton integrimin rajonal si një kërcënim për ambiciet e veta hegjemoniste. Ajo vazhdon të përpiqet të ushtrojë ndikim në rajon dhe të mbajë pretendimet e saj ndaj Kosovës në kushtetutën e saj, e cila paraqet një sfidë të vazhdueshme politike dhe të sigurisë jo vetëm për Kosovën, por edhe për stabilitetin e të gjithë rajonit.

7. A i sheh Bashkimi European vendet e Ballkanit si një kërcënim për stabilitetin e Europës?

Bashkimi European nuk i sheh vendet e Ballkanit si një kërcënim të drejtpërdrejtë për stabilitetin e Europës, por është i vetëdijshëm se paqëndrueshmëria në Ballkan mund të ketë pasoja të rënda për sigurinë dhe prosperitetin e rajonit e më gjerë. Megjithatë BE-ja mbështet integrimin e Ballkanit përmes procesit të zgjerimit, i cili përfshin reforma politike, ekonomike dhe sociale në vendet candidate, vetë BE-ja njeh gjithashtu sfidat specifike me të cilat përballlet Ballkani, duke përfshirë

tensionet etnike, paqëndrueshmërinë politike, korrupsionin dhe ndikimin e aktorëve të jashtëm, si Rusia dhe Kina. Gjatë viteve, BE-ja ka vazhduar të investojë në stabilizimin e Ballkanit, por me theksin se çdo vend duhet të plotësojë kriteret për anëtarësim në BE, duke siguruar kështu stabilitet politik dhe ekonomik afatgjatë. Gjithashtu, BE-ja inkurajon bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Ballkanit dhe përpiqet të ulë tensionet përmes dialogut dhe ndërtimit të besimit, me synimin për të reduktuar potencialin për përshkallëzim konflikti. Megjithatë, BE-ja ende përballet me sfida në lidhje me politikat që ajo udhëheq në disa vende të Ballkanit, veçanërisht në kontekstin e institucioneve demokratike, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Paqëndrueshmëria në këto zona mund të përbëjë një kërcënim për mjedisin më të gjerë të sigurisë në Europë. Megjithëse Bashkimi European nuk i konsideron vendet e Ballkanit një kërcënim në kuptimin tradicional, rajoni ende kërkon vëmendje, mbështetje dhe reforma për të siguruar stabilitetin, që është me rëndësi vendimtare për të gjithë Europën.

8. Keni një diasporë të fortë kosovare, 200 000 në Zvicër, 400 000 në Gjermani etj., cili është roli i tyre në krijimin politik dhe ekonomik të vendit?

Diaspora kosovare, e cila sot është e pranishme në vende, si Zvicra, Gjermania e shumë të tjera, tashmë që nga ky vit ka të drejtën e votës në zgjedhjet parlamentare, në ambasadat tona nëpër botë, që paraqet një kthesë në jetën politike të vendit. Kjo mundësi jo vetëm që i mundëson diasporës të ndikojë në vendimet politike, por siguron një lidhje më të thellë me atdheun, duke forcuar kontributin e saj politik, ekonomik dhe kulturor. Politikisht diaspora ka një rol kyç në formësimin e politikës së Kosovës, sepse me votat e saj merr pjesë drejtpërdrejt në përzgjedhjen e liderëve dhe partive politike, që do ta çojnë vendin drejt integriteteve europiane dhe reformave demokratike.

Diaspora historikisht ka qenë motori i lobimit politik për njohjen e Kosovës në skenën ndërkombëtare dhe tani, me të drejtën e saj të votës, ka mundësinë të formësojë edhe dinamikën e brendshme politike. Ky hap nxit ndjenjën e përgjegjësisë politike të kosovarët jashtë vendit dhe u mundëson atyre që të jenë pjesëmarrës të barabartë në formësimin e së

ardhmes së vendit të tyre. Ekonomikisht, diaspora mbetet shtylla kryesore e Kosovës, veçanërisht përmes remitancave, të cilat përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të PBB-së së Kosovës. Këto remitanca u mundësojnë shumë familjeve të mbajnë jetën e tyre të përditshme, por edhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe në investime. Diaspora luan një rol kyç në financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sektorin e pasurive të paluajtshme dhe nisjen e nismave të reja, që ndihmojnë në uljen e papunësisë dhe forcimin e stabilitetit të tregut të punës. Gjithashtu, përmes investimeve në arsim dhe shëndetësi, diaspora kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndërtimin e themeleve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Nuk duhet neglizhuar ndikimi kulturor i diasporës. Duke ruajtur lidhjet kulturore, gjuhësore dhe fetare me Kosovën, diaspora jo vetëm që mbron identitetin kosovar, por edhe e promovon atë në mbarë botën. Përmes projekteve kulturore, iniciativave arsimore dhe lidhjes së brezave të rinj, diaspora kontribuon në njohjen globale të Kosovës, duke u mundësuar vendeve pritëse të kuptojnë më mirë shoqërinë dhe kulturën e Kosovës. Duke kombinuar këto aspekte, diaspora e Kosovës bëhet një faktor i pashmangshëm në formësimin e së tashmes dhe të ardhmes së vendit. Kontributi i saj nuk është vetëm ekonomik, por edhe politik e kulturor, duke krijuar themele të forta për stabilitet dhe zhvillim të përhershëm. Si diplomat, kuptimi dhe vlerësimi i këtij kontributi më mundëson që të vazhdoj të përmirësoj marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të kontribuoj në afirmimin e Kosovës në skenën globale.

9. Qeveria zvicerane është partner strategjik i Kosovës. Në këtë kontekst, ajo e mbështeti Kosovën gjatë procesit të pavarësisë dhe mbështet respektimin e të drejtave të njeriut të grupet etnike, si: boshnjakët, kroatët në Kosovë, serbët, romët, ashkalitë, egjiptianët etj. Cilat janë të drejtat e tyre dhe si do ta ndërtoni një të ardhme multietnike?

Qeveria zvicerane, si një nga partnerët strategjikë të Kosovës, luajti një rol kyç në mbështetjen e procesit të pavarësisë dhe vazhdoi të ofrojë ndihmë në një numër sektorësh, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe integrimin e pakicave etnike. Zvicra jo vetëm që ka mbështetur

politikisht njohjen e Kosovës, por është gjithashtu e angazhuar në mënyrë specifike në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë, duke përfshirë boshnjakët, kroatët, serbët, shqiptarët, shqiptarët e Kosovës, romët, ashkalitë, egjiptianët etj. Kjo mbështetje nuk është vetëm simbolike, por reflektohen në projekte dhe iniciativa të ndryshme, që u mundësojnë komuniteteve të kenë akses në arsim, kujdes shëndetësor, punësim, por gjithashtu ofrojnë një platformë për pjesëmarrje politike në shoqëri. Në këtë kontekst, të drejtat e pakicave në Kosovë bazohen në kornizën kushtetuese dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kosova. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për arsimim në gjuhën amtare, akses në shërbimet publike pa diskriminim, përfaqësim politik dhe pjesëmarrje në të gjitha aspektet e jetës së vendit.

Qeveria zvicerane, përmes programeve të saj zhvillimore dhe mbështetjes për shoqërinë civile, merr pjesë aktive në fuqizimin e komuniteteve pakicë dhe promovimin e politikave gjithëpërfshirëse të bazuara në të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ndërtimi i një të ardhmeje multietnike për Kosovën kërkon një respekt të thellë për diversitetin dhe një përkushtim të vërtetë për integrimin social dhe politik të të gjitha komuniteteve. Qasja ime ndaj këtij misioni bazohet në disa udhëzime kryesore: inkurajimi i dialogut dhe i bashkëpunimit të ndërsjellë përmes programeve arsimore dhe kulturore që u mundësojnë të rinjve të komuniteteve tona etnike të njihen më mirë, të kuptojnë dhe të bashkëpunojnë. Këtu përfshihen projekte të përbashkëta arsimore, shkëmbime studentore, festivale kulturore dhe platforma për dialog, në mënyrë që të reduktohen stereotipet dhe paragjykimet dhe të ndërtohet besimi reciprok. Kjo është thelbësore për ndërtimin e një mjedisi politik, që do të mundësojë zhvillim të gjithanshëm, sepse çdo qytetar, pavarësisht nga përkatësia etnike, është po aq i rëndësishëm për të ardhmen e vendit. Mbrojtja e identiteteve kulturore mbështetet përmes projekteve, që u mundësojnë të gjitha komuniteteve të ruajnë dhe të ushqejnë identitetin e tyre kulturor dhe gjuhësor, duke promovuar në të njëjtën kohë vlera të përbashkëta që lidhin të gjithë qytetarët. Kosova duhet të jetë një vend, ku diversiteti kulturor do të përjetohet si aset dhe jo si pengesë. Sigurimi i mundësive

të barabarta ekonomike mundësohet duke inkurajuar iniciativa ekonomike dhe akses në punësim për të gjithë qytetarët, përfshirë anëtarët e komuniteteve pakicë. Duke zhvilluar iniciativa biznesi dhe duke krijuar një ekuilibër në punësim, Kosovës i mundësohet të ndërtojë një shoqëri të qëndrueshme dhe të begatë. Qeveria zvicerane, me angazhimin e saj afatgjatë, ka treguar se bashkëpunimi ndërkombëtar mund të jetë çelësi për ndërtimin e stabilitetit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

10. Çfarë mund t'u ofroni investitorëve të huaj në zhvillimin ekonomik të vendit? Jeni një vend me peizazhe malore tepër të bukura, kanione, manastire të vjetra, kisha, xhami etj. Çfarë tjetër mund të tërheqë vizitorët, si do të bëheni më interesantë për turistët?

Kosova ofron mundësi të jashtëzakonshme për investitorët e huaj, jo vetëm për shkak të pozitës së saj strategjike në zemër të Ballkanit, por edhe për shkak të pasurisë së saj të burimeve dhe sektorëve të ndryshëm që presin zhvillim. Si një vend me peizazhe malore jashtëzakonisht të bukura, kanione, manastire të vjetra, kisha dhe xhami, Kosova ofron një kombinim unik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, që është baza për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe një destinacion tërheqës për investime.

Për investitorët e huaj, Kosova ofron disa përparësi kryesore:

Mjedisi i favorshëm i biznesit: Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në miratimin e ligjeve që mbështesin investimet, duke përfshirë lehtësirat tatimore për investitorët e huaj, normat tatimore jashtëzakonisht konkurruese dhe procedurat e përsheptuara administrative. Klima e biznesit është e favorshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe investitorët mund të presin një kthim të shpejtë të investimit.

Fuqia punëtore e kualifikuar: Kosova është krenare për fuqinë e re dhe të arsimuar punëtore, e cila është e gatshme që t'u përshtatet teknologjive të reja dhe sfidave të tregut. Nismat e arsimit dhe të aftësimit profesional sigurojnë që fuqia punëtore e Kosovës të vazhdojë të zhvillohet në përputhje me standardet globale të industrisë, duke e bërë

vendin jashtëzakonisht konkurrues për industrinë e teknologjisë, prodhimin dhe shërbimeve.

Resurset natyrore të pashfrytëzuara: Kosova ka resurse të pasura natyrore, duke përfshirë mineralet, energjinë dhe kushte jashtëzakonisht të favorshme për prodhimin bujqësor. Këto zona, së bashku me projektet e infrastrukturës, krijojnë mundësi të mëdha për zhvillim industrial dhe prodhim, të cilat mund të tërheqin investitorët e huaj për të investuar në sektorin e energjisë, bujqësisë dhe minierave.

Qasja e tregut të Eurazisë: Kosova ka nënshkruar marrëveshje tregtare me BE-në dhe shumë vende të tjera, gjë që e bën atë shumë tërheqëse për tregtinë dhe shpërndarjen ndërkombëtare. Nisur nga pozita e saj e favorshme gjeografike dhe politike, Kosova mund të konsiderohet si pikë hyrëse për zgjerim në tregjet e Bashkimit Europian, por edhe në tregjet e Europës Juglindore.

Sa i përket turizmit, Kosova ofron një pasuri të trashëgimisë kulturore dhe historike, që mund të zhvillohet më tej dhe të profilizohet si një destinacion turistik që tërheq vizitorë nga e gjithë bota.

Për turistët, Kosova ofron: bukuri natyrore dhe është shtëpia e peizazheve malore, lumenjve, liqeneve dhe kanioneve të pabesueshme, disa prej së cilave janë praktikisht të panjohura për turizmin masiv. Turizmi i ecjes, çiklizmit dhe aventurës mund të bëhet baza për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, ndërsa alpinizmi në dimër gjithashtu mund të tërheq vizitorë në kërkim të përvojave autentike.

Trashëgimia e pasur kulturore: Kosova është shtëpia e manastireve, kishave dhe xhamive të shumta, shumë prej së cilave janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, si Manastiri i Deçanit dhe Patriarkana e Pejës. Këto monumente historike ofrojnë një mundësi për turizëm fetar dhe kulturor, duke tërhequr vizitorë që duan të eksplorojnë historinë e pasur të Ballkanit.

Ofertë autentike gastronomike: Kosova ofron specialitete unike gastronomike të bazuara në lokale, përbërës të freskët dhe metoda tradicionale të përgatitjes së ushqimit. Zhvillimi i turizmit të kuzhinës, i cili përfshin vizita në tregjet lokale, restorantet dhe bodrumet e verës, mund të promovojë më tej produktet rajonale dhe të krijojë mundësi të reja biznesi për investitorët.

Zhvillimi i turizmit *Wellness dhe Spa*: Duke pasur parasysh burimet natyrore, burimet termale dhe natyrën e paprekur, Kosova ka potencial për të zhvilluar turizmin *Wellness dhe Spa*, të cilat mund të tërheqin turistët që kërkojnë paqe, shëndet dhe relaksim në një mjedis natyror.

11. Si do t'i tërhiqni vizitorët?

Zhvillimi i infrastrukturës, investimi në promovim, siç është qëndrueshmëria apo turizmi i qëndrueshëm, do të jenë faktorë kyç në arritjen e qëllimit, që Kosova të bëhet një destinacion i kërkuar për turistët. Gjithashtu, përmes marketingut të synuar dhe krijimit të paketave specifike turistike, duke përfshirë turne me tematikë, evente festivalesh dhe manifestime kulturore, Kosova mund të profilizohet si një vend që ofron përvoja autentike, por edhe si një destinacion i sigurt dhe mikpritës. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, Kosova ka potencialin të ndërtojë njohje globale, si një destinacion turistik që ofron bukuri të jashtëzakonshme natyrore, trashëgimi të pasur kulturore dhe mikpritje autentike.

Në fund të fundit, si diplomat, qëllimi im do të ishte që Kosova të njihet jo vetëm si një destinacion ekonomikisht në rritje, por edhe si një parajsë turistike me natyrë të bukur, duke i fisnikëruar kulturën dhe duke ruajtur traditën në çdo aspekt të zhvillimit të saj.

6.2 DR. YASCHA MOUNK

“PËR UASHINGTONIN, BOTA NDAHET NË SFERA INFLUENCE. ATA QË E NDAJNË ATË JANË SHBA-JA, RUSIA DHE KINA”

“Moska do të marrë atë që dëshiron, pa lëshime. Për Trump-in, Ukraina i përket Kremlinit”

Telefonata midis Donald Trump dhe Vladimir Putin sapo ka përfunduar. Një telefonatë nga e cila mund të varet jo vetëm e ardhmja e luftës në Ukrainë, por edhe, në njëfarë mënyre, e ardhmja e të gjithë Europës. Yascha Mounk, politolog, një nga studiuesit kryesorë të krizës së demokracisë liberale dhe të ngritjes së populizmit, ditët e fundit ishte shprehur i shqetësuar për atë që parashikohej të ishte një marrëveshje, ku Ukraina kishte gjithçka për të humbur dhe Rusia gjithçka për të fituar. Pas përfundimit të telefonatës, ai nuk është i habitur.

Kanë kaluar muaj, që situata duket se po shkon në këtë drejtim, me Ukrainën që do të detyrohet të pranojë humbjen e një pjese të territorit të saj sovran. Prej kohësh është bërë e qartë se ajo nuk është në gjendje ta dëbojë ushtrinë ruse nga territori i saj, dhe për këtë arsye, në njëfarë mënyre, një formë ndërprerjeje e luftimeve është e nevojshme. Problemi është se, edhe nëse ky realitet ekziston, do të kishim pasur nevojë për një kusht për të arritur një paqe, në mos të drejtë, të paktën sa më pak të padrejtë.

1. Cili është ky kusht?

Kushti është vazhdimi i mbështetjes publike dhe ushtarake nga Shtetet e Bashkuara dhe Europa, në mënyrë që ta detyronin Putinin të bënte lëshime të vërteta. Frika në këtë moment nuk është armëpushimi, të cilin të gjithë e dëshirojmë, por që do të pranohet që një pjesë e territorit ukrainas të mbetet nën kontrollin e Rusisë dhe që nga Rusia nuk do të kërkohet asgjë në këmbim. Këto dy gjëra, edhe nëse sjellin paqe, nuk do të sjellin një paqe të qëndrueshme, duke marrë parasysht synimet ekspansioniste të Putinit.

2. A del Putini i rehabilituar dhe i forcuar nga kjo telefonatë me Trump-in?

Skandali nuk është që Trump-i flet me Putinin, por mënyra se si flet për të. Trump-i flet për *ndarjen e aseteve ukrainase*. Kjo është një gjuhë biznesi, më shumë sesa diplomaci. Ka edhe një kontradiktë në atë që unë e quaj *instinktin e tij të dyfishtë në politikën e jashtme*: ai flet në mënyrë shumë agresive kur bëhet fjalë për Panamanë, Kanadanë, Grënländën, vende për të cilat duket se ka ambicie ekspansioniste. Nga ana tjetër, kur flet për Ukrainën, por edhe për Tajvanin dhe territore të tjera, ai duket sikur po thotë se interesat e Shteteve të Bashkuara nuk janë të zgjerohen, por përkundrazi, të lënë kontrollin mbi këto territore te fuqitë historikisht armiqësore ndaj SHBA-së. Në të vërtetë, sipas meje, ka një shpjegim për këtë paradoks të dukshëm: Trump-i e sheh botën të ndarë sipas sferave të influencës. Ai beson se Ukraina bën pjesë në sferën natyrore të influencës së Rosisë, se Tajvani bën pjesë në sferën natyrore të influencës së Kinës, dhe se Grënlanda ose Panamaja duhet të jenë pjesë e sferës natyrore të influencës së Shteteve të Bashkuara. E gjithë kjo e shoqëruar me një qasje oportuniste, sipas së cilës objektivi është të përfitohet sa më shumë nga ato zona që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të SHBA-së, dhe të braktisen të tjerat ndaj Rosisë apo Kinës, me një indiferencë të plotë ndaj rendit të mëparshëm botëror.

3. Në këtë kontekst, si e sheh Trump-i Europën?

Europa është një aleate, por ka më shumë ose më pak rëndësi në varësi të asaj se sa u shërben interesave amerikanë. Europa Lindore është në rregull të mbetet nën ndikimin e Rosisë, dhe për këtë arsye nuk mbrohet; Europa Perëndimore është më mirë të mbetet në sferën e influencës së Shteteve të Bashkuara, por në kushte shumë më pak të favorshme sesa më parë. Në këtë kontekst të ri botëror, Europa duhet të vendosë se çfarë të bëjë: nëse dëshiron të jetë një entitet, fati i të cilit përcaktohet nga politikanë apo diktatorë të largët, apo nëse dëshiron të bëhet zonjë e fatit të saj. Dhe nëse dëshiron të marrë në dorë të ardhmen e saj, atëherë duhet të ndryshojë shumë, jo vetëm të shpenzojë më shumë për mbrojtjen, por edhe të bëhet sërish një forcë e vërtetë ekonomike në botë, që do të thotë të prodhojë avionë modernë, të ketë automjete

elektronike konkurruese, të jetë në pararojë të kërkimit mbi inteligjencën artificiale. Për shumë kohë, Europa ka menduar se mund të ndjekë një model si ai italian, një rënie e ngadaltë, por mjaft komode. Në këtë realitet të ri botëror, më duket se kjo mundësi nuk ekziston më.

4. Ursula von der Leyen thotë se, nëse Europa dëshiron paqe, duhet të përgatitet për luftë.

Historia e 20 viteve të fundit na ka treguar se Putini e sheh çdo formë dobësie si një provokim. Ai e ka parë mundësinë e zgjerimit të territorit të tij me Gjeorgjinë dhe Ukrainën, por edhe me vende të tjera, si një ftesë për të nisur një luftë dhe për të realizuar qëllimin e tij të vërtetë: zhbërjen e asaj, që ai e konsideron si tragjedinë më të madhe gjeopolitike të shekullit XX: shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik. Unë besoj se mënyra më e mirë për t'u mbrojtur kundër rrezikut të zgjerimit rus është të kesh një forcë të besueshme penguese, por për ta realizuar këtë, duhet të jesh edhe i aftë të mbrohesh. Askush në Europë nuk dëshiron luftë, por ndonjëherë mënyra më e mirë për ta shmangur luftën është të dish të mbrohesh. *[La Stampa]*

6.3 ALBERT VLASH NIKOLLA

SHQIPJA ME VJETËRSINË E SAJ - NJË ÇELËS MAGJIK PËR GJUHËT INDOEUROPIANE!

Intervistë e realizuar nga dr. Mujo Buçpapaj.

Bisedë me gjuhëtarin dhe filozofin Albert Vlash Nikolla, Bruksel

1. Dr. Mujë Buçpapaj: Në emër të Institutit Ndërkombëtar të Studimeve Filologjike dhe të gazetës “Nacional”, së pari ju urojmë gëzuar Vitin e Ri 2025!

- **Albert Vlash Nikolla:** Uroj gëzuar Vitin e Ri 2025 të gjithë stafin ndërkombëtar të profesorëve e doktorëve të nderuar, anëtarëve të bordit drejtues, por edhe për të gjithë bashkëpunëtorëve në të pesë kontinentet dhe, mbi të gjitha, lexuesve të gazetës “Nacional”!

2. Zoti Nikolla, le të flasim për arritjet e bordit drejtues, sidomos në lëmin e lobimit mbi gjuhën shqipe dhe vjetërsinë e saj. Si e keni përjetuar ju këtë punë të madhe filologjike!

- Ne ishim të gjithë së bashku, për të ngritur lart gjuhën shqipe, jo me gënjeshtër e falsifikime, por me fakte shkencore dhe përpjekjet tona në arenën ndërkombëtare, në sajë të lobimit të pastër edhe të profesorëve të shumtë të universiteteve, anëtarëve të bordit të Institutit Filologjik Kombëtar, që u kurorëzuan duke e klasifikuar gjuhën e bukur që të parët tanë na lanë, si “gjuha më e vjetër ende gjalle në familjen indoeuropiane”. Dhe kjo nuk u krye nga njerëz dosido, por nga më të mëdhenjtë dhe me të pakorruptuarit e shkencës botërore... Kjo ndodhi, sepse ne kudo që shkuam, të gjithë së bashku si shqiptarë, pa përjashtim, folëm me urtësi për bukurinë e gjuhës shqipe dhe madhështinë e të qenit shqiptar, me akademikë dhe shkencëtarë të huaj, me miq të shqipes, ku bindëm kundërshtarët dhe hodhëm në koshin e plehrave të historisë 2 trilionë dollarë të financuara (sipas një përlllogaritjeje të përafërt) nga Shërbimet Sekrete Ruso-Serbe kundër kulturës ilirike. Ky ishte plani sekret i Katerinës së Madhe të Rusisë, të mbiquajtur “Panin”, që

konsistente në financime të fshehta në të gjithë rrjetin akademik botëror përgjatë tre shekujve të fundit.

Tani le të gëzojmë së bashku “DALJEN E SË VËRTETËS SË MADHE”! Drejtësia është vendosur në vend... Ata janë zhytur në kaos dhe nuk dinë se si ta parandalojnë këtë tendencë shkencore, por duhet pranuar kanë në dorë ende Akademinë Shtetërore dhe shumë “udhëheqës” të shtetit shqiptar, që i kanë blerë e korruptuar... Por ne jemi me të vërtetën dhe themi: Rroftë Amerika dhe miqtë tanë perëndimorë! Mendoj se me ardhjen e Donald Trump-it në Shtëpinë e Bardhë, aleanca shqiptaro-amerikano-angleze do të funksionojë me një forcë shumë më të madhe, dhe drejtësia do t’u “këpusë” kokat të gjithë “gjarpërinjve dhe kryekuqendrës antishqiptare”, që kanë dashur të na groposin shtetin, kulturën dhe të na fshijnë nga faqja e dheut si popull...

Ndoshta shumë shpejt do të hapen dosjet e agjentëve të infiltruar në Akademinë e Shkencave... Kjo është Porosia amerikane. Por ne nuk duhet të flemë gjumë. Lufta për mbrojtjen e Shqipes së Shenjtë vazhdon, derisa ajo të zërë vendin që meriton: nëna e gjuhëve indoeuropiane dhe nëna e gjuhëve të botës... sepse shqipja është gjuha gjenetike dhe, rrjedhimisht, gjuha e memories së organizuar të universit...

Anglo-amerikanët dhe gjermanët, që kanë kryer studime të thelluara në laboratorët e tyre gjuhësorë, e dinë mirë një gjë të tillë!

3. Pse ne jemi një popull shumë i vjetër dhe si mund të na e shpjegoni këtë, nisur nga gjuha dhe simbolet?

- Gjuha shqipe është një gjuhë idiomatike dhe matricore. Kjo ishte teoria e algoritmit të brendshëm të Petro Zhejit, i cili ishte një partizan i postulatit të gjuhëtarit të madh francez, Roland Barthes, sipas të cilit “kuptimi i fjalës duhet kërkuar brenda vetë strukturës së fjalës”. Sipas kësaj teorie semantike, falë ndarjes në matrica gjuhësore (elementet strukturore [morfologjike] të ndërtimit të fjalës) ne mund të zbulojmë se emri *flamur*, ta zëmë, vjen nga një frazë e vjetër e shqipes: /*Fe l’am ur*/ [*/*Fe*/ do të thotë */*Fe*/ (*besim*); & */*L’am*/ do të thotë */*shpirti i lindur*/ domethënë */*Le am*/ (*lindet ama*) dhe */*Ur*/, do të thotë */*lidhje*/](shqip dhe sumerisht). Pra, **flamur** do të thotë */**feja e shpirtit të lidhur**/ në konceptin semantik: */**Bashkim në një simbol**/...

Nga gegërishtja dhe toskërishtja së bashku kemi: */ *fe l'am*/, nga ku rrjedh fjala */*flamë*/, një sinonimi i fjalës */*dashuri*/. Nisur nga prejardhja teutone (iliro-gjermanike), gjithashtu mendohet se edhe emri */*Flaman*/ (emri i banorëve të Belgjikës që flasin flamisht), vjen nga fjala "*flamë*" e ilirishtes, që gjendet e pastër në shqipen e sotme. Sipas Ana Seitz, "Në gjermanisht */*die Flamme*/ i thonë */*flakës*/, p.sh., *die */Flamme der Kerze*/. */*The flame*/ në anglisht ka të njëjtin kuptim: */*the flame of the candle*/. Pra, flamuri ynë është *flamë* (DASHURI) shpirtërore dhe tregon origjinën e vërtetë etimologjike të fjalës "FLAMUR" të gjuhës shqipe.


4. Ju keni thënë se jo vetëm gjuha, por edhe vallja e Tropojës është një model i ruajtur i kërcimit iliro-keltik, që ngjan me baletin, pasi është kërcim në hapësirë, por edhe iso-polifonia labe janë shenja etnografike të një vjetërsie fillestare të etnogjenezës sonë?

- Saktë! Kur i drejtohesh një malësori nga Tropoja, Kukësi, Mirdita apo Malësia e Mbishkodrës se "A po na e kërcen një valle?", ai të përgjigjet: "*Pe baj leht*". Mos nuk është e dukshme, se togfjalëshi i shqipes "*ba leht*" ka dhënë fjalën "*balet*"?! Apo nuk ju duket se fjala */*valle*/ ka lidhje me fjalën *vals*... Apo fjala e shqipes geqe */*muz*/, që ka dhënë fjalën */*muzeqe*/, nuk ka lidhje me fjalën */*muzë*/ dhe */muzikë*/?!

Këto lloj fjalësh janë karakteristike e gjuhës iniciale, asaj që ka krijuar konceptet fillestare. Kjo e klasifikon shqipen direkt në një gjuhë të parë, dhe etninë tonë ndër etnitë e para të krijimit të indoeoropanishtes, siç e thotë edhe artikulli i revistës "Science" dhe studimet e Universitetit të Munihut dhe të Institutit Paneuropian "Max Planck".

Po, një ndër mrekullitë e kulturës sonë kombëtare është iso-polifonia labe. Edhe kur kam qenë fëmijë, polifoninë e kam dashur me gjithë shpirt, siç kam dashur vallen e Tropojës apo këngën qytetare shkodrane! ***Atdheu dhe kombi yt të bën të lumtur, nëse ti vendosesh në harmoni shpirtërore me të.*** Por tani unë e dua iso-polifoninë jo në mënyre instiktive, por sepse zbuloj disa gjëra misterioze. Kjo lloj muzike është muzikë kurative, të shëron dhe popullata shqiptare nëpërmjet saj jo vetëm që ka bërë art, por ka ushtruar trurin në një lloj simfonie mendore

(mendimesh) zanore (vibrim tingëllor). Është diçka shumë e thellë, shumë hyjnore. Është ushtrimi më perfekt për zhdërvjelltësinë e trurit dhe kordave zanore. Tani e kuptoj pse toskët janë shumë të zgjuar në mënyrë natyrore. Ata kanë një suport për trurin: alternimin e mendimit me fjalën dhe vibracion kurativ për ekuilibrimin e brendshëm të njeriut. Sigurisht që nuk do t'i dija këto gjëra, edhe pse shkolla na i ka mësuar, por kur më rastisi të bisedoja me një akademik francez, ai më tregoi se në Akademinë Franceze në Paris kishin kënduar bashkë një këngë labe, *“për të ndier vibrimin e saj, për t’u çliruar dhe për të krijuar unitetin dhe koherencën shpirtërore në grupin e akademikëve”*. Sinqerisht që mbeta pa fjalë! Pra, ata e shikonin iso-polifoninë shqiptare si ushtrim të madh mendor e shpirtëror.



5. Kemi dy kampe të mëdha gjuhëtarësh. Një pjesë pretendojnë se shkrimet e shqipes fillojnë shumë herët, që në prehistori, të tjerët

thonë se fillojnë me “Formulën e pagëzimit”. A keni shembuj konkretë të shkrimit të shqipes në ndonjë variant primitiv.

- Shqipja duke qenë një gjuhë shumë e vjetër, është shkruar në të gjitha periudhat dhe me alfabetë të ndryshme. Ne duhet t’i ridefinojmë konceptet tona për shqipen. Janë shkrimet gjeometrike, që janë gjetur në të gjithë territorin e Shqipërisë (piktogramet e Xhuxhës dhe shkrimi gjeometrik i Shkallës në Xibërr të Matit). Por duke qenë se sumerologu George Smith për të deshifruar shkrimet e sumerëve u mbështet në të folmet shqipe të Alepho-s në Siri, po ju jap si shembull një fragment sumerian, që e keni në foton e mësipërme. Nuk është deshifrimi im, por është deshifruar nga specialistë të sumerishtes, ku dallohet lehtësisht në deshifrim një frazë e gegërishtes **/Ka i nim ma/ [Ka (Nga) i (një) ndi (dëgjoj) ma (mba)]*, do të thotë “*kainime*” (*këngë*), siç thonë shkodranët: “*ka i nime (po e dëgjojmë)*, në konceptin lloj këngë i veçantë *iso-polifoni*. Shqipe primitive e qartë! Del njëfarë akademiku shqiptar, dhe thotë se iso-polifonia shqiptare e ka origjinën nga koret bizantine! Mos vallë lelegët, fis parailir, për të cilin na flet akademiku i madh francez, Louis Benloew, në veprën e tij “Greqia para grekëve” nuk kanë kënduar? A e kuptoni se çfarë lloji akademikësh ka Shqipëria aktualisht?

6. Ju keni deshifruar një numër shumë të madh shkrimesh, të cilat konsiderohen si “greke” nga studiues që nuk e njohin shqipen, ndërkohë që tekstet janë në ilirisht.

- Varet se çfarë quhet ilire. Termi “ilir” është konvencional. Kështu na kanë quajtur të huajt, por ilirët si e kanë quajtur veten? Mos e kanë quajtur pellazgë, mos e kanë quajtur epirotë, mos e kanë quajtur maqedonë! Ju e dini se në flamurin e ushtrisë maqedonase, që erdhi përkrah popullit të Brukselit në Mesjetë dhe që ishin me flamurin që ne kemi sot, shqiptarët vetëquheshin maqedonë?! Këto janë fakte të dokumentuara. Por ka fakte të tjera më të hershme, sepse tribuja helene ka qenë një tribu ilire, dhe e ke në mbishkrimin e Kretës së shekullit XII para Krishtit rmërtimin */Eliros /*. Privatizimi i kulturës nga “grekët e rinj” ka qenë një nga falsifikimet më groteske dhe qesharake, sepse me kalimin e kohës gjithë e më shumë përralla po “zhbëhet” dhe me gjithë financimet agjenturore në rrjetin shkencor botëror, falsifikimi po del në

shesh. Po nuk është vetëm ky një fakt, sepse artefaktet janë të panumërta. Ja të marrim një mbishkrim, i cili i atribuohet Herkullit, por që në të vërtetë del të jetë një seri mbishkrimesh për Anteun. Në të shkruhet “*Ante po tosh*”, që korrespondon me shqipen e sotme “*Anteu po dosh*”, në konceptin kuptimor “*Anteu po do shumë*” (*po e do pa masë - i shkreti ka ra dekun n’dashni*), kërkon dorën e vajzës ilire, se dhe ai është ilir, dhe kjo sipas “shkencës akademike të lopëve të çmendura angleze” refuzon se është e vogël. Problemi është se këta mbajnë qeleshe shqiptare dhe nga një yll ilir në kokë... Sipas riteve labe, për ta marrë nusen duhet të provosh se, edhe në kohërat më të vështira, duhet të jesh i aftë të sigurosh ushqim për familjen (të vjedhësh desh e dema, të bësh trimëri, pra të tregohesh trim Vlore. Shihni qeleshet e lebërve në gdhendje).



Deshifrimi i shkrimit të Xhuxhës, nga Albert V. Nikolla | Radi & Radi

7. Askush nga Akademia e Shkencave apo nga ato albanologjike nuk ka guxuar të dalë hapur kundër studimeve tuaja. Si do ta shpjegoni një fakt të tillë?

- Hapur jo, sepse shkencërisht asnjëri nga trimat e pseudo-shqiptarizmit nuk është i aftë dhe i ditur që të përballlet me mua si në media, ashtu dhe në publik. Sulmohem pas shpine me thashetheme, dhe madje në disa televizione u është ndaluar rreptësisht që unë të ftohem në

emisione. Ka urdhër nga lart, nga Luminati! Për shembull, në televizione të tilla, si grupi mediatik “Klan”, me sa duket u është dhënë urdhër gazetarëve të mos thirrem. Në shumë institucione zyrtare thuhet nën zë, se “*Albert V. Nikolla nuk është shkencor, sepse bën etimologji popullore*”, kjo sipas akademykëve të certifikuar “Carush Belgradushi”, “Qirje Spirodhopulos” apo Dullabedin Shutriç), pavarësisht se ka 23 vite shkollë (pesë vite në Belgjikë) dhe është Prof. Doc. Emeritus ne Europë. Dhe, për më tepër, bën gabim që vërteton tezën e William Rathbone Greg (1833), se greqishtja e re është një komplikacion teknik i shqipes arvanite. Problemi është se tezat e mia ua plasën në tavolinë drejtuesit e Universitetit të Munihut dhe të Akademisë së Shkencave të Austrisë, dhe ata ndenjën si mumie, pa bërë as “gëk e as mëk”.

8. Ju keni nxjerrë në dritë fakte dhe dokumente të pakundërshtueshme, ku hidhni dritë mbi një unitet ilirik të Ballkanit dhe provoni faktin, që gjuha e vjetër greke ishte një standardizim i ilirishtes ashene të Atikës, duke shtuar se arvanitët janë pasardhësit e vetëm gjenetikë, gjuhësorë dhe kulturorë të grekëve antikë.

- Nuk e kam thënë këtë, sepse “një ditë të bukur me diell u zgjova dhe ma tha truri si shpikje entuziaste”. E thotë Straboni... Vini re, Straboni i mbiquajtur si një nga burimet më të sigurta historike dhe gjeografike nuk e shënon në kartën e tij gjeografike Greqinë, pasi i gjithë Ballkani ishte thjesht ilir, dhe preferon ta shënojë Iliri. Dhe helenët (nga të dhënat e tij), ishin thjesht një fis ilir i Jugut. Të njëjtën gjë bënë dhe romakët. *Gjithë Ballkani shënohet Iliri*. Mos vallë Straboni ka qenë një nacionalist shqiptar si unë. Tani kush gënjen, këta akademykët e sotëm apo Straboni dhe romakët? Le të ma japë ndonjëri ndonjë përgjigje.

9. E megjithatë, ju keni shprehur një respekt të madh për popullin e sotëm grek! Mos vallë këtu ka një kontradiktë?

- Të duash popullin grek nuk do të thotë të mos i thuash të vërtetat. Ata kanë gjak të vjetër helen (Kuptohet nga pjesa arvanite), por e kanë varrosur kulturën e tyre me braktisjen e gjuhës arvanite. Sa për njerëzit, me ata që kam takuar, them se aktualisht janë një popull i mirë, pavarësisht se politika krijon konflikte mes nesh dhe atyre. E kam

vizituar shumë herë Greqinë, dhe populli është Mikpritës, dashamirës. Na presin shumë mirë, na thonë se jemi vëllezër të një gjaku, po shumica e tyre, duke qenë se e kanë humbur gjuhën e vjetër greke dhe flasin një gjuhë pa dialekte...(Gjuhë pa dialekte vetëm në Greqi gjen), janë si krijesa paksa të çuditshme për ne... Popullin grek, atë që është i pastër dhe pa krime, e dua... Po, do ta dua dhe me shume kur të fillojmë ta ndajmë historinë së bashku pa hile dhe kur të ndalojnë gjenocidin kishtar mbi arvanitët, dhe tu lejojnë atyre mësimin e gjuhës se tyre amtare, arvanishten. Unë e kam thënë se ne kemi të njëjtin gjak e këtë e provon **gjeni shqiptar EV-13**, Por ata s’duhet të marrin rolin e Kaimit dhe të kryejnë gjenocid kulturor mbi ne... Ne si popuj jemi dy anët e ndryshme të së njëjtës medalje, dhe situatën e sotme të ndarjet në 7 shtete të Ilirisë së vjetër, nuk e kemi zgjedhur ne, por na e kanë imponuar fuqitë e mëdha, kryesisht Rusia. Dokumentet mesjetare vërtetojnë se Greqia është banuar vetëm nga arbanë, pra shqiptarë. Dokumentet janë kokëforta.

10. Këto që thoni janë pretendime shumë të forta. A ka vërtet dokumente për këto që shprehët?

- Para se gjuha teknike greke, koinea, të shpikëj në Hilandar nga priftërinjtë e Orlovit rus, ka dalë e botuar në frëngjisht një vepër enciklopedike, “Maqedonia, Epiri, Thesalia dhe Morea, përfshirë edhe ishujt”, pra “Magma Greca” nuk ishte gjë tjetër, vetëm se Iliria natyrore dhe kjo tregon se flitet ilirisht dhe më pas arbërisht në të gjithë Ballkanin. Mos vallë gjeografët e huaj që kanë vizituar Ballkanin dhe veçanërisht viset e Greqisë së sotme në shekullin XVIII-XIX gënjejnë, apo nuk i kanë dalluar grekët? Kush i ndau, kush i përçau territoret ilire, dhe pse Europa i trembej rikthimit të Ilirisë si një superfuqi e ardhshme?! Pse në Mesjetë deri në shekullin XIX nuk gjendet asnjë shenjë e grekëve të sotëm me gjuhën e tyre greke koinea? Nga mbinë këta grekët e sotëm që ngjajnë shumë me ortodoksët karamanlinj turq, që u zhdukën si me magji nga Turqia dhe u shfaqën në Greqi. Si na u transformuan me “urdhër të peshkut” në grekë, duke asimiluar pasardhësit e grekëve të vjetër, arvanitët e lavdishëm? Shkatërrimin e Ilirisë, pra edhe të kombit iliro-shqiptar, e shkaktoi pushtimi osman. Të gjithë gjendjen e sotme konfliktuale mes grekëve dhe shqiptarëve, tjetërsimin e ortodoksëve

shqiptarë të Maqedonisë në sllavo-ortodoksë, e shkaktoi pushtimi turk. Pastaj turqit, meqenëse ishin pa kulturë, filluan të vjedhin simbolet e etnisë ilire.

11. Ju keni thënë se në vjedhjen e simboleve shqiptare, Turqia nuk i lë gjë mangët Greqisë së rishpikur. Na jepni një shembull konkret?

- Gjithë bota e quan grek Aleksandrin e Madh, ndërsa vetë Leka thotë “jo” në kurorën e tij. “Jam ilir” - bërtet, me hënën dhe diellin ilir si kurorë. Tashti, turqit mongolë e kanë në flamur simbolin e kurorës së Aleksandrit. Ata na thonë se kanë “uzurpuar për të na çliruar ne nga simbolet dhe historia jonë”, pasi na shembën me gjyle topash mbi 37 qytete, ku mund të përmendim Gurin e Bardhë të Matit, Stefigradin e Dibrës, Stelushin e Mirditës, Sebastien e Laçit, Danjën e Lezhës, Drishtin e Shkodrës, Drojën e Mamurrasit, Sarden e Pukës, Turamin e Petrelës e Tiranës, Justinianën e Prishtinës, (ku tash u gjetën themelet e kishës së vjetër paleo-kristiane, sipas arkeologëve francezë). Dhe pasi na e bënë gjëmën duke na ndaluar edhe gjuhën me fermanin Sulltan Hamidit I, të vitit 31 maj 1779, miratuar nga parlamenti otoman, ne si popull jemi të detyruar të shohim edhe filmat madhështorë të Sulejmanit të Madh...

Pra, pasi na zhveshën nga civilizimi ynë madhështor dhe u tallën me ne si macja me miun e, pas gjithë kësaj, vazhdojnë prapë të tallen hapur: *“Ju shfrytëzuam si skllevër duke ju vjelë taksa e xhelep, jua vodhëm të ardhmen duke shkatërruar dy nga universitetet më të vjetra të Europës, në Durrës dhe Shkodër; dhe duke ju lënë të pazhvilluar! Dhe në fund, pasi jua morëm dhe sarkofagun e Meleagrit në Durrës, po ju marrim edhe historinë, simbolet tuaja, se s’keni ç’i doni”*. Dhe jo dosido, po ata të Aleksandrit të Madh na bëjnë madje dhe dhurata: “Po ju lëmë kafenetë me opium, qebaporet dhe haletë publike”. Kësaj i thonë vëllazëri otomane! Shihni fotografitë e skulpturave... Enki me qeleshe dhe me yllin sumeriano-ilir, Aleksandri gjithashtu me kurorën e tij, madje edhe Jupiteri (kjo statujë quhet dardano-latine). Latinë me qeleshe shqiptare... pak për të qeshur kjo, apo jo. Dhe pse ky Jupiteri latin ka një qeleshe sumero-hitito-iliriane të hënës dhe diellit?

Pyetja shtrohet pse zoti sumer **/Enk-i/*, u bë **/Enk-eleid/ilir* dhe më pas vuri qeleshe ilire dhe themeloi Romën Dardane, sipas Virgjilit? Dhe pse në gjermanisht engjëllit i thonë **/Enkel/* dhe në anglishtja **/Angel/*.

12. Ju gjithashtu keni deshifruar dy pllaka atike, të zonës së Korintit, të cilat gjithashtu janë në ilirishte?

- Herë pas here deshifroj disa pllaka kur kam kohë. Njohja e mekanizmit morfologjik dhe matricor të shqipes dhe deontologjia e deshifrimit të shkrimeve, të cilat janë baza e kërkimeve arkeologjike të universitetit të Gjenezës, janë udhërrëfyese për saktësinë shkencore të deshifrimeve. A është shqip kjo frazë e ilirishtes? ΙΣΕ ΠΡΥ ΤΑΝ Ε ΥΕ = ISHE PRY TAN E YE= ISHE PRITAN E JE. Kjo është greqishtja antike, një ilirishte e pastër. Kur unë thashë se “helenishtja antike ishte një parashqipe e standardizuar me urdhër të Pisistratit”, më shanë e më mallkuan grekë dhe shqipfolës. Por tani, në çfarë vrimë duhet të futen, kur erdhi e ua tha të gjitha profesori i studimeve albanologjike në Universitetin e Munihut, se “*shqipja ka lidhje shumë të forta me greqishten e vjetër*”. Por ka me mijëra, për të mos thënë me qindra mijëra mbishkrime të tilla. Lexoni në plakën e varrit: **/HEROI TOI MARATHONONOI/ (ARVANITE) */ HEROI TON MAR-A -THAN -OI/*, (GEGNISHTË) dhe **/HEROI JON MARATHONOI/-* (Toske) **/Termâ pile* (mirditorçe/: *Termal Pile* (ngjitje shumë e pjerrët - e vështirë) , **/Mar a thôn/*, – (*Mbarë është thënë*) plus **/O Mak/* (*Është mbartut – Mbartësi i lajmit të mirë*)... *Diogjeni i thotë Aleksandrit: */A po sko ti son / (A po shko ti të shikoj)* – pra m’u hiq nga rrezja e shikimit... *Tani më shqip se kaq a ka?! (Location of ancestor haplogroup -7,000 years before present E-V13, Cardium Culture, R1bZ2103 Yamnaya Culture, J2b-L283 Sumerian)*

13. Këto janë zbulime impresionuese! Po shkenca gjuhësore botërore, çfarë thotë?

- Tani unë s’jam “shef i shkencës gjuhësore”, por shkenca botërore vërteton edhe gjuhësisht, antropologjikisht dhe gjenetikisht ato që kam thënë unë nga ana gjuhësore. Të dhënat gjenetike dhe antropologjike, të cilat përcaktohen në një nga hartat e mëposhtme, vërtetojnë se kultura

cardium, e cila përfarohet me gjenin EV-13 plot 9-mijëvjeçare, fiton betejën gjenetike me kulturën “Yanaya” (Kurgane -R1b-Z2102), e cila del të jetë 3 mijë vite më e vonë si fillesë. Madje edhe kërkimet e fundit gjeologjike mbi zonat e mundshme të mbijetesës gjatë periudhës së akullimit të madh, aty ku ka mundur të mbijetojë homosapiensi evropian i quajtur “Kromagnon”, tregon se në Europë ka pasur vetëm dy zona ku mbijetesa ishte e mundur: a) zona nga Mallakastra deri në Peloponez, për shkak të zefirit afrikan dhe burimeve të gazit natyror që digjeshin në gjendje të lirë (të cilat i përmend edhe Straboni) dhe b) zona ku jetojnë baskët e sotëm, për shkak të rrymës së ngrohtë detare “Golfstrim”. Kështu që historia e vjetërsisë së paraardhësve të shqiptarëve është një nga teoritë më të kopsitura dhe më të plota që ekzistojnë, sa u takon përputhshmërive shkencore.

Burimi: <file:///home/sadri/Downloads/Nacional%20%20%20746.pdf>

VII. KOMENTI

7.1 EMIN AZEMI

Datat serbe të ripushtimit të Maqedonisë së Veriut inspirojnë kryetarin e Kumanovës, Dimitrievskin

Më 24 tetor 1912, rreth orës 15:00, Divizioni i parë i Ushtrisë Serbe “Morava” hyri triumfalisht në Kumanovë, që shënoi edhe fundin Luftës së Parë Ballkanike. Në këtë betejë, siç dihet, shqiptarët e pësuan më keq pas tërheqjes së trupave turke. Ato, në fakt, ngelën të vetmuara në frontin e përballjes me serbët, por këta të fundit kishin epërsi të konsiderueshme taktiko-ushtarake dhe thyen çdo rezistencë.

Në betejën e Kumanovës dominoi miti për Kosovën, të cilin gjeneralët serbë e kishin mbjellë tek ushtarët e tyre. Në një pankartë të saj, ushtria serbe triumfin në fushëbetejën e Kumanovës e shpreh duke ushqyer mitin për Kosovën dhe si hakmarrje pikërisht në Kumanovë. Beteja e Kumanovës nga serbët u përdor si revansh ndaj humbjes së tyre në Betejën e Kosovës (15 qershor 1389). 24 tetori i 1912-ës në memorien serbe ka hyrë si datë e rëndësishme e rikthimit të fuqishëm në gjeopolitikën e dominimit të dhunshëm mbi popujt e tjerë të Ballkanit, përfshi edhe shqiptarët.

Në anën tjetër, kjo datë në memorien e shqiptarëve ende kullon gjak, sepse i gjithë mllefi dhe urrejtja e Serbisë mbi Perandorinë Osmane u shkarkua mbi shqiptarët, duke i masakruar, djegur e dëbuar këta të fundit nga trojet e tyre. Por nuk e paskemi ditur që kjo datë e kobshme paska qenë aq e dashur dhe aq inspiruese edhe për kryetarin e Kumanovës, Maksim Dimitrievskin, i cili pikërisht në këtë datë, 24 tetor, në prani të politikanëve të koalicionit aktual qeverisës ka hapur solemnisht Konsullatën e Serbisë në Kumanovë.

Analogjitë historike nganjëherë mund të jenë coincidenca krejt të rastësishme, por në rastin konkret të zgjedhësh një datë historike të Serbisë (24 tetor 1912), që shënonte fillimin e ripushtimit të këtyre trojeve, që atëherë quhej Juzna Serbia, ku është Maqedonia e sotme e Veriut, jo vetëm që nuk paraqet jorastësi, por provokim direkt ndaj

shqiptarëve dhe të gjithë atyre që e paguan shtrenjtë invazionin serb, para më shumë se 100 vjetësh.

Kryetari i Kumanovës, Maksim Dimitrievskin, ka të drejtën e Zotit të deklarohet serb, sepse kjo është një e drejtë që buron nga të gjitha parimet e rregullat qoftë juridike, qoftë njerëzore, por nuk është në rregull që sensibilitetet e tij të fshehura proserbe t'ia imponojë një qyteti të tërë, me strukturë të larmishme nacionale e fetare.

Nuk iu deshën të kalojnë as dy ditë pas pjesëmarrjes së tij në promovimin e një libri anti-UÇK, që Dimitrievski, si bashkë me disa pjesëmarrës në koalicionin aktual qeverisës, sërish të dërgojë mesazhe të gabuara, kësaj radhe duke zgjedhur një datë nga historia e hegjemonisë serbe (24 tetor 1912) dhe duke e vendosur atë datë në kalendarin e ri të ngjarjeve aktuale, siç është hapja e një konsullate serbe në Kumanovë.

VIII. RECENSIONE

8.1 DR. VALBONA EMINI PLLAHA

Eskadronët e vdekjes, kronikë e komunikimeve dezinformuese, shtyllë e së vërtetës në procesin e drejtësisë tranzicionale

“E vërteta që nuk thuhet tretet dhe shuhet”

Abstrakt

“Eskadronët e vdekjes” me autor Bardhyl Mahmutin, është një roman historik, kronikë që flet të vërtetën dhe shërben si mburojë ndaj komunikimeve dezinformuese, një kontribut i rëndësishëm në proceset e realizimit të drejtësisë tranzicionale. Kronika e një kasaphane të pajis me njohje të thellë dhe të detajuar për gjenocidin që përjetoi Kosova në vitet ‘98-‘99 dhe përmes situatave të përshkruara qartësisht na sjell në vëmendje se rruga e drejtësisë është plot pengesa dhe peripeci. Po ashtu, duke vënë përballë komunikatat zyrtare serbe të publikuara me rrëfime reale të dëshmuara, fjalën e lirë dhe rreziqet që vijnë prej saj autori na fton në reflektim dhe gjykim kritik të ngjarjeve, për të cilat shpesh e vërteta është fshehur, devijuar dhe manipuluar.

I qasemi “Eskadronëve të vdekjes”, për të kuptuar rëndësinë e dokumentimeve, shkrimeve në formën e kronikave dhe dëshmimeve me besimin se vepra të tilla u shërbejnë jo vetëm proceseve të drejtësisë, por edhe ndërtimit të kujtesës kolektive mbi themelet e së vërtetës, si një element i domosdoshëm në parandalimin e përsëritjeve të ngjarjeve të tilla në të ardhmen. Kronika e një kasaphane i ofron lexuesit një dritare njohjeje nga disa këndvështrime, madje edhe përmes optikës së palës armike, që mund të shërbejë si “Kalë Troje” në proceset e drejtësisë tranzicionale, kryesisht në shtyllën e parë kryesore të saj: “njohjen e së vërtetës”.

Fjalë kyç: dezinformim, dëshmi, njohja e së vërtetës, kujtesa kolektive, gjenocid, drejtësi tranzicionale

E drejta për të njohur të vërtetën - një ndër shtyllat kryesore të drejtësisë tranzicionale

“Verba volant, scripta manent” është postulati që kam zgjedhur të hap këtë studim, duke dashur të theksoj rëndësinë e shkrimeve që dokumentojnë ngjarjet konfliktuale, si domosdoshmëri për popujt që përfetojnë mizori masive të shkaktuara nga udhëheqës diktatorialë apo shtete të drejtuara nga interesa politikë, ekonomikë, etnikë, socialë, gjeopolitikë etj. Në këtë fokus kemi renditur veprën e Bardhyl Mahmutit, *“Eskadronët e vdekjes: kronikë e një kasaphane”*, si një ndër veprat me vlerë *Scripta Manent*, pasi mendojmë që do t’i shërbejë zbardhjes së çështjeve që lidhen kryesisht me ngjarjet e ndodhura në Kosovë në vitet 1998-1999, duke veçuar rëndësinë e njohjes së të vërtetës, parandalimin e zhbërjes dhe transformimin e saj, si një element thelbësor në procesin e drejtësisë tranzicionale. Kur flasim për drejtësi tranzicionale [1], duhet të kemi parasysh se ky term është shfaqur për të përshkruar një shoqëri që merret me abuzimet e të drejtave të njeriut në të kaluarën, trajton mizoritë dhe u qaset abuzimeve jo vetëm me mjete juridike, por edhe me ato jojuridike.

Për të treguar rëndësinë dhe rolin e kësaj vepre dhe veprave të ngjashme në procesin e drejtësisë, është me rëndësi të fokusohemi në studimin objektiv të rrëfimit, renditjes së dëshmive dhe gjendjeve të përjetuara, akuzave, problemeve dhe zgjidhjeve të mbetura pezull, dokumentimeve zyrtare, proceseve gjyqësore etj., pasi besojmë se çdo studim do t’i shërbejë mbrojtjes së të vërtetës së një kombi, të vërtetat e të cilit klithin nga terrori, padrejtësia dhe abuzimi.

Bardhyl Mahmuti përmes rrëfimeve krejtësisht të vërteta, të vendosura herë në personazhe reale dhe herë në personazhe imagjinare [2], na ka njohur me ngjarjet e ndodhura në Kosovë kryesisht në fund të viteve ‘90. *Kronika e një kasaphane* është rrëfim dhe dokumentim qysh në pjesën e parë dhe kështu vazhdon të jetë në 9 pjesët e tjera, duke i plotësuar situatat e përshkruara me dëshmi të ndryshme, nga këndvështrime të ndryshme: *të viktimave, fajtorëve, urdhëruesve, zbatuesve* etj. Por në ndryshim nga veprat e tjera, në të cilat vdekja është ajo që sjell trishtimin, këtu nuk është vdekja si e tillë, nuk është vdekja në vetvete ajo që ngjall dhimbjen, mëshirën dhe zemërimin, por format e

zgjedhura dhe torturat barbare. Ndaj mendojmë se “Eskadronët e vdekjes” janë si “Ferri” i Dantes, rrathët e së cilit janë të mbushur me gjak, përdhunime, abuzime, vrasje fëmijësh e pleqsh, llamba kafkash [3], foshnja të ngulura në thika, kufoma të ngrira, viktimat të varrosura dhe zhvarrosura, gjymtyrë të thyera, tortura e kërcënime...

Në vepër autori e pasqyron me detaje se me çfarë agresioni iu desh të përballëj populli shqiptar i Kosovës; rrëfen dhunën, vrasjet, përdhunimet, bastisjet, po ashtu transformimet, manipulimet, heroizmat dhe antiheroizmat dhe, për ironi të fatit, tregon edhe më qartë se “terroristët” shqiptarë, për të cilët propagandonin mediat serbe dhe me të cilët u përballën serbët, nuk ishin veçse *fëmijë, gra, pleq, civilë të paarmatosur...*

Këtë e pohojnë edhe vetë ushtarët serbë, ndër të cilët Rade M., i cili shprehet se *“nuk ka pasur asgjë heroike, asgjë që të na bëjë të mburremi, kemi përdorur tanket kundër grave, fëmijëve, pleqve, plakave dhe njerëzve të paarmatosur...[4]*. Përmes njohjes së veprave të tilla dhe përballjes me të vërtetën pengohet dezinformimi publik dhe mbrohet kujtesa kolektive, vlerësohen traumat e një shoqërie postgenocidi dhe dëmshpërblehen viktimat, merren masat për ndëshkime penale dhe vendosen para drejtësisë fajtorët e vërtetë.

Nëse ne ende sot gjendemi përballë pyetjes: *“Si është e mundur që eskadronët e vdekjes i kanë shpëtuar ndëshkimit [5]”*, do të thotë që drejtësia tranzicionale po shmanget dhe të vërtetat që nuk sjellin ndëshkim, i vrasin sërish viktimat.

Ndaj që të funksionojë si duhet drejtësia tranzicionale [6], duhet që procesi të jetë i besueshëm dhe transparent, të qëndrojë mbi interesat individuale, të shmangë nxitjen e urrejtjes dhe të qartësojë jo vetëm të vërtetat e së shkuarës, por edhe të marrë masat e duhura dhe t’i shërbejë ndërtimit të paqes mbi themele që nuk do të lëkunden sërish në të ardhmen për interesa etnikë, politikë, ekonomikë e gjeopolitikë. Duhet të jetë një proces që vëzhgon dhe studion situatat aktuale dhe ndikon në parandalimin e përsëritjes së ngjarjeve të dhunshme në të ardhmen.

Ky proces duhet bazuar në katër shtylla kryesore [7], që lidhen kryesisht me:

1. të drejtën për të njohur të vërtetën,

2. të drejtën për të siguruar drejtësi,
3. të drejtën për dëmshpërblim,
4. garancinë për mospërsëritje. [8]

Këtij procesi duhet t'i bashkohen proceset e reformave institucionale përkatëse, që sigurojnë zbatimin dhe përmbushjen e kriterëve me korrektësi dhe transparencë, konkretisht:

1. krijimi i komisioneve të së vërtetës,
2. ndjekja penale e fajtorëve;
3. krijimi i institucioneve që vlerësojnë dëmin (*fizik, emocional, material, social etj.*) dhe sigurojnë jo vetëm shpërblime monetare, por edhe simbolike (*krijimi i vendeve të kujtesës, datave përkujtimore, aktiviteteve sensibilizuese, vlerësimi i figurës së viktimave etj.*),
4. krijimi i reformave institucionale për garantimin e sigurisë dhe mospërsëritjes së mizorive masive [9].

Këto procese janë treguese të qarta të veprimeve, që instancat kombëtare e ndërkombëtare duhet të ndërmarrin për t'u angazhuar seriozisht në të shkuarën e popujve që kanë qenë viktimë e gjenocidit, me qëllim parandalimin e dhunës dhe krijimin e një të ardhmeje më të sigurt. Ndaj nëse ky proces realizohet si duhet dhe në kohën e duhur, e vendos të vërtetën në themele të palëkundura nga dezinformimet e prodhuara në masë, që përhapen në forma nga më të ndryshmet, të nxitura nga interesa që e devijojnë fokusin kryesor.

Duhet të kemi parasysh, që dezinformimi në shoqëritë që janë përballur me konflikte dhe mizori, nxit urrejtje, rebelim dhe akte të dhunshme; dezinformimi e vesh fajtorin me pafajësi dhe viktimën e kthen në terrorist. Pikërisht kjo është një ndër problematikat që autori e trajton shpesh në vepër, duke e vendosur theksin te ndikimi që transformimi i së vërtetës ka te marrësi, por edhe në proceset e drejtësisë, ndaj përmes rrëfimeve njihemi me format e ndryshme të dezinformimit që prodhon media e drejtuar nga politika (qeveritarët) serbe përmes propagandës kryesisht ndaj:

- qytetarëve të vet, rezervistëve, ushtarakëve dhe policëve serbë, me qëllim nxitjen e urrejtjes dhe mobilizimin për luftë ndaj shqiptarëve të Kosovës (të etiketuar prej tyre si “terroristë”);

- ndërkombëtarëve për të fshehur të vërtetën, për t'u shfajësuar dhe për të përfitur ekonomikisht, politikisht etj.

Nëse lexojmë rrëfimin e tankistit serb "T84" tek "Eskadronët e vdekjes", kuptojmë qartë se si shumë krime të forcave të armatosura serbe iu adresoheshin shqiptarëve të Kosovës e veçanërisht UÇK-së: *"Pas tërheqjes së këmbësorisë, në fshat u futën njësitet e Forcave të Veçanta Policore dhe eskadronët e vdekjes. Edhe pse na u komunikua se kishim shkatërruar zonën që konsiderohej si Zonë e Terroristëve, artileria vazhdonte të bombardonte Bjeshkët e Berishës, ndërsa ne u urdhëruam të ktheheshim te Kryqi i Komoranit... Të nesërmen secilit prej nesh na sollën nga një kopje të shkrimit të titullar "Xhelatët e Kleçkës", të publikuar në gazetën serbe. Dëshmi të tmerrshme! Terroristët e së ashtuquajturës UÇK kishin aplikuar recetat e nazistëve të Aushviçit.*

Po ashtu edhe rasti i vrasjeve në kafenenë "Panda" [10] ishte një veprim i mirëmenduar dezinformimi për nxitje zemërimi dhe mobilizimi në luftë kundër shqiptarëve: *"Shefi i Shërbimit Sekret të Serbisë, Radomir Marković, që shpresonte të përfitonte nga hedhja e përgjegjësisë te të tjerët, nxori në shesh sekretin më të madh shtetëror: vrasja e djelmoshave serbë dhe malazezë në kafenenë "Panda" në Pejë ishte organizuar nga shefi i Beretave të Kuqe".*

Kjo ishte një praktikë e përdorur shpesh nga forcat serbe, ndaj e shohim edhe në raste të tjera, konkretisht: *"I shqetësuar nga veprimet e forcave tona, doktori (Branimir Gijokiqi) kishte kërcënuar komandant Nenad Stojkovićin se, kur të kthehej në Serbi, do të tregonte çdo gjë që kishte parë. Dy ditë më vonë, polici Goran Stamenković, i cili rrinte gjithmonë afër komandantit, e vrau doktorin. Disa minuta pas vrasjes u lëshua kumtesë zyrtare, që ishte përpiluar paraprakisht, në të cilin thuhej se doktori ishte vrarë heroikisht në përleshje me forcat terroriste të UÇK-së. [11]*

Në këtë kuadër mendojmë që vepra *"Eskadronët e vdekjes: kronika e një kasaphane"*, vjen si një mburojë që na mbron dhe nuk na lejon të biem pre e manipulimeve mediatike e politike, të përhapura shpejt dhe gjerësisht sidomos nga zhvillimi digjital i viteve të fundit përmes rrjeteve sociale, por jo vetëm. Është me rëndësi që ngjarjet e rrëfyera në vepër të njihen nga publiku, të vijojnë të dokumentohen, që të tregojnë

dimensionin e vërtetë të asaj që ka ndodhur për të ndarë viktimën nga abuzuesi, rolin nga pushtuesi, të vetëmbrojturin nga armiku, përndryshe rrezikon që ngjarjet dhe e vërteta të tjetërsohen dhe rrezikon që raportet të përmbysen sërish në kurriz të viktimave, madje ndodh që armiku të trajtohet si hero dhe viktimat si armik. Dhe kjo absolutisht nuk duhet të lejohet për asnjë arsye, marrëveshje apo përfitim politik.

Kur flasim për të vërtetë kemi parasysh ngjarje makabre që përjetuan dhe u përballën njerëz të pafajshëm në tokën e vet: *“...para se t’ia përplasja derën, i thashë se ata nuk kanë vdekur, por i kemi vranë në shtëpitë e tyre.[12]* Janë bombardimet, vrasjet, abuzimet, torturat, plaçkitjet, janë terrorët e natës dhe shtëpitë e djegura, janë varret masive, gjymtyrët e thyera të shqiptarëve në burgjet serbe, janë trupat që digjen në shkretore dhe kamionët frigoriferikë, me të cilat njihemi në vepër përmes rrëfimeve: *“Kufomat e zhvarrosura i ngarkuam në kamionin frigoriferik...[13]* Në familjen Gërxfaliu të këtij fshati, në sy të prindërve kishin vranë njëri pas tjetrit 7 fëmijë të mitur, pastaj kishin ekzekutuar prindërit e fëmijëve dhe, në fund, gjyshen plakë... Ndërkaq, vetë në shtëpinë e familjes Pasoma të Vushtrrisë u vranë 64 persona. [14]

Të vërtetat e mizorive të kryera rrjedhin ndër vite, siç rrjedh edhe rrëfimi me formën e zgjedhur të shkrimit, që të çon me shpejtësi nga një gjendje në një tjetër, nga një ngjarje në një tjetër, nga një abuzim në një tjetër, nga një torturë në një tjetër, nga një varr në një tjetër. Nëse njihemi me to, mund të ndërtojmë themele të forta të kujtesës kolektive, të cilat e qetësojnë një shoqëri që ka nevojë të shohë para dhe të zhvillohet, një shoqëri me vlera dhe parime, që është e vetëdijshme për të shkuarën e vet dhe nuk e shkel të vërtetën saj. Nëse të vërtetat nuk njihen si duhet dhe nuk vijon procesi i drejtësisë, atëherë kjo shoqëri do të vazhdojë të jetojë me të kaluarën dhe me traumat e saj, pasi zërat e viktimave të së shkuarës nuk mund të heshtin në ndërgjegjen e tyre.

Dihet që në shoqëritë e “postmizorive” [15], dhuna e së shkuarës vijon të luajë një rol të veçantë jo vetëm në të tashmen, por edhe të ardhmen dhe, në thelb, drejtësia tranzicionale dhe parandalimi janë masat që duhet të marrë një shoqëri për të kapërcyer vuajtjen, për të nderuar dhe kujtuar viktimat e së shkuarës, dhe për të jetuar në të tashmen pa mbartur në shpatulla të shkuarën dhe fajtorët e saj. Përndryshe, nëse

ngjarjet nuk dokumentohen dhe nuk trajtohen si duhet, por manipulohen, risku i nxitjes së pakënaqësive dhe rikthimit të ngjarjeve të dhunshme sërish në të tashmen do të jetë gjithmonë i pranishëm. Një popull që ka kaluar një gjenocid mund ta kapërcejë peshën e vdekjes dhe terroreve, por nuk e toleron abuzimin me të vërtetën dhe tjetërsimin e saj.

Ndaj ritheksojmë rëndësinë e dokumentimeve, që tregojnë me vërtetësi atë që popullit iu desh të kalonte dhe jo atë që interesat ekonomike, gjeopolitike apo ndërkombëtare parashikojnë. Ndaj besojmë se njohja me të vërtetën, përballja me të, është një proces i rëndësishëm që duhet të ndodhë njëherë dhe përgjithmonë, si një proces thelbësor në ndërtimin e paqes dhe shoqërive demokratike. Është detyrë e të gjithëve ne, qytetarëve të thjeshtë, gazetarëve, dëshmitarëve, studiuesve, gjyqtarëve, politikanëve, ndërkombëtarëve që të vijojmë zbardhjen e ngjarjeve të ndodhura për të ndërtuar të vërtetën me të gjitha dimensionet e saj, pa u frikësuar dhe pa u ndier të kërcënuar nga askush. “Shpaliri” [16] ndaj popullit shqiptar nuk duhet të zgjasë përjetësisht. [17] E vërteta e shqiptarëve nuk mund të mbetet mes shpalirëve serbë dhe të dhunohet e tjetërsohet prej tyre.

Kronika e një kasaphane është kronika e një gjenocidi që nuk u parandalua

Kur flasim për gjenocid, kemi parasysh që gjatë Luftës së Dytë Botërore, nazistët gjermanë kryen krime të tmerrshme, që askush nuk dinte si t’i përkufizonte. Në këtë kontekst, juristi polak me origjinë hebraike, Rafael Lemkin, krijoi fjalën *gjenocid*, si neologjizëm, duke përdorur fjalën greke *genos*, që do të thotë *fis*, dhe prapashtesën latine *cide*, që do të thotë *vrasje (akti i vrasjes)*, çështje e trajtuar gjerësisht në veprën e tij: “*Axis rule in occupied Europe*” [18], e publikuar më 1944. Sipas tij, me *gjenocid* do të kuptojmë *një plan të koordinuar veprimesh të ndryshme, me qëllim shkatërrimin e themeleve thelbësore të jetës së grupeve kombëtare, popujve, me synim asgjësimin e tyre*. Objektivat e një plani të tillë ishin shpërbërja e institucioneve politike e shoqërore, e kulturës, e gjuhës, e ndjenjave kombëtare, fesë, ekonomisë, po ashtu shkatërrimi i sigurisë personale, lirisë, shëndetit, dinjitetit dhe, madje, edhe jetës së individëve që u përkasin këtyre grupeve. Gjenocidi

drejtohet kundër grupit kombëtar si ent dhe veprimet e përfshira drejtohen kundër individëve jo si individë, por si anëtarë të grupit kombëtar. [19]

Mirëpo u desh të përfundonte Procesi i Nurembergut, që çështja e përkufizimit të krimeve të kësaj natyre të shtrohet në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në seancën plenare të pesëdhjetë e pestë të mbajtur më 11 dhjetor 1946, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën, në të cilën gjenocidi cilësohet si *“mohimi i së drejtës për ekzistencë për grupe të tëra njerëzish, në të njëjtën masë siç është homicidi mohim i së drejtës së një individi për të jetuar”*... *“Është krim i së drejtës ndërkombëtare, i cili i ka shkaktuar humbje të mëdha njerëzimit”* duke *“shkatërruar tërësisht ose pjesërisht grupe racore, fetare, politike ose grupe të tjera”*. Si i tillë, *“gjenocidi është në kundërshtim me frymën dhe qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe i dënueshëm nga e tërë bota e civilizuar”* [20].

Prandaj Asambleja e Përgjithshme e OKB-së *“ftoi shtetet anëtare, që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme legislative për të parandaluar dhe dënuar këtë krim; rekomandoi të organizohet bashkëpunimi ndërkombëtar i shteteve, me qëllim që të ndërmerren sa më shpejt masa parandaluese kundër krimit të gjenocidit dhe ta lehtësojnë ndëshkimin e tij”* [21], ndaj më 9 dhjetor 1948 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, që shënon një moment kyç në formësimin e së drejtës penale ndërkombëtare.

Në vijim të zhvillimit të akteve normative të së drejtës penale ndërkombëtare u miratua Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare [22] dhe në fund, më 2010, edhe teksti i tretë themelor juridik i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Elementet e Krimeve [23].

Në përkufizimin e krimit të gjenocidit sipas Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe Statutit të Romës, karakteristikë e krimit të gjenocidit është *“vënia në shënjestër e një grupi kombëtar, etnik, racial ose fetar, me qëllim që të shkatërrohet, tërësisht ose pjesërisht, grupi si i tillë”*. Për të shmangur spekulimet lidhur me numrin e krimeve të kryera, që një akt të cilësohet si gjenocidal, teksti themelor *“Elementet e krimeve”* saktëson se aktet gjenocidale të

numëruara në paragrafët a), b), c), d) dhe e) duhet të jenë kryer kundër një ose më shumë personave, me qëllim që të shkatërrohet, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si i tillë.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe saktësimet juridike hapën mundësinë që të rritet ndërgjegjësimi ndërkombëtar se “*gjenocidi i ka shkaktuar humbje të mëdha njerëzimit*”.

Gjenocidi në Kosovë ishte një “gjenocid i paralajmëruar”, nëse u referohemi ngjarjeve të ndodhura edhe më herët se ato të vitit 1998 dhe fqinjësisë gjithnjë të tensionuar mes Serbisë dhe Kosovës. Sinjale paralajmëruese dhe “flamujt e kuq alarmantë”, që i paraprijnë një lufte si ajo me të cilën u përball Kosova, kanë qenë gjithmonë të pranishme, pasi kemi parasysh krimet e tmerrshme që kanë bërë serbët që nga koha e kryengritjes së parë dhe të dytë serbe të fillimshekullit XIX; shkatërrimi i tërësishëm i çdo gjëje që lidhet me identitetin e shqiptarëve të Sanxhakut të Nishit në periudhën 1877-1879; krimet monstruoze gjatë luftërave ballkanike 1912-1913; krimet ndërmjet dy luftërave botërore; krimet në përfundim të Luftës së Dytë Botërore dhe krimet gjatë tërë periudhës që i parapriu shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë ishin indicie të mjaftueshme se ndodheshim përpara një “gjenocidi të paralajmëruar”. Prandaj me të drejtë shtrohet pyetja: *përse nuk u ndërmorën të gjitha masat e nevojshme dhe zgjidhjet efikase, marrëveshjet e nevojshme, politikat e duhura që i ndalonin konfliktet mes popujve, qofshin këto konflikte etnike, sociale, ekonomike apo gjeopolitike?*

Nga sa përmendëm është e qartë që gjenocidi në Kosovë nuk ndodhi menjëherë dhe brenda një nate, por erdhi si pasojë e marrëdhënieve konfliktuale, të cilat ishin “faktorët e riskut” që u anashkaluan dhe nuk u vlerësuan si duhet nga politikëbërësit kombëtarë e ndërkombëtarë, faktorët e riskut që duhet të ishin identifikuar dhe parandaluar para se konflikti të kalonte në mizori masive, por kjo nuk ndodhi për interesa të njohur dhe të panjohur për popullin. Ndaj gjenocidi ka fajtorë, po aq sa ka viktimat, dhe fajtorët duhet të përballen me dënimet.

Shpesh refuzohet termi *gjenocid* për atë çka ndodhi në Kosovë, ndaj është me rëndësi të vlerësohet fakti, që autori përpiket të japë dimensionin e vërtetë të ngjarjeve të ndodhura përmes dëshmive të

renditura, të cilat janë të shumëllojshme dhe cekin forma nga më të ndryshme të abuzimit, mes të cilave:

- **Plaçkitje dhe vrasje fëmijësh:** *Në kohën kur bëhej ndarja e njerëzve në dalje të një fshati në Klinë, Cërnë nga Z. iu afrua një burri të moshuar, që mbante në krahë një fëmijë 3-4 vjeç. I shkuli fëmijën nga krahët dhe me thikën në fytyrë e fëmijës i kërkoi 20 000 marka gjermane, që ta linte gjallë. I thyer nga pafuqia për të mbrojtur fëmijën, shqiptari nxori rreth 5000 marka, aq sa kishte. Cërnë e kapi fëmijën prej flokësh dhe ia preu kokën...[24] Si i çmendur kërkoi të nxirrnin çdo gjë me vlerë që kishin fshehur, përndryshe të gjithë do t'i shkonte në thikë...[25]*

- **Bombardime, bastisje dhe pushkatime:** *Gjithë mburrje, Dejani na tregoi si e kishin bombarduar fshatin tërë ditën dhe tërë natën dhe se në mëngjes kishin gjetur mijëra familjarë terroristësh të strukur në një lug. Pasi kishin bërë bastisjen e tyre dhe u kishin marrë çdo gjë me vlerë, për të mos pasur mundësi t'i këmbenin me armë, kishin ndarë të aftit për pushkë dhe ua kishin dorëzuar eskadronëve të vdekjes. Nga këta kishin veçuar 33 vetë, të cilët i kishin dërguar në një kanal rreth 200 m më larg, në afërsi të pyllit. I kishin detyruar të ktheheshin në drejtim të pyllit dhe u kishin thënë të iknin. "Askush nuk zbatoi urdhrin dhe në luftë moszbatimi i urdhrin parasheh dënimin me pushkatim," - na tha me tallje Dejani.[26]*

- **Përdhunime, shtëpi dhe trupa të shkrumbuar:** *Në brendi të shtëpisë gjërmadhë, ku trarët dukeshin si zorë nëpër këmbë, kundërmonte erë gjaku dhe gome të djegur. Në "dhomën e argëtimit", siç e quajti Dragani një hapësirë me mure të shkrumbuara, kishin shpëtuar pa u djegur tërësisht katër kufoma vajzash të reja, të cilat "kishin shërbyer" deri në momentin e vrasjes... [27]*

- **Varreza masive dhe zhvarrime:** *Për shkak të baltës së madhe, ekskavatori nuk mund të hynte në vendin ku ishin varrosur 127 kufoma. Zhvarrimin e bënë ushtarët dhe policët që na shoqëronin dhe 6 punëtorë të Ndërmarrjes Komunale të Pastrimit. Në dy kamione frigoriferikë ngarkuam baltë e kufoma pleqsh, grash, fëmijësh dhe i nisën në drejtim të Mitrovicës. [28]*

- **Tortura për pranim akuzash të rreme:** *Ti nuk e ke idenë sa e kam dëshiruar vdekjen. Gjithmonë më kanë mbyllur në dhoma, ku as vetëvrasje nuk ke mundësi të bësh... Më kanë lidhur me pranga këmbë e duar, pastaj nëpër hundë më kanë futur sondën deri në lukth; në vend të ushqimit më kanë dhënë gjëra që nxitin diarrenë... E kupton pse e kam pranuar kryerjen e veprave që nuk i kam bërë apo dëshiron të dëgjosh edhe gjëra të tjera?* [29]

- **Fshehje të kufomave:** *Me mburrje i kishte thënë Zokit, se pjesën më të madhe të eshtrave të shkrumbuara i kishin hedhur në lumin Drin i Bardhë, ndërsa mbetjet e tjera mortore, të përziera me hirin e shtëpive, i kishin groposur shtatë pashë nën dhe.* [30]

- **Poshtëtime dhe tortura të shqiptarëve në burg:** *Në mbërme na nxirrnin individualisht nga dhoma “për të pastruar korridorin” dhe pasi na shtrinin në dysheme, na tërhqnin zvarrë, që ta fshinin dyshe-menë me trupin tonë. Goditjet më të shpeshta me shkelma na i bënë në zonën pranë veshkave dhe çdo mëngjes na pyesnin nëse na kishin ardhur të përmuajshmet. Në fillim kujtuam se ishte përpjekje për të na fyer dhe për të na poshtëruar, por pas një jave torturash të përditshme filluam të urinonim gjak. Atëherë e kuptuam për çfarë të përmuajshmesh e kishin fjalën.* [31]

- **Dëbime në funksion të spastrimit etnik** [32]: *Pasi u morëm të gjitha gjërat me vlerë, njerëzit që u përzgjodhën për atë botë, i vramë brenda shtëpive, u vumë zjarrin katundeve, ndërkaq gratë dhe fëmijët i vumë si bagëtinë para dhe u dhamë urdhër që të shporreshin në Shqipëri.* [33]

- **Dezinformim:** *Kulmi arriti më 26 shtator, ditën kur mbusha 24 vjeç. Pas dy ditësh përpjekje, më në fund depërtuam në fshatin Obri. Pasi spastruam terrenin, njësitë speciale të policisë e morën situatën në dorë. Si fitimtarë që ishim, parakaluam disa herë rrugicave të fshatit, që nuk kaloheshin më këmbë nga gërmadhat. U ndalëm në dalje të fshatit, në drejtim të pyllit. Nga pylli dëgjoheshin britma grash dhe fëmijësh, që bëheshin gjithnjë e më të fuqishme. Edhe pse nuk i shihnim, zëri i tyre përcillte trishtim, që ne vetëm mund ta imagjinonim. Pas gjysmë ore të gjitha britmat u ndalën. Më pas një grup komandosh të policisë dolën nga pylli, në mesin e të cilëve*

dallova Tozon, tezakun tim nga fshati P... Në mbrëmje me disa shokë të mi kralevas festuam fitoren dhe ditëlindjen time njëkohësisht. Në orët e vona me ne u bashkua edhe Tozoja. Në një çast gjatë mbrëmjes më tërhoqi mënjanë tejet i shqetësuar. Kishte parë tmerr. Tundte kokën në shenjë mohimi dhe thoshte me zë të ulët: “Kjo nuk duhej të ndodhte, tezak! Foshnjën disamuajsh e vranë në gjoksin e nënës, bashkë me nënën; bënë shoshë fëmijën 2-vjeçar, që thithte cullën nga uria! Nuk është trimëri të vrasësh fëmijë, gra, pleq, plaka... Një grua ishte shtatzënë... Jo, jo, kjo nuk duhej të ndodhte! Po bëhemi njëlloj si terroristët... Ishte i pikëlluar dhe i zhgënjyer tej mase. Pas dy ditësh erdhi të më takojë. Kishte marrë gazetën “Jedinstvo”[34]. E hapi në faqen ku ishte artikulli që donte të më tregonte dhe, duke tundur kokën, më tha ta lexoja. Në atë shkrim përgënjeshtrohej propaganda antiserbe, që kishte përhapur të pavërtetat se gjoja njësitë e policisë sonë speciale kishin vranë 28 civilë shqiptarë në fshatin Obri. Artikulli theksonte se një gazetar i “Kohës ditore” kishte bërë fotomontazh të një kukulle të përgjakur, me cucëll në gjoks, për të krijuar përshtypjen se kishim të bënë me një fëmijë të vranë. Madje i kishin vënë emrin Valmir Deliu! Por, gazetarët tanë e kishin zhveshur në tërësi gënjeshtren e tyre dhe kërkonin përgjegjësi nga ata që njoftosnin imazhin e luftës sonë... Nuk janë normalë këta njerëz! – më tha Tozoja . –Në vend që të kërkohet falje dhe të nxirren përpara përgjegjësisë ata që kanë bërë këtë akt të shëmtuar, gazetarët tanë e vrasin për së dyti këtë foshnjë, duke shfaqur pamjen e lemerishme si të ishte një skenë nga teatri i kukullave! [35]

Nga dëshmitë e sipërpërmendura dhe një seri e konsiderueshme dëshmish të rrëfyera në vepër na krijohet qartësisht tabloja e një gjenocidi [36] të mirëfilltë, që nuk mund t’i vendoset emër tjetër dhe nuk mund të tjetërsohet nga asgjë. Por ngjarjet makabre të rrëfyera mund ta vendosin lexuesin e brezave të ardhshëm në provën e së vërtetës apo trillimit, pasi janë ngjarje që shkojnë përtej asaj çka mendja njerëzore mund të konceptojë, dhe mosnjohja mirë e ngjarjeve rrezikon të çojë në dyshimin e tyre dhe pranimin e varianteve të tjera, që mund ta zvogëlojnë peshën e madhe që iu desh të mbante mbi supe një popull i pafajshëm.

Ndaj shkrimi i sa më shumë veprave të tilla dhe trajtimi me seriozitetin e duhur i tyre, njohja me personazhet reale të cituara, verifikimi i rrëfimeve dhe dëshmime (pjesa më e madhe del e vërtetuar me dokumente) [37] është domosdoshmëri, të cilat na tregojnë se fatkeqësisht ky ishte realiteti, i cili nuk u parandalua në kohën e duhur para se të kryheshin aktet mizore. Autori Bardhyl Mahmuti nuk ngurron të pasqyrojë në vepër verifikimet dhe vërtetësinë e ngjarjeve të rrëfyera, ndër të cilat mund të përmendim: *“Zhvarrosjet në këtë qendër nxorën në dritë, se vëllezërit Bytyqi ishin vrarë me duar të lidhura me tel pas shpinës, me sy të mbyllur me shirit, ndërsa në pjesën e pasme të kokës kishin plagë të shaktuara me armë zjarri. Ministria e Brendshme njoftoi se, tani për tani, në varrezat masive të kësaj qendre kishin gjetur 60 kufoma civilësh shqiptarë të ekzekutuar me armë zjarri, 9 kufoma të personave të mbytur me sende jo të mprehta dhe për 8 raste nuk dihen shkaqet e vdekjes.* [38]

Nga dokumentimet në vepër është qartësisht e kuptueshme, që gjenocidi është më shumë sesa thjesht dëmtim apo shkatërrim fizik i një populli, ndaj parandalimi dhe ndëshkimi i krimeve të gjenocidit është një detyrim i përcaktuar qysh në Konventën e vitit 1948, ku përcaktohet qartë se me “gjenocid” kuptohet cilindo nga aktet e mëposhtme, të kryera me qëllim shkatërrimin, tërësisht ose pjesërisht, të një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar, të tilla si: *vrasje; lëndim i rëndë i integritetit fizik ose mendor, shkatërrim fizik tërësisht ose pjesërisht; vendosja e masave për të parandaluar lindjet; transferimi me forcë i fëmijëve* [39] dhe sa e sa akte të tjera, që i duhen shtuar kësaj konvente për rastin e Kosovës.

Pavarësisht se qysh më 1948 është folur shumë për rëndësinë e procesit të parandalimit të masakrave masive të njohura me termin “mass atrocity” dhe rëndësinë e evidentimit në kohë të risqeve dhe sinjaleve paralajmëruese, edhe pse mjaft të dukshme dhe alarmante, sërish gjenocidi ndodhi, ndaj natyrshëm na lind pyetja: *pse nuk u parandalua zhvillimi i një gjenocidi të tillë të paralajmëruar, të ndodhur në zemër të Ballkanit dhe në mes të Europës, dhe pse vendimet politike e strategjitë ndërkombëtare prodhuan akte të tilla dhune dhe vrasje? A kishim të bënim me vendime të parashikuara apo lojëra politike?*

“Millan F-ja e filloi rrëfimin e tij kështu: “Nuk më ka shkuar në mend, që Brigada e 37-të do të transferohej tërësisht nga Rashka në Kosovë. Sidomos jo në kohën kur pritej t'i vihej kapaku çështjes së Kosovës. Transferimi i forcave shtesë një javë para se të fillonte faza përmbyllëse e bisedimeve në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë, na dukej si strategji politike për të shtuar presionin ndaj shqiptarëve, që ta pranonin marrëveshjen. Por kur ata nënshkruan marrëveshjen në ndërkaq refuzuam të bënim të njëjtën gjë: e kuptuam që nuk kishim shkuar në Kosovë për lojë politike”.[40]

Ngjarjet makabre në vepër na përplasen para syve në çdo moment, të tronditin e të mposhtin emocionalisht dhe po aq të revoltojnë për politikat e tejzgjatura dhe gjyqet e ngelura pezull për dënimin e fajtorëve. Patkonjtë, kamioni frigoriferik, shpaliri, llamba e kufomave janë disa nga monstruozytet e kryera, por *“operacioni cezarian pa anestezi”* ndaj një gruaje shtatzënë në muajin e tetë, që i shkulin fëmijën prej barku dhe e ngulin në tehun e mprehtë të thikës embrionin që ende s'arriti të merrte frymën e parë dhe trajtimi i këtij embrioni si trofe lufte dhe heroizma ushtarakë, tregon qartë se kush e kreu gjenocidin dhe kush ishte viktimë.[41]

Në konventën e sipërpërmendur theksohet se *“personat që kryejnë gjenocid ose ndonjë nga aktet e tjera të renditura më sipër do të dënohen, qofshin ata pushtetarë përgjegjës kushtetues, zyrtarë publikë apo individë”*. [42] Natyrshëm na lind pyetja: *përse ende sot zvarriten proceset gjyqësore për të dënuar shkaktarët e këtij gjenocidi? Përse vonohet dënimi i tyre?* Sepse, fatkeqësisht, me kohën ngjarjet mund të fshihen, të tjetërsohen dhe të interpretohen nëse të vërtetat nuk thuhën. Sepse pushtetet politike kërkojnë herë pas here marrëveshje, bashkëpunime që cenojnë popullin e thjeshtë, ndaj dakordësohemi me shprehjen, se politika është vazhdimi i luftës me mjete të tjera, që në dukje nuk e dëmtojnë fizikisht individin, por me pasoja që mund ta rëndojnë po aq sa lufta një komb në të ardhmen.

Pesha e rëndë e fjalës së lirë në veprën e Bardhyl Mahmutit

Liria e fjalës dhe e shprehjes së mendimit paraqet të drejtën themelore të njeriut, e cila ka rol thelbësor në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave

të tjera. Mundësia për t'u shprehur mendimi dhe për t'u shkëmbyer informacioni paraqet tregues të vlefshëm për kapacitetin demokratik dhe pozicionin institucional të demokracisë në shoqëritë. [43]

Pas Luftës së Dytë Botërore, baza juridike për lirinë e shprehjes vendoset me aktet themelore të OKB-së, siç është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut nga viti 1948, e cila konsiderohet si dokument themeltar juridiko-ndërkombëtar për standardet e të drejtave të njeriut dhe vlen për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. Neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut nga viti 1948: *Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.* [44]

Ndaj duhet të theksojmë se vepra na fton në reflektimin, se në një shtet që pretendon të jetë demokratik, që i shmang situatat konfliktuale dhe respekton mendimin e lirë, askush nuk duhet të etiketohet si trim apo i çmendur për të vërtetat që thotë dhe askush nuk duhet të ndihet i kërcënuar për fjalën e lirë.

Por qysh në fillim të rrëfimit, autori na tregon qartë se me çfarë shteti kemi të bëjmë, duke na përballur me rrezikun që i kanoset vetë gazetarit serb Mifi L., që foli për “lotët e fëmijëve në Kosovë”, që denoncoi terrorin serb mbi shqiptarët e pafajshëm, që shkroi mbi të bardhë, të zezat e vërteta dhe tmerruese, dhe me qëndrimin e tij profesional kundërshtonte aktet e dhunës në Kosovë e nuk pranonte tjetërsimin e ngjarjeve dhe, për më tepër, i ngjallnin neveri “heroizmat” dhe manipulimet e veprave të bashkëkombësve të vet.

Një tjetër dokument që shpjegon lirinë e shprehjes dhe elementet e saj, është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, i cili parashikon se: “1. Askush nuk mund të procedohet për shkak të mendimeve të veta 2. Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë, pavarësisht kufijve, nënkupton lirinë e kërimit, marrjes dhe përhapjes së informatave dhe ideve të të gjitha llojeve gojarisht, me shkrim, të shtypur ose në formë artistike, ose në çdo mënyrë tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Realizimi i

lirive, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përfshin detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta...[45]

Përmes ngjarjeve të rrëfyera autori na tregon se as ky dokument nuk është marrë në konsideratë dhe kërcënimet ndaj fjalës së lirë në vepër dalin në forma nga më të ndryshmet dhe Mifi L. i duhet të përballet me:

- Etiketim i trim ose i çmendur: *Ishe çuditur pse i kisha publikuar në emrin tim gjëra që të gjithë i dinë. Madje më quajte “të çmendur” për publikimin e atij shkrimi! Dëgjo, Grujo, të gjitha rreziqet i kam marrë parasysh, para se të bëja një veprim të tillë. Nuk e di nëse jam “i çmendur”, “trim” apo “frikacak”, por s’jam nga ata që hedhin gurin dhe fshehin dorën. Në ndërgjegjen time nuk mund të duroja klithmat, lotët dhe gjakun e civilëve të pafajshëm të Kosovës. [46]*

- Përballjen me fatin e kolegëve të tij: *Në këtë çast ktheu fotografitë dhe i vendosi me kujdes në mes të tavolinës. Pamjet e Sllavko Quruvijës, me fytyrë të mbuluar me një pellg të madh gjaku, ishin të tmerrshme.[47]*

- Kërcënime për jetën e fëmijëve të tij: *Lëri marrëzitë dhe mos merr në qafë familjen! Ke djalin adoleshent dhe, si të gjithë adoleshentët e botës, ka dëshirë të stimulojë adrenalinën. Prandaj, tani që jemi duke hyrë në verë, mos u habit nëse hidhet nga ura e Glavçiqevës mbi lumin Ibër dhe thyen zverkun në rërë... Mund të bëjë edhe aksident me motor, ngase të rinjtë janë të apasionuar pas motorëve... Mos e përjashto mundësinë që edhe vajza të dehet dhe, nën ndikimin e alkoolit, të hidhet nga ballkoni i banesës së saj, apo të bëjë mbidozë heroine, për shkak të heroizmit tënd... [48]*

- Këshilla miqësore për heshtje: *I dashur Mifi, kam informacione se “bisha” është tërbuar, kur ka marrë vesh që ato të dhëna janë publikuar në shtypin perëndimor. Të lutem, bëj kujdes për veten tënde dhe mendo edhe për ne të tjerët... [49]*

Por fjala e lirë karakterizohet edhe nga revolta, ndaj në revoltën e tij Mifi L. shpreh: *“Në vend që të arrestohen ata që kanë vrarë pleq, gra, fëmijë dhe civilë në Kosovë, ju ma keni sjellë shpirtin në majë të hundës, për të treguar kush më ka rrëfyer për krime të tilla! Në vend që t’u ktheni familjarëve mijëra kufoma njerëzish të pafajshëm që i keni lënë pa varr në Kosovë, ju përpiqeni të më shtini të gjallë në varr dhe më akuzoni për shpifje dhe përhapës gënjeshtresh! Në vend që të dënohen urdhëruesit e*

bombardimeve nga aeroplanët tanë të kolonave civile shqiptare që dëboheshin për në Shqipëri, ju kërkon të zbuloni kush ishin ata që nuk paskan recituar propagandën tuaj për të fajësuar NATON-n...[50]

Xhon Stjuart Mili thotë: *“Liria e shprehjes na mbron nga pushteti i korruptuar dhe tirania. Kjo liri është një nga garancitë themelore për shoqëri të hapur dhe pluraliste.*[51] Ndaj përpjekjen e Mifi L. për të treguar të vërtetën e shohim edhe si përpjekje për ta mbrojtur nga tirania popullin shqiptar të Kosovës, por edhe për ta shpëtuar vendin e tij (Serbinë) “nga diktatura”. Mendimi i lirë karakterizohet nga drejtësia dhe dhembshuria, ndaj para padrejtësive zëri i lirë nuk duhet të heshtë: *“Kam ngritur zërin për lotët e fëmijëve në Kosovë, për t’i treguar botës se ka serbë që i dënojnë ato krime të shëmtuara”.* [52]

Por pavarësisht qëllimeve dhe idealeve të tij të larta, autori na njeh në vepër me torturat dhe tmerrin që Mifi L. iu desh të përjetonte pas marrjes në hetuesi në vendin e tij, pikërisht sepse nuk pranoi të heshte ndaj padrejtësive dhe refuzoi të manipulonte të vërtetën. *“Më kaploi një ndjenjë paniku, që nuk e kisha përjetuar kurrë më parë: dridhesha nga brenda, ndërsa çdo qelizë e trupit prodhonte energji të ftohta frike... Më paskan sjellë në duart e eskadronëve të vdekjes...”* [53]

Autori e ka parapërgatitur lexuesin me faktin, se kush e zotëronte guximin e fjalës së lirë, do të përballej me format dhe mënyrat e ndëshkimit të beretëkuqve, të prezantuar si *eskadronët e vdekjes, tigrat, çakejtë, akrepat, grerëzat e verdha...* ndaj përmes rrëfimitarit shprehet se *“...sa më shumë dëgjoj për krimet e pushtetit tonë, aq më shumë bindem, se vërtet nuk e paskam ditur se çfarë janë në gjendje të bëjnë.* [54] Por, nëse shprehja e lirë hesht nga frika dhe nuk do të karakterizohej pikërisht nga mendimi kritik dhe revolta, atëherë edhe ajo do të binte pre e grackës së udhëheqësve dhe do të përtypej me të njëjtin “çamçakëz” politik. *“Një gazetar që përtyp copën e çamçakëzit që i ka dhënë prokurori dhe nga ky çamçakëz fryn përpara turirit të tij balonën që ia mbulon surratin, nuk është gazetar, por hije e prokurorit...”* [55]

Po ashtu, autori në vepër cek edhe pozicionin e intelektualëve serbë: *“Përveç kolegëve të “Danasit”, atyre të Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë dhe ndonjë gazetari aty-këtu, shumica e gazetarëve dhe e intelektualëve të Serbisë heshtnin.* [56] *Prokurori yt paska*

publikuar një shkrim kundër teje dhe të prezantuaka si “spiun i huaj” dhe “përhapës gënjeshtresh”! ... Sjellje e tillë e intelektualëve është e pështirë. [57]

Në vepër tregohet forca edhe guximi i jashtëzakonshëm i gazetarëve shqiptarë të Kosovës, të cilët ishin të vetëdijshëm se për mendimin e tyre të lirë, do të përballeshin me rrezikun, por nga ana tjetër besonin fort se heshtja ishte terrori vetë. Personazhi Sadik Z. [58], ndërkohë që ndan të njëjtën qeli me Mifi L., i rrëfen atij se për fjalën e lirë, që në thelb mishëron drejtësinë, shqiptarët e Kosovës kanë sakrifikuar edhe frymën e fundit... *“Edhe pse luftonim kundër shtetit tënd, sikur ta kishe njohur Nazmi Muzlijajn, do të kishe parë se si një jurist dhe gazetar lufton deri në frymën e fundit për çlirimin e vendit të vet. [59] Kam një brengë të madhe që më rëndon në shpirt: nuk di asgjë për fatin e Muhamet Mavrajt, Ernest Lumës, Petrit Musollit dhe gazetarëve të tjerë që kemi punuar bashkë... Ishin gazetarë, që asnjë presion politik e policor nuk mundi t’i detyronte të hiqnin dorë nga përkrahja e luftës për një botë të re!” [60]*

Sadiku ishte intelektual i ri, fati i të cilit ishte lidhur me zinxhirë... *“Në këtë udhëtim për diku gjetkë, fatin tonë e kishin lidhur me zinxhirë” [61]. Student i juridikut dhe njëkohësisht gazetar, i rrëfen Mifit se “paralelisht me studimet për juridik, punoja si gazetar në gazetën studentore “Bota e re”. Krahas shkrimeve nga terreni dhe analizave politike, kryeredaktori i gazetës sonë, Muhamet Mavraj, mori përsipër të ribotonte gazetën “Zëri i Kosovës”, që dilte jashtë vendit dhe që ishte e vetmja gazetë që mbronte politikisht UÇK-në. Për ju që keni jetuar jashtë Kosovës, janë të pakapshme përmasat e kësaj sfide që iu bë pushtetit në atë kohë. Të mos harrojmë se, mjaftonte të konstatohej që kishte kontakte me Adnan Asllanin dhe Lulëzim Etemajn, që udhëhiqnin punën e “Zërit të Kosovës”, dhe pasojat ishin të paparashikueshme!” [62]*

Mifi L. është gazetari intelektual, që nuk heshti për atë çka ndodhi në Kosovë dhe profilin e tij intelektual autori e dokumenton edhe përmes çmimeve të ndryshme ndërkombëtare: *“Ai ishte shpallur “Gazetari european i vitit 2000” nga “Net Media” britanike, laureat i “Çmimit për lirinë e shtypit”, që ndahet nga Shoqata e Shkrimtarëve të Gjermanisë dhe çmimi “Gazetari më i mirë për publikimet në internet” nga ana e*

“British press awards”, që për nga vlera në gazetari konsiderohet si çmimi “Oskar”. [63] Përmes kontributit të Mifi L. për rrëfimin dhe dokumentimin e ngjarjeve, për fjalën e lirë dhe rebelimin e tij, pa marrë parasysh rrezikun që i kanosej atij dhe familjes së tij, autori nxjerr në pah se Mifi ishte intelektual jashtë radhëve politike, ishte intelektual i që gjykonte, vepronte me mendjen e tij dhe nuk propagandonte çka i servirej nga pushteti.

Gjatë leximit të veprës nuk mund të mos kuptojmë, që mes rreshtave kemi edhe përjetimin personal të autorit, dhe veprat e Bardhyl Mahmutit janë kontributi dhe fjala e tij e lirë që kaloi në peripeci dhe vuajtje, dënime dhe dhunë, por nuk heshti, përkundrazi po vijon t’u tregojë brezave të rinj të vërteta drithëruese. Intelektualët e vërtetë e dinë që presionet e formave të ndryshme politike e policore mund të dhunojnë fizikun, por jo fjalën, ajo mbetet e pacenuar dhe e paprekur. Ajo merr jehonë dhe kapërcen kufizimet dhe hekurat, brenda të cilëve mund të kufizohen, ndaj ne *“besojmë fort, se fjala e lirë dhe guximi intelektual mund të ndryshojnë fatin e një kombi...”*

Reflektim

Vepra e Bardhyl Mahmutit është shumëdimensionale: ajo është roman, studim, kronikë, dokumentar, është një provë e domosdoshme informimi dhe një mburojë e rëndësishme, që do të pengojë dezinformimin, sidomos për brezat e rinj që nuk i kanë përjetuar apo njohur mirë ngjarjet e ndodhura.

Vepra është thellësisht tronditëse, por të fton në reflektim përmes procesit njohës, përmes renditjes së të dhënave, dëshmimeve, ballafaqimeve, rrëfimeve nga disa këndvështrime:

- ushtarët serbë krenarë me “heroizmat” e tyre; ushtarët serbë të turpëruar nga veprimet e tyre dhe manipulimi mediatic,
- gazetari serb që përjetoi torturën nga bashkëkombësit e vet,
- të rinj dhe studentë shqiptarë që po vuajnë dënimet në burgjet e Serbisë.

Të gjitha rrëfimet përputhen me pohimin: *Askush që nuk e ka parë me sytë e vet, nuk mund ta marrë me mend tmerrin që mbizotëroi në Kosovë.* [64]

Përmes personazhit kryesor, autori na udhëzon se është e rëndësishme, që *rrëfimet e Sadikut, Vllaznimit dhe dëshmitarëve të tjerë nuk duhet të mbeten në heshtje, por duhet të dalin përtej hekurave të burgut dhe duhet t'u jepet zë, pavarësisht kërcënimeve.* Rrëfimet janë sytë që u japin brezave të tjerë pamjen e ngjarjeve, ndaj dëshmitarët kanë rëndësi të veçantë në ndërtimin e kujtesës kolektive të një vendi në kërkim të drejtësisë tranzicionale.

Të ngresh zërin për të njohur të vërtetat nuk do të thotë që do të zhbësh të shkuarën, por që po përpiqesh të parandalosh përsëritjen e të njëjtave veprime në të ardhmen; nuk do të thotë që do të ringjallësh viktimat, por do të thotë t'i kujtosh dhe nderosh ata dhe të dënosh fajtorët; nuk do të thotë që do të kthesh foshnjat në jetë, por do të thotë të sigurosh vazhdimësinë e një kombi. Fshehja e së vërtetës i jep fuqi Hidrës mitologjike që përmend personazhi Jovo në libër dhe bën që të shfaqen sërish *përbindësja të tjerë, që do të gëlltisnin ardhmërinë e fëmijëve tanë!* [65]

Procesi i përballjes me të vërtetën për brezin që e përjetoi dhe brezat pas tij, është një proces që nuk ndodh menjëherë, që kalon nëpër faza që plotësojnë kriteret me veprime konkrete. Kur flasim për të vërtetën, nuk kemi parasysh vetëm njohjen e saj nga individët, por edhe nga institucionet e posaçme kombëtare dhe ndërkombëtare, komisionet e posaçme të së vërtetës [66], që e verifikojnë, dokumentojnë dhe mbrojnë atë.

Fuqia intelektuale nuk është arma dhe dhuna, por fjala dhe mendimi i lirë kritik, është krijimi i mundësive për ta bërë të njohur të vërtetën që nuk duhet të harrohet, pasi kanë klithur fëmijë, të rinj, gra e pleq, dhe *mizoritë e gjejnë rrugën e britmave*, ndaj është e pamundur të heshtësh.

Përshkrimet në vepër janë të tmerrshme, por siç nënvizohet në rreshtat e përgjakura të saj, *krimet janë edhe më të tmerrshme se përshkrimet...* [67], ndaj duhet të flasim, pasi “e vërteta që nuk thuhet, tretet dhe shuhet”.

Referenca

1. Cutter, P., De Greiff, P. and Waldorf, L. (2009), *Disarming the past: Transitional Justice and Ex-Combatants*, NY: Social Sciences Research Council.
2. Në vepër, f. 508.
3. Në dëshminë e tij, Stojanović rrëfente hollësisht për rastin, kur një pjesëtar i çetës së tyre i kishte prerë kokën një burri dhe një gruaje shqiptare. Më pas saktësonte nxjerrjen e dhëmbëve prej ari dhe zierjen e kokave. Kur kishte përfutur kafkat, i kishte lyer ato me llak dhe i kishte shndërruar në abazhurë tavoline... f. 452.
4. Në vepër, f. 64.
5. Mahmuti Bardhyl, *Eskadronët e vdekjes: Kronikë e një kasaphane*, janar 2021, f. 7.
6. Davis, L. (2009), *Transitional Justice and Security System Reform*, Initiative for Peace building, NY: ICTJ
7. <http://auschwitzinstitute.instructure.com/courses/335/pages/transcript-transitional-justice>
8. Fletcher, L. et al. (2009), Context, timing, and the dynamics of transitional justice: A historical perspective, *Human Rights Quarterly*, 31 (1): 163-222.
9. <http://auschwitzinstitute.instructure.com/courses/335/pages/transcript-transitional-justice>
10. Në vepër, f. 496.
11. Mahmuti Bardhyl, *Eskadronët e vdekjes: Kronikë e një kasaphane*, janar 2021, f. 81, (referuar në vazhdim, po në vepër).
12. Në vepër, f. 135.
13. Në vepër, f. 76.
14. Në vepër, f. 78.
15. Post atrocity.
16. Masë ndëshkuese e dhunshme, që mbizotëroi në shumë ligje ushtarake deri në shekullin XIX.
Në mes të korridorit të burgut, dy rreshta gardianësh, njëri përballë tjetrit, kishin bërë një korridor të gjatë dhe me shkopinj bejsbolli kishin krijuar shpalirin serb, f. 289.
17. Kalimi nëpër “shpalir” zgjaste përjetësisht, *Mifi! Megjithëse i*

rraskapitur, në çastet kur torturoheshin më të moshuarit, lutesha t'i kaloja unë vuajtjet e tyre. Por ato nuk ishin këmishë që zhvishen e vishen sipas dëshirës sonë! f. 290.

18. Lemkinn R., Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation, Analysis of Government, Proposals for Redress, Lawbook Exchange, Ltd. 2008.

19. The road of the Genocide Convention: Raphael Lemkin Seminar for Genocide Prevention.

https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocity-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf

20. United Nations, General Assembly / The Crime of Genocide. English: A_RES_96(I)-EN, PDF; Français: A_RES_96(I)-FR-PDF. f. 188-189.

<https://digitallibrary.un.org/record/209873>

Cituar nga Bardhyl Mahmuti, *Krimi i gjenocidit - Aspekte teorike dhe studime rastesh*, Origjina e nocionit gjenocid (2)

<https://kosovogenocide.com/origjina-e-nocionit-gjenocid-2/>

21. Po aty.

22. Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, i datës 17 korrik 1998, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2002. Në vijim do të përdoret shkurtimisht: Statuti i Romës. <https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/NR/rdonlyres/ADD16852-AEE9-4757-ABE7-9CDC7CF02886/283948/RomeStatuteFra1.pdf>.

23. Dokumentin zyrtar i miratuar në Konferencën për Rishikimin e Statutit të Romës, mbajtur nga 31 maj-11 qershor 2010 në kryeqytetin e Ugandës, në Kampala.

Cour Pénale Internationale, Textes juridiques fondamentaux, Éléments des crimes,

<https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/Publications/Elements-des-crimes.pdf>.

24. Në vepër, f. 63.

25. Në vepër, f. 64.

26. Në vepër, f. 73.

27. Në vepër, f. 75.

28. Në vepër, f. 74.

29. Rrëfimi i Vllaznimit, në vepër, f. 181.
30. Në vepër, f. 96.
31. Rrëfimi i Sadikut, në vepër, f. 287.
32. “Heronjtë tanë” që projektuan “Planin Patkoi” për spastrimin etnik të Kosovës, u përkujdesën edhe për “dekorin” e skenës ku u luajt tragjedia shqiptare. Madje, në planet e tyre nuk kishin harruar as kamionët frigoriferikë të thertoreve, që duhej të “spastronin” skenën e kasaphanës. Në vepër, f. 472.
33. Në vepër, f. 89.
34. E përditshme në gjuhën serbe që botohej në Prishtinë.
35. Në vepër, f. 60.
36. “Plani Patkoi” shërbeu si dëshmi e ekzistencës së projektit të gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë dhe hodhi poshtë për përpjekjet e regjimit të Millosheviqit, që për krimet e kryera në Kosovë. të hiqte përgjegjësinë nga vetja. duke fajësuar eskadronët e vdekjes, të prezantuar si gjoja “grupe paramilitare jashtë kontrollit të shtetit”! Në vepër, f. 469.
37. *Besoj se e ke marrë vesh, që u publikua një dëshmi për kamionin frigoriferik që bartte kufoma nga Kosova. Pohimet e zhytësit profesionist, Zhivorad Gjorgjeviç, vërtetojnë atë që ke thënë ti dhe kjo do të na shërbejë si dëshmi për të hedhur poshtë pjesën e akuzës për gjoja shpifje që ke bërë ti.* Në vepër, f. 433.
Përveç këtyre deponimeve, avokati kishte siguruar nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Beograd listën e identitetit të mbi 1300 fëmijëve dhe të mbi 1700 grave shqiptare të vrara në Kosovë dhe kjo u vinte kapakun akuzave ndaj meje. Në vepër, f. 442.
38. Në vepër, f. 447.
39. https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf.
40. Në vepër, f. 69.
41. Në vepër, f. 94.
42. https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf
43. <https://www.osce.org/files/f/documents/0/1/116609.pdf>

44. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së, numër: 217(III), më 10.12.1948 <http://www.un.org/en/documents/udhr/>.
45. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, neni 11 “Liria e shprehjes dhe informimit: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/fc583291-b51a-445f-987a-ee24ad1d8f3e>.
46. Në vepër, f. 21.
47. Në vepër, f. 23.
48. Në vepër, f. 23.
49. Në vepër, f. 23.
50. Në vepër, f. 337.
51. <https://www.thefire.org/research-learn/john-stuart-mills-enduring-arguments-free-speech>.
52. Në vepër, f. 299.
53. Në vepër, f. 45.
54. Në vepër, f. 104-108.
55. Në vepër, f. 280.
56. Në vepër, f. 377.
57. Në vepër, f. 280.
58. Personazhi Sadik Z. është gazetari Sadik Zeqiri, që u mbijetoi tmerreve dhe aktualisht është kryeredaktor i gazetës “Epoka e re”.
59. Në vepër, f. 282.
60. Në vepër, f. 281.
61. Në vepër, f. 292.
62. Në vepër, f. 281.
63. Në vepër, f. 413.
64. Në vepër, f. 71.
65. Në vepër, f. 428.
66. Freeman, M. (2006), *Truth Commissions and Procedural Fairness*, NY: Cambridge University Press.
67. Në vepër, f. 442.

BIBLIOGRAFI

1. Cutter, P., De Greiff, P. and Waldorf, L. (2009), Disarming the past: Transitional Justice and Ex-Combatants, NY: Social Sciences Research Council.
2. Davis, L. (2009), Transitional Justice and Security System Reform, Initiative for Peace building, NY: ICTJ
3. Dokument zyrtar i miratuar në Konferencën për Rishikimin e Statutit të Romës mbajtur nga 31 maj-11 qershor 2010 në kryeqytetin e Ugandës, në Kampala. Cour Pénale Internationale, Textes juridiques fondamentaux, Éléments des crimes, <https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/Publications/Elements-des-crimes.pdf>
4. Fletcher, L. et al. (2009), Context, timing, and the dynamics of transitional justice: A historical perspective, Human Rights Quarterly, 31 (1): 163-222.
5. Freeman, M. (2006), Truth Commissions and Procedural Fairness, NY: Cambridge University Press
6. <http://auschwitzinstitute.instructure.com/courses/335/pages/transcript-transitional-justice>
7. https://eudocs.lib.byu.edu/index.php/Memorandum_of_the_Serbian_Academy_of_Sciences_and_Arts
8. <https://www.osce.org/files/f/documents/0/1/116609.pdf>
9. https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf
10. Lemkinn R., Axis Rule in Occupied Europe: Laws of Occupation, Analysis of Government, Proposals for Redress, Lawbook Exchange, Ltd. 2008.
11. Mahmuti, B., *Eskadronët e vdekjes: Kronikë e një kasaphane*, janar 2021 f. 104-108
12. Mahmuti, B., Mashtrimi i madh, Çabej, 2015.
13. Mahmuti, B., *Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Në shënjestër të vazhdueshme*, “Epoka e re”, 2024.

14. Serbian Academy of Arts and Sciences (SANU) Memorandum, 1986, in World History Commons, <https://worldhistorycommons.org/serbian-academy-arts-and-sciences-sanu-memorandum-1986>.

15. Snyder, J. and Vinjamuri, L. (2004), “Advocacy and Scholarship in the Study on International War Crime Tribunals and Transitional Justice”, Annual Review of Political Science, 7: 345-362.

16. Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, i datës 17 korrik 1998, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2002. Në vijim do të përdoret shkurtimisht: Statuti i Romës. <https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/NR/rdonlyres/ADD16852-AEE9-4757-ABE7-9CDC7CF02886/283948/RomeStatuteFra1.pdf>

17. Shala Xh., “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe në vitet 1912-1918”, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1990.

18. The road of the Genocide Convention: Raphael Lemkin Seminar for Genocide Prevention; <http://auschwitzinstitute.instructure.com/courses/335/pages/transcript-transition-justice>

19. United Nations, General Assembly / The Crime of Genocide. English: A_RES_96(I)-EN - PDF; Français: A_RES_96(I)-FR-PDF. f. 188-189. <https://digitallibrary.un.org/record/209873>
Cituar nga Bardhyl Mahmuti, *Krimi i gjenocidit-Aspekte teorike dhe studime rastesh*, Origjina e nocionit gjenocid (2) <https://kosovogenocide.com/origjina-e-nocionit-gjenocid-2/>.

8. 2. PETER TASE

SHABAN MURATI: KROACIA ËSHTË ALEATI KRYESOR I SHQIPËRISË NË BE

Ambasadori Shaban Murati ka kryer një kërkim të gjerë mbi politikën e jashtme shqiptare dhe për aleatët e saj strategjikë në Europën Juglindore, veçanërisht për partneritetin në rritje të vazhdueshme midis Tiranës dhe Zagrebit.

Më 15 nëntor 2023, Fondacioni Çamëria “Hasan Tahsini” promovoi në Tiranë librin emblematic të Shaban Muratit, me titull: “Shqipëria dhe Kroacia - aleanca e nevojshme” [“Aleanca e duhur Shqipëri-Kroaci”], ku ish-presidenti i Kroacisë, Stjepan “Stipe” Mesić dha një mesazh mbështetës, së bashku me prof. dr. Bamir Topin, ish-president i Shqipërisë.

Sipas kryetarit të Fondacionit Çamëria “Hasan Tahsini”, z. Alket Veliu: *“Ky libër po del në një periudhë shumë kritike dhe pozitive për marrëdhëniet ndërmjet Kroacisë dhe Shqipërisë”*. Veliu vlerësoi angazhimin e Muratit për forcimin e pranisë së shërbimit të jashtëm shqiptar në rajon dhe krijimin e lidhjeve të qëndrueshme mes qeverive të Shqipërisë dhe Kroacisë, gjatë njëzet viteve të fundit.

Në këtë ngjarje historike, kryetari Alket Veliu i dhuroi ish-presidentit Stipe Mesić Medaljen e Argjendtë “Mbështetës i Madh i Kombit Shqiptar”.

“Albania and Croatia, the Necessary Aleance” (*Aleanca e duhur Shqipëri-Kroaci*) është libri i parë dhe i vetëm i shkruar nga një ekspert shqiptar i marrëdhënieve ndërkombëtare, i cili fokusohet ekskluzivisht në marrëdhëniet aktuale midis Kroacisë dhe Shqipërisë dhe në përpjekjet e vazhdueshme diplomatike, negociatat ndërkombëtare dhe rolin pragmatik të Kroacisë në Ballkan që nga shpallja e pavarësisë më 25 qershor 1991 e deri më sot.

Ky libër përmban analizë profesionale diplomatike të Shaban Muratit, shkruar gjatë njëzet viteve të fundit, kushtuar ekskluzivisht politikës së jashtme të Kroacisë dhe zbatimit të saj në rajonin e Ballkanit, duke

trajtuar marrëdhëniet e Zagrebit me vendet e tjera të Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë.

Analiza e portretizuar fokusohet në zhvillimet më domethënëse të diplomacisë dhe politikës së jashtme kroate, dhe rolin e saj pozitiv në zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve rajonale, duke ruajtur një stabilitet afatgjatë në rajon. Boshti kryesor në analizën e ambasadorit Murati janë marrëdhëniet e veçanta mes Shqipërisë dhe Kroacisë, një partneritet që ai e vlerëson në një kontekst më të gjerë diplomatik, historik, në koncepte gjeopolitike dhe strategjike, duke fuqizuar ngritjen e marrëdhënieve strategjike midis Shqipërisë dhe Kroacisë.

Përvoja e tij personale si një diplomat i nivelit të lartë është pasqyruar në kërkimet dhe analizat në këtë libër, duke theksuar një politikë të jashtme më realiste dhe efikase shqiptare, të krijuar brenda një aleance strategjike me shtetin kroat. Të dyja kombet janë anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe ruajnë një miqësi historike, që është konsoliduar gjatë shekujve, veçanërisht e zbuluar përmes shkrimit të Milan Šufflay-t, albanolog dhe gjuhëtar i njohur kroat me origjinë hebreje.

Interesi diplomatik dhe perceptimi gjeopolitik i ambasadorit Shaban Murati i kushton një vëmendje të veçantë nevojës së Shqipërisë për të krijuar një aleancë të fortë strategjike me Kroacinë, nisur nga fakti se administrata e Edi Ramës ka ndryshuar kurs dhe ka zhvilluar marrëdhënie më të mëdha ekonomike dhe politike me Serbinë, duke i lejuar kësaj të fundit të përshpejtojë më tej agjendën e saj ekspansioniste, revanshizmin, operacionet subversive në pjesën tjetër të Europës Juglindore.

Murati zbulon aspektet e ndërlikuara të marrëdhënieve delikate, të ndjeshme dhe të vakëta që ekzistojnë midis Kroacisë dhe Serbisë, gjatë periudhës së pasluftës, marrëdhëniet midis Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës dhe bashkëpunimi midis Kroacisë dhe Sllovenisë, që janë argumente të forta se përse Shqipëria duhet të ndryshojë menjëherë kursin me krijimin e një kuadri më të madh bashkëpunimi me shumë shtresa me qeverinë kroate.

Kosova është një kapitull tjetër, që në thelb përfshin një angazhim më të madh të Shqipërisë me Kroacinë, drejt ruajtjes së shoqërive

demokratike dhe rritjes së nivelit të sigurisë rajonale përmes bashkëpunimit më të ngushtë.

Ambasadori Shaban Murati mban qëndrimin intelektual, se kriza e Jugosllavisë vazhdon të mbahet në jetë, shumë konflikte dhe tensione ndëretnike janë të gjalla dhe kërkojnë zgjidhje kohezive; se shovinizmi serb ndodh kundër të gjithë popujve të Ballkanit, si dhe politikat lehtësuese të Europës ndaj Beogradi e bëjnë këtë skenar mjaft të komplikuar për t'u zgjidhur në afat të shkurtër.

Sipas Arta Dades, ish-ministre e Punëve të Jashtme të Shqipërisë (2001-2002), *“libri i ambasadorit Murati pasqyron mirëkuptimin e tij të thellë për këtë rajon, veçanërisht marrëdhëniet e Bashkimit European me Ballkanin, duke përfshirë edhe rolin e çdo vendi në këto organizata shumëpalëshe. Unë e kam vlerësuar gjithmonë bashkëpunimin e tij gjatë kohës që kam shërbyer si drejtor i Çështjeve Rajonale, gjatë mandatit tim si ministre e Punëve të Jashtme. Udhëzimet e Muratit janë pa dyshim një pikë referimi, se ku Shqipëria duhet të ketë prioritet zbatimin e politikës së saj të jashtme dhe të krijojë një qëndrim të ri ndaj aleatëve të saj tradicionalë rajonalë”*.

Beqir Ismaili, drejtor i Akademisë Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës shprehet: *“Ambasadori Murati dhe kërkimet e tij në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare po udhëheq gjeneratën e re të diplomatëve në një terren shumë të rëndësishëm, që ka aq shumë degëzime në politikën rajonale dhe çështje të sigurisë globale.”*

Më 2 tetor 2023, Presidenti Zoran Milanović zhvilloi një takim me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, i cili ndodhej për një vizitë zyrtare në Republikën e Kroacisë. Gjatë vizitës së tij në Zagreb, kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim të gjerë me kryeministrin Andrej Plenković. Ky i fundit kujtoi se *“bashkëpunimi tregtar mes dy vendeve arriti në 170 milionë euro, por të dy vendet fqinje janë thellësisht të interesuara për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ekonomik”*. Dy kryeministrat diskutuan gjithashtu për bashkëpunimin në sektorin e energjisë dhe projektet e infrastrukturës, me theks në *Korridorin Adriatik-Jon*.

Kryeministri Plenković u shpreh se *“Kroacia ka vendosur të financojë ndërtimin e korridorit që kalon nëpër territorin e saj, ndërsa Tirana është në proces nënshkrimi të kontratës për segmentin kryesor të korridorit përmes Shqipërisë”*.

Plenković theksoi edhe një herë, se Kroacia mbetet një mbështetëse e fortë dhe konsekuente e rrugës së Shqipërisë drejt BE-së: *“Kjo është koha kur agresioni i Putinit kundër Ukrainës përshpejtoi procesin e zgjerimit, BE-ja e shikon në një mënyrë krejtësisht tjetër”*, përfundoi kryeministri kroat. Vizita zyrtare e kryeministrit Rama në Zagreb është një çështje me rëndësi të madhe në politikën e jashtme bashkëkohore shqiptare, ndërsa Tirana dhe Zagrebi kanë një potencial në rritje për bashkëpunim dhe duhet të punojnë së bashku për të reduktuar ndikimet e recensionit gjeopolitik, për të shfrytëzuar rritjen ekonomike dypalëshe dhe zhvillimin industrial.

* **Peter Tase** është një autor dhe gazetar i pavarur në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, çështjeve aktuale të Amerikës Latine dhe Kaukazit Jugor. Ai është autori i librit të parë të Amerikës, të botuar mbi thesaret historike dhe arkeologjike të Republikës Autonome të Nakhçivanit (Republika e Azerbajxhanit). Ka botuar katër libra mbi politikën e jashtme dhe ngjarjet aktuale ekonomiko-politike të Qeverisë së Azerbajxhanit. Tase ka shkruar për marrëdhëniet ndërkombëtare për *“Eurasia Review Journal”* që nga qershori i vitit 2012. Ai është bashkëpunëtor i Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë.

8.3 DR. SKËNDER DEMALIAJ DHE DR. DRITAN HOTI

Vendi, roli, detyrat dhe misioni i shqiptarëve në gjeopolitikën postmoderne

Libri i dr. Sadri Ramabajës “Rivaliteti shekullor – Gjeopolitika postmoderne: Rikthimi te vetvetja”, Onufri & ISHGJ, Tiranë 2024, f. 486.

Gjeopolitika përpiket të shpjegojë zhvillimin politik e shoqëror të një vendi me kushtet gjeografike dhe të përligjë politikën agresive e pushtuese me mospërputhjen e popullsisë me hapësirën gjeografike. Sipas Klaus Dodds: “*Gjeopolitika fokusohet te roli i territoreve, resurseve dhe gjeografisë fizike në formimin dhe zhvillimin e shteteve*”. [1]

Të udhëhequr nga këto formulime teorike, shteti serb ka pushtuar dhe tjetërsuar territore shqiptare që nga viti 1862 e në vazhdim. Këtë e ka realizuar me metoda brutale, nisur nga parimi famëkeq i Çubrilloviçit: “*Kur fuqia e një shteti dëshiron të ndërhyjë në interes të elementit të vet në luftën për tokën, kjo mund të ketë sukses vetëm kur veprohet brutalisht*”. [2]

Kosova është e pasur me minerale të çmuara dhe të shumëllojshme, ka tokë pjellore, fusha dhe rezerva të mëdha hidroenergjetike. Burimet natyrore dhe ushqimore janë elemente kyç në përcaktimin e gjeopolitikës dhe në sigurimin e interesave ekonomike dhe strategjike të vendit.

Për shtetin serb spastrimet etnike ishin mjetet kryesore për të realizuar programin për një “*Serbi të Madhe*” dhe “*të pastër etnikisht*”. Vetëm të bashkuar, me dhunë, me gjak, me metodat më antihumane, të ngjashme me ato të regjimit hitlerian për shfarosjen e hebrenjve, do të realizonin pastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë. Simboli i tyre ishte një kryq dhe 4 shkronja S: “*Samosloga Srbinasprasova*” (*Vetëm bashkimi i shpëton serbët*).

Foljen “*Oçestiti*” - *me pastrue*, emrin – *të pastruarit* e ka përdorur Vuk Karaxhiq për të treguar shfarosjen dhe dëbimin e popullatës joserbe. [3]

Gjenocidi përmbledh të tria të këqijat: racizmin, dhunën për shkak të ndryshimit mes palëve dhe dhunën si pasojë e mendjengushtësisë. **Çfarë krimi mund të jetë më i tmerrshëm sesa gjenocidi? Nëse nuk e dallojmë zhdukjen e planifikuar të një populli si tmerrin e tmerreve, atëherë cili është qëllimi i shekullit të njëzetë?** [4]

Gjatë luftërave që serbët kanë zhvilluar, ka përlindur koncepti dhe programi koherent dhe ambicioz i shtrirjes tokësore. Spastrimi është një nga mjetet e përdorura për të zbatuar programin dhe për të realizuar një Serbi “homogjene” dhe “të pastër e të kulluar”. Sipas Ilia Garashanin: “*Historia na thotë dhe na tregon qartë, se për t’i salduar më mirë territoret e aneksuara, për të realizuar një bashkim sa më homogjen që të jetë e mundur, ky operacion na paraqitet në dy etapa: fillimisht ekspansioni, pastaj homogjenizimi*”. [5] Edhe Memorandumi i ASHS-së i vitit 1986 sugjeronte që serbët duhet të jetonin në një vend unik dhe të vetëm.

Në të gjitha platformat serbe prevalon ideja, se vetëm “pastërtia etnike” mund të sigurojë paqen dhe progresin e Serbisë. Për Dobrica Qosiqin siguron jo vetëm paqen, por edhe demokracinë. Në librin e tij “Çështja serbe”, botuar në vitin 1991 në Francë, ai “Me fjalën “demokraci” kupton të drejtën e “popullit serb”... në realizimin e qëllimit të tij final dhe historik “unifikimin e të gjithë serbëve në një shtet të vetëm”. [6]

Objektivi nuk është vetëm të mbrohet serbizimi, por edhe të spastrohet territori nga elementi joserb, sepse kështu realizohet aspirata për një shtet serb të fortë dhe të zgjeruar. Libri trajton me kompetencë shkencore çështje që lidhen me gjeopolitikën postmoderne, ku në fokus janë edhe shqiptarët, veçanërisht ata të Kosovës.

Libri i autorit Sadri Ramabaja ka shtatë kapituj:

1. Gjeopolitika dhe shqiptarët.
2. Rivaliteti shekullor.
3. Mes Perëndimit dhe Lindjes.
4. Agjenda e munguar e BE-së.
5. Rusia përballë Perëndimit.
6. Lufta hibride.
7. Rendi i ri botëror në krijim.

Në të gjithë këta kapituj të librit përvijohen ide dhe koncepte interesante në lidhje me rolin dhe peshën e gjeopolitikës mbi çështjen shqiptare. Dhe ato janë:

- Çfarë është gjeopolitika, elementet përkufizues të saj.
- Evoluimi i gjeopolitikës dhe interferencat e këtij fenomeni në përcaktimin e çështjeve kombëtare në Ballkan.
- Gjeopolitika e fuqive historike europiane si përcaktuese në trajtat historike të çështjes shqiptare.
- Gjeopolitika e Luftës së Ftohtë si pamundësi e realizimit të një objekti madhor kombëtar përgjatë kësaj epoke.

Në kapitujt pasues të punimit paraqiten nocione, që kanë të bëjnë me nisjen e zgjidhjes së çështjes shqiptare nëpërmjet etapave të njëpasnjëshme.

Këndvështrimi i autorit është shumëdimensional, por edhe orientues, se çfarë duhet të bëjnë shqiptarët në vazhdim:

- Hartimi i një strategjie të përbashkët. Jemi para ndryshimit esencial të rendit politik, përmbysjes së rendit global. Autori shtron pyetjen: *Nëse do të jemi dhe sa do të jemi në gjendje ta transformojmë potencialin tonë të brendshëm në fuqi integruese dhe garantuese të sigurisë në rajon dhe më gjerë, duke përfshirë një ndryshim strategjik në mentalitet.*
- Gjeopolitika cilësohet si *“shkenca që qëndron në kufijtë mes gjeografisë, shkencave politike, historisë dhe shkencave sociale”*.
- Porosia e autorit është: BE-ja nuk duhet të përqendrohet e tëra tek Ukraina, duke i lënë hapësirë të lirë veprimi Rusisë dhe satelitëve të saj. Analizon luftën në Ukrainë dhe pasojat e saj gjeopolitike për BE-në, dështimin e politikës gjermane dhe franceze jo vetëm në raport me Rusinë e Putinit, por edhe me Beogradin e Vuçiqit dhe ky dështim nuk është gjë tjetër, veçse dështim i politikës së jashtme të BE-së.
- Rikthimi te vetvetja, sidomos pas leksioneve që mund të nxirren nga lufta e Ukrainës, është i natyrës urgjente edhe për shqiptarët. Pra, përpjekjet e Vladimir Putinit për restaurimin e

Rusisë imperiale të epokës së Pjetrit duket se do të prodhojnë efekte pozitive në rrafshin gjeopolitik.

- Prania e fuqishme ushtarake e SHBA-së në të dyja republikat tona është garancia më e fuqishme e ndalimit të çfarëdo projekti sllav për rikthim të mundshëm, së paku për aq kohë sa nuk do të kemi një ushtri unike të fuqishme.

- Është koha t'u jepet fund përkëdhelive dhe të fillohet një politikë e re me Serbinë. Afrimi me Serbinë dhe Rusinë nuk ka se si të cilësohet si hap strategjik për ruajtjen e paqes në Europë. Dështimi i aleancës gjermano-ruse, e cila po gatitej në heshtje për disa dekada rresht, ku u parapriu gjeoekonomia dhe lufta në Ukrainë, e ka rikthyer në vëmendje çështjen shqiptare.

- Strategjia shqiptare: marrëdhënie të mirë me SHBA-në, me Bllokun Transatlantik, krijimi i "*Aleancës së sigurisë*" me SHBA-në, Shqipërinë, Britaninë e Madhe, Kroacinë etj., derisa Kosova të arrijë anëtarësimin e plotë në NATO. Aleanca e sigurisë Kosovë-SHBA është një zgjidhje e ndërmjetme.

- Veriu i Kosovës - interesi jetik i kombit.

- Mungesa e bllokimit ndaj Beogradit tregon mungesë ekuilibri dhe moskoherencë strategjike. Pse Serbia mund të shihet si një sfidë për paqen në Europën Juglindore? Pasojat e luftës në Jugosllavi, marrëdhëniet etnike, mosnjohja e pavarësisë së Kosovës, politika e jashtme dhe marrëdhëniet me fqinjët, procesi i integritetit në BE.

- Nacionalizmi agresiv serb bazohet në tri shtylla: tek imperializmi rus, klerofashizmi dhe patriarkalizmi ekstrem, autokracia tipike serbe. Serbia mund të detyrohet të marrë pjesë në "denazifikimin" e Ballkanit.

- Refuzimi i planit franko-gjerman nga Serbia - një hap më afër luftës.

- Krijimi i Republikës së dytë shqiptare nuk është vullnet i shqiptarëve, por vetë kompromisi dhe me këtë fakt, duhet të pajtohet ndërkohë edhe Beogradi.

- Koncepti i ri i politikës së jashtme serbe ushqen pretendimin e elitës serbe për rikthimin e hegjemonisë në rajon.

Kursi i bazuar në mitet historike dhe idealet ortodokse. Elita serbe është hedhur në aksion për afrimin e Serbisë me Perëndimin. Koncepti i ri i politikës së jashtme serbe është produkt i kësaj elite.

- Rikthimi te Lufta e Ftohtë na kthen gjithashtu te “loja pa rregulla”.

